

**KRAHASIMI I GJYKIMEVE MORALE ME
PERCEPTIMET E VLERAVE TE STUDENTËT
(E ARSIMIT TË LARTË)**

Fatih Ufuk Bağcı

Dorëzuar:
Universiteti Evropian i Tiranës
Shkolla Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës pranë Fakultetit të Shkencave dhe Edukimit, me profil pedagogji, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Prof. Dr. Kseanela Sotirofski

Numri i fjalëve: 73.520

Tiranë, Korrik 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në të gjithë tezën, nga fillimi deri në përfundimin e saj, u jam përmbajtur rregullave akademike me rreptësisht të gjitha të dhënat e saj janë përftuar dhe pasqyruar në përshtatje me kuadrin e rregullave akademike dhe sjelljes etike. Gjithashtu, në këtë punim të përgatitur në përputhshmëri me rregullat e shkrimit të tezës, deklaroj se në rastet kur kam përfituar nga veprat e autorëve të tjerë, i kam referuar në përshtatje me rregullat akademike.

ABSTRAKTI

Fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar shënoi një tjetër stad të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, e cila do të përballej me një tjetër mënyrë jetesë, me të tjera kushte sociale. Lënia pas e një regjimi totalitar bëri që shqiptarët të mbusheshin me shpresën për një të ardhme krejt ndryshe, me mendimin se gjithçka do të ndryshonte, por nga ana tjetër, sfidat e së ardhmes askush nuk mund t'i përfytyronte.

Një ndër tiparet kryesore që shoqëroi shoqërinë shqiptare në vitet e para të periudhës paskomuniste, por që vazhdoi edhe më vonë, ishte largimi i një pjesë të konsiderueshme të popullatës nga zonat me lartësi më të mëdha drejt ultësirave. “U populluan në mënyrë intensive dhe fillimisht kaotike periferitë e qyteteve të mëdha, në radhë të parë ato të Tiranës. Po kështu një pjesë e mirë e shqiptarëve i hynë aventurës së emigracionit duke zbuluar territore dhe hapësira të banuara nga kombe e kultura të tjera.”(Fuga, 2013, f. 9)

Kemi studiuar (anketuar) studentë, të cilët jetojnë në të njëjtin vend, por që janë rritur me një frymë të ndryshme kulture dhe edukimi. Këta studentë janë analizuar, nëse kanë apo jo ndryshime midis qasjes së gjykimeve morale dhe vlerave të tyre. Me metodën krahasuese kemi përcaktuar faktorët që ndikojnë në formimin dhe ndryshimin e tyre si dhe bashkëveprimin që kanë këta faktorë me njëri-tjetrin.

Bazën teorike të këtij studimi e përbën një nga qasjet më të rëndësishme të zhvillimit moral: *Teoria e zhvillimit moral*. Për këtë arsye, bazuar në teorinë e zhvillimit njohës moral të Kohlbergut, për përcaktimin e nivelit të moralit të studentëve që studiojnë në universitetet shqiptare, kemi paraqitur (kryer) këtë studim.

Për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur testin e përcaktimit të vlerave DIT (Defining Issues Test), i zhvilluar nga James Rest (1979) në përcaktimin e niveleve

të zhvillimit moral, si një variabël i varur. Ndërsa si variabël të pavarur kemi përdorur formularin personal, i zhvilluar nga kërkuesi për të përcaktuar disa veçori individuale.

Hipoteza bazë e studimit është *ekzistenca e një lidhjeje mes ndjenjës, mendimit dhe sjelljeve morale me disa faktorë psiko-socialë efektivë në procesin e zhvillimit moral të studentëve*. Është përcaktuar nëse ekzistojnë ndryshime midis variablave të pavarur, si: *universitetet, departamentet, gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, nëse prindërit janë në jetë apo jo, niveli arsimor i prindërve, qëndrimet e prindërve, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, studenti e ka kaluar kohën më të gjatë të jetës në qytet apo fshat, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë, lidhja e prindërve me fenë dhe lidhja e studentëve me fenë*, si edhe nivelet e pjekurisë morale të studentëve.

Subjekt i këtij studimi janë 1851 studentë nga Universiteti i Tiranës, universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, universiteti “Fan S. Noli” në Korçë. Këta studentë studiojnë në programe të ndryshme dhe janë përzgjedhur me metodën *random* të përzgjedhjes.

Në përfundim të studimit është përcaktuar se niveli i pjekurisë morale të studentëve që studiojnë në universitetet shqiptare, sipas teorisë së gjykimit moral të Kohlberg, *është në nivelin tradicional*. Gjithashtu, vërehet ekzistenca e një lidhjeje në mes ndjenjës, mendimit dhe sjelljeve morale me disa faktorë psiko-socialë efektivë në procesin e zhvillimit moral të studentëve të universitetit.

Fjalët kyçe: zhvillimi moral, aftësia e gjykimit moral, universitet, studentë

ABSTRACT

The early 90's of the last century marked another stage of development in the Albanian society. It faced another lifestyle with different social conditions. Albanians were full of hope for a different future after experiencing a totalitarian regime. They thought that everything would change, but on the other hand no one could predict the challenges of the future.

One of the main features of the Albanian society in the early years of post-communist period was the change in the internal demography for a considerable percentage of the population. The population was leaving the highlands towards the lowlands. "It was so intense and it continued even after those early years. Initially the suburbs of major cities were populated in a chaotic way, especially the city of Tirana. Likewise, a good percentage of Albanians started the immigration adventure to discover territories and areas inhabited by other nations and cultures. (Fuga, 2013, f. 9)

So by taking this situation into consideration, through this study it was analysed whether there were any differences between the approaches of moral judgments and their values regarding the students who live in the same country but are brought up with a different cultural and education background. We tried to determine the factors affecting their formation and change by using a comparative method. The interaction of these factors with each other was also analysed.

The theoretical aspect of this study is considered an important approach related to moral development, called Theory of Moral Development. For this reason, we are trying to present a study based on the Theory of Moral Development of Kohlberg.

So, we focused on determining the level of moral for students who study in Albanian universities.

As a tool for data collection we used the values determining test DIT. (Defining Issues Test) developed by James Rest (1979) in determining the levels of moral development, as a dependent variable. Whereas as an independent variable we used a personal form developed by the researcher to determine some individual features.

The main hypothesis of the study is about the existence of a relation between feeling, thought, and moral behavior with some effective psycho-social factors in the process of moral development of the university students. It was determined whether there were any differences between independent variables such as: *universities, departaments, gender, age, class, statute of parents, if parents are still alive or not, parents educational degree, parents attitudes towards their children, parents economic situation, profession of their parents, the region where the students come from, whether students spent most of their life in rural or urban region, type of high school students graduated from, the inculsion of a course related to the moral values in the pre-university curricula, whether they have acquired the values of the society they are living, parents affiliation to religion, students affiliation to religion and the students level of moral maturity.*

The subject of this study are 1851 students of University of Tirana, Aleksandër Moisiu University in Durrës, Alexandër Xhuvani University in Elbasan, Luigj Gurakuqi University in Shkodra, and Fan Noli University in Korçë. These students are actually studying in various programs and are selected by random selection method.

At the end of the study it was determined that the level of moral maturity of the students who study in Albanian universities according to Kohlberg moral judgment

theory is in traditional level. Also it is noticed the existence of a relation between feelings, thought and moral behaviours with some effective psycho-social factors in the process of moral developments of the students.

Key words: Moral Development, Moral Judgment Ability, Universities, University Students.

FALENDERIME

Falenderoj udhëheqësen e këtij punimi, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, e cila me personalitetin energjik dhe profesionalizmin e saj ka qenë burim morali dhe motivacioni për mua, duke më udhëzuar, mbështetur dhe ndihmuar vazhdimisht pa u kursyer në të gjitha fazat e këtij punimi. Falenderoj edhe z. Uğur Aslan, i cili më ka ndihmuar në përlogaritjen e anketave dhe nxjerrjen e rezultateve nga këto anketa. Gjithashtu, falenderoj të gjithë kolegët e mi, për ndihmën e dhënë për realizimin deri në fazën përfundimtare të këtij punimi. Veçanërisht, falenderoj të gjithë drejtuesit, profesorët dhe studentët e universiteteve, të cilët na ndihmuan në mbledhjen e të dhënave përmes plotësimit të anketave.

FATİH UFUK BAĞCI

Tiranë, 2015

PASQYRA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË	..
ABSTRAKTI	i
ABSTRACT.....	iii
FALENDERIME	vi
TABLE OF CONTENTS.....	Error! Bookmark not defined.
LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE	xii
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	xvii
KAPITULLI I	1
HYRJE	1
1. 1. Objekti i studimit	14
1. 2. Rëndësia e studimit	15
1. 3. Supozimet mbi studimin	23
1. 4. Kufijtë e studimit	24
1. 5. Problemet e studimit	24
1. 6. Hipotezat e studimit	25
1. 6. Metoda e studimit	28
1. 7. 1. Modeli i studimit	28
1. 7. 2. Koha dhe ilustrimet	29
1. 7. 3. Mjetet e mbledhjes së të dhënave.....	30
1. 7. 3. 1. Testi i përcaktimit të vlerave (DIT)	31
1. 7. 3. 1. 1. Pikët e testit në përcaktimin e vlerave	33
1. 7. 3. 1. 2. Prova e vlefshmërisë e testit të përcaktimit të vlerave.....	34
1. 7. 3. 1. 3. Prova e sigurisë e testit të përcaktimit të vlerave.....	35
1. 7. 3. 2. Formulari individual	35
1. 7. 3. 3. Intervista	36
1. 7. 4. Mbledhja e të dhënave	36
1. 7. 5. Analiza statistikore e të dhënave.....	37
KAPITULLI II	38
KONCEPTET E KËRKIMIT	38
2. 1. Konceptet e kërkimit.....	38

2. 1. 1. Morali.....	38
2. 1. 1. 1. Morali universal	45
2. 1. 1. 2. Vlerat morale	47
2. 1. 1. 3. Pjekuria morale	48
2. 1. 2. Faktorët që ndikojnë në pjekurinë morale.....	49
2. 1. 2. 1. Faktorët biologjikë	50
2. 1. 2. 2. Faktorët psikologjikë	50
2. 1. 2. 3. Faktorët socialë	54
2. 1. 3. Sjellja e moralshme dhe veçoritë	61
2. 1. 4. Moraliteti.....	68
2. 1. 5. Cili është burimi i moralit	70
2. 1. 5. 1. Burimi i moralit sipas filozofëve	72
2. 1. 5. 2. A është shoqëria burimi i moralit.....	73
2. 1. 5. 3. A është feja burimi i moralit	74
2. 1. 6. Vlera.....	75
2. 1. 6. 1. Klasifikimi i vlerave.....	79
2. 1. 6. 2. Vlera nga aspekti sociologjik.....	86
2. 1. 6. 3. Vlera nga aspekti filozofik.....	87
2. 1. 6. 4. Vendi dhe rëndësia e vlerave në edukim.	89
2. 1. 6. 5. Disa veçori të vlerave.....	90
2. 1. 6. 6. Funksionet e vlerave	94
2. 1. 6. 7. A janë universale vlerat?	96
2. 1. 6. 7. Shkaqet e largimit nga vlerat sociale	101
2. 1. 6. 7. 1. Jeta e metropolit.....	101
2. 1. 6. 7 .2. Bashkëpunimi social dhe kulturor.....	102
2. 1. 6. 7. 3. Media	104
2. 1. 6. 7. 4. Kërkimi i identitetit.....	106
2. 1. 6. 8. Transmetimi i familjes dhe vlerave në botën moderne	108
2. 1. 6. 9. Rinia dhe vlerat	112
2. 1. 6. 10. Krijimi i vlerave në arsimin e lartë dhe procesi i zhvillimit	113
KAPITULLI III.....	116
SKELETI TEORIK + MODELI ANALITIK I TEMES	116
3. 1. Bazat teorike të konceptit të moralit	116

3. 1. 1. TEORIA PSIKANALITIKE.....	117
3. 1. 1. 1. Mungesa e sigurisë ndaj sigurisë themelore (0-1 vjeç).....	121
3. 1. 1. 2. Ndjenja e turpit dhe dyshimit përballë pavarësisë (1-3 vjeç).....	122
3. 1. 1. 3. Ndjenja e fajit përballë iniciativës (3-6 vjeç).....	122
3. 1. 1. 4. Ndjenja e pamjaftueshmërisë përballë suksesit (7-11 vjeç).....	123
3. 1. 1. 5. Çrregullimi i personalitetit përballë fitimit të personalitetit (11-17 vjeç).....	123
3. 1. 1. 6. Abstraksionimi përballë afrimit (17-30 vjeç)	124
3. 1. 1. 7. Qetësia përballë produktivitetit (30-60 vjeç)	124
3. 1. 1. 8. Dëshpërim, humbje shprese ndaj tërësisë së personalitetit (+ 60 vjeç)	125
3. 1. 2. TEORIA ETIKE	125
3. 1. 3. TEORIA E TË MËSUARIT SOCIAL.....	127
3. 1. 4. TEORIA E NXËNIES NJOHËSE (ZHVILLIMI MENDOR)	133
3. 1. 4. 1. Teoria e zhvillimit moral sipas Dewey-it (Deveut)	138
3. 1. 4. 2. Teoria e zhvillimit moral sipas Piagetit (Piaxhetit)	141
3. 1. 4. 2. 1. Periudha e fluksit emocional (0-2 vjeç):.....	144
3. 1. 4. 2. 2. Periudha para veprimit (egocentrizmi) (2-7 vjeç).....	145
3. 1. 4. 2. 3. Periudha e veprimeve objektive (7-11 vjeç)	145
3. 1. 4. 2. 4. Periudha e veprimeve subjektive (11 vjeç e sipër)	146
3. 1. 4. 3. Teoria e zhvillimit moral sipas Kohlbergut	147
3. 1. 4. 3. 1. Periudha paratradicionale (mendimi tradicional– <i>preconventional reasoning</i>)	157
3. 1. 4. 3. 2. Periudha tradicionale (mendimi tradicional– <i>conventional reasoning</i>).....	158
3. 1. 4. 3. 3. Periudha pastradicionale (periudha e mendimit pastradicionale– <i>postconventional reasoning</i>).	159
3. 1. 4. 3. 4. Vlerësimi i teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut.....	161
KAPITULLI IV	163
ANALIZA EMPIRIKE	163
4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve të universiteteve në përgjithësi.....	165
4. 2. Pikët e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit të pjekurisë morale	166
4. 3. Variablat e pavarur që mendohet se kanë ndikim në formësimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve.....	166
4. 3. 1. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër	167
4. 3. 1. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve, sipas shpërndarjes në universitete të vajzave dhe të djemve, në universitetet e studiura	168

4. 3. 2. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës.....	170
4. 3. 2. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës dhe universitetit.....	172
4. 3. 3. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike	173
4. 3. 3. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike në universitetet e studiuara	175
4. 3. 4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve ...	176
4. 3. 4. 2. Niveli i pjekurisë morale dhe gjendjes civile të prindërve në universitetet e studiuara.....	178
4. 3. 5. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve	179
4. 3. 5. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve në universitetet e studiuara	182
4. 3. 6. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve.	184
4. 3. 6. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve në universitetet e studiuara.....	187
4. 3. 7. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar	190
4. 3. 7. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në llojin e shkollës së mesme ku kanë mbaruar, në universitetet e studiuara	192
4. 3. 8. 1. Gjendja e besimit fetar të studentëve dhe nivelet e pjekurisë morale.....	194
4. 3. 8. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve dhe gjendja e besimit fetar të tyre në bazë të universiteteve të studiuara.....	195
4. 3. 9. 1. Gjendja e besimit fetar të prindërve dhe nivelet e pjekurisë morale të studentëve	197
4. 3. 9. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes fetare të prindërve në universitetet e studiuara.....	198
4. 3. 10. 1. Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse i kanë prindërit në jetë ose jo	200
4. 3. 10. 2. Niveli i pjekurisë morale dhe faktit nëse i kanë prindërit në jetë ose jo në universitetet e studiuara	202
4. 3. 11. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale	205
4. 3. 11. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, të cilët pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në qytete ose zona rurale në bazë të universiteteve të studiuara	207
4. 4. Variablat e pavarur që mendohet se nuk kanë ndikim në formësimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve.....	208
4. 4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve	209

4. 4. 2. Pikët dhe niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve	211
4. 5. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve	212
4. 5. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universitetit dhe departamentit ..	214
4. 6. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur.....	216
4. 6. 2. Niveli i pjekurisë morale në bazë të universiteteve sipas zonës nga kanë ardhur studentët.....	217
4. 7. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë	219
4. 7. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë, në universitetet e studiuara	220
4. 8. 1. Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar.....	222
4. 8. 2. Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar në universitetet e studiuara.....	224
4. 9. 1. Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të prindërve	226
4. 9. 2. Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të prindërvenë universitetet e studiuara	229
4. 10. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve	232
4. 10. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve në universitetet e studiuara	234
KAPITULLI V	237
KONKLUSIONE.....	237
REKOMANDIMET	252
SHTOJCA I.....	255
SHTOJCA II	260
SHTOJCA III	261
BIBLIOGRAFIA	291

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela 1: Klasifikimi i të dënuarëve për krime sipas grup -veprave penale.....	12
Tabela 2: Numri total i studentëve të viteve të para dhe të treta në universitet e studiara	30
Tabela 3: Klasifikimi i vlerave nga Rokeach.....	82
Tabela 4: Klasifikimi i vlerave sipas Spranger	82
Tabela 5: Klasifikimi i vlerave sipas Schwartz.....	83
Tabela 6: Pikëprerjet e rekomanduara në treguesit e % të pikve P dhe D	164
Tabela 7: Pikëprerjet e rekomanduara në treguesit e % të pikave P dhe D	165
Tabela 8: Niveli i pjekurisë morale të studentëve të universiteteve në përgjithësi.....	165
Tabela 9: Pikët e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit të pjekurisë morale	166
Tabela 10: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër ..	167
Tabela 11: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër.....	167
Tabela 12: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas shpërndarjes në universitete të vajzave dhe të djemve në universitetet e studiara	168
Tabela 13: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës.....	170
Tabela 14: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas moshës.....	171
Tabela 15: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës dhe universitetit.....	172
Tabela 16: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademikë	173
Tabela 17: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademikë	174
Tabela 18: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademikë në universitetet e studiara	175
Tabela 19: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve .	176
Tabela 20: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve	177
Tabela 21: Niveli i pjekurisë morale dhe gjendjes civile të prindërve në universitetet e studiara	178
Tabela 22: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve	179
Tabela 23: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave	180

Tabela 24: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve	181
Tabela 25: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave.....	181
Tabela 26: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve në universitetet e studiuara.....	182
Tabela 27: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave në universitetet e studiuara	182
Tabela 28: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të baballarëve	184
Tabela 29: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave...	185
Tabela 30: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të baballarëve	186
Tabela 31: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave	186
Tabela 32: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të baballarëve në universitetet e studiuara	187
Tabela 33: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave në universitetet e studiuara.....	188
Tabela 34: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar	190
Tabela 35: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar	191
Tabela 36: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në llojin e shkollës së mesme ku kanë mbaruar apo në universitetet ku studiojnë.....	192
Tabela 37: Gjendja e formimit fetar të studentëve dhe nivelet e pjekurisë morale	194
Tabela 38: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së formimit fetar të studentëve	195
Tabela 39: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve dhe gjendja e formimit fetar të tyre në bazë të universiteteve ku studiojnë	195
Tabela 40: Gjendja e formimit fetar të prindërve dhe nivelet e pjekurisë morale të studentëve	197

Tabela 41: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së formimit fetar të prindërve	198
Tabela 42: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së formimit fetar të prindërve në universitetet ku studiojnë	198
Tabela 43: Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo	200
Tabela 44: Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo	200
Tabela 45: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo	201
Tabela 46: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo	201
Tabela 47: Niveli i pjekurisë morale dhe faktit nëse e kanë babain në jetë ose jo, sipas universiteteve ku kanë studiuar	202
Tabela 48: Niveli i pjekurisë morale sipas faktit nëse e kanë nënën në jetë ose jo sipas universiteteve ku kanë studiuar	204
Tabela 49: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona bujqësore (rurale)	205
Tabela 50: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin se pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona bujqësore (rurale).....	206
Tabela 51: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve të cilët pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në qytete ose zona bujqësore (rurale) në bazë të universiteteve ku kanë studiuar	207
Tabela 52: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas Universiteteve	209
Tabela 53: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve	210
Tabela 54: Pikët dhe niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas Universiteteve	211
Tabela 55: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve	212
Tabela 56: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve	213
Tabela 57: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universitetit dhe departamentit.....	214

Tabela 58: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur.....	216
Tabela 59: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur.....	216
Tabela 60: Niveli i pjekurisë morale në bazë të universiteteve sipas zonës nga kanë ardhur studentët.....	217
Tabela 61: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë	219
Tabela 62: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë.....	220
Tabela 63: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë në universitetet ku kanë studiuar	220
Tabela 64: Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar	222
Tabela 65: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar.....	223
Tabela 66: Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar në Universitetet ku kanë studiuar.....	224
Tabela 67: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të babait.....	226
Tabela 68: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të nënës	227
Tabela 69: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të babait.....	227
Tabela 70: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të nënës	228
Tabela 71: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të babait në universitetet e studiuara	229
Tabela 72: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të nënës në universitetet ku kanë studiuar	231
Tabela 73: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve	232
Tabela 74: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve	233

Tabela 75: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve në universitetet ku kanë studiuar	234
---	-----

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

DIT	testi i përcaktimit të vlerave
Etj.	e të tjerë
Fan S. Noli	Fan Stilian Noli
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto
HIV-AIDS	virusi i mungesës së imunitetit te njeriu
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
N	numri i studentëve
OJF	organizatë jofitimprurëse
P.sh.	përshebull
Pers.	personale
Pikë M	studentët që i janë përgjigjur gabim testit dhe në një fletëpërgjigje, pikët M të studentëve janë 8 ose më shumë
Pikë P	pikë pastradicionale
Prof. Dr.	Profesor Doktor
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Shik.	shikoni
STD	devijime standarte
T.C	Republika e Turqisë
Unesco	Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë
Unicef	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
Who	Organizata Botërore e Shëndetësisë
X	të dhëna mbi nivelin e gjykimit moral

KAPITULLI I

HYRJE

Në kuptimin më të përgjithshëm, *morali është tërësia e rregullave jozyrtare, për të cilat njerëzit tregojnë kujdes dhe ndjeshmëri në realizimin ose mosrealizimin e tyre në komunitet*. Pavarësisht faktit se këto rregulla nuk kanë fuqi ligjore detyruese si ligjet, të paktën kanë një vend të rëndësishëm sa ato në shoqëri. Madje në disa raste, ju mund të vëreni se në disa vende, ku ligjet nuk kanë efektshmëri, rregullat dhe vlerat morale kanë një reputacion të madh. Ligjet mund të këshillojnë të jemi të respektueshëm, të kemi kujdes për komshiun në nevojë, të jemi tolerantë, të sillemi me tolerancë ndaj njerëzve, por nuk kanë fuqi detyruese. Këto mund t'i siguronin me konceptimin e vlerave dhe rregullave morale të shoqërisë. Vjedhja dhe vrasja e njeriut ashtu siç sanksionohen penalisht, sanksionohen edhe sipas rregullave të pashkruara të asaj shoqërie. Në këtë kuptim do të ishte e përshtatshme t'i quanim rregullat morale *norma zakonore, norma tradicionale ose norma jozyrtare*.

Njerëzit gjatë rritjes së fëmijëve, krahas sigurimit të arsimimit, siç është parashikuar në legjislacion, kanë parasysh edhe perceptimet e vlerave të shoqërisë (dasma, xhenaze, marrëdhëniet ndërkombëtare). Në këtë kuptim, prindërit dëshirojnë që fëmija i tyre në opinionin e shoqërisë të jetë i respektuar, të jetë i kualifikuar dhe i integruar me vlerat e shoqërisë dhe të vendit në të cilin ai jeton. Për këtë arsye e dërgon fëmijën e tij në shkollë, në aktivitetet shoqërore merr pjesë së bashku me fëmijët e tij, u tregon atyre zbatimet praktike të gjërave që i ka mësuar teorikisht ose gjërave që nuk mund të mësohen teorikisht.

Sipas një prej mendimtarëve të mëdhenj të lashtësisë, Sokratit, morali ka lidhje të drejtëpërdrejtë me dijen.

“Sipas Sokratit, të jesh i lartësuar moralisht lidhet ngushtë me dijen. Vetëm dija e vërtetë të çon në veprime të drejta. Sipas atij, thelbi i të qenit i moralshëm është të njohësh të mirën. Dija ndikon në vullnetin e njeriut. Asnjë njeri nuk bën keq me vetëdije. E keqja buron nga mungesa e dijes. Ashtu siç mësohet dija, mësohet edhe morali. Sipas Sokratit, morali dhe lumturia janë e njëjta gjë.” (Gökberk, 2005, f. 46)

Në botë ekzistojnë shumëllojshmëri kombesh dhe si rrjedhim ekzistojnë edhe qasje morale dhe gjykime vlerash të ndryshme. Për arsye se çdo popull ka zakone, opinione botërore dhe mënyra jetese të ndryshme mund të thuhet se kjo ka bërë që të kemi qasje morale dhe gjykime vlerash të ndryshme. Madje edhe brenda për brenda një vendi mund të ndeshemi me rregulla morale dhe perceptime vlerash të ndryshme.

Nga ana tjetër, te çdo njeri ekziston perceptimi i të mirës dhe i të keqes. Kur një person përballlet me një sjellje, ai mund të bëjë komente në lidhje me saktësinë e tij dhe pasaktësinë e tij. Në të njëjtën kohë, këto komente dhe perceptime, na japin të dhëna në lidhje me qasjen morale të tij, perceptimin e vlerave apo botëkuptimin e tij. Ky koncept aq sa reflekton perceptimin e moralit dhe vlerave të personit, reflekton edhe gjendjen e shoqërisë në lidhje me këtë temë.

Moral do të thotë tërësi rregullash të përcaktuara, të domosdoshme për rregullimin e shoqërisë, të sugjeruara nga njerëzit, të cilët zotërojnë kulturën e jetesës shoqërore. Sipas Korkmazit, (2015) “moral janë rregullat e pashkruara. Ato, të cilat ndezin në ndërgjegjet e njerëzve ndjenjën e domosdoshmërisë së përshtatjes, ekuilibrojnë marrëdhëniet jozyrtare në mes njerëzve dhe i japin një formë të caktuar shoqërisë.”

Njeriu është një qenie sociale. Ai ndjen nevojën e një strukture sociale për ta vazhduar jetën në kushte normale. I detyruar në një farë mënyre ndaj kulturës së bashkëjetesës shoqërore, njeriu duhet të plotësojë sistematikisht disa rregulla. Sepse,

një jetë pa rregulla do të bëhej shkak i krijimit të shumë problemeve serioze në shoqërinë, ku jeton ai.

Një pjesë e këtyre rregullave të domosdoshme, të ardhura si rezultat i kulturës së bashkëjetesës, gjenden në një strukturë të quajtur shtet dhe praktikimi, vazhdimësia, krijimi dhe emri i të cilave është “ligj”. Këto janë rregulla të shkruara dhe ato të cilët nuk u përshtaten marrin dënime morale dhe materiale.

Nga ana tjetër, ekzistojnë rregullat e pashkruara të vendosura sipas kulturës e traditës së vendit dhe të cilat cilësohen si “moral ose vlerë”. Rregullat morale nuk kanë një sanksion penalizues. Edhe njerëzit nuk janë të detyruar t’u përshtaten, por, ndonjëherë, këto rregulla të cilësuar si “presion i lagjes” i detyrojnë njerëzit t’u përshtaten. Veprime të ndaluara me ligj, si vjedhja apo mashtrimi, shihen si të tilla edhe nga rregullat morale. Megjithatë, rregullat morale nuk japin një penalizim të ngjashëm ligjor: kritikimi i personave, të cilët e kryejnë veprimin, izolimi apo përjashtimi i tyre nga shoqëria është një dënim i mjaftueshëm.

Me maturi morale kuptojmë përvetësimin sa më mirë nga njerëzit të rregullave morale të pashkruara dhe shndërrimin e tyre në principe themelore të jetës së tyre individuale. Ky përvetësim e shfaq veten ndonjëherë në trajtën e një ndjenje e ndonjëherë në trajtën e një veprimi. Maturia e individëve në këtë rast është shndërruar në pjesë të natyrshmërisë së tyre. Të gjitha sjelljet e tyre pasqyrojnë një maturi morale. Këta persona ndodhen gjithnjë nën kontrollin e ndërgjegjeve. Para bërjes së një gabimi apo para pasqyrimit të një sjelljeje të gabuar, në trurin dhe zemrën e tyre, sinjalet pozitive i drejtojnë nga e mira dhe si rrjedhojë shfaqin një sjellje të drejtë.

Një aspekt tjetër i rregullave morale apo botëkuptimit moral është dhe “koncepti vlerë”. Ashtu siç perceptohet nga pikëpamja morale, çdo shoqëri ka një botëkuptim të veçantë vlerash. Nga ana tjetër, pavarësisht polemikave rreth vlerave

morale, të gjithë pranojnë një grup vlerash morale në mënyrë apriori. Për këtë arsye, këto vlera janë quajtur ndryshe *vlera universale*. Në çdo vend të botës, familja është vlerë më vete. Gënjeshtra, vjedhja dhe korrupsioni janë dukuri të papranueshme dhe të dënuara në çdo vend të botës. Nisur nga ky këndvështrim, vlerat mund t'i shohim si një koncept i ndryshëm i moralit, sepse, dukuritë e cilësuara si vlerë dhe moral janë si dy anët e një medalioni.

Një nga komponentët më të rëndësishëm në formimin e një shoqërie të shëndetshme dhe në ruajtjen e qëndrueshmërisë së saj është transmetimi te brezat e rinj të konceptit moral dhe të vlerave të atij populli. Përvetësimi i vlerave morale të popullit është shumë i rëndësishëm në rritjen e brezave të shëndetshëm. Brezat që qëndrojnë të huaj ndaj konceptimit moral të vendit të tyre dhe që nuk përvetësojnë vlerat e të parëve, do të rriten si një tumor i pakurueshëm në trup, i cili do ta shpjerë shoqërinë në pika të pakthyeshme.

Në kohën kur teknologjia po përjeton shekullin e artë, në shekullin kur shpikjet dhe zhvillimet teknologjike pasojnë njëra-tjetrën, shumë gjëra janë ndarë heshturazi nga ne, krahas hyrjes së shumë të rejave në jetën tonë. Janë të shumtë njerëzit e moshës së mesme të cilët ndjejnë mall, nostalgji për të kaluarën, kur hedhin kokën pas dhe kur e kuptojnë që shumë gjëra janë ndarë prej tyre heshturazi dhe pa u ndjerë.

Kenan (2009, f. 261), pohon se ky ndryshim ka prekur të gjithë vendet, si ato të zhvilluara, ashtu edhe vendet në zhvillim e sipër. Dobësimi i vazhdueshëm i institucionit familjar, përkeqësimi i botëkuptimit dhe kulturës civile, tendosjet e përjetuara në mes komponentëve vendas\universal, materiale\shpirtërore, vjedhjet e ndodhura në ambjente të ndryshme të bursave, degjenerimi i sistemeve, mospërcaktimi i një politike të vlefshme në vendosjen e kufijve, përsa i përket

dëmtimit serioz të ambientit janë shembuj seriozë, të cilët, sipas Kenanit, tregojnë se në botën ku jetojmë po ndodhin ndryshime të mëdha.

Köylü (Këjlu) (2010, f. 20), mendon se zhvillimet në fushën teknologjike e shkencore nuk sjellin asnjë zhvillim serioz për civilizimin e njeriut, por e largojnë nga shumë vlera dhe si rrjedhojë, në fund do ta përballin njeriun me shumë probleme, si: lufta, padrejtësia sociale, varfëria, dhuna etj.

Sipas Turanit (2013, f. 282), një nga shkaqet e këtyre problemeve, si rrjedhojë e këtij zhvillimi lind nga filozofia e edukimit. Turani është i mendimit se është e domosdoshme kritika e performancës pozitiviste, e cila përjashton metafizikën. Ky pozitivizëm i edukimit qendron përballë problemeve morale të vazhdueshme, të cilat janë gjithnjë e në rritje e sipër në ditët e sotme. Sipas Turanit (2013, f. 282):

“Nëse u hedhim një sy metodave të përdora në filozofinë e edukimit, duke filluar nga shekulli XVIII, vihet re ndjekja e një metode, ku botëkuptimi pozitivist, që u jepet brezave të rinj shoqërohet me transmetimin dhe mbështetjen e informacionit, me zhvillime teknologjike dhe shkencore. Si rrjedhojë, përpjekjet për një edukim individual, edukim vlerash, apo edukim të paqes, të shfaqura sot në SHBA dhe Kontinentin Evropian, tregojnë se të rinjtë e sotëm nuk mund të arrijnë perfeksionin me anë të shkencave pozitiviste dhe nënvizojnë domosdoshmërinë e zotërimit të një karakteri moral.”

Ne sapo kemi filluar të njihemi me ndryshimet shoqërore, të cilat kanë filluar të gjejnë vend me revolucionin industrial evropian, apo kemi filluar t’i japim një kuptim se çfarë po ndodh me ne. Akoma kërkojmë përgjigjen e kësaj pyetjeje. Thuhet që historia përsëritet. Ç’është e vërteta, gjërat e përjetuara nuk janë gjëra, të cilat historia botërore po i sheh për herë të parë. Evropa i ka përjetuar këto ndryshime bashkë me periudhën e Rilindjes, studiues dhe specialistë të ndryshëm janë përpjekur të kuptojnë ndryshimin shoqëror me anë të librave dhe artikujve të panumërt.

Sipas Taşözit (Tashozit) (2012, f. 21), të gjitha shoqëritë janë të pafuqishme përballë forcës së ndryshimit. Kur vjen koha e duhur, çdo shoqëri, kulturë është e detyruar t'i përshtatet rrotës së ndryshimit. Ndërkohë që ky proces realizohet në mënyrë shumë të shpejtë te disa shoqëri, te disa shoqëri të tjera vazhdon në mënyrë më të ngadaltë. Kjo situatë e re e krijuar në kulturën tonë, e cila është një pjesë e pandashme nga ne, nuk pasqyrohet njësoj te brezat e ardhshëm. Kultura e transmetuar te brezat e rinj ndonjëherë shpejt e ndonjëherë ngadalë mund të bëhet shkak i ndryshimeve individuale dhe shoqërore. Ndërkohë që ndryshimi mund të sjellë zgjidhje për disa probleme shoqërore, ai mund të krijojë dhe shumë probleme të tjera. Për këtë arsye, disa shoqëri mund të tregohen rezistente ndaj ndryshimit.

Sipas Aşıkoğlu (Ashikollu) (1997, f. 299) bashkë me shtimin e mundësive të transportit dhe rritjes së nivelit ekonomik të njerëzve është lehtësuar largimi i njerëzve nga vendi i tyre në vende apo shtete të tjera. Krahas dobive dhe avantazheve që mund të sigurojë kjo situatë, nuk mund të mohojmë dhe problemet që sjell ajo. P.sh. një lëvizje emigrimi e shpjeguar pak më sipër do të sjellë me vete, veçanërisht në zonat industriale dhe qytetet e mëdha, konceptin “e mozaikut të kulturave dhe besimeve”. Pra, njerëz të kulturave dhe besimeve të ndryshme janë të detyruar të jetojnë së bashku. Si rezultat i kësaj, njerëz të kulturave dhe besimeve të ndryshme kanë filluar të jetojnë së bashku, duke mbetur të ekspozuar ndaj pyetjes se çfarë qëndrimi u duhet të mbajnë ndaj kësaj situate të re. Krahas kësaj, në vende të ndryshme të botës ndodhin përplasje të lindura nga shkaqe ekonomike, politike, botëkuptime fetare apo rrënjëve etnike. Nëse këto mosmarrëveshje analizohen me kujdes, vihet re se edhe në burimin e problemeve etnike vlerat e shenjat luajnë një rol shumë të rëndësishëm.

Sociologu gjerman Hans Freyer (1956, f. 16) na tërheq vëmendjen te ndryshimi moral i përjetuar nga shoqëritë në shekullin modern. Ai pohon se shoqëritë

po zgjasin duart drejt burimeve të energjisë, si uranumi, nafta, qymyri, të cilët krijojnë epokën industriale, por krahas tyre u duhet të prekin dhe thesaret e shpirtit e mendjes.

Sociologu amerikan Francis Fukuyama (1992, f. 23) e mbështet këtë mendim dhe nënvizon rëndësinë e faktit të vlerësimit njëkohësisht të teknologjisë dhe zhvillimeve morale. Përkundrazi, zhvillimet shkencore të cilat lënë pas dore moralin, etikën mund të bëhen shkak të rreziqeve shumë serioze për njerëzimin.

Sipas Turanit,(2013, f. 271), të folurit shumë rreth gjërave të cilësuar si morale tregon se këto probleme janë një nga problemet më të rëndësishme të shekullit tonë. Dhuna e krimi, vartësia alkolike dhe narkotike, depresionet shpirtërore dhe vetëvrasjet të përhapura shumë ditëve të sotme nuk janë më probleme individuale, por probleme të përmasave shoqërore, madje globale. Prandaj, kur i analizojmë këto probleme duhet të mendojmë me një këndvështrim ndërkombëtar.

Kenan (2009, f. 265) e përngjason ndryshimin e përjetuar nga njeriu nën emrin “zhvillim”, si një stuhi, e cila rrezikon jetën e tij. Kjo stuhi do të vazhdojë të veprojë, nëse nuk merren masa parandaluese serioze në çdo vend. Për këtë arsye, mendimi i “zhvillimit” duhet filluar të kritikohet nga shumë aspekte. Nga ana tjetër, ngjarjet sociale dhe psikologjike, me të cilat përballemi në jetën shoqërore, krahas shkaqeve ekonomike dhe politike të këtij procesi, tregojnë haptazi se janë përcaktuese të krizës morale dhe shpirtërore.

Në lidhje me pyetjen se ku po i çon njerëzit ky “zhvillim”, i cili vazhdon rrugën e tij në një mënyrë agresive dhe të pamatur, Walter Benjamin (2004, f. 42) në vitin 1921 ka bërë këtë analizë, duke u nisur nga tabloja me emër “Angelus Novus”, të marrë nga Paul Klee:

“Në këtë pikturë është përshkruar një engjëll. Ai duket sikur dëshiron ta largojë shikimin e tij nga një vend ku i kanë mbetur sytë. Janë hapur sytë,

goja dhe krahët. Edhe engjëlli i historisë duhet të jetë i tillë. E ka sjellë fytyrën nga e kaluara. Në pikën ku ne shohim një zinxhir ngjarjesh, ai sheh vetëm një fatkeqësi, e cila hedh një mbi një shkatërrimet dhe i hedh tutje. Engjëlli me siguri që dëshiron të qëndrojë aty, të ringjallë të vdekurit dhe të bashkojë edhe një herë copëzat e ndara. Por, nëse je nga parajsa, një furtunë ka mbështjellë krahët e tu dhe është aq e fuqishme, sa që engjëlli nuk mund të mbyllë më krahët e tij. Stuhia e shpie atë drejt së ardhmes, të cilës vazhdimisht i kishte kthyer shpinën, ndërsa grumbulli i mbeturinave para tij po ngrihet në qiell.”

Sipas Taşözit (2012, f. 23) teknologjia ose ideologjia përbëjnë bazën e ndryshimit, ndërsa pas fillimit të ndryshimit fillon procesi i ndikimit mes teknologjisë dhe ideologjisë. Kultura shpirtërore dhe vlerat morale të shoqërive ndonjëherë konsiderohen si filluese të ndryshimit shoqëror e ndonjëherë si rezultat i ndryshimit shoqëror. Veçanërisht ndryshimi i ardhur si pasojë e industrializimit nuk është përherë pozitiv. Në shoqëri të tilla, marrëdhëniet njerëzore nuk janë të zhvilluara aq shumë sa ç’është e zhvilluar industria.

Në të vërtetë, në të gjithë botën, jo vetëm në gjeografinë tonë, po përjetohet një ndryshim, të cilin Evropa e ka përjetuar kohë më parë. Në vija të përgjithshme mund të themi se nuk ka njerëz, të cilët nuk e pranojnë se ekziston një shthurje morale. Probleme të ndryshme, si terrorizmi, racizmi, shkelja e të drejtave të njeriut, dhuna ndaj gruas, prostitucioni, përdorimi i lëndëve narkotike etj. ndikojnë direkt te shoqëritë. Megjithëse organizata ndërkombëtare të ndryshme, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në vende të ndryshme të botës si: Unicef, Unesco, WHO harxhojnë miliona dollarë për të përballur probleme të tilla dhe akoma nuk është arritur një rezultat i prerë në këtë pikë.

Kaya, (Kaya M. , 1995, f. 124) e analizon kështu ndryshimin:

“Me kalimin e kohës, kur analizohen shkaqet e varfërimit të jetës morale dhe shpirtërore në të gjithë botën, gjatë 200 viteve të fundit, vihet re se

konceptet, të cilat njeriu është munduar t'i idealizojë për mijëra vite, si dashuria, respekti, ndershmëria, besnikëria, virtyti, turpi, sinqeriteti dhe sakrifica kanë filluar të fshihen nga kujtesa dhe një nga shkaqet kryesore të kësaj fshirjeje është përhapja e pikëpamjes së botës materialiste. Thënë ndryshe, kjo situatë vjen si pasojë e kërimit të lumturisë dhe qetësisë të kënaqësitë materiale.”

Yazıcı (Jazici),(2013, f. 1490) flet për procesin e ndryshimit, duke u bazuar edhe te mendimi i Kuhn. Strukturat shoqërore janë të ndërlidhura me vlera dhe norma të caktuara. Këto vlera dhe norma dobësohen me kalimin e kohës dhe bashkë me këtë shfaqen analizat e para në lidhje me vlerat e normat ekzistente, ndërsa nga ana tjetër, shfaqen shenjat, të cilat tregojnë fillimin e përvetësimit të vlerave e normave të reja. Si rezultat i kësaj, ndikimi i vlerave (normave) të vjetra fillon të dobësohet, por nuk zhduket plotësisht. Vlerat e reja nuk janë përvetësuar akoma siç duhet dhe në fund lind një periudhë “gri” e pathelluar në nivelin “anomi”. Në periudhën “gri” mund të shtohen debatet dhe mosmarrëveshjet. Por, kjo rrëmujë nuk vazhdon për shumë kohë. Me kalimin e kohës krijohet një botëkuptim tërësor, gjithëpërfshirës shoqëror i ri, i cili sillet rreth përvetësimit të vlerave të reja dhe rianalizimit të vlerave të vjetra.

Kenani (2009, f. 275) pohon se kur vëzhgojmë shkaqet e këtij ndryshimi të të gjithë shoqëritë, njëri nga shkaqet është shkatërrimi i edukimit të vlerave, i cili fokusohet mbi subjektiven, ndjenjën, fushën e patestuar dhe metodën edukuese pozitive-mekanike, që ka arritur majat në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Edukimi pozitiv gjatë kësaj periudhe nuk ka arritur t'u pasqyrojë studentëve rrënjët e vlerave më të rëndësishme, të cilat i japin kuptim jetës dhe e bëjnë atë të vlefshme për të jetuar, nuk u ka treguar mënyrën sesi duhet jetuar.

Viteve të fundit edhe shoqëria jonë është prekur nga ky ndryshim. Sigurisht që është e pamundur të qëndrosh përballë këtij ndryshimi dhe t'i mbyllësh të gjitha dyert

ndaj pjesës tjetër të botës. Zhvillimet e shfaqura në globalizëm, modernizëm apo teknologji krahas dobive që i sjellin njeriut, ndikojnë direkt në jetën tonë duke na bërë më individualistë dhe duke dobësuar lidhjet familjare. Kjo gjë shihet mjaft qartë te përballja jonë me lajme të pamësura në faqet e gazetave dhe ekranet televizive.

Sipas Xhaferajt, (2015) shoqëria shqiptare me ndryshimet që ndodhën pas rënies së komunizmit u përball me vështirësi dy herë më të mëdha. Shoqëria shqiptare nga njëra anë duhej të transformonte ekonominë e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë dhe ndërkohë duhej të garantonte rritjen ekonomike. Kjo do të thotë se shumë angazhime të tjera që kanë të bëjnë edhe me formësimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore dhe demokratike kanë mbetur në periferi të objektivave të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Gjatë dekadës së parë të tranzicionit, institucionet shtetërore nuk e konceptonin si angazhim të tyre parësor problematikën e kultivimit në shoqëri të vlerave morale dhe shoqërore ndërsa shoqëria civile ishte inekzistente. Gjatë kësaj dekade në fushat e jetës morale ne u ballafaquam me një situatë të shpërthimit të nihilizmit moral. Kjo sepse për më shumë se gjysmë shekulli të regjimit diktatorial shoqëria shqiptare pranoi apo u detyrua të pranojë si parime morale ca dogma antihumane, të cilat duke nëpërkëmbur dinjitetin njerëzor ndihmuan në shkatërrimin e vlerave të trashëguara të shoqërisë shqiptare. Vetëm vitet e fundit mund të themi se si shoqëria civile ashtu edhe institucionet shtetërore janë angazhuar dhe kanë bashkëpunuar së bashku për të krijuar infrastrukturën e nevojshme për të trajtuar me cilësinë e duhur problematikën e kultivimit në shoqëri të vlerave morale.

Sipas Mustafajt, (2015) termi “tranzicion” merr tashmë kuptim edhe më të plotë se sa kur flasim për ndërtimin e tregut të lirë apo të shtetit të së drejtës. Shoqëria shqiptare është në tranzicion të plotë nga një shoqëri e mbyllur e ksenofobike drejt një shoqërie të hapur e kozmopolite. Ky tranzicion po përcillet me një konfuzion të madh, i cili ka shpjegimin e vet kur është fjala për sjelljet dhe normat tradicionale të shqiptarëve. Nga një anë, ky konfuzion shpjegohet me faktin se gjatë izolimit gjysmë shekullor, regjimi komunist jo vetëm shkëputi lidhjet dhe komunikimin e shoqërisë shqiptare me pjesën tjetër të Evropës, por veprooi në mënyrë sistematike dhe të dhunshme për të asgjësuar deri në rrënjë traditat e kësaj shoqërie, të cilat

i binin ndesh stereotipit të “njeriut të ri komunist”. Për pasojë, vetë brezi i prindërve të rinisë së sotme nuk ka përgatitjen e mjaftueshme për t’u përcjellë fëmijëve sjelljet dhe normat tradicionale shqiptare. Nga ana tjetër, përfshirja e shoqërisë shqiptare në rrjedhat e zhvillimeve globaliste u bë në mënyrë të menjëhershme dhe shumë të vrullshme, pa u lënë elitave kohë për reflektim, që do të thotë se elitat shqiptare nuk ishin dhe vazhdojnë të mos jenë në rolin e tyre për t’i orientuar këto zhvillime drejt një ndërthurjeje më të natyrshme midis normave të shëndetshme tradicionale dhe atyre kozmopolite.

Ndërsa sipas Tushit, (2015) trendi i shoqërisë shqiptare është formatur nga ndikimet e një tranzicioni kaotik, me të cilin u kalua nga shoqëria totalitare dhe njeriu dogmatik në shoqërinë demokratike dhe njeriun e lirë. Situata tregon se aktualisht në se tranzicioni politik dhe ekonomik duhet konsideruar të mbyllur (pa rrezik për rikthim të komunizmit apo restaurim të pronës shoqërore), për sa i takon tranzicionit moral ai nuk është mbyllur. Shkaku është kalimi eruptiv nga shoqëria kolektiviste, holiste, tradicionale në atë postmoderne, në qëndër të të cilit nuk është më shoqëria por njeriu individualist, egoist që ka qëllime dhe kërkesa konkrete që do t’i plotësojë me cdo kush “këtu dhe tani”.

Sipas Sinanit (2015), në periudhën paskomuniste lëvizja e shoqërisë shqiptare drejt lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës është një trend pozitiv. Në qoftë se do të ndaleshim në ritmin dhe shpejtësinë e këtij procesi, këtu ka shumë pengesa që e kanë vonuar këtë trend të shoqërisë shqiptare drejt demokracisë e lidhur kjo me shulmë faktorë, ku përgjegjësia qëndron në faktorin politik që ka drejtuar këto vite tranzicioni. Prandaj, në kuadër të një tipologjie politike, demokracia shqiptare mbetet një demokraci hibride.

Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë (2013) në statistikat që ka publikuar në lidhje me llojet e krimeve dhe numrit të tyre midis viteve 2004-2013, veçanërisht në krimet ndaj moralit, dinjitetit dhe familjes vëren rritje. Në krahasim me vitet e kaluara, në krimet, si: krimet seksuale, krimet ndaj pasurisë dhe krimet në sferën ekonomike, krimet ndaj rendit dhe sigurisë publike është vërejtur një rritje e vogël.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna në lidhje me llojet e krimeve dhe numrit të tyre midis viteve 2004-2013.

Tabela1:Klasifikimi i të dënuarve për krime sipas grup veprave penale

Grup-veprat penale	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Krime kundër jetës	269	269	220	197	242	245	221	213	216	178
Krime kundër shëndetit	64	64	81	77	96	106	129	145	163	112
Krime seksuale	65	42	37	40	38	25	31	20	23	34
Krime kundër lirisë se pers.	41	35	23	15	25	23	26	22	29	27
Krime kundër moralit, dinjitetit dhe familjes	168	157	95	98	126	80	74	79	133	339
Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	2700	2766	2429	2322	2637	2216	2445	2710	3057	2732
Krime kundër rendit dhe sigurisë publike	1172	1206	1116	1281	1460	1366	1386	1679	1724	1580
Krime kundër drejtësisë	168	94	83	76	109	110	133	146	107	107
Krime të tjera	7	100	248	3	52	165	132	103	62	95
Kundërvajtje	1725	1584	1662	1152	2253	2205	2566	3101	2,233	2,400

Ky ndryshim mbart kuptime të ndryshme sipas mendimit të njerëzve. Ndërkohë, që sipas disave, këto ndryshime konsiderohen si një problem serioz, sipas disa të tjerëve, ato shihen si një domosdoshmëri e shekullit tonë, si një ngjarje e lindur nga një marrëveshje joligjore me botën e ndryshuar, lidhjet e botës me integrimin.

Ndërsa një nga problemet më të rëndësishme të të gjithë botës, e veçanërisht të vendit tonë, nuk është mosmarrja e këtyre vlerave, por mosdhënia e tyre në edukim. Arsimi i detyruar në shumë shtete është deri në fund të shkollës së mesme. Menaxhimi i kësaj periudhe dhe krijimi i programeve mësimore i përket Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Nisur nga ky fakt, institucionet shtetërore, të cilat zotërojnë fuqinë e drejtimit, duhet të përgatisin fëmijët tanë për të ardhmen me anë të temave “edukimi i vlerave” të vendosura në programin e çdo mësimi, apo në programet udhëzuese, të edukojnë një brez mësuesish të pajisur me njohuri dhe aftësi dhe t'i

ndihmojnë familjet në këtë pikë. Nga ana tjetër, të informohet brezi i ri duke përdorur në mënyrë efektive komponentët e medias vizive dhe të shkruar dhe të mësohen me vlerat kombëtare e universale, para se të vijnë në periudhën e pjekurisë.

Objekti i studimit tonë është një nga temat, e cila kohë më parë është bërë temë diskutimi në Evropë dhe është shprehur me konceptet, si “moral, sjellje morale, koncepti i vlerave morale”. Bashkë me ardhjen e demokracisë, populli shqiptar ka filluar të evropianizohet shpejt, por nga ana tjetër ka filluar të flasë me nostalgji për të kaluarën për shkak të largimit nga vlerat e tij. Ndryshimi në mendime, stilin e jetesës, mënyrës së veshjes mes brezit të ri dhe atij të vjetër të tërheq më shumë vëmendjen. Njerëzit këtu përpiqen t’i japin një kuptim kësaj gjëje. Ç’është e vërteta, njerëzit nuk arrijnë t’i japin një kuptim kësaj situate dhe vazhdojnë të diskutojnë në kafene, kopshtet e çajit, rreth pyetjes se ku kanë gabuar dhe çfarë nuk kanë arritur të bëjnë. Ndërkohë që disa e shohin këtë ndryshim si diçka normale dhe pjesë të natyrshmërisë së zhvillimit, disa të tjerë nuk arrijnë ta kuptojnë.

Sipas Kenanit, (2009, f. 277) megjithëse një grup njerëzish mund ta konsiderojnë këtë ndryshim si diçka normale, nuk ka ekzistuar ndonjëherë një kohë më e volitshme për “forcimin e vullnetit” i mundësuar nga realizimi i vlerave dhe virtyteve morale duke sjellur përmbys “shkatërrimin e vullnetit”, për të cilin flet Kierkegaard dhe duke përvetësuar edukimin e larguar nga debatet teologjike, ideologjike dhe politike, pavarësisht gjeografisë apo kulturës, vlerave apo virtyteve morale dhe duke analizuar dinamikën e reja, zhvillimet ekologjike, politike dhe globale brenda të cilave jetojmë. Si rrjedhojë, ne nuk duhet t’i lëmë brezat tanë të paeksponuar ndaj edukimit moral, por krahas edukimit mendor të programojmë edukimin brenda të cilit përfshihen vlerat morale.

Duke qenë një vend, i cili sapo ka filluar të realizojë aktivitete të ndryshme sociale dhe politike në emër të demokratizimit e evropianizimit, Shqipëria akoma nuk arrin të prodhojë projekte serioze në lidhje me këtë ndryshim. Shpresohet që në të ardhmen, brenda pak viteve, Shqipëria, si pjesë e vendeve të cilat do të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, të mbajë një qëndrim të drejtë rreth këtyre temave, të ulë në minimum ndikimet negative të modernitetit e globalizmit dhe të hedhë hapa të sigurt drejt të ardhmes.

1. 1. Objekti i studimit

Universitetet luajnë një rol efektiv në formimin e brezave intelektualë dhe në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe shoqëror të vendit në rang kombëtar ose ndërkombëtar. Sipas Sotirofskit, (2009, f. 80) në shoqëritë e mirinformuara, universitetet mbajnë përgjegjësi jo vetëm për zhvillimin e informacionit, por edhe për prodhimin dhe praktikimin e tij. Në të njëjtën kohë, ato mbajnë përgjegjësinë e formimit social dhe teknik, jo vetëm të shtresës elitare, por përgatisin për jetën shumë studentë. Për këtë arsye, mund të themi se në mbështetje edhe të ligjeve të arsimit të lartë, universitetet në Shqipëri janë vendi i prodhimit, praktikimit dhe transmetimit të informacionit. Në të njëjtën kohë, ato janë institucione, të cilat mundësojnë kushtet e studimeve shkencore. Nga ana tjetër, ato kanë marrë përsipër një mision shumë të rëndësishëm në zhvillimin e demokracisë, rritjen e nivelit të jetës shoqërore dhe transmetimit të këtij ndryshimi te brezat e rinj.

Nisur nga ky aspekt, mund të pohojmë se objekti i studimit është analizimi i ndryshimeve në mes niveleve të gjykimeve morale dhe konceptimeve të vlerave mes studentëve të viteve të para dhe të fundit, të cilët studiojnë në universitete të ndryshme, t'i nxjerrim në pah ato dhe të analizojmë shkakun e tyre nëse ekzistojnë

shkaqe të tilla. Studimi nuk synon të etiketojë si “të mirë apo të keq” gjykimin moral apo konceptimin e vlerave të njerëzve, apo t’i kritikojë ato. Qëllimi i studimit është të pasqyrojë gjendjen aktuale.

Objekti i studimit është shkurtimisht si më poshtë:

1. Analizimi i ndikimit të faktorëve të ndryshëm, si gjinia, mosha, statusi arsimor i prindërve, qëndrimet e prindërve ndaj fëmijëve, gjendja ekonomike e prindërve, zona nga ka ardhur studenti, lidhja e prindërve me fenë, lidhja e studentëve me fenë etj, në formimin e gjykit moral dhe konceptimit të vlerave.

2. Analizimi i ndryshimit që mund të shfaqet në mes gjykit moral dhe konceptimit të vlerave, duke u bazuar te fakultetet apo departamentet ku studiojnë studentët.

3. Në fund të studimit, të përcaktohet niveli i gjykit moral dhe konceptimit të vlerave të studentëve.

4. Të matet efektiviteti i edukimit të dhënë në universitetet shqiptare në krijimin, në mbrojtjen dhe në shtimin e vlerave.

5. Të përcaktojmë gjykimet morale dhe botëkuptimin e vlerave të studentëve shqiptarë, në lidhje me të ardhmen, duke u bazuar në të dhënat e arritura në fund të studimit.

1. 2. Rëndësia e studimit

Brezat e rinj përbëjnë të ardhmen e vendit, dinamikën e tij më vitale. Nisur nga ky fakt, edukimi i pasqyruar në ciklin parauniversitar dhe atë të arsimit të lartë luan një rol shumë të rëndësishëm. Të rinjtë e dalë nga universitetet e vendit do të bëhen pjesë e drejtimit të vendit dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e zhvillimin e tij. Prandaj, një brez me baza të shëndetshme, i përputhur

me vlerat kombëtare e universale, i cili ka marrë një edukim gjithëpërfshirës, do të luajë një rol efektiv në rritjen në mënyrë të shëndetshme të vendit dhe në integrimin më të lehtë të tij në botën moderne.

Periodha e universitetit përfaqëson, në aspektin e përfitimit në jetë dhe arsmimit të individit, periudhën më të ndjeshme të tij. Sipas Aslanturkës (2001, f. 159) të rinjtë që përfundojnë periudhën e rritjes biologjike, në të njëjtën kohë kompletohen edhe me normat e shoqërisë në të cilën bëhen pjesë. Veçanërisht, eksperiencat e jetuara në këtë periudhë, kanë një rëndësi edhe për formimin e karakterit. Faktikisht, në mënyrë specifike individët gjatë universitetit fillojnë të formojnë stilin në përgjithësi, përfshi atë të veshjes, pikëpamjet politike dhe filozofinë e jetës, që u përshtatet atyre.

Veçanërisht të rinjtë e sotëm përjetojnë në të njëjtën kohë shqetësimin dhe çlodhjen e ndarjes për herë të parë nga familja. Tashmë, në jetën e tyre nuk ekziston më një njeri, i cili të ndërhyjë në vendimet e tyre apo t'i kritikojë për to. Kjo situatë do të ndikojë në pasqyrimin e filozofisë së tyre për jetën dhe botëkuptimin realist që mbartin. Do të thurin grupe shoqërore të përshtatshme me strukturën e tyre të mendimeve dhe do të bëhen pjesë e grupeve shoqërore që u përshtaten. Do të përjetojnë marrëdhënie të reja emocionale të afërta me mendimet e ndjenjat e tyre. Tashmë, në këtë periudhë, fillojnë të krijohen dhe këndvështrimet e para politike, filozofia për jetën.

Ndërsa Gizir (2005, f. 210) pohon se të rinjtë e periudhës universitare përballen me vetëvendimmarrjen, sjelljen më idealiste përballë seksit të kundërt, kërkimin e mundësive të përshtatshme të punësimit sipas karakterit dhe aftësive përkatëse.

Në këtë pikë, duhet nënvizuar mirë fakti që periudha e universitetit përbën periudhën më kritike në edukimin e të rinjve. Arritja në pikën më kulmore të ndryshimeve fizike dhe emocionale dhe kalimi në një status të ndryshëm, duke i bërë ata përgjegjës të veprimeve dhe vendimeve të marra është shumë i rëndësishëm në vendosjen e gjykimeve morale dhe vlerave. Sepse, ato do të vazhdojnë jetën, do të krijojnë familje dhe do të marrin përsipër përgjegjësi në firmat, kur do të punojnë me anë të informacionit dhe eksperiencës së fituar në universitet.

Pas periudhës së komunizmit, Shqipëria ka përjetuar një ndryshim të shpejtë, ka edukuar njerëz të mendimeve të ndryshme në shumë fusha. Studentët, të cilët kanë bërë udhëtime, apo kanë studiuar jashtë vendit për një kohë të gjatë apo të shkurtër, kanë mbartur në Shqipëri, edhe stilin e jetesës dhe vlerat e fituara në vendet ku kanë studiuar.

Sipas Fugës, (2008, f. 321) si rregull, sa më i madh të jetë ndryshimi politik në një shoqëri sikurse mund të jetë kalimi nga një shoqëri e mbyllur totalitare drejt një shoqërie të hapur demokratike ose anasjelltas, aq më të mëdha janë edhe transformimet në marrëdhëniet midis njerëzve apo grupeve sociale dhe shoqërisë civile në varësi të ndryshimeve në shoqëri, pasi, nëse do të përballeshim me një kalim nga një shoqëri demokratike në një shoqëri totalitare, atëherë edhe transformimet në marrëdhëniet midis njerëzve apo grupeve sociale dhe shoqërisë civile do të ishin më të kufizuara për arsye të politikave totalitare, ose sikurse e themi ndryshe, aq më shumë ndryshon edhe tërësia e lidhjeve shoqërore midis grupeve shoqërore të interesuara. Sipas Fugës, (2008, f. 20):

“Qytetari shqiptar dukej se kishte grumbulluar për një kohë të gjatë brenda vetes, kishte zbrapsur thellë në skutat e vetëdijes të vërtetën e tij të pashprehur dhe ndërkaq, kur liria i shfaqej përpara, nuk mbaronte së foluri për të. U rrit dëshira për t’i dhënë diçka më shumë tjetrit. Në fakt, lind tjetri

si një objekt i parrezikshëm për të dialoguar. Ishte një bashkëbisedim pafund, që herë-herë mbetej një qëllim më vetvete.”

Kur flet për ‘Rënien e qytetit’, akademiku Artan Fuga vlerëson se duhet thënë se dendësia e popullsisë në hapësirat urbane, sidomos në Tiranë, ka bërë që ndërsa hapësira makrosociale njihet rritje dhe zgjerim, hapësira mikrosociale, ajo që rrethon njeriun në jetën e tij të përditshme urbane, është ngushtuar, tkurrur, bërë pra një territor gjithnjë e më i ngushtë, pra që jep më pak mundësi për punë, bën që të mirat materiale të ndahen në më shumë duar e frymë, dhe sidomos shkakton stres, sepse në lëvizjet e tyre njerëzit prodhojnë më shumë ndotje, më shumë zhurma, i bllokojnë pamjen njëri-tjetrit, krijojnë masa njerëzore pa njohje dhe pa lidhje mes tyre.

Sipas sociologut Zyhdi Dervishi, (2004) gjatë periudhës së regjimit socialist totalitar, veçanërisht gjatë viteve ’70 dhe viteve ’80, strukturat partiako-shtetërore i përforcuan gjithnjë e më shumë filtrat vetizoluese, të cilat e mënjanuan konsiderueshëm Republikën e Shqipërisë jo vetëm nga dukuritë disfunktionale të shoqërive të tjera, veçanërisht të atyre më të urbanizuara të Perëndimit, por edhe nga arritjet e tyre më të përparuara në të gjitha fushat e veprimtarisë. Vetizolimi u shoqërua dhe u përforcua nga psikoza etnocentrike të skajshme deri në kufijtë e absurditetit. Përmbysja e sistemit socialist në Shqipëri u shoqërua me kalimin nga vetizolimi bunkerizues drejt një hapjeje të plotë ndaj ndikimeve të vendeve të tjera. Procese të tilla komplekse, mjaft shqiptarë i përjetuan edhe si zhvendosje nga psikozat etnocentrike të skajshme drejt atyre ksenocentrike. “Në këtë ‘klime’ ndryshimesh të shpejta shoqërore, politike, ekonomike dhe psikokulturore, strukturat e komunikimit të shtetit shqiptar, si të thuash, i çmontuan filtrat me sita etnocentrizmi, gati të padepërtueshme, por nuk i zëvendësuan me filtra të tjerë, më fleksibël, të cilët përdoren përgjithësisht në marrëdhëniet ndërmjet shteteve me demokraci të

konsoliduar. Përvoja tregon se filtra të tilla ndihmojnë për të përzgjedhur dhe “modifikuar” nga kulturat e tjera ata elementë që i përshtaten më mirë kulturës kombëtare.”

Emigrimi ishte një ndër shfaqjet që binin më shumë në sy te shqiptarët e kësaj periudhe. “Brenda harkut kohor të pak viteve, ata ripërtërinë një traditë pothuajse krejt “të pezulluar”, nga regjimi totalitar gjatë viteve 1944-1990. Fluksi i emigrimit të shqiptarëve ka qenë i tillë, saqë Shqipëria sot renditet një ndër vendet me koeficient më të lartë emigrimi për frymë të popullsisë.”(Dervishi, 2003, f. 2)

Sjellje sociale të parastisura më parë në shoqërinë shqiptare ishin ato që dëmtuan ndjeshëm jetën sociale të familjeve shqiptare. Mungesa e filtrave për t'i mbajtur nën kontroll sjellje të tilla, si rendja pas lojrave të fatit, përdorimi i lëndëve narkotike, veçanërisht nga të rinjtë, rritja e shkallës së përhapjes së marrëdhënieve seksuale paramartesore e jashtëmartesore, sidomos e prostitucionit dhe e rrjedhøjave më shqetësuese, që nxiten prej tyre, si shtimi i virulencës së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, i infeksionit vdekjeprurës HIV-AIDS etj., kanë provokuar ndikime traumatizuese në shoqëri.

“Nga padija ose frustrimi, nga pakujdesia ose dëshpërimi, mjaft shqiptarë, veçanërisht në moshë të re, dashur pa dashur, si të thuash, flirtojnë me këto plagë. Flirte të tilla u kanë helmuar në mënyrë të pakthyeshme jetën jo vetëm këtyre “dashnorëve” fatkeqë, por edhe familjarëve, të afërmeve e miqve të tyre. Madje, si të thuash, edhe hija e flirteve të kësaj natyre ka tendosur të modifikuar gjithë sistemin e mentaliteteve të marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve, ka traumatizuar gjithë jetën e shoqërisë tonë.”
(Dervishi, 2004)

Mema, (2015) zhvillimet që ndodhën në shoqërinë shqiptare në periudhën paskomuniste i vlerëson pozitivisht, por së bashku me këtë nënvizon edhe faktin që kanë lindur një sërë problemesh. Ndryshimet në shoqërinë shqiptare sollën si

rrjedhje disa ndryshime në rrethanat politike, sociale, ekonomike, kulturore, shvendosjen e popullsisë, emigrimin ku kalimi nga një vend tejet i izoluar me një kufizim ekstrem lirie në një liri pa kufij, përballja me shumë situata e fenomene të panjohura më parë (droga, prostitucioni, krimi etj.) vunë në pikëpyetje vlerat, identitetin dhe personalitetin individual duke ndikuar dhe krijuar një konfuzion shoqëror të kushtëzuar nga mjaft faktorë.

Sipas Mustafajt (2015) Shqipëria pas rënies së regjimit komunist, edhe pse u përball me një sërë probleme, ajo po përparon në një mënyrë pozitive drejt rrugës së duhur, tashmë ajo është pjesë e organizatave ndërkombëtare si NATO dhe Bashkimi Evropian si një vend i civilizuar. Ruajtja e kësaj kahjeje (këtij trendi) është vlera kryesore e klasës politike udhëheqëse të Shqipërisë gjatë këtij çerek shekulli postkomunist. Në sajë të këtij trendi politik është ruajtur edhe trendi për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Përparimi i një vendi është i lidhur drejtëpërdrejt me zhvillimet politike të atij vendi, sa më e mirë të jetë klasa politike atij vendi aq më tepër do të përparojë në rrugën e demokracisë, mirëqenies dhe zhvillimit. Thelbi i kritikizmit mbi zhvillimet e brendshme në shoqërinë shqiptare, gjatë kësaj periudhe, ka të bëjë me ritmet e transformimeve që kupton ky trend dhe me cilësinë e procesit nëpërmjet të cilit do të realizoheshin këto transformime demokratike.

Në Shqipërinë demokratike të vitit 1992 akoma nuk ishte vendosur një sistem i ri, si pasojë e kësaj ka qenë i lartë numri i njerëzve të larguar jashtë vendit, qofshin këta me një bagazh inetelektual apo njerëz të thjeshtë. Në krye të vendeve të frekuentuara nga shqiptarët janë Italia, Greqia, Amerika dhe Kanadaja. Kaya (Kaya M. , 2009, f. 19) pohon se rrjedhja më e madhe e trurit ka ndodhur në vende si Jugosllavi, Shqipëri dhe Rumani.

Nga ana tjetër Baramidze shprehet, (2001, f. 19) në studimin e realizuar në vitin 1992 se bëhet e ditur se 23,3 % e të ardhurave totale të një familjeje në Shqipëri mundësohej nga dërgimet monetare (remitancat) të emigrantëve jashtë vendit. Sipas parashikimeve zyrtare, shuma totale e dërgimeve monetare të emigrantëve të cilët punonin në Itali dhe Greqi në vitin 1994 ishte 266 milion dollarë. Kjo shumë përbënte 16% të GDP-së të Shqipërisë dhe ishte një shenjë treguese e thellësisë së plagës së emigracionit.

Kjo dallgë emigracioni mund të shihej edhe në trajtën e një dhurate të majme për Shqipërinë. Tanseli dhe Gungöri (Gyngëri) (2004, f. 1) e shohin emigrimin e fuqisë punëtore të vendeve në zhvillim drejt vendeve të zhvilluara si një dhuratë me përfitim të lartë ekonomik për vendet në zhvillim. Kjo lëvizje masive dhe serioze drejt vendeve të tjera e përjetuar pas komunizmit tregon edhe një herë për vërtetësinë e këtij mendimi. Kushtet moderne të punës të mundësuar jashtë vendi, rrogat e larta, një stil më cilësor jetese janë disa nga shkaqet më kryesore të kësaj rrjedhjeje të parë të trurit. Në emigrimet e mëpasshme na shfaqen edhe shkaqe, si siguria apo mundësitë e arsimimit.

Sipas mendimit të Sotirofskit, (2011, f. 3-4) në qendër të lëvizjeve emigruese të shfaqura në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit qëndrojnë ndryshimet ekonomike dhe sociale. Sipas të dhënave të Qendrës kërkimore sociale e ekonomike afërsisht 50 % e intelektualëve, pedagogëve janë larguar nga Shqipëria në vitet' 90 dhe kanë plotësuar formimin e tyre në Evropë. 66% e personave, të cilët kanë përfunduar tezën e doktoraturës në Evropë dhe SHBA janë emigrues nga Shqipëria në vitin 1990, pas diplomimit nuk janë kthyer më në vendin e tyre. Në të vërtetë, edhe sot nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Shumë studentë të aftë, të cilët kanë mbaruar bachelorin apo masterin jashtë vendit vazhdojnë jetën e tyre atje.

Valën e migrimit që filloi me kalimin në demokraci dhe ndryshimet që ndodhën në shoqërinë tonë gazetari Dervishi (Dervishi L. , 2015) e përshkruan në këtë mënyrë:

Shqipëria ka qenë e mbyllur jo vetëm ndaj “Perëndimit”, por edhe ndaj fqinjëve. Një moment ekstrem është se u shpall edhe shteti vetëm ateist në botë. I rrënuar ekonomikisht, i rraskapitur shpirtërisht, vendi përjetoj një eksod të konsiderueshëm dhe vlerësohet se mbi 30% e popullsisë është larguar. Në vitin 2000 numri i personave që merrnin pjesë për llotarinë amerikane i kalonte 1 milionë! Ndarja e familjes, (numri i konsiderueshëm i divorceve erdhi nga emigrantë të vendosur në Greqi dhe Itali.) Në këto 25 vjet shoqëria po përpiqet të njohë rrënjët e veta (të prera dhunshëm) dhe në të njëjtën kohë të jetë në hapin e kohës. Tronditja e vlerave shoqërore, morale dhe etike është e pranishme edhe sot e kësaj dite.

Nga ana tjetër, si pretendente kandidate e Bashkimit Evropian, Shqipëria nuk ka marrë nën kontroll apo ka mbrojtur kulturën e saj kombëtare, strukturën demokratike përse i përket integritetit në botën moderne dhe si rrjedhojë është njohur më shpejt me botën demokratike, duke u bërë pjesë e procesit ndryshues në mënyrë më të shpejtë. Si pasojë e kësaj, nga njëra anë është krijuar një grup, i cili e vlerëson mirë ndryshimin pas komunizmit dhe nga ana tjetër një grup që nuk arrin t’i përshtatet ndryshimit. Vendi, i cili vazhdon rrugëtimin e tij në mes këtyre dy grupeve ka filluar të përballet me probleme të ndryshme, si mosmarrëveshjet familjare, dhuna ndaj gruas, vjedhjet, divorci etj.

Ndërkohë që Durkheim (1951, f. 386) e shpjegon vetëvrasjen si një nga problemet më të rëndësishme të botës moderne, ai pohon se shkak i vërtetë i vetëvrasjeve nuk qëndron në vështirësinë e vazhdimin të jetës, por në boshllëkun shpirtëror, në pavetëdijshmërinë në lidhje me nevojat dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

Përsëri sipas Durkheimit, (1951, f. 389) sot mund të flasim për dy veçoritë themelore të gjendjes tonë emocionale. Këto janë: mosgjatja e një fuqie (force) përtej fuqisë së njeriut dhe si rrjedhojë moslidhja e vetes me një rregull apo ligj të caktuar.

Padyshim që zotëruesit e kulturës më fisnike në gjeografinë ballkanase, shqiptarët, do të shpëtojnë sa më shpejt dhe në mënyrë të shëndetshme nga kjo gjendje. Nga njëra anë, duke përdorur forcën magjike të medias e nga ana tjetër duke përgatitur programe edukuese të fokusuara në fitimin e vlerave kombëtare e universale në çdo cikël arsimor. Mund të organizohen aktivitete të ndryshme dhe kërkime në terren në emër të përgatitjes së brezave të rinj me erën e ndryshimit. Në fund të studimit, do të paraqiten propozime konkrete në lidhje me këtë.

Studentët shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në universitete prestigjioze, emigrojnë nga qytetet e vogla në qytete të mëdha. Qytetet e mëdha janë shndërruar në qendra të mëdha, ku jetojnë njerëz të ardhur nga zona të ndryshme të vendit. Ndryshe nga vendi, ku janë rritur të rinjtë, mund të pasqyrojnë ndryshime në këndvështrimet morale dhe konceptimet e vlerave në këta vende, ku gjenden larg presionit të lagjes dhe kontrollit të familjes. Sigurisht që kjo nuk është veç pasojë e një emigrimi të thjeshtë. Sigurisht që kjo situatë ka lindur nga shumë faktorë dhe është produkt i një procesi të gjatë. Nisur nga ky fakt, studimi është shumë i rëndësishëm, përse i përket informacionit të përfituar në fund, përcaktimit të gjendjes ekzistente dhe sqarimit të prirjeve të së ardhmes.

1. 3. Supozimet mbi studimin

1. Supozohet që mjetet e përdora në mbledhjen e të dhënave në këtë studim kanë matur saktë veçoritë e kërkuara.

2. Supozohet që studentët pjesëmarrës në studim u janë përgjigjur drejt dhe në mënyrë të sigurtë pyetjeve të përdora nga mjetet në mbledhjen e të dhënave.

3. Është parë që studentët pjesëmarrës në studim zotërojnë aftësinë e realizimit të një studimi të tillë, aftësinë e përfaqësimit dhe vendimmarrjes.

1. 4. Kufijtë e studimit

1. Subjekt i këtij studimi janë studentët, të cilët ndoqën studimet në vitin 2014-2015 në “Universitetin e Tiranës”, në “Aleksandër Moisiu”, në “Aleksandër Xhuvani”, në “Luigj Gurakuqi” dhe në “Fan S. Noli”.

2. Ky studim kufizohet me mjetet matëse të përdorura.

3. Ky studim lidhet me “Aftësinë e gjykimit moral” si njësi matëse e sjelljeve të personit në aspektin moral.

1. 5. Problemet e studimit

Problemet e shfaqura në lidhje me objektivat e përmendura më sipër janë si më poshtë:

1. Në cilën periudhë zënë vend studentët e universitetit sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut (etapa paratradicionale, tradicionale apo pastradicionale)?

2. A ekzistojnë ndryshime midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve të viteve të para me ato të viteve të fundit?

3. A ekzistojnë ndryshime midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve sipas departamenteve dhe universiteteve?

4. A ekzistojnë ndryshime midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve sipas gjinisë dhe moshës?

5. A ekzistojnë ndryshime midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve sipas qëndrimit të prindërvetë tyre (autoritar, tolerant, indiferent)?

6. A ekziston ndonjë lidhje midis profesioneve të prindërve dhe niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve?

7. A ekziston ndonjë lidhje midis gjendjes ekonomike të familjes dhe niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve?

8. A ekziston ndonjë lidhje midis statusit arsimor të prindërve dhe niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve?

9. A ekziston ndonjë lidhje midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentit me zonën nga ka ardhur?

10. A ekziston ndonjë lidhje midis niveleve të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentit me shkollën e mesme, në të cilën ka mbaruar studimet?

11. A ndikon vendi (qytet/ zona rurale) ku studenti ka jetuar pjesën më të madhe të jetës në formimin e nivelit të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të tij?

12. A ndikon besimi fetar në formimin e nivelit të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentët?

13. A ndikon besimi fetar i prindërve në formimin e nivelit të pjekurisë morale dhe konceptimit të vlerave të studentët?

1. 6. Hipotezat e studimit

Njeriu është një qenie që i ka dhënë rëndësi kulturës së bashkëjetesës. Elementët kryesorë të kulturës së bashkëjetesës janë familja, farefisi, shoqëria dhe rrethi social

me të gjitha aspektet e tij. Në formësimin e personalitetit të njeriut krahas veçorive që burojnë nga natyra e njeriut tashmë është e vërtetë që ndikojnë edhe elementët e kulturës së bashkëjetesës.

Në thelb të punimit qëndron përcaktimi i elementëve psiko - socialë ndikues dhe masa e ndikimit të tyre.

Duke u nisur nga ky mendim në studimin tonë janë përcaktuar tri hipoteza kryesore, si më poshtë:

1- Sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut, konceptimet morale të studentëve në vija të përgjithshme janë në *nivelin tradicional*.

2- Në procesin e zhvillimit moral të studentëve të universitetit variablat e pavarur si; *gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, qëndrimet e prindërve ndaj femijëve, niveli arsimor i prindërve, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, lidhja e prindërve me fenë dhe lidhja e studentëve me fenë, a i kanë prindërit në jetë apo jo, vendi ku studenti ka kaluar pjesën më të madhe të tij kanë ndryshime më të theksuara se variablat e tjerë. Sipas variablave të pavarur ky ndryshim mendohet se do të realizohet në këtë mënyrë:*

- a- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të vajzave është më e lartë se ai i djemve, përse i përket gjinisë.
- b- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që janë në moshë më të madhe është më e lartë.
- c- Procesi arsimor-edukativ në universitet është lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me gjykimin. Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të

studentëve të vitit të fundit është më i lartë se gjykimi moral dhe konceptimi i vlerave të studentëve të vitit të parë.

- d- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që prindërit u jetojnë bashkë është më e lartë.
- e- Niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e vlerësonin qëndrimin e prindërve si demokratik (tolerant) ishte më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e cilësonin qëndrimin e prindërve të tyre si autoritar ose indiferent.
- f- Fëmijët të cilët i kanë prindërit me një nivel më të lartë arsimor zotërojnë gjykime më të larta morale.
- g- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve të ardhur nga shkollat e mesme private është më i lartë se niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve të ardhur nga shkolla të mesme të përgjithshme apo profesionale.
- h- Ekziston një lidhje pozitive midis lidhjes së studentëve me fenë me nivelet e pjekurisë morale dhe qasjen e vlerave.
- i- Ekziston një lidhje pozitive midis lidhjes fetare të prindërve me nivelet e pjekurisë morale dhe qasjen e vlerave të fëmijëve të tyre .
- j- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që i kanë prindërit në jetë është më i lartë se niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që nuk i kanë prindërit në jetë.

k- Niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që e kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës së tyre në qytet është më i lartë se niveli i pjekurisë morale dhe qasja e vlerave të studentëve që e kanë kaluar pjesën më të madhe në zona rurale.

3- Në formësimin e procesit të zhvillimit moral të studentëve, variablat e pavarur si, *universitetet, departamentet, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë* nuk kanë ndikim. Edhe pse midis nivelit të pjekurisë morale të grupeve të ilustrimeve ka ndryshime, sipas variablave të pavarur këto ndryshime janë në një strukturë heterogjene.

1. 6. Metoda e studimit

Në këtë pjesë janë analizuar të dhënat statistikore të marra nga analizimi i informacionit dhe metodave të ndjekura, mjetet e mbledhjes së të dhënave të përdorura gjatë kohës dhe ilustrimit të studimit.

1. 7. 1. Modeli i studimit

Në këtë studim do të analizohen faktorët, të cilët ndikojnë në ndryshimin e gjykimëve morale dhe konceptimit të vlerave të studentëve të universitetit dhe efektiviteti i tyre. Si rrjedhim, bazën teorike të këtij studimi e përbën një nga qasjet më të rëndësishme në lidhje me zhvillimin moral *Teoria e zhvillimit moral*. Për këtë arsye bazuar në *Teorinë e zhvillimit moral* të Kohlbergut për përcaktimin e nivelit të moralit të studentëve që studiojnë në universitetet shqiptare, jemi munduar të paraqesim një studim.

Gjykimet morale të njerëzve përbëjnë një koncept social. Si rrjedhojë, konceptet sociale duhen vëzhguar dhe shpjeguar. Mënyra më e mirë e bërjes së shpjegimit është metoda e “skanimit të literaturës”. Sipas Arslanoğlu (Arslanollusë), (2012, f. 14) studimet përshkruese rreth një teme të caktuar përcaktojnë se cilat janë konceptet dhe me çfarë mund të analizohen ato dhe jo me çfarë ka lidhje tema. Rezultatet e përftuara në fund të studimeve të tilla pasqyrohen duke përdorur disa grafikë duke treguar kështu se cilat janë lidhjet dhe sa është dendësia e tyre.

Metoda *Survey* e përdorur në studimin tonë është një *analizë regresioni*. Sipas Büyüköztürk (Byjyköztürk), (2012, f. 91) analiza regresion cilësohet procesi, ku pasqyrohet si një barazi matematikore, marrëdhënia në mes një variabli të varur me një të pavarur dhe ndryshimi mes tyre.

Variablat e pavarur të studimit janë universitetet, departamentet, gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, nëse prindërit janë në jetë apo jo, niveli arsimor i prindërve, qëndrimet e prindërve, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, studenti e ka kaluar pjesën më të madhe të jetës në qytet apo në zona rurale, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë, lidhja e prindërve me fenë dhe lidhja e studentëve me fenë. Variabli i varur është aftësia e gjykitimit moral.

1. 7. 2. Koha dhe ilustrimet

Koha e realizimit të studimit ishte viti akademik 2014-2015 në këto universitete: Universiteti i Tiranës, Durrës “Aleksandër Moisiu”, Elbasan “Aleksander Xhuvani”, Shkodër “Luigj Gurakuqi” dhe Korçë “Fan S. Noli”. Ilustrimi i studimit

përbëhet nga studentë të zgjedhur me anë të metodës Random te studentët e viteve të para dhe të fundit te këta universitete. Kjo anketë u është dërguar gjithsej 1851 studentëve të cilët studiojnë në 6 departamente të ndryshme. Nga këta vetëm 1799 studentë e kanë plotësuar atë. 52 studentë kanë marrë 8 ose më shumë pikë nga pika M (e kanë kuptuar keq testin ose janë përgjigjur gabim me dëshirë). Për këtë arsye nuk janë marrë në vlerësim. Sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, numri total i studentëve të viteve të para dhe të treta në universitet e studiuar është 82917. (Shih. Tabela 2) Kështu, anketa është realizuar në 2,16 % e studentëve që studiojnë në këto kurse . Studentët e marrë si shembull janë ndarë si më poshtë sipas universiteteve dhe departamenteve. Më poshtë do të gjeni tabelën me universitet, në të cilat është aplikuar anketa. Anketuesit janë ndarë sipas gjinisë për çdo departament përkatës.

Tabela2: Numri total i studentëve të viteve të para dhe të treta në universitet e studiuar

Univer siteti	Departamenti											
	Mësuesi për arsimin fillor		Psikologji		Anglisht		Sociologji		Gjuhë dhe letërsi		Gazetari	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Tiranës					208/307 T:708	38/84 T:163	77/73 T:229	7/8 T:21	125/118 T:367	5/5 T:19	68/72 T:214	23/13 T:53
Luigj Guraku qi			54/46 T:168	8/2 T:19	79/89 T:250	3/55 T:94			84/55 T:205	20/7 T:35		
Aleksan dër Moisiu	49/303 T:421	0/8 T:9			45/208 T:340	10/94 T:118	49/168 T:311	1/22 T:29				
Fan S. Noli	46/30 T:115	8/15 T:60					35/57 T:136	35/40 T:97	45/118 T:240	15/43 T:78		
Aleksan dër Xhuvani	111/64 T:248	1/15 T:28			92/119 T:306	55/9 T:189			103/172 T:372	24/28 T:70		

Total: 82917

1. 7. 3. Mjetet e mbledhjes së të dhënave

Si mjet për mbledhjen e të dhënave është përdorur testi i përcaktimit të vlerave DIT. (Defining Issues Test) i zhvilluar nga James Rest (1979) në përcaktimin e

niveleve të zhvillimit moral, si një variable i varur. Ndërsa si variabël i pavarur është përdorur formulari personal i zhvilluar nga kërkuesi për të përcaktuar disa veçori individuale. Ja disa të dhëna rreth mjeteve të përdora në mbledhjen e të dhënave:

1. 7. 3. 1. Testi i përcaktimit të vlerave (DIT)

Sipas Cesurit (Xhesurit), (2010, f. 1663) testi i përcaktimit të vlerave është një test i mbështetur në modelin e zhvillimit moral të Kohlbergut. James Rest është personi, i cili ka krijuar dhe zhvilluar testin. Testi DIT (Defining Issues Test) përdoret si një mënyrë zgjedhjeje masive për të matur zhvillimin moral. Përdorimi i testit DIT në më shumë se 20 shtete dhe arritja e rezultateve të ngjashme, përtaqëson përkjet zhvillimit moral të individëve tregon edhe njëherë vlefshmërinë e tij në kultura të ndryshme.

Sipas Martinit, (1977, f. 461) në testin e përcaktimit të vlerave ka 6 histori të përdorura në matjen e gjendjes së gjykimit moral të personit. Më poshtë po japim 6 historitë e treguara në DIT., kuptimin e tyre dhe llojin e vlerës së matur.

1. Heinz dhe ilaçi (Heinz and the drug): të drejtat e pronës \ vlera e jetës së njeriut.
2. Protesta e studentit (Student Take over): Mosbindje civile \ autoritet ligjor.
3. I burgosuri i arratisur (Escaped prisoner): Vendimi i ligjit \ qëllimi i ligjit.
4. Dilema e doktorit (Doctor's dilemma): Çështja otenazi.
5. Gazeta (Newspaper): Liria e shprehjes \ autoriteti i pozicionuar.
6. Webster (Webster): Mundësi të njëjta \ të drejtat e pronës

Në studimin tonë kemi përdorur vetëm 4 nga historitë e mësipërme. Shkaku i moszgjedhjes së 2 historive të tjera është mospërshtatja me kushtet e vendit dhe moskuptimi i tyre. Tek 4 historitë e tjera kemi bërë ca ndryshime të vogla për

kuptimin sa më të qartë e të lehtë nga studentët shqiptarë. Kemi realizuar testin e sigurisë dhe të vlefshmërisë të studentit e vitit të fundit të dy shkollave të mesme në qendër të Tiranës. Arritja e një rezultati të përshtatshëm me teorinë e zhvillimit moral të Kohlbergut na shtyu në praktikimin e saj. Ndryshimet e bëra, ashtu siç tregohet në shtojcën 1, janë realizuar në trajtën e mosprishjes së logjikës së përgjithshme. Zgjedhja në mes 6 historive të DIT është bërë si më poshtë:

1. Heinz dhe ilaçi (Heinz and the drug): Të drejtat e pronës \ vlera e jetës së njeriut
2. I burgosuri i arratisur (Escaped prisoner): Vendimi i ligjit \ qëllimi i ligjit
3. Dilema e doktorit (doctors dilemma): Çështja otenazia
4. Erlis (Webster). Mundësi të njëjta të drejtat e pronës.

Sipas Restit, (1979, f. 93-102) në secilën prej historive të zgjedhura gjenden 12 mendime, të cilat pasqyrojnë gjykime të ndryshme të lidhura me njëra-tjetrën. Të marra nga matësja Likert, personat të cilët është aplikuar testi kanë të drejtën e zgjedhjes në mes mundësive të dhëna: nuk jam aspak dakord; nuk jam dakord; jam neutral; jam dakord; jam shumë dakord. Më pas, nga këto 12 alternativa zgjedhim 4 më të rëndësishmet, duke i radhitur si i pari i rëndësishëm, i dyti i rëndësishëm, i treti i rëndësishëm, i katërti i rëndësishëm. Pikët e fituara nga të anketuarit tregojnë nivelet e zhvillimit të gjykimit moral, 2,3,4, 5A, 5B dhe 6. Mbledhja nga çdo i anketuar i pikëve, të cilët i përkasin etapave 5A, 5B, dhe 6 rezulton pikën P. Pika P tregon se gjendja morale e personit i përket etapës 5 dhe 6. Thënë ndryshe, pranon etapën pastradicionale të gjykimit moral të Kohlbergut.

Periodha tradicionale mbi të cilën fokusohet studimi ynë përftohet duke mbledhur pikët e etapës së 3-të dhe të 4-t. Në studimin tonë janë vlerësuar pikët P të

përfutuara nga etapat 5A, 5B dhe 6 të përdora me qëllimin e matjes së zhvillimit moral në etapën tradicionale dhe pastradicionale të Kohlbergut te studentët shqiptarë.

Universiteti Minnesota akoma sot e përdor këtë test. Universiteti ka themeluar një qendër në lidhje me këtë temë, emri i së cilës është *Center for the study of ethical development*. Sipas Cesurit, (2010, f. 1665) studimet e kësaj qendre, e cila mund të cilësohet si neokohlbergiste ose qëndrim Minnesota e kanë shpjeguar moralin me anë të një seti me 4 përbërës ndryshe nga psikologjitë etike me një variabël. Sipas kësaj teorie, etika përbëhet nga *ndjeshmëria, gjykimi, motivimi dhe karakteri etik*.

1. 7. 3. 1. 1. Pikët e testit në përcaktimin e vlerave

Sipas Restit, (1979, f. 93-102) ndërkohë që përgatitim pikët për testin e përcaktimit të vlerave për çdo student, përgatitet një fletëpërgjigjeje, ku përcaktohen pikët e etapave 2, 3, 4, 5A, 5B, 6A, M, dhe P për 6 historitë. Për pjesët e radhitura në fund të inventarit “*më e rëndësishmja*”, “*e dyta e rëndësishme*”, “*e treta e rëndësishme*” dhe “*e katërta e rëndësishme*” përcaktohen se cilës etapë i përket. Duke dhënë 4 pikë për radhitjen më të rëndësishme, 3 pikë për të dytën të rëndësishme, 2 pikë për të tretën të rëndësishme dhe 1 pikë për të katërtën të rëndësishme përcaktohet përshtatshmëria e 4 historive për çdo etapë dhe shkruhet në një letër të dhënash. Studenti mund të ketë bërë zgjedhje të njëjta në të njëjtën etapë për çfarëdolloj historie, në këtë rast 2 pikë i shtohen shtyllave të etapës. Më pas, në letrën e përgjigjeve mblidhen pikët në çdo shtyllë të çdo etape dhe kështu zbulohen pikët e etapave 2, 3, 4, 5A, 5B, 6A dhe M. Duke mbledhur pikët e etapave 5A, 5B dhe 6A, duke i ndarë me numrin e historive të aplikuara, përfitojmë përqindjen e etapave.

1. 7. 3. 1. 2. Prova e vlefshmërisë e testit të përcaktimit të vlerave

Kaya (Kaya M. , 1993, f. 69) jep shpjegimin e tij për vlefshmërinë e testit të përcaktimit të vlerave sipas katër grupeve të mëposhtme:

1. Vlefshmëria e kritereve në grup (Criterion group): Qëllimi i vlefshmërisë së grupit është arritja e pikëve të ndryshme në fund të testit nga grupe të ndryshme. Për të matur vlefshmërinë, testi DIT i është dhënë një grupi studentësh, të cilët bëjnë doktoraturën në shkenca filozofike dhe politike dhe rezultatet kanë pasqyruar ndryshimin e këtyre dy grupeve.

2. Vlefshmëria e ndryshimit horizontal (Longitudinal change): Me praktikimin e Test Rest nga ana e Davison dhe Robbins (1978), te të anketuarit është vënë re një zhvillim i caktuar. Studimet horizontale të DIT kanë pasqyruar zhvillim tek 66% e të anketuarve dhe tërheqje prapa tek 7 % prej tyre. Ky zhvillim është parë i lidhur më shumë me ndryshimin ontogenetik sesa me atë kulturor.

3. Vlefshmëria e matësve të ngjashëm: Ndërkohë që marrëdhënia në mes mjeteve të tjera matëse të etikës me “testin e kuptimit të gjykimeve morale” dhe testeve të ndryshme të Kohlbergut me DIT, është $r=70$ testet e tjera të zhvillimit mendor dhe zgjuarsisë janë $r=50$.

4. Rritja eksperimentale (ekperimental enhancement): një studim i realizuar në këtë fushë ka krahasuar studentët etikë me ata logjikë dhe është parë se studentët logjikë kanë shënuar rritje në testin e logjikës, ndërsa ata etikë kanë shënuar rritjen në testin DIT.

1. 7. 3. 1. 3. Prova e sigurisë e testit të përcaktimit të vlerave

Për realizimin e testit të përcaktimit të vlerave janë ndërmarrë masa të ndryshme sigurie. Sipas Kayas, (Kaya M. , 1993, f. 70) në fund të provës së sigurisë të realizuar nga Davison dhe Robbins (1978) mbi 1080 pjesëmarrës të grupmoshave 15 me 82, në provat e testit të bërë për pikët P dhe D dhe testit të përsëritur, koeficienti i korelacionit ka qenë 80, koeficienti i indeksit alfa të Cronbach ka qenë 70.

Në një provë tjetër sigurie të realizuar mbi një grup studentësh të përbërë nga 35 veta është gjetur koeficienti i sigurisë 81 nga përsëritja e testit pas një periudhe kohore prej 3 javësh. Sipas rezultateve të përfutuara është arritur në përfundimin se testi i përcaktimit të vlerave është mjaftueshëm i sigurtë. (Kaya M. , 1993, f. 30)

1. 7. 3. 2. Formulari individual

Ky formular përbëhet nga 20 pyetje të përgatitura nga kërkuesi nisur nga mendimi se mund të ekzistojë një lidhje në mes veçorive personale të studentëve të universitetit me gjykimet e tyre morale.

Në formimin e formularit janë analizuar studime dhe shkrime në lidhje me zhvillimin etik dhe vlerat, janë parë mendimet e specialistëve në lidhje me temën, mendimet e akademikëve të mëparshëm, të cilët kanë realizuar studime të ngjashme dhe është menduar se mund të përdoren si komponentë krahasues në përfitim të informacionit të dhënave në lidhje me studentin, universitetet, departamentet, gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, nëse prindërit janë në jetë apo jo, niveli arsimor i prindërve, qëndrimet e prindërve, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, studenti e ka kaluar pjesën më të madhe të jetës në qytet apo zona rurale, qëndrimi i prindërve, lloji i shkollës së mesme që ka

përfunduar, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë, lidhja e prindërve me fenë dhe lidhja e studentëve me fenë, me gjykimet morale dhe vlerat.

1. 7. 3. 3. Intervista

Testi që do të përdorim DIT (testi për përcaktimin e vlerave) për të matur konceptimet e vlerave morale të studentëve të universiteteve është një test cilësor. Nga ana tjetër tema jonë ka edhe drejtim sasior. Për këtë arsye duke marrë parasysh edhe rëndësinë e kësaj teme me qëllim arritjen e një ekuilibri midis mjeteve matëse në studimin tonë kemi aplikuar edhe metodën e intervistës.

Për këtë arsye kemi zgjedhur 11 persona nga shtresa të ndryshme të shoqërisë që mendojmë se mund të na ndriçojnë mbi këtë temë. Janë realizuar intervistat me këta persona intervistat përbëhen nga 5 pyetje të ndryshme të hartuara paraprakisht. Dokumentet në lidhje me pyetjet e pyetura dhe përgjigjet ndaj personave që janë intervistuar ndodhen në shtojcën numër 3.

1. 7. 4. Mbledhja e të dhënave

Aplikimi i Definin Issues Test (Testit të përcaktimit të vlerave) dhe formularit personal të përdorur në studim është realizuar gjatë vitit akademik 2014-2015 në muajt shkurt dhe mars. Aplikimet janë realizuar nga ana e vetë kërkuesit dhe kanë zgjatur 2 muaj. Para bërjes së aplikimeve përkatëse, kërkuesi ka marrë lejet e nevojshme nga drejtuesit e universiteteve. Aplikimi i dy mjeteve matëse është realizuar në klasat dhe orët e caktuara të mësimi. Para fillimit të aplikimit, studentit janë sqaruar në lidhje me qëllimin e studimit, mjetet e mbledhjes së të dhënave dhe mënyrën sesi duhet t'i përgjigjen inventarit. Më pas, studentëve u janë dorëzuar Testi

i përcaktimit të vlerave dhe formulari personal dhe janë vëzhguar për 30-35 min për përgjigjet e testit.

1. 7. 5. Analiza statistikore e të dhënave

Pas aplikimit të mjeteve mbledhëse të të dhënave të përdora në studim, fletët e përgjigjeve të testit të përcaktimit të vlerave dhe formularit personal janë kontrolluar një nga një, duke mos u marrë parasysh testet e mangëta dhe ato të plotësuara gabim. Krahas kësaj edhe fletët e përgjigjeve, të cilat nuk kanë arritur kufirin e pikëve të kalueshme nuk janë vlerësuar.

Nuk janë vlerësuar edhe inventarët, ku personi ka dhënë përgjigje të paekuilibruara në një apo më shumë histori apo u ka dhënë përgjigje në të njëjtën mënyrë pesë apo më shumë pikave. Në etapën e parë të vlerësimit është vlerësuar me dorë testi i përcaktimit të vlerave. Të dhënat e lidhura me faktorët ndryshues të formularit personal dhe Testi i përcaktimit të vlerave janë kaluar në tabelat e koduara të informacionit nga ana e kërkuesit. Në një etapë më pas, të dhënat janë analizuar duke përdorur një program të veçantë për këtë studim.

KAPITULLI II

KONCEPTET E KËRKIMIT

2. 1. Konceptet e kërkimit

Konceptet themelore të përdorura në këtë studim janë të përcaktuara si më poshtë:

2. 1. 1. Morali

Sipas Weilit, (2014) fjala “moral”, e përdorur në kuptimin e moralit në gjuhën angleze rrjedh nga fjala latine “moralis”. Fjala moralis është përdorur për herë të parë nga Ciceroni në gjuhën greke në këmbim të fjalës "etika" në gjuhën latine.

Sipas Özenit (Ëzenit), (2012, f. 171) kuptimi i moralit në filozofi, ka dalë në pah duke kërkuar përgjigjet e pyetjeve “Çfarë është mirë?” dhe “Si mund të bëhesh i mirë?”. Pyetjet “Çfarë do të thotë të jesh i mirë?”, “sipas mendimit të kujt jemi të mirë?”, “Cilat janë sjelljet që na bëjnë ne të jemi të mirë dhe cilat janë sjelljet që na bëjnë ne të jemi të këqinj?”, “Për cilët persona shprehem, sa i mirë që është ose sa i keq që është?, janë pyetje që filozofët janë përpjekur t’u japin shpjegime duke u nisur nga dukuritë morale.

Sipas Güngörit (Gyngërit), (1993, f. 18) filozofët kanë zhvilluar tri lloj perspektivash në lidhje me përmbajtjen e fjalës “mirë” ose “e drejtë”. Sipas disa filozofëve, “kur themi se një gjë është e mirë, asaj i përcaktojmë një cilësi të caktuar. Sipas disa filozofëve të tjerë, një person që e cilëson një gjë si të mirë, ai ka shprehur ndjenjat e tij. Ndërsa sipas një grupi të tretë filozofësh, konceptet morale konsiderohen si urdhra dhe komanda që u janë dhënë të tjerëve që të sillen në një mënyrë të caktuar. Kur themi se një gjë e caktuar është gjë e mirë, faktikisht do të thotë bëjeni atë gjë ose keni respekt ndaj asaj gjëje.

Sipas Aristotelit, (1999, f. 22) të vepruarit në harmoni me mendjen është në harmoni me virtytet. Njeriu arrin në nivelin më të lartë të virtutit duke bërë përpjekje të vazhdueshme, duke mësuar dhe duke i vënë në jetë ato që ka mësuar.

Sipas Çubukçus, (1972, f. 13) te *stoikët*, qëllimi i moralit është arritja e të shprehurit e harmonisë ndërmjet njeriut dhe natyrës. Për këtë arsye, veprimet e njeriut duhet të jenë brenda kornizës së logjikës. Sipas stoikëve, njeri i ditur është ai njeri që vepron duke u bazuar në përputhshmëri të plotë me logjikën e mendjes së tij. Çubukçu shprehet se, sipas Epikurit, sjelljet janë ato që përbëjnë vlerën e moralit dhe të cilat e bëjnë të lumtur njeriun dhe se njeriu nuk duhet të ketë frikë nga vdekja dhe jeta e përtejme .

Taşözi (2012, f. 10) shprehet se, kuptimi i nocionit moral sipas Sokratit është:

“Njohja e mirësisë sjell si pasojë zbatimin e saj në mënyrë të detyruar. E keqja është injorancë. Askush nuk bën keq me vetëdije”. Sipas Platonit, ajo që është e rëndësishme te morali është arritja e mirësisë superiore. Lumturia nuk është për këtë botë dhe arrihet vetëm me kënaqësitë që i përkasin botës së përherëshme. Sipas Spencerit, moral do të thotë të sillesh në përputhshmëri me traditat dhe rregullat e vendit ku jeton. Ndërsa Kanti e përshkruan moralin si nevojë dhe detyrim. “Përderisa njeriu e vendos vetë ligjin e tij, atëherë ai është i lirë dhe për rrjedhojë është një njeri me moral.”

Gjithashtu Taşöz, (2012, f. 8) në një përkufizim tjetër e përshkruan “moralin si mënyrë sjelljeje shoqërore, që e ka burimin nga individi dhe që individi e ka rregulluar në jetën e tij të brendshme. Morali sipas tij na shfaqet si mburojë vlerash, si dhe formë reflektimi të individit i mënyrave të sjelljes, të përcaktuara nga shoqëria dhe përcjellja e tyre brezave të ardhshëm.”

Një përkufizim tjetër i moralit është bërë në *Fjalorin e termave filozofikë* të Bedia Akarsusë. Akarsu (1984, f. 13) e përshkruan moralin si,

“Tërësia e rregullave etike të sjelljes, të ligjeve dhe të parimeve të miratuara në një kohë të caktuar nga grupe të caktuara të shoqërisë njerëzore, që rregullojnë marrëdhëniet e individëve me njëri-tjetrin; fusha e vlerave morale, qëllimi dhe përmbajtja e të cilave ndryshon ose tërësia e rregullave të veprimeve që janë zgjedhur nga një person ose nga një grup i shoqërisë njerëzore në shoqëri dhe epoka të ndryshme.”

Sipas mendimit të Hançerlioğlusë (Hançerliolusë), (1993, f. 11) “moraliteti është gjendja e vetëdijshme shoqërore dhe tërësia e rregullave të vlefshme individuale dhe kolektive në një kohë të caktuar të një shoqërie të caktuar.”

Këtu pika që na tërheq vëmendjen, nuk është ajo që moraliteti është një ligj, një rregull i përkohshëm, por ajo që moraliteti përfshin të gjitha rregullat e një shoqërie që i përkasin një periudhe të caktuar, të drejta ose të gabuara qofshin ato.

Sipas Pieperit, (1999, f. 17) moraliteti ka lindur si rrjedhojë e marrëdhënieve njerëzore. Si rezultat i këtyre marrëdhënieve, njerëzit pranojnë njëri-tjetrin dhe lind respekti ndërmjet tyre. Prandaj, ky respekt dhe pranim sjell dhe një sërë sanksionesh. Duke u nisur nga kjo, mund të themi që moraliteti është mënyra e jetesës së një shoqërie, një formë e institucionalizuar e vlerave të mirëkuptimit.

Aydın (Ajdini), (Aydın C. H., 2003, f. 126) i shpjegon në këtë mënyrë aspektet psikologjike dhe sociologjike të moralitetit:

“Në aspektin psikologjik, moraliteti formëson sjelljet e personit, dhe formësohet nga besimi, qëndrimet, zakonet, ndjenjat, prirjet Moraliteti është tërësia e sjelljeve që mund të vlerësohen pozitive ose negative të një personi. Në aspektin sociologjik, moraliteti përkufizohet si tërësia e rregullave, parimeve dhe besimeve, që rregullon marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe që është miratuar me kalimin e kohës nga shoqëritë njerëzore”.

Mendimi i İnami (1999, f. 71) për moralitetin është: “Njerëzit që përpiqen të jenë të suksesshëm për të bashkëjetuar. Një ditë, kur ta kuptojnë se problemet e tyre nuk

mund t'i zgjidhin vetëm me pikëpamje politike, juridike, sociologjike, psikologjike, atëherë, ata do të mendojnë me më shumë rëndësi t'i drejtohen një fushe tjetër.”

Binbaşioğlu (Binbashollu), (1992, f. 186) duke tërhequr vëmendjen te dimensionin zakonor i moralit, citon se morali nxit personin që të respektojë zakonet e vendit ku jeton, ose e thënë ndryshe, morali përbën tërësinë e rregullave që respektohen. Prandaj, si rezultat i respektimit të këtyre rregullave, personi integrohet në shoqërinë ku ai jeton dhe arrin të bëjë një jetë të lumtur.

Ndërsa sipas Ustas, (2011, f. 42) morali është një zë i brendshëm, që e drejton njeriun tek e drejta. Morali është kontrollimi i vetvetes si të ishte një person me sistem vetëkontrolli. Në arritjen e këtij kontrolli, roli i mendjes dhe superegos është i madh. Të kesh virtyte, të ndihmosh të tjerët dhe drejtësia janë sjellje që përshihen në konceptin e moralit. Kur njeriu të gjykojë veten e tij dhe të arrij të sundojë veten e tij, në këtë rast, morali përbën lirinë. Në këtë kuptim, morali është tërësia e gjërave që individi i ka ndaluar vetes së tij ose që i ka pranuar për veten e tij.

Bergson (1935, f. 46-50) mendon se ka dy lloje morali: *zakon i mbyllur* dhe *zakon i hapur*. Zakoni i mbyllur lind si rrjedhojë e presioneve të shoqërisë dhe nuk përmban ndonjë aspekt vetjak. Bazohet te disa gjëra të ndaluara. Ndërsa zakoni i hapur është të vlerësosh mendimet e tua dhe të tjerëve duke i patur parasysh ato dhe mbart më shumë vlera universale. Ky lloj zakoni nuk është i ashpër dhe fleksibël si tjetri. Në formësimin e këtij zakoni luan rol dhe zgjuarsia e individit. Një zakon i tillë mbart vlera krijuese.

Pavarësisht faktit që Bergson e ka cilësuar moralin si zakon i mbyllur dhe zakon i hapur, marrëdhëniet e moralit me traditën dhe zakonet është bërë temë diskutimi nga sociologët. Sepse, morali nuk mbart vetëm aspekte zakonore, por në të njëjtën kohë, brenda konceptit të tij përfshihen edhe disa segmente të fushës fetare

dhe asaj juridike. Si rrjedhojë, këto disiplina përmbajnë sanksione mjaft të ndryshme nga njëra- tjetra. Prandaj, nëse do të bënim lidhjen e traditave dhe zakoneve me moralin është e nevojshme përcaktimi i kufijve në lidhje me këtë fushë.

Sipas Taşözit (2012, f. 18), në çdo shoqëri ekzistojnë disa rregulla që rregullojnë sjelljet e njeriut. Rregullave që nuk u dihet autori dhe koha e krijimit në i quajmë tradita dhe zakone. Ndryshimi mes rregullave morale dhe traditave e zakoneve, edhe pse rregullat morale janë një sistem urdhërash dhe sanksionesh që i përkasin marrëdhënieve ndërmjet personave, traditat dhe zakonet të gjitha ngjarjet sociologjike i përfshijnë të pandara në brendësinë e tyre. Sipas sociologëve që e shikojnë moralin të lidhur ngushtë me traditat e zakonet për të ruajtur vlerat morale dhe shoqërinë, tradita dhe zakonet përbëjnë domosdoshmëri. Sipas këtyre sociologëve, tradita dhe zakonet janë të domosdoshme në një shoqëri dhe paralelisht me zhvillimet e reja duhet të na paraqiten si një vlerë e re.

Ekşi (Ekshiu) (2006, f. 30) shprehet se sipas Kohlbergut, morali në temat e drejtë-e gabuar, mirë-keq i referohet një strukture njohëse që përmban gjykim të vetëdijshëm, vendimmarrje dhe sjellje që lindin si rrjedhojë e këtyre vendimeve. Pika që na tërheq më shumë vëmendjen në këto struktura njohëse është kapaciteti i njeriut për të arsyetuar.

Duke u nisur nga fusha që mbulojnë, të gjitha religjionet kanë opinionin, pikëpamjet dhe kuptimet e tyre etike në lidhje me moralin. Duke qenë se në Shqipëri ekzistojnë bazat e kësaj, mendoj se do të ishte e udhës të përmendim në mënyrë të shkurtuar pikëpamjet e myslimanizmit dhe kristianizmit në lidhje me këtë temë.

Mendimet në lidhje me moralin, sipas burimeve myslimane, mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

Në kuptim të përgjithshëm, mendimi i islamit rreth moralit është kryerja e veprave të mira dhe qëndrimi larg veprave të këqija. Të gjithë njerëzit lindin në të njëjtën natyrshmëri. Natyrshmëria e të gjithë njerëzve është e pastër. Për këtë arsye, fëmijët e moshave të vogla nuk kryejnë gjëra të këqija me vetëdije dhe me dëshirë. Duke u nisur nga fakti se natyrshmëria e tyre nuk i lejon ata që të kryejnë veprime të këqija, fëmijët nuk janë përgjegjës për veprimet e tyre. Pastaj, ata formësojnë jetën e tyre nën ndikimin e mjedisit ku ata jetojnë dhe familjes së tyre duke fituar një natyrshmëri tjetër.

Sipas Taşözit, (2012, f. 14) në fenë islame të gjithë janë përgjegjës për veprat e mira dhe veprat e këqija të tyre para Zotit. Është i vlefshëm rregulli “Çdo njeri fiton vetëm llogarinë e tij, çdo njeriu i ngarkohen vetëm mëkatet e tij”. Gjithashtu në Islam, ajo që pohohet me gojë është e detyrueshme të miratohet me zemër. Pra thelbi, fjala dhe veprat duhet të jenë një, në përputhshmëri të plotë me njëra-tjetrën. Në Islam mbizotëron koncepti “Çdo njeri lind në një natyrë të sigurtë krijimi”. Në këtë mënyrë, individët kanë përgjegjësi në raport me mendjen që ata zotërojnë. Nga ana tjetër, një nga parimet e fesë islame është paqja. Parimi “Nuk ka dhunë në fe” është tregues i rëndësishëm që tregon se individët i zgjedhin me vullnetin e lirë të tyre veprimet dhe mënyrën e jetesës. Marrja shembull e jetës së profetit të fesë islame nga ana e myslimanëve të tjerë dhe thënia e profetit “Unë jam dërguar vetëm për të përosur moralin e bukur” ka mjaft ndikim në formësimin e jetës së besimtarëve dhe në formimin e koncepteve të moralit.

Në Islam është thelbësore që njerëzit të jenë personalitet shembull në komunitetin ku ata jetojnë. Kjo arrihet nëse ata janë të pajisur me cilësi të larta morali. Myslymanët që kanë mangësira morale dhe që nuk janë personalitete shembull në komunitetin ku ata jetojnë, kanë mangësi në besimin e tyre. Sepse thënia e profetit

“Unë jam dërguar vetëm për të përsosur moralin e bukur” është treguesi i rëndësisë së moralit që ngrihet në nivelet më të larta. Në qoftë se feja e një profeti urdhëron që të jemi të moralshëm, është më se e natyrshme të shpjegohet edhe rruga e mënyrat e arritjes së niveleve më të larta të moralit.

Sipas Erdemit, (1990, f. 233) në fenë kristiane morali mbart një cilësi mbinatyrore. Principet e këtij morali i mbështeten plotësisht një “sekreti” mistik. Njeriu sjelljet morale nuk i bën për arsyen se i duken të logjikshme ose se i gjykon si të mira, por për arsyen se i beson dhe i shikon si një detyrim ndaj besimit. Ashtu si në besimin mysliman dhe hebraik, edhe në besimin kristian, Perëndia është parim moral. Perëndia gjen qetësi vetëm në zemrën e njeriut, i cili duhet ta mbajë gjithmonë të pastër zemrën, sepse ajo është pikëshikimi dhe vendbanimi i Perëndisë, duhet të përpiqet të jetë i pastër dhe i përkryer si Perëndia.

Në lidhje me temën e përmbajtjes së moralit të njerëzve në burimet e besimit kristian ka mendime të ndryshme. Kur shqyrtojmë teoritë që kanë të bëjnë me moralin, do të ndeshim tri teori të mëdha. Sipas Frankelit, (2012, f. 52) teoria e parë është e mbrojtur nga Shën Agustini, të cilën e mbrojnë dhe teologët: “Doktrina e larjes së mëkatit dhe natyrës mëkatore” ose “Doktrina e mëkatit të parë”. Sipas kësaj doktrine fëmijët lindin si krijesa mëkatore. Prandaj, e vetmja rrugë shpëtimtare e shpirtit është një ndërhyrje me vlera të shenjta dhe materiale në moshë të re të individit nga të rriturit.

Sipas Byrnesë, (1997, f. 179) teoria e dytë është doktrina që përfaqësohet nga Jean-Jacques Rousseau (Zhan Zhak Ruso), e cila quhet “Doktrina e pafajsisë natyrore”. Sipas kësaj doktrine, fëmijët lindin të pafajshëm dhe sjellejet amorale i fitojnë duke u ndikuar nga të rriturit. Në kah të kundërt të teorisë së sipërmendur, në edukimin e fëmijëve, ndërhyrja e të rriturve duhet të jetë në nivelet më të ulëta.

Ndërsa sipas Puckett (Puketit) dhe Diffily (Difilisë), (2003, f. 41) doktrina e tretë është ajo e themeluar nga John Locke (Xhon Loku) “Tabela e pashkruar (Tabula Rasa)”. Sipas kësaj teorie, fëmijët janë në një gjendje neutrale. Pra, as amoralë, as të pafajshëm, por ata vijnë në jetë në një strukturë të pastër. Arsimimi dhe mënyra e jetesës janë faktorë të mëvonshëm, që e bëjnë njeriun të drejtë ose mëkatar.

2. 1. 1. 1. Morali universal

E vërteta më e madhe që kemi hasur në këtë pjesë të shekullit XXI është ndryshimi gjeografik brenda të cilit jemi. Kryefjala e këtij ndryshimi nuk është vlerësimi i tij si pozitiv ose negativ, por është përjetimi i një ndryshimi absolut. Pika më e ndjeshme e këtij ndryshimi është se nga pamundësia e kontrollit të këtij procesi të kemi lindjen e rezultateve të mundimshme.

Drejtimi kryesor i këtij ndryshimi është mbartja e vlerave universale. Përballja me probleme morale të njëjta të popujve të ndryshëm, krijon mendimin e një ekzistence të një krize morale në kuptimin universal. Në të gjithë botën, përballja me probleme, si: dhuna ndaj grave, të drejtat e njeriut, e drejta sociale, kumari, prostitucioni etj. tregon se ky mendim i krijuar është i drejtë.

Një nga zgjidhjet e këtij problemi shekullor është mbajtja gjallë e vlerave universale, përdorimi i aktiviteteve arsimore për t’i shpjeguar komunitetit rëndësinë e kësaj çështjeje. Sipas Arslanit, (2010, f. 41) problemeve të moralit me profil global, iu duhen gjetur zgjidhje globale. Prandaj, njerëzimi për të kapërcyer këto probleme, duhet të ketë një pikë të përbashkët, ky mirëkuptim duhet të shndërrohet në institucione që funksionojnë me drejtësi.

Sipas Durakut, (2009, f. 43) mendimin e parë në lidhje me konceptin e moralit universal e ka dhënë teologu zvicerian Hans Kung . Për herë të parë në vitin 1993,

Kuvendi i Feve Botërore pranoi *Deklaratën e Moralit Universal* dhe diskutoi rreth kësaj teme.

Nga ana tjetër, sipas Falkit (1999, f. 63) doktrina "Etika Universale" e Kungut, kundër tezës "Përplasje e qytetërimeve" e Samuel P. Huntingtonit, me tezën "Pajtimi i kulturave" është një shprehje e kundërshtimit.

Njëra nga kërkesat që kemi më shumë nevojë, në periudhën që jetojmë, është pasja e moralit në një kontekst universal. Sipas Durakut, (2009, f. 47) themeli i ekzistencës së paqes në kuptim universal, është pasja e një sistemi të përbashkët të vlerave për të gjithë njerëzit, krahas kësaj, duhet të fitojnë ndjenjën e përgjegjësisë së të drejtave dhe detyrave individuale. Vetëm në këtë mënyrë mund të ketë një zgjidhje mirëkuptuese për problemet aktuale në shkallë universale.

Arsyeja e përjetimit të këtyre problemeve në përmasa universale, buron nga problemet e përgjithshme ekonomike, politike dhe problemet e tjera. Megjithatë, tërheq vëmendje rritja e zgjedhjes së radikalizmit fetar nga disa rryma të caktuara. Për këtë arsye, siç thekson edhe Kung, në bazë të krijimit të dialogëve mes feve nuk duhet të lihet mënjanë marrja e masave serioze për parandalimin e krijimit të këtyre rrymave themelore.

Në këtë pikë, Duraku tregon rëndësinë e organizatave ndërkombëtare dhe si shembull sjell Kombet e Bashkuara. Sipas Durakut, (2009, f. 45) "Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut" e vendosur nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948, megjithëse juridikisht nuk kishte fuqinë e vendosjes së dënimeve, për arsye se i reflektonte vlerat në kuptimin universal, për shkak të mendimeve rreth përkufizimit të njeriut dhe konceptit të të drejtave tregon se në lidhjet ndërkombëtare me emërues të përbashkët, është e mundur vendosja e një mirëkuptimi nga veprime të përbashkëta.

2. 1. 1. 2. Vlerat morale

Vlerat morale janë tiparet aktive që pasqyrojnë moralin. Rrjedhimisht, të gjitha nënçështjet pjesë e përkufizimit të moralit mund të futen te vlerat morale. Në këtë pikë, sipas Kızılçelikut (Kizilçelikut) (1996, f. 128) vlerat morale, që sigurojnë veprimtarinë e shëndetshme të një shoqërie, mund t'i përshkruajmë si mendim, besim apo parime që luajnë një rol aktiv tek individët.

Sipas Durakut, (2009, f. 41) vlerat morale janë klasifikime, të cilat na lejojnë të komentojmë e të ndajmë sjelljen e njeriut në të mirë dhe në të keqe, krahas mundësisë për të folur për kuptimin universal të vlerave morale, tregon se në kohë dhe vende të ndryshme mund të kemi gjykime dhe aplikime të ndryshme të tyre.

Nga ana tjetër, Sezeni (1988, f. 54) në mbështetje të këtyre mendimeve, për shkak të shfaqjes së ndryshme të moralit, tregon se është e mundur që vlerat morale të ndryshojnë sipas popujve dhe kulturës. Faktikisht, duke qenë se morali është një e vërtetë që i përket njeriut, atëherë dhe vlerat morale janë pjesë e të vërtetave që ka vendosur njerëzimi.

Sipas Durakut, (2009, f. 108) vlerat morale janë të rëndësishme për t'i dhënë qetësi ndërgjegjes së njeriut dhe në emër të afrimit të lidhjeve shoqërore në një nivel të përmbajtur dhe të shëndetshëm. Si përfundim, individi e fiton respektin e shoqërisë me anë të jetesës dhe ideve të tij.

Për individët, që mendojnë në mënyrë të shëndetshme dhe të qëndrueshme, një nga kushtet për formimin e një shoqërie të rregullt krahas pranimin të vlerave morale, është respektimi dhe vënia në jetë e tyre. Individët e një shoqërie që jetojnë sipas këtyre parimeve, janë më të ekuilibruar dhe më të ndjeshëm ndaj mjedisit ku jetojnë. Mund ta shohim këtë ndjeshmëri në formimin e qyteteve, në zbatimin e ligjeve, në marrëdhëniet midis njerëzve.

2. 1. 1. 3. Pjekuria morale

Sipas Başaranit (Basharanit), (1991, f. 148) pjekuria morale dëshmohej kur individit zbaton rregullat e tij morale.

Ndërsa sipas Lickonas (Likonasit), (1992, f. 51) pjekuria morale, “I referohet përshkrimit të nivelit të përsosmërisë së ndjenjës, mendimit, gjykimit, qëndrimit dhe sjelljes së individit.”

Sipas Çirpanit (Çirpanit), (2007, f. 106) pjekuria morale “është përpjekja për dhënien e një vendimi të drejtë, pavarësisht ndikimeve të brendshme ose të jashtme, kapacitetit dhe ndërgjegjjes për të bërë një zgjedhje të duhur.”

Sipas Fukuyamas (Fukujamas), (1992, f. 59) moslënia vetëm në kuadrin e mendimit të pjekurisë morale, në të njëjtën kohë, kthimi i tyre në veprime është një temë mjaft e rëndësishme. Sipas Fukuyamës, pranimi si i pjekur moralisht, nuk është e mjaftueshëm vetëm me pranimin si vlera morale të ndjenjës, mendimit dhe gjykimit, por duhet kthimi i këtyre vlerave në qëndrime dhe sjellje.

Ndërsa sipas Özenit (Ëzenit), (2011, f. 69) pjekuria morale është niveli më i lartë i ndjenjës morale, mendimit moral, gjykimit moral, qëndrimit moral dhe sjelljes morale. Sipas tij, pjekuria morale është niveli i përsosmërisë në ndjeshmërinë e menjëhershme të çdo lloji dëmtimi moral dhe shmangie të ndërgjegjjes në bazë të ndjenjës, të mendimit, të gjykimit, të qëndrimit dhe të sjelljes së individit.

Mund të nxjerrim shumë përfundime nga shpjegimet e deritanishme. Megjithatë, veçanërisht në kohën që jetojmë, kërkohet nga personi që t’upërmbahet rregullave maksimalisht. Prandaj është e lidhur direkt më një lloj pjekurie morale, sepse pjekuria morale nuk është një gjendje që ka të bëjë me informacionin dhe mendimin. Duhet të dimë se, përveç rasteve kur kërkohet, nuk ka asnjë kuptim pozitiv ose negativ për individin dhe shoqërinë ku jetojmë.

Mund të thuhet se pjekuria morale është zbatimi i moralit të bukur te individët që kanë arritur pjekurinë morale. Ata kanë veçori, si: *paqe të brendshme*, janë të dobishëm për shoqërinë, i përshtaten dhe kanë si qëllim zbatimin e ligjeve si dhe janë të qëndrueshëm në sjellje dhe mendime. Kështu që këto veçori, janë tregues i masës së përvetësimit të vlerave morale. Për individin që ka arritur pjekurinë morale për zbatimin e ligjeve dhe ndjekjen e rregullave nuk është e nevojshme ekzistenca e një nëpunësi. Këta individë në çdo veprim të tyre veprojnë në të mirë të shoqërisë dhe njerëzimit. Kuptimi i jetës së tyre është të jenë të dobishëm për komunitetin dhe vendin ku jetojnë. Të gjitha sjelljet e tyre i lidhin rreth kësaj çështje.

2. 1. 2. Faktorët që ndikojnë në pjekurinë morale

Qenia njerëzore nuk është vetëm trup, e përbërë nga mishi dhe kockat, por është një qenie që ka edhe anën shpirtërore. Kësisoj, së bashku me një sërë nevojash që ka si nga ana materiale dhe nga ajo shpirtërore, është e nevojshme të jetë e vetëdijshme, të ndjekë një linjë të hapur për zhvillimin e vazhdueshëm dhe rritjen në të dy drejtimet. Procesi i pjekurisë morale është një nga këto. Pjekuria morale e njeriut është brenda një ndërveprimi të vazhdueshëm në drejtim pozitiv ose negativ. Faktikisht, njeriu është një qenie sociale që jeton në shoqëri. Ndikohet nga ngjarjet që ndodhin rreth tij dhe i formon sjelljet e tij në përputhje me rrethanat.

Özen (2011, f. 71) thotë se fundi i zhvillimit të moralit është arritja e pjekurisë së tij. Duhet të merret parasysh se në procesin e zhvillimit të moralit ndikojnë shumë lloje faktorësh. Sipas Özenit, elementet që ndikojnë në zhvillimin e moralit mund të ndahen në 3 grupe: biologjik, psikologjik dhe social.

2. 1. 2. 1. Faktorët biologjikë

Trashëgimia gjenetike është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në pjekurinë morale. Inteligjenca njerëzore, zhvillimi fizik dhe gjinia janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin moral. Sigurisht, fëmijët që rriten në mjedise të ndryshme kulturore edhe perceptimet morale do t'i formojnë nën ndikimin e këtyre mendimeve. Midis një fëmije të rritur në qytet dhe një fëmije të rritur në fshat padyshim ka ndryshime në pikëpamje dhe kuptimin e vlerave. Në kuptimin universal, këtë sjellje mund ta klasifikojmë edhe në bazë të popujve të ndryshëm. Të gjitha këto rrethana tregojnë fëmijë të rritur me formim të ndryshëm rreth përbërjes së moralit (Kushtet mjedisore vlerësohen brenda trashëgimisë gjenetike).

2. 1. 2. 2. Faktorët psikologjikë

Një nga faktorët më të rëndësishëm në ndikimin e pjekurisë morale është faktori psikologjik. Faktorët që ndikojnë në pjekurinë morale nisin që nga bindjet e personit, deri te të gjitha ndjenjat dhe mendimet. Këto faktorë mund t'i klasifikojmë kështu:

1. Identifikim: identifikimi është përvetësimi i ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve të dikujt tjetër sikur të ishin të tuat. Sipas Özenit , (2011, f. 71) në themelin e teorisë psikoanalitike të Freudit qëndron ky mendim. Faktikisht, fëmijët gjatë foshnjërisë së tyre kanë interes ndaj seksit të kundërt dhe kopjojnë sjelljet e tyre. Modeli perfekt i identifikimit është fëmija që në moshë të vogël merr si shembull nënën dhe babain.

Ndërsa Kağıtçıbaşı (Kagitçibashit) (2004, f. 92-97) e përcakton identifikimin si ngjashmëri të individit me dikë që e vlerëson, si fitim të mendimit të ngjashëm me këtë person. Në bazë të konceptit të identifikimit qëndron gjetja e bukurisë në sendin

ose individin që të përshtatet dhe për sa kohë kjo bukuri vazhdon edhe procesi i identifikimit forcohet. Si shembull mund të japim të rinjtë të cilët identifikohen me një këngëtar ose futbollist të famshëm dhe presin të njëjtin model flokësh apo mbajnë veshje si të tyre .

2. Ndërgjegjja: Ndërgjegjja sipas Demirit (2013, f. 100-102) është përkufizuar: “Në Greqinë e lashtë, nxitësi i brendshëm moral i njeriut të Sokratit i quajtur “daimonion”, në filozofinë skolastike të mesjetës, zëri hyjnor brenda njeriut, në epokën e Iluminizmit, ndjenja unike morale e njeriut apo aftësia intelektuale.” Gjithashtu, ligjet morale të Kantit, superegoja e Freudit, konceptet e pavarura të Piagetit tregojnë ngjashmëri me ndërgjegjen. Ndërsa sipas Freudit, (2004, f. 79) i cili ka bërë një përshkrim sipas qëndrimit ndërgjegjja është ndjenja e kundërshtimit që ka njeriu kundrejt disa dëshirave të tij.

Inwood, (1992, f. 191-193) shprehet se, sipas Hegelit, ndërgjegjja ka të bëjë me besimin në vetvete si një veçori e jetës modeme. Por, ndërgjegjja e vërtetë është dëshira për të mirën në mënyrë objektive (Gesinnung). Sipas Gesinnungut (Gesinnung) (dëshira për të mirën në mënyrë objektive) është qëndrimi, ndjenja apo tendenca e brendshme morale e njeriut. Në të njëjtën kohë mund të jetë edhe qëndrim politik. Gesinnungu politik është atdhedashuri.

3. Besimi: Besimi është një nga aspektet më themelore që e dallojnë njeriun nga qeniet e tjera të gjalla. Që nga njeriu i parë, njerëzimi e ka ndjerë gjithmonë nevojën për të besuar në një qenie superiore. Edhe pse në kohë të ndryshme në histori njerëzit mund të jenë të ndryshëm, njeriu ka ndjerë gjithmonë nevojën e strehimit nga dobësia e frika në një fuqi të mbinatyrshme. Në këtë situatë është bërë e nevojshme vendosja e rregullave në njësi të ndryshme për t’iu bindur kësaj fuqie më të madhe

ose për të plotësuar kërkesat dhe dëshirat e Zotit. Ritualet fetare, rregullat morale, me pak fjalë në çdo fushë të jetës është e mundur të hasemi me këto rregulla.

Özeni thotë se ,(2011, f. 71) morali që është në shkallën e besimit ndihmon njeriun që të veprojë në mënyrë më të ekuilibruar dhe të matur. Sjellja morale e gërshtuar me besim nuk sjell vetëm të qenit i moralshëm, por krahas kësaj bashkon shumë qëllime të tjera, p.sh. vrasja e një njeriu është një sjellje e keqe nga aspekti i moralit. Por nga ana e besimit, vrasja e një njeriu nuk është vetëm një sjellje e keqe, por njëkohësisht është e rëndësishme për shenjtërinë e jetës njerëzore.

4. Personaliteti: Sipas Butlerit, (1986) fjala personalitet rrjedh nga fjala latine “Persona”. Ai ka kuptimin e “shprehjes së jashtme të natyrës së njeriut”. Personaliteti është si maskat e personazheve të trilluara nga aktorët në Greqinë e Lashtë dhe në Romë. Ose si shprehja e Shekspirit “Një njeri luan në të njëjtën kohë shumë role” duke e përcaktuar si maskën që vëmë kur përballemi me botën e jashtme.

Sipas Köknelit (Këknelit), (1982, f. 22) personaliteti i njeriut ka të bëjë me tendencat sociale, biologjike dhe psikologjike që e dallojnë nga njerëzit e tjerë. Faktori më i rëndësishëm që ndikon në formimin e personalitetit të njeriut është pjesëmarrja.

Një nga faktorët e tjerë që ndikojnë në formimin e personalitetit është familja. Në situatat normale familja është grupi i parë shoqëror me të cilët ndeshet njeriu. Nga ky këndvështrim, vendi i parë që individët fillojnë të mësojnë vlerat social-kulturore është mjedisi familjar.

Faktorët social-kulturore janë një nga aspektet e rëndësishme në formimin e personalitetit. Sipas Köknelit, (1982, f. 69) individi është nën ndikimin e grupeve sociale, kombit dhe prejardhjes së cilës i përket si edhe familjes në të cilën ka lindur. Procesi i anëtarësimit të fëmijës në shoqëri quhet “shoqërizim”. Në procesin e

shoqërizimit, individi nga njëra anë ka si qëllim përshtatjen me shoqërinë, ngjashmërinë me individët e tjerë, nga ana tjetër fiton dhe rriten fuqitë e fshehta të lindura që e dallojnë nga pjesa tjetër e shoqërisë. Domethënë, çdo individ jeton brenda një strukture kulturore specifike dhe ndikohet nga procesi i jetesës në të. Ideat dhe interesat e individit marrin formë në këtë ambient kulturor.

Eroğlu (Erollu), (1998, f. 146) thotë se një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikim në formimin e personalitetit është edhe klasa shoqërore, të cilës i përket individi. Klasa shoqërore mund të ndikojë tek individi në mundësinë për shkollim, mënyrën e jetesës, mendimet dhe tendencat, pikëpamjet politike, modelet e konsumit dhe në tipare të ndryshme të personalitetit.

5. Temperamenti: Temperamenti tregon gjendjen e individit nga ana emocionale. Sipas Köknelit, (1982, f. 19-20) shkalla e ndjenjave të njeriut, si nxitimi, zemërimi, humori, shpërfillja apo mërzia janë veçoritë që i përkasin temperamentit të tij.

Ndërsa temperamenti sipas Aydınit, (Aydın C. H., 2003, f. 149) është ë tendenca shpirtërore e njeriut trashëguar me krijimin dhe potencialet e tij, të cilat kanë lidhje me trashëgiminë gjenetike. Si për shembull, droja, trishtimi, nervozizmi, emocionalizmi, agresiviteti të tilla tipare të personalitetit të tilla shpjegojnë temperamentin.

Eroğlu, (1998, f. 149) si fillim tregon si tipare të temperamentit këto ndarje “gjakëmbël (shumë i dashur dhe i gëzuar-sanguin), gjakftohtë (i mërzitshëm, i ashpër-flegmatik), melankolik (i dashuruar, i trishtuar dhe sentimental) dhe nevrik-kolerik (i zemëruar, agresiv dhe i rrëmbyer).”

2. 1. 2. 3. Faktorët socialë

1. Familja: Familja është vendi ku fëmijët për herë të parë informohen dhe marrin mësimet e para. Statusi i familjes në shoqëri, statusi ekonomik dhe niveli kulturor janë faktorë që ndikojnë në formimin e këndvështrimit të fëmijëve për jetesën. Profesioni i prindërve, qenia në jetë ose jo e tyre, koha përkushtuar fëmijës, sjelljet ndaj fëmijës dhe shkaqe të tjera si këto ndikojnë në zhvillimin moral dhe në formimin e personalitetit të fëmijës.

Sipas Aydınit, (Aydın M. Z., 2007, f. 6) fëmijët nga një anë në mjedisin familjar fitojnë disa ndjenja dhe mendime rreth moralit, nga ana tjetër padashur marrin edhe nga besimet, filozofia dhe sjellja e familjes. Këto përvetësime brenda familjes arrihen në një formë informale të paplanifikuar.

Ndërsa Altıntaş (Alltëntashi),(2009, f. 60) e vlerëson mjedisin familjar si vendin ku fëmijët marrin mësimet e para në jetën e tyre. Duke qenë se fëmijët gjatë kësaj periudhe, janë në një pozitë blerësi aktiv duke imituar të gjitha lëvizjet dhe praktikatat që ata shikojnë te të rriturit, ata realizojnë edhe procesin e të mësuarit dhe anëtarësimin në familje. Një njësi si mjedisi familjar ka një ndikim të madh te fëmijët, upërcjell kulturën dhe vlerat e tyre fëmijëve, kryen një detyrë shumë të rëndësishme në krijimin e një shoqërie të shëndoshë.

Sipas Aydınit, (Aydın M. Z., 2007, f. 6) komunikimi i shëndetshëm brenda familjes zë një vend të rëndësishëm në formimin e personalitetit të fëmijës. Pozita e fëmijës brenda familjes, cilësia e komunikimit të realizuar me fëmijën është shumë e rëndësishme në formimin e personalitetit të tij.

Sipas Aydınit, (Aydın M. Z., 2007, f. 6) “Ndërkohë që në periudhën parashkollorë fëmijët mësojnë si të jenë individë socialë, në të njëjtën kohë ndiejnë nevojën e një modeli me të cilin do të identifikohen. Identifikimi që është i nevojshëm për formimin e personalitetit me shumë mundësi do të

ndodhë me një anëtar të ngushtë të familjes. Në përgjithësi nëna dhe babai janë objekt i identifikimit. Por edhe një i rritur brenda familjes, si p.sh. vëllai i madh, tezja, halla, daja ose xhaxhai mund të jetë objekt identifikimi. Nëse këta anëtarë do të zotëronin një personalitet të keq, rritet mundësia e reflektimit të sjelljes negative të fëmija.”

Duke qenë se ka lidhje edhe me punimin tonë, vlen të përmenden edhe pikëpamjet e Şengunit (Shengynit) në lidhje me qëndrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Sipas tij, (2007, f. 204-205) në rritjen e shëndetshme të fëmijëve si individë të dobishëm për shoqërinë në të ardhmen dhe në formësimin e zhvillimit moral, një nga dinamikat më të rëndësishme janë qëndrimet e nënës dhe babait. Sipas Şengunit (2007, f. 204-205):

“Prindër demokratë janë ata që, duan fëmijët, u kushtojnë rëndësi atyre, marrëdhëniet i bazojnë në dashuri dhe respekt, zgjidhin problemet duke biseduar dhe u konsultuar me njëri-tjetrin dhe u japin fëmijve të tyre të drejtën e fjalës. Prindër autoritarë janë ata që i mbajnë fëmijët e tyre nën mbikqyrje të vazhdueshme, duke pritur zbatimin e rregullave në mënyrë strikte, marrin çdo lloj vendimi në emër të fëmijës së tyre dhe presin që fëmija të zbatojë këto vendime. Prindër jashtëzakonisht mbrojtës janë ata që janë të lidhur me një dashuri të madhe pas fëmijëve, organizojnë jetën e tyre sipas fëmijëve, vlerësojnë sjelljet e tyre me një tolerancë të madhe dhe janë shumë të kujdesshëm ndaj tyre. Prindërit indiferentë janë ata që janë të pavëmendshëm ndaj fëmijës, të pandjeshëm ndaj nevojave materiale dhe shpirtërore të tyre, nuk tregojnë dashuri dhe dhembshuri të mjaftueshme ndaj tyre dhe që nuk i kontrollojnë mirë fëmijët e tyre.”

Në gjendjen që ndodhemi në ditët e sotme, mendimi i përbashkët i të gjithë popujve të botës, për një të ardhme të mirë, synon të kultivojmë breza të suksesshëm. Për të arritur këtë sukses ndihet nevoja e ndodhjes së prindërve të ndërgjegjshëm si dhe e programeve të duhura arsimore. Popujt që duan ta ndërtojnë të ardhmen mbi themele të forta, nga njëra anë ndërgjegjësojnë familjet që të jenë të kujdesshme në

edukimin e fëmijëve të tyre kurs e nga ana tjetër analizojnë me një seriozitet të madh sistemin arsimor dhe përmirësimet në sistemin arsimor i realizojnë në përputhshmëri të plotë me këtë kontekst. Për kultivimin e brezave të shëndetshëm rëndësia e aktiviteteve formale dhe informale të kryera në periudhën e fëmijërisë është e madhe.

2. Rrethi shoqëror: Pas familjes, rrethi shoqëror është mjedisi ku fëmija kalon më shumë kohë, ndan sekretet më të veçanta. Rrethi shoqëror është mjedisi ku fëmija vepron duke mënjanuar ndjenjat dhe mendimet e tij, ndonjëherë si një detyrim i psikologjisë së komunitetit. Rrethi shoqëror, që nuk është zgjedhur në mënyrë të shëndoshë dhe që është i vështirë për t'u kontrolluar, ka impakt më të madh se familja dhe edukimi shkollor në kontekstin e formimit të fëmijës.

Tezcani (Tezkhani), (1985, f. 193-196) i quan përfitime të “grupit shoqëror” përfitimet e fëmijës jashtë familjes dhe mjedisit shkollor që i ka fituar nga rrethi shoqëror. Sipas Tezcanit, grupet shoqërore janë të strukturara në forma të ndryshme, këta janë: grupi i lojrave natyrore, grupet e bandës, klikat (grupmoshat e së njëjtës gjini), ose grupet shkollore. Të gjitha këto grupe kanë rregullat e tyre dhe mënyrën e tyre të organizimit. Brenda grupit janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e secilit anëtar. Te fëmijët që janë pjesë e grupit, ndjenja e besnikërisë, guximit dhe pronësisë është në nivele të larta. Individët që janë pjesë e grupit shoqëror, duke u ndikuar edhe nga liria e mjedisit, bisedojnë për tematika të ndryshme dhe në këtë mënyrë zhvillojnë ndjenja të pavarura, kështu si rezultat i zhvillimit të përbashkëta arrijnë të konceptojnë autoritetin dhe fuqinë e grupit.

Elkini (1995, f.88-93) parashtron mendimin se pjesëmarrja e fëmijëve në rreth shoqërore luan një rol të rëndësishëm në formimin e identitetit dhe pozicionit në komunitetin ku ai jeton, sepse në sajë të miqësisë së rrethit shoqëror të tyre, ata

mësojnë një sërë vlerash. Vlerat shoqërore si sakrifica, bashkëpunimi, të ndash diçka me të tjerët dhe barazia mësohen dhe zbatohen brenda rrethit shoqëror.

Edhe Köse (Këse), (1997, f. 141) na tërheq vëmendjen për të njëjtën pikë dhe disa lloj karakteresh. Nevojat e ndryshme sociale dhe psikologjike mund t'i plotësojnë vetëm duke u bërë pjesë e një grupi shoqëror dhe në këtë mënyrë gjejnë vendin e tyre në komunitetin ku ata jetojnë.

Atkinsoni na kujton për rëndësinë e rrethit shoqëror në drejtimin e individëve për të fituar sjellje. Sipas Atkinsonit, (1995, f. 107)

“Grupi, shokët dhe anëtarët e grupit, në të njëjtën kohë janë modele që imitohen. Fëmijët duke vëzhguar sjelljet e grupit fitojnë aftësi të reja. Shumë studime kanë treguar se grupet që merren si shembuj nga të tjerët ndikojnë në sjelljet e fëmijëve. Për shembull, fëmijët e moshave 4 dhe 5-vjeçare që kishin parë sesa bujarë ishin disa shokë klase në ndarjen e çmimeve në krahasim me moshatarët e tyre, që nuk e kishin parë një gjë të tillë, ishin shumë më bujarë.”

3. Media: Në veçanti në epokën që po jetojmë, ana drejtuese dhe formësuese që zotëron media është një e vërtetë që nuk është mohuar nga asnjë. Aktualisht, kjo kuti magjike nuk ka kundërshtar në pikën e drejtimit të shoqërive të ndryshme. Në ditët e sotme, kur teknologjia e quajtur internet ka depërtuar shumë thellë në jetën tonë, brezi i ri, që rritet në një rreth të ngushtë nën ndikimin e medias në kuptimin universal, ka detyra dhe përgjegjësi në drejtimin e të gjithë shoqërisë.

Edhe Giddens (Gidensi) tërheq vëmendjen për rëndësinë që ka media në shoqëri dhe në formësimin e jetës sonë. Sipas Giddensit, (2000, f. 388-403)

“Mjetet si gazetat dhe televizioni ndikojnë shumë në jetën tonë dhe në shoqëri, por jo vetëm që ndikojnë në qëndrimet tona në një mënyrë të caktuar, por janë edhe mjet informacioni për aktivitetet shoqërore. Një nga teoricienët bashkëkohorë të medias, Bodrilard (Baudrillard), mendon se ndikimi i mediave

masive moderne është shumë më i ndryshëm se të gjithë teknologjitë e tjera dhe shumë më i thellë se ato.”

Sipas Pekerit, (1994, f. 75) transmetimet televizive kanë rëndësi në formimin e disa ndjenjave të mira te fëmijët dhe në shndërrimin e këtyre ndjenjave në sjellje. Për këtë arsye, në programet që transmetohen në media, në vend të programeve që përfshijnë në tematikën e tyre pije alkoolike, cigare, lëndë narkotike ose skena dhune është e nevojshme të transmetohen programe që përfshijnë në tematikën e tyre dashuri, respekt, drejtësi, korrektësi dhe bamirësi, sepse sipas Temelit, (2001, f. 65) teoricienët e mësimi social kanë vërtetuar se fëmijët me model agresiv që u janë prezantuar atyre, duke e përgjithësuar modelin e sjelljes agresive përballë situatave të reja kanë reaguar agresivisht. Nëpërmjet studimeve eksperimentale është arritur në përfundimin se sjelljet agresive fëmijët i kanë mësuar nga prindërit e tyre dhe nga modelet agresive të transmetuara në masmedia.

Sipas Şengünit, (2007, f. 210) metoda që do të ndjekë masmedia në procesin e miratimit të vlerave në shoqëri është e thjeshtë, por efektive. Mjetet e komunikimit duke përparuar vazhdimisht dhe duke përdorur një sërë slogane vlerash u imponojnë masave shoqërore vleratë reja.

Në një kohë ku interneti ka depërtuar thellë në jetën tonë, kontrolli i përgjithshëm i mediave është punë vërtet e vështirë. Por në familje si edhe në shkollë, duke përdorur në mënyrë efektive anën pozitive të medias dhe duke marrë erën e furishme të mediave pas nesh, do të na ndihmojë rigorozisht në një rritje të shëndetshme të brezave tanë. Duke menduar për sjelljet modele dhe mbi njerëzit model, krijimi i perceptimeve dhe synimi i miratimit të tyre nga fëmijët tanë nëpërmjet medias na tregon se nuk duhet harruar fuqia ndikuese dhe fuqia e vendosjes së sanksioneve që media zotëron.

4. Niveli i mirëqenies materiale të njeriut dhe lëkundjet ekonomike. Në radhë të parë na vijnë në mendje se çfarë lidhje gjendet midis nivelit të mirëqenies materiale të njeriut dhe etikës. Por ajo që jetoj Evropa pas revolucionit industrial dhe ndryshimet shoqërore që po ndodhin tani në shumë vende në zhvillim, në të vërtetë përbën përgjigje për këtë rast. Në fakt, mesazhi që kërkohet të përcillet është jo vetëm degradimi moral i shoqërisë, por në të njëjtën kohë është ndryshimi i perceptimeve dhe kuptimeve të një sërë vlerash.

Sipas Taşözit, (2012, f. 25) moderniteti sa ka nevojë për moralin, aq edhe e bën të pamundur zbatimin e moralit. Sipas tij, bota moderne nuk ofron arsye të drejta për të besuar në parimet universale të moralit dhe të vlerave. Nga ana tjetër, si rrjedhojë e industrializimit dhe racionalitetit në "shoqërinë e tregut" që ka lindur herët por është forcuar dukshëm, individët maksimizojnë interesat e tyre dhe minimalizojnë interesat e të tjerëve. Kjo marrëdhënie përbën pengesë për realizimin e vlerave morale në kuptimin universal dhe shoqëria e tregut po i shtyn njerëzit që të sillen si të pamoralshëm.

Sipas Kozakut, (1984, f. 380) brenda shoqërisë ekziston një përpjekje, prandaj statusi, vlerat dhe marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin formohen sipas kësaj përpjekjeje. Kozaku shprehet se, sipas Balzakut "Jeta është fitore e të fuqishmëve, ajo është një luftë që motivon pushtetin e interesit vetjak. Ngjarjet shoqërore dhe marrëdhëniet midis njerëzve, vlerat dhe pushteti, kërkesat e statusit dhe burimet e pakta po na shfaqen si konflikte që ndodhin gjatë jetës."

Sipas Kozakut, (1984, f. 113) dhe F. Schumacher (F. Shumakerit), shkak i problemeve dhe depresioneve të përjetuara në këtë kohë është braktisja e vlerave nga njerëzit dhe drejtimi i tyre drejt konkurrencës, lakmisë dhe xhelozisë. Kjo gjendje e njeriut imponohet nga një sërë sistemesh ekonomike dhe politike dhe në sajë të këtyre

po shkatërrohet qetësia dhe lumturia e popullit. Kozaku e shpjegon një nga sistemet e Shumakerit në këtë mënyrë: Në shoqëritë e sotme kapitaliste, marrëdhëniet mes individëve dhe grupeve të bazuara në baza konkurruese i kanë drejtuar njerëzit më shumë nga objektivat e interesave personale sesa i kanë drejtuar drejt objektivave shoqërore. Në këto struktura sociale ku ekziston pabarazia ekonomike, njerëzit lakmitarë materialistë me një egoizëm të shkëlqyer hyjnë në një garë për t'u pasuruar dhe fuqizuar.

Nga ana tjetër, edhe Şengüni, (2007, f. 212) është i mendimit se një nga arsytet më të rëndësishme që ndikon të menduarit dhe sjelljet morale janë faktorët ekonomikë. Sipas tij, në një shoqëri ku ndarja e të ardhurave është e padrejtë, standartet e jetesës janë mjaft të ulëta. Ka mjaft njerëz që vuajnë nga ushqimi i pamjaftueshëm dhe nuk arrijnë të përfitojnë nga mundësitë që ofron jeta sociale. Nga ana tjetër, në një shoqëri ku ndarja e të ardhurave është e drejtë, mirëqenia e njerëzve është e lartë, standartet e jetesës janë mjaft të larta. Ekzistenca e një komuniteti ku standartet e jetesës janë në nivele më të larta se standartet e jetesës të atij vendi do të ndikojë në mendimet morale dhe në perceptimet e vlerave në brezat që jetojnë ose edukohen në atë komunitet.

Duke u nisur nga fakti se në ditët e sotme shtetet, nga pamundësia për të vendosur vetë për rregullimin e sistemeve ekonomike, rregullimin e nivelit të të ardhurave midis njerëzve dhe mbajtjen e tyre në një nivel të arsyeshëm e kanë një punë të vështirë. Megjithatë, sistemi që e kemi quajtur shtet, në emër të formimit të perceptimit moral dhe vlerave në një bazë të shëndetshme të brezat e rinj, duke vepruar me konceptin e shtetit social, për të minimizuar pabarazitë në shoqëri, dhe duke organizuar veprimtaritë socialo-kulturore duhet të mos rreshtin përbënte nga veprimtaritë më racionale. Sigurisht që kjo situatë është e lidhur drejtpërdrejt me

mundësitë materiale të shtetit. Megjithatë, asnjë shtet nuk dëshiron të ketë shtetas të tij që edukohen me një filozofi të tillë dhe një stukturë të tillë ku numri i këtyre shtetasve të tillë është rritur në përmasa serioze. Pavarësisht se në shoqërinë ku ne jetojmë është pak i theksuar, duke menduar se numri i tyre është vazhdimisht në rritje, nëse në lidhje me këtë temë do të analizonim fëmijët e komunitetit rom, zhvillimi i një sërë programesh në emër të pjesëmarrjes së tyre në jetën sociale, mendojmë se është një detyrim i të paraqiturit shtet social.

2. 1. 3. Sjellja e moralshme dhe veçoritë

Sjellja e moralshme, në një kuptim të përgjithshëm, pranohet si vënia në veprim e moralit. Erdemi (2003, f. 60) e përshkruan sjelljen e moralshme si “Sjelljen e kryer me vetëdije, me qëllim të mirë, nga një njeri i ndërgjegjshëm dhe i zgjuar.”

Sipas Heimsoethit (1978, f. 12) vënia në jetë e sjelljes së moralshme të njeriut është një temë e rëndësishme mbi të cilën duhet të mendohemi. Faktikisht, ekzistojnë përkufizimet e bëra nga të gjithë popujt rreth asaj se çfarë është e shpërblyeshme dhe e lavdërueshme, çfarë është e keqe dhe çfarë duhet shmangur në aspektin e moralit. Nga ana tjetër, fetë e mëdha, të gjitha mendimet botërore, sistemet juridike janë të mbushura me shumë këndvështrime rreth asaj që duhet të bëjë ose është i detyruar të bëjë njeriu, për çfarë ka leje dhe nuk ka leje që të veprojë. Kjo situatë na tregon këtë gjë: A janë të gjitha veprimet e njeriut drejt qëllimit “të jesh i dobishëm”? Apo realizohen vetëm me qëllimin e vendosjes së disa sjelljeve të moralshme?

Uysal (Ujsali), (2003, f. 61) pasi e përcakton moralin si një grup rregullash që duhen zbatuar, qëndron mbi shpjegimin se cilat janë këto rregulla dhe thekson nevojën për të njohur natyrën e tyre. Një studim i bërë në këtë mënyrë formon “dimensionin e informacionit” të sjelljes së moralshme. Sepse është e pamundur

kryerja e një veprimi të panjohur. Qenia njerëzore në përgjithësi ka tendencën të kryejë sjellje të cilat i njeh. Për shkak të kësaj, Sokrati e shihte edhe vet informacionin si një virtyt, epse nëse nuk ke informacionin e duhur, nuk mund të kryesh as veprime të duhura. Nëse bën një veprim pa patur informacionin e duhur, ky është një veprim i pandërgjegjshëm, pa vlera morale. Përsëri për shkak të kësaj, Sokrati thotë se askush nuk do të bënte keq me vetëdije, nëse dikush bën një veprim të keq, vepron nga që nuk e di se ai veprim është i keq.

Më sipër, Uysal (2003, f. 62) tërheq vëmendjen rreth përmasave të informacionit mbi moralin. Megjithatë marrja e informacionit si virtyt është diçka teorike. Nuk ka një dimension praktik. Si rrjedhojë, teoria duhet të vërtetohet me praktikë. Si fillim në kuptimin intelektual, rregulli ose rregullat lindin nga ndikimet e faktorëve të ndryshëm. Më pas, ne sillemi sipas këtyre rregullave të formuar në mendjen tonë. Për këtë arsye, individit të cilit ne i drejtohem si “i moralshëm, i përshtatshëm, i ekuilibruar”, është dikush që sillet si e mendon, një person i cili nuk ka asnjë kontradiktë ndërmjet të menduarit e sjelljes së tij. Pra, nëse virtyti teorik nuk bashkohet me virtytin praktik, kurse virtyti praktik nuk përmban virtytin teorik, atëherë ky virtyt është i paplotësuar.

Kur thuhet sjellje e moralshme, mund të themi shumë mendime në lidhje me sjelljet që mund të jenë ose jo të moralshme. Binbaşıoğlu, (1992, f. 192) si veçori të sjelljeve të moralshme përmend: korrektësinë, ndjenjën e përgjegjësisë, ndjenjën e altruizmit, ndjenjën e bashkëpunimit, vullnetin dhe karakterin.”

Nëse duhet t’i shpjegojmë shkurtimisht:

a. Korrektësia: Korrektësia është përdorur në fjalor si karakteri i individit, i cili realisht përshtatet dhe vepron sipas mendimit të tij, mbart qëllimin më të lartë të dijes ose nuk gënjen, është i ndershëm. (Büyük Larousse, 1986, f. 3071)

Sipas Uysalit, (2003, f. 52) të jesh korrekt do të thotë të kesh mendime, fjalë dhe vepra, të cilat i përshtaten korrektesisë. Korrektesia, ndershmëria, dashamirësia, bekimi janë veçori, të cilat e shenjtërojnë personin që i zotëron, krahasuar me personat të cilët nuk i zotërojnë. Këto veçori e bëjnë të veçantë atë në mesin e individëve jokorrektë.

b. Ndjenja e përgjegjësisë: Sipas Hançerlioğlusë, (1993, f. 133) përgjegjësia përshkruhet në fjalor, si detyrimi moral për dhënien e llogarisë për një punë të marrë përsipër. Edhe pse përgjegjësia si fjalë në metafizikë mund të ketë mbetur në një kuptim teologjik dhe juridik, doktrina bashkëkohore idealo-ekzistenciale e ka pranuar atë si “përfundimin e detyruar të lirisë”.

Sipas Afşarit (Afsharit), (1997, f. 15) përgjegjësia është detyrimi më i përgjithshëm dhe i prerë i të qenit njeri. Ashtu siç është detyrim për realizimin e një qëllimi, ashtu është detyrim për korrigjimin e një gabimi.

Özeni (2013, f. 344) e përcakton përgjegjësinë, si vetëdija e individit rreth sjelljeve dhe veprimeve, të cilat janë në kompetencat e tij, dhe marrjen përsipër të sjelljeve dhe përfundimeve të situatave.

Sipas Binbaşioğlusë (1992, f. 193) është e rëndësishme që fëmijëve t’iu ngarkohen përgjegjësi sipas moshës së tyre dhe të kenë pritshmëri po në të njëjtin nivel. Në këtë kuptim, duke e parë nga vështrimi i përfitimit të ndjenjës së përgjegjësisë, institucionet zyrtare arsimore marrin një funksion të rëndësishëm përsipër. Nga ana tjetër, mund të marrim përfundime më efektive dhe të qëndrueshme nga bashkëpunimi shkollë-familje.

Sipas Afşarit, (1997, f. 15-20) përgjegjësia është një nevojë. Përgjegjësinë e përcakton ndërgjegja e lirë. Nëse nuk dihet natyra e përgjegjësisë, atëherë nuk ka përgjegjësi. “Nëse jam lidhur bashkë me duart në pemë, nuk mund ta shpëtoj fëmijën

që është me tutje.” Nga ana tjetër, përgjegjësia është ndjenjë shpirtërore. Të jesh i përgjegjshëm do të thotë të kesh shpresë. Nëse nuk jemi gjithmonë në pritje të diçkaje nga të tjerët, atëherë të kesh shpresë do të thotë të jesh i përgjegjshëm.

Tozlu (Tozluja) (1997, f. 26) e përshkruan ndjenjën e përgjegjësisë si një ndjenjë që njeriu e fillon nga vetja. Sipas tij si Rousseau (Rusoi), Descartes (Dekarti), Kanti, të cilët shprehen se ndërgjegjja vjen nga lindja dhe se është ndjenja më e madhe që Zoti u ka dhënë njerëzve, theksojnë se është fuqia e zgjedhjes. Ose tërheq vëmendjen në lidhjen midis përgjegjësisë dhe mendjes, lirisë dhe vullnetit ose si Spenceri vë në dukje lidhjen me rolin e zakoneve. Nga ana tjetër, për të përkrahur Durkeimin, pranoni se komuniteti është i vetmi përcaktues. Ose kaloni në anën e kundërt dhe mbështesni Spinozën. Ose besojini Bergsonit dhe mos diskutoni kurrë për përgjegjësinë para se të keni vërtetuar se jemi përgjegjës para vetes tonë. Veçoritë e qenies sonë, mendja jonë, mendimi i lirë mbi veprimet tona, të jesh vetvetja, mosqenia automatik sjell ndjenjën e përgjegjësisë. Të jemi të shoqërueshëm, jetesa në rrethin shoqëror dhe në botë sjell dhe zgjeron rrethin e ndjenjës së përgjegjësisë. Rëndon përgjegjësinë tonë.

c. Ndjenja e altruizmit: Vjen nga fjala latine “Alter (Altruizëm)”, ka kuptimin e ndihmës së njerëzve pa pritur diçka tjetër në shkëmbim. Për herë të parë është përdorur nga Auguste Comte (August Komt) në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe është përcaktuar si prirja apo dëshira për të jetuar për të tjerët. Një tregues i saj është edhe shkrimi mbi varrin e Komtit “Për të tjerët”.

Sipas Hançerlioğlusë, (1993, f. 94-95) altruizmi i Komtit është një marrëdhënie midis individëve dhe tregon heqje dorë nga të ardhurat personale për dikë tjetër, pa pritur diçka në këmbim. Ndjenja si dashamirësia, qëllimi i mirë, toleranca dhe besnikëria, me shikim të parë mund të duken si ndjenja të kundërta me

iniciativën mbrojtëse të njeriut, në të vërtetë janë një prodhim i iniciativës mbrojtëse. Ky nuk është një zhvillim mendimi, por një zhvillim ndjenje. Zhvillimi i egoizmit të brendshëm dhe emocional të njeriut lidhet me ndjenjën morale, ndërsa zhvillimi i ndjenjës së jashtme dhe mendore lidhet me ndjenjën e drejtësisë. Për këtë arsye, altruizmi shoqëror del në pah si një strukturë.

Ndërsa sipas Durkeimit, altruizmi nuk është dhembshuria ose ndihma e dhënë dikujt tjetër. Durkheimi e përshkruan si lëvizjen e dhunshme dhe vullnetare të shkatërrimit personal pa patur interesa personale. (Dubeski, 2001)

Sipas Tuzcuoğlusë (Tuzxhuolusë), (1995, f. 280) altruizmi është ndarja strukturore e problemeve të tjerëve. Në altruizëm, njeriu në momentin që ndihmon dikë tjetër, përfiton edhe vetë një kënaqësi të brendshme.

Sipas Hançerlioğlusë, (1992, f. 195) në themel të arsimit ka dashuri. Ata që janë të privuar nga kjo gjë, e kanë të pamundur pjesëmarrjen në aktivitetet arsimore dhe suksesin në to. Ai që do dikë, një person që e ndjen dashurinë shpëton nga egoizmi. Njeriu imiton njerëzit që do dhe dëshiron të bëhet si ata. Prandaj marrëdhëniet e mbushura me sakrifica, dashuri dhe respekt u kushtojnë rëndësi rritjes së brezave altruistë.

d. Marrëdhënia e bashkëpunimit: Njeriu është një qenie sociale. Prandaj për të vazhduar jetën e tij duhet në një farë mënyre të bashkëveprojë me të tjerët. Që nga procesi i të ngrënit, të veshurit, më vonë në arsimim e në të gjitha fushat njeriu ka nevojë për ndihmën e një qenie nga e njëjta racë që të bashkëveprojë dhe të vazhdojë një jetë të përshtatshme. Bashkëveprimi nuk është një veçori që i përket vetëm qenies njerëzore. Faktikisht shumë gjallesa bashkëveprojnë, jetojnë së bashku dhe ndajnë jetën e tyre.

e) Vullneti: Në fjalor përshkruhet si aftësia për të përcaktuar veprimet në varësi të motiveve racionale dhe si fuqia për të bërë ose jo diçka. Sipas Spinozës, vullneti është aftësia e shpirtit për të përcaktuar nëse diçka është e drejtë ose e gabuar. Sipas Kantit është aftësia për të vepruar në përputhje me konceptet praktike. Sipas Hegelit mund të përshkruhet si thelbi i personave të pavarur.

Në këto kontradita që jeton njeriu, mosqenia i vendosur në situata ku duhet të marrë vendime do të ndikojë në të gjithë jetën e tij. Në zgjedhjen e profesionit, në fusha të tjera të lidhura me jetësën, kjo fuqi e quajtur vullnet i tregon njeriut rrugën e duhur, është baza më e rëndësishme e mendimeve dhe veprimeve të pavarura. Prandaj rritja e brezave që kanë vullnet të shëndoshë dhe besim në vetvete është një qëllim i rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

66

njeriut, përshtatja me vetveten, matura në mendime e veprime, si veçori që i mundësojnë një qëndrim të shëndetshëm.

Një pjesë e madhe e njerëzve besojnë se karakteri formohet me anë të trashëgimisë gjenetike. Sipas Karatayit (Karatajit), (2011, f. 1400) tregojnë si provë veset dhe një sërë veçorish të tjera që fëmijët i kanë të ngjashme me nënën dhe babain. Nga ana tjetër, në formimin e karakterit kanë një ndikim më të madh kushtet e rrethit shoqëror, sepse kur fëmija vjen në jetë nuk është në dijeni të asaj që është e mirë ose e keqe. Me kohë, nëpërmjet familjes dhe shoqërisë, mësojnë këto njohuri dhe formojnë mënyrën e jetesës së tyre.

Sipas Binbaşoğlu (1992, f. 198) zhvillimi i karakterit është i lidhur me dëshirën e njeriut. Në ambientin që njeriu forcon vullnetin e tij, në atë ambient edhe karakteri fiton plotësimin e tij, sepse individ duhet t'i thotë "Ndal" impulseve të tij. Është vullneti i tij që i drejton këto impulse në drejtimin e duhur. Individin e drejtojnë rreth një sjellje të caktuar motive fiziologjike dhe shoqërore, por me ndihmën e vullnetin ato hyjnë në një rregull të caktuar dhe zënë vend në karakterin e njeriut.

Sipas Uysalit, (2003, f. 57) duhet të ketë një propocion të saktë midis karakterit të njeriut dhe personalitetit moral. Faktikisht, karakteri i njeriut merr formë sipas rrethit shoqëror në të cilin ndodhet. Nga gjërtiparet që ka marrë në rrethin familjar, në shkollë apo në rrethin shoqëror ndikojnë në themelin e formimit të personalitetit moral. Individin i tregojnë këto udhëzime në sjelljet e tij.

Uysal thotë (2003, f. 62-63) se një tjetër veçori e sjelljes së moralshme është dhe "aspekti ndjesor". Faktikisht, ndjesia e lumturisë që përfitojmë kur veprojmë diçka të mirë, ndjenja e mërzisë që kemi kur bëjmë diçka të keqe dhe pendesa për këto veprime tregojnë se ndjenjat kanë ndikim. Kur shikojmë jetën e përditshme do të vëmë re se është e vërtetë se kjo do të jetë një ndihmesë për të kuptuar më mirë arsyet

e problemeve të moralit. Në nivele të ndryshme të shoqërisë kemi hasur probleme në kuptimin e sjelljeve të disa personave. Është e qartë se nuk ka një standard të caktuar të sjelljes njerëzore. Megjithatë, është një realitet që kemi pritshmëri ndaj modeleve të sjelljes të denja të njerëzve me pozitë dhe që duhet të jenë shembull për të tjerët, të cilët kanë marrë një arsimim të rëndësishëm, kanë një pozitë të rëndësishme, qëndrojnë në krye të shoqërisë, që mendojmë se kanë arritur një nivel të caktuar të botëkuptimit dhe sjelljes. Nga ana tjetër, individët që e cilësojnë veten si besimtarë, kanë disa sjellje që vëmë re te njerëzit të cilët e kanë fenë si edukatë dhe standart jetese. Shqetësimi që sjellin këta njerëz për arsye të strukturës së ndryshme të mendimeve të tyre nga ne dhe nga shoqëria, ndodh për arsye se morali i tyre nuk ka marrë akoma formën e dijes.

2. 1. 4. Moraliteti

Moralitet është kryerja ose nxjerrja në pah e sjelljeve nga individët, që përmbajnë cilësi morale. Akarsu (1998) thekson se veprimet e njerëzve kanë qenë ndarë në të moralshme dhe të pamoralshme që në kohët e lashta. Edhe në shoqëri shumë të vjetra, një sërë veprimesh dhe gjurmësh jetese të pashkruara, që brezat i kanë lënë si trashëgimi njëri-tjetrit, na bëjnë të kuptojmë se ekzistonte një fenomen i quajtur “moralitet”.

Sipas Çilingirit, (2003, f. 120) “Parimi i moralitetit” është “intellectualis internum”, (“inteletuale internum”), prandaj atë duhet ta kërkojmë në brendësinë e veprimit nëpërmjet mendjes së pastër. Moraliteti është pajtueshmëria e veprimeve përgjithësisht të pranuar me ligjin e vullnetit të lirë. Moraliteti është marrëdhënia e veprimeve me rregullat e përgjithshme. Nëse unë marr parasysh se veprimet e mia

jam i detyruar t'i përshtas me rregullat e përgjithshme që zbatohen përherë dhe për të gjithë, atëherë veprimet e mia burojnë nga parimi i moralit.

Taşözi (2012, f. 11) shprehet se sipas Spinozës, moraliteti në mënyrë objektive konsiston në informacionin e përkryer dhe të qartë të universit dhenuk duhet harruar që edhe njeriu është pjesë e këtij universi. Megjithatë për arsyen se “ligjet që drejtojnë universin kanë qenë të përcaktuara edhe veprimet e njeriut janë të përcaktuara në të njëjtin nivel, njeriu nuk mund ta ndryshojë veprimin e tij, por ai mund ta njohë atë dhe domosdoshmërinë që zotëron natyrën. Pikërisht nga këtu buron edhe përsosja e njeriut.”

Nëse moraliteti realizohet me vullnet të lirë, sjelljet që kryejmë janë sjellje që janë bërë si rrjedhojë e një ndërgjegjeje. Prandaj, ashtu siç janë llogaritur paraprakisht rezultatet e fjalëve dhe veprimeve, ashtu duhet të jenë menduar edhe pasojat. Natyrisht që këto sjellje mbartin edhe disa probleme. Një pjesë është ligjërish detyruese, ndërsa një pjesë tjetër vlerësohet nga shoqëria, sepse saktësia dhe pasaktësia e këtyre sjelljeve është e përcaktuar nga shoqëria. Të veprosh në kundërshtim me traditën dhe zakonet, të mos respektosh të mëdhenjtë, të mos uqëndrosh pranë të afërmëve dhe fqinjëve në ditët e mira dhe në ditët e këqija të tyre, të veprosh në kundërshtim me rendin dhe një sërë rregullash të cilat shoqëria i vlerëson, janë sjellje që përfundojnë në përjashtim nga ana e shoqërisë.

Nga ana tjetër, imoraliteti ose sjelljet që janë të varfëra nga vlerat morale kanë edhe një aspekt ligjor. Këto janë sjellje që duhet të mendohen më parë. Vjedhja, çënimi i jetës personale të njerëzve, korrupsioni, etj. janë sjellje që dënohen në një farë mënyrë nga shoqëria dhe absolutisht që do të përballen edhe me dispozitat ligjore.

Sipas Inwoodit (Invudit), (1992, f. 191-193) “Hegel mbështet mendimet e Kantit në lidhje me moralin. Sipas Kantit, të jesh i moralshëm do të thotë të jesh racional, ndërsa racionaliteti është domosdoshmëri e natyrës së njeriut. Prandaj të jesh i moralshëm do të thotë të jesh i lirë. Por, ai kundërshton mendimet në vijim të Kantit si: “racionaliteti që të detyron të jesh i moralshëm nuk është racionaliteti që gjendet brenda njeriut dhe racionaliteti që realizohet në institucionet e shoqërisë, por është racionaliteti që buron nga vetë njeriu. Ndërmjet mendjes dhe dëshirave ekziston një kontraditë absolute: Moraliteti është i lidhur ngushtë me gjërat që njeriu është i detyruar t’i kryejë, ai është udhëtimi i shenjtë në pafundësi i njeriut drejt së mirës.”

Sipas filozofëve, në lidhje me çështjen që i përcakton veprimet e njeriut në morale dhe amorale ose më saktë në kuptimin moral si të vlefshme dhe të pavlefshme, ekzistojnë dy mendime kryesore:

1. Veprimet janë ose nuk janë të vlefshme sipas çështjes që shkakton ardhjen e tyre.
2. Sipas rezultatit të veprimeve tona, diçka është me vlerë ose nuk është me vlerë. (Akarsu, 1982, f. 10)

2. 1. 5. Cili është burimi i moralit

Në lidhje me burimin e moralit ka diskutime të vazhdueshme që nga kohëra të lashta. Disa mendojnë se burimi i moralit është natyrshmëria e njeriut, disa të tjerë mendojnë se është familja dhe disa të tjerë mendojnë se është shoqëria. Mund të thuhet se çdo mendim është bazuar në vlerësimet që ka bërë rreth burimeve të moralit.

Mund të përmenden shumë veçori që e ndajnë njeriun nga gjallesat e tjera. Duke qenë se ka lidhje me temën tonë, mund të themi se një nga këto veçori është morali. Morali mund të analizohet në dimensionin e ideve dhe dimensionin e sjelljeve.

Për shkak se njeriu e kryen me vullnetin e tij përbën veçorinë më të rëndësishme që e ndan atë nga krijesat e tjera. Edhe pse është shumë e rëndësishme për njeriun në lidhje me formimin e moralit dhe rreth çështjes se çfarë hyn në kornizën e fenomenit të quajtur moral, ka patur shumë diskutime.

Sipas Şengünit, (2007, f. 201) morali, rrjedhimisht sjelljet morale, janë ndër faktorët më të rëndësishëm që individët e shoqërisë të jetojnë në paqe, lumturi dhe siguri. Njerëzit i fitojnë karakteristikat morale në procesin e rritjes dhe zhvillimit të tyre. Zhvillimi moral është një nga aspektet më të rëndësishme të zhvillimit njerëzor. Njeriu që nga momenti i lindjes e deri në fund të jetës së tij jeton procese të ndryshme zhvillimi si: zhvillimi biologjik, zhvillimi psikologjik dhe zhvillimi social. Edhe zhvillimi moral i njeriut formësohet paralelisht me këto procese zhvillimi.

Sipas Haidthit, (2001, f. 819) pavarësisht procesit të arsytimit gjykimet morale në shumicën e rasteve realizohen vetvetiu në mënyrë spontane. Në këtë situatë e kemi të vështirë të shpjegojmë burimin e gjykimeve tona morale, si edhe e kemi të vështirë të shpjegojmë nga se janë shkaktuar gjykimet tona morale.

Ceylan (Xhejlan), (2004, f. 86) shprehet se sipas Kantit,

“Burimi kryesor i moralit është individi. Morali që mbështetet te natyrshmëria e njeriut rrjedh nga burimi i brendshëm. Ky burim, pa patur parasysh ndryshimet kulturore edhe racore, vetëm për faktin që posedojnë mendje, është i njëjtë te të gjithë njerëzit. Parimet e burimeve të brendshme nuk janë monopol i asnjë kulture apo feje. Kjo është arsyeja pse është e mundur që në çdo shoqëri të vërejmë sjellje të virtytshme dhe njerëz të virtytshëm. Kjo quhet etikë natyrore.”

Chomsky (Çomski) (1988, f. 153) beson se morali është një veçori e lindur. Për ta vërtetuar këtë, ai nxori tezën e “Gjuhës natyrore”. Sipas Chomsky, më të qenësishmet në mendjet e foshnjëve qëndrojnë në faktin se arrijnë të flasin gjuhën e njerëzve të zonës ku ata jetojnë dhe realizojnë këtë ngjarje të vështirë.

Sipas Öztürkut (Ozturkut), (2006) në lidhje me burimin e moralit vihet re se gjatë historisë njerëzore janë paraqitur tri teza kryesore. Nga këto,

“Teza e parë është teza e feve që e ka përdorur moralin në kuptimin e ligjeve të krijimit dhe të natyrës njerëzore. Teza e dytë është teza e doktrinëve të ndryshme filozofike, e cila e analizon moralin me referencë mendore, e shikon moralin si një fenomen metafizik dhe fenomen praktik njerëzor. Ndërsa teza e tretë janë teoritë antropologjike dhe sociologjike që janë zhvilluar rreth anës shoqërore të moralit. Le t’i përmendim shkurtimisht ato tani.”

2. 1. 5. 1. Burimi i moralit sipas filozofëve

Sipas disa njerëzve të dijes burimi i moralit është filozofia. Në radhët e filozofëve ka patur nga ata që e kanë perceptuar moralin si një të vërtetë teorike dhe praktike dhe në bazë të saj kanë zhvilluar sistemet e mendimeve të tyre.

Öztürku (2006) është filozofi i parë i rëndësishëm në fushën e filozofisë morale të Platonit. Ai pohon se sipas Platonit ka një marrëdhënie të drejtë ndërmjet virtyshmërisë dhe informacionit. Studenti i Platonit, Aristoteli, e analizon moralin në aspektin teorik dhe praktik. Aristoteli i ndan nga njëri-tjetri virtytin dhe mendimet që synojnë mirësi me virtytet e karakterit që shndërrojnë në praktikë mirësinë.

Öztürku (2006) në lidhje me burimin e moralit e analizon çështjen nga një këndvështrim i ndryshëm dhe thekson që një pikë tjetër e rëndësishme, e cila mund të përbëjë burimin e moralit, është ndërgjegjja. Përse njerëzit në shumë raste janë të detyruar të dëgjojnë zërin e ndërgjegjes? Përse Sokrati, pa patur asnjë shkak, ka ikur vetë drejt vdekjes? Këto pyetje kanë vazhduar të ekzistojnë nga e kaluara deri në ditët e sotme por edhe në të ardhmen ekzistenca e tyre do të jetë e pranishme. Öztürku duke u nisur nga shembulli i ndërgjegjes ka përmendur një problem të rëndësishëm të filozofisë morale. Në këtë mënyrë, ai ka bërë të ditur se burimi i moralit mund të jetë filozofia.

Sipas Türgülüsë (Tyrgylsë), (1968, f. 291) njerëzit nuk mund të lëvizin rastësisht pa patur asnjë qëllim. Ata kryejnë veprime të ndërgjegjshme dhe janë të detyruar të llogarisin të mirën dhe të keqen. Sipas filozofëve, fillimi i ndërgjegjes morale zë fill moralisht. Por pika që duhet theksuar këtu është që kjo veçori e cila i përket njeriut, edhe para se të diskutohej nga filozofët, ka qenë e tillë si fenomen moral. Në të vërtetë, nga të dhënat historike, kuptojmë se në disa fise primitive morali është gjëja më e rëndësishme që mban në këmbë komunitetin. Kështu që ajo që filozofët moralistë kanë bërë dhe kanë nxjerrë në pah nuk është asgjë më shumë përpara se të vërtetohet në kuptimin shkencor.

2. 1. 5. 2. A është shoqëria burimi i moralit

Njeriu jeton brenda shoqërisë, prandaj është një qenie sociale. Si domosdoshmëri e të qenit qenie sociale, njeriu duhet të përshtatet me realitetin e mjedisit ku jeton dhe nuk duhet ta shmangë atë. Vetëm prej saj del në pah kuptimi i bashkëjetesës. Këto rregulla, që njerëzit i respektojnë në bashkëjetesë, në një farë kuptimi mund t'i emërojmë rregulla morale. Edhe pse mund të ketë disa ndryshime sipas popujve dhe mënyrës së jetesave të tyre, në çdo vend ku është prezent faktori njeri ka nevojë për rregulla të tilla. Duke u nisur nga fakti që njeriu është i predispozuar të veprojë edhe mirë edhe keq, me kalimin e kohës ka zhvilluar sjellje të mira dhe sjellje të këqia morale.

Sipas Öztürkut, (2006) në mendimet e Durkheimit, sjellja morale është produkt i shoqërisë. Morali pikë së pari lind në shoqëri dhe realizohet në formë veprimi individual. Sipas Durkheimit, njeriu është një qenie morale, nuk mund të imagjinohet një shoqëri pa moral. Njeriu sa më social të jetë, aq më tepër bëhet i moralshëm. Moraliteti fillon me anëtarësimin në një grup social, prandaj rreth moralit

mund të flitet vetëm aty ku ka shoqëri. Durkheimi ka zhvilluar “teorinë e moralit sociologjik”. Sipas kësaj teorie, mirësia është gjendja objektive e moralit, ajo nuk është një gjë abstrakte. Ajo është shoqërore. Mirësi është ajo që është në të mirë të shoqërisë. Mirësia e njeriut, e vetme, nuk mbart asnjë vlerë, prandaj moraliteti nuk është individual, por është i përgjithshëm dhe qëndron larg interesave personale.”

2. 1. 5. 3. A është feja burimi i moralit

Sipas atyre që mendojnë se burimi i moralit është feja, morali ka lindur së bashku me njeriun e parë. Në të gjitha fetë qiellore është e përcaktuar se kujt dhe në çfarë mënyre duhet t’i besojnë. Madje kanë përcaktuar një sërë rregullash në lidhje me bashkëjetesën. Duke u nisur nga kjo, mund të thuhet që një sërë rregullash, të cilat njerëzit i quajnë moral ose vlerë, e kanë burimin kryesor në fe.

Öztürku (2006) për të përforcuar mendimin e tij tregon si shembull ngjarjen që zhvillohet midis Habilit (Abeli) dhe Kabilit (Kaini) dhe që është e pranuar nga të tri fetë qiellore. Në këtë ngjarje urdhri i fesë “nuk duhet të vrasësh” nuk ka arritur të pengojë vëllanë, që i është nënshtruar presionit të xhelozisë, dhe si rrjedhojë ka vrarë vëllanë tjetër. Rregulli “nuk duhet të vrasësh” që feja ka vendosur qysh atëherë sot është shndërruar në një rregull ligjor pranuar nga i gjithë njerëzimi.

Sipas Erdemit, (1990, f. 230) të izolosh tërësisht moralin nga feja dhe ideja e botës tjetër, si rrjedhojë ta izolosh nga Perëndia, do të shkaktonte te morali një vakum autoriteti. Edhe Kanti ndjen këtë vakum autoriteti prandaj Perëndinë dhe pavdekësinë i shikon si të domosdoshme në këndvështrimin moral. Nuk e ka ndaluar dot veten dhe ka pranuar se moraliteti dhe e mira superiore do ta gjejnë shpërblimin në një botë tjetër, në jetën e përtejme.

Sipas Taslamanit, (2014, f. 54) morali do të ishte i mundur edhe nëse nuk do të ekzistonte besimi në Zot, por një nga cilësitë më të rëndësishme, heqja dorë nga interesat personale të detyrueshme, kur kjo është e nevojshme formohet nga ligje që kërkojnë sakrificë dhe sisteme morale, të cilat pretendojnë se pa ekzistencën e besimit në Zot nuk ka bazë racionale. “Bazë racionale” do të thotë heqja dorë, nëse ndjehet e nevojshme, nga interesat personale dhe realizimi i saj. Të gjitha këto veprime duhet të jenë mbështetur në një bazë racionale. Filozofët ateistë Nietzsche (Niçe) dhe Sartre (Sartër) kanë theksuar se pa ekzistencën e Zotit saktësia e vlerave morale nuk do të kishte vlerë.

2. 1. 6. Vlera

Janë dhënë shumë përkufizime të fjalës vlerë. Pothuajse të gjitha degët e shkencave kanë dhënë përkufizimin përkatës. Ne dëshirojmë të japim vetëm disa nga këta përkufizime.

Sipas Uysalit, (2003, f. 52) të gjitha sjelljet e njeriu janë të lidhura me një “vlerë”. Si rrjedhojë, vlera mund të përkufizohet si “përcaktuese, drejtuese e veprimeve dhe principeve, që qëndrojnë në bazë të sjelljes tonë”. Asnjë njeri, i cili nuk ka lidhje me “vlerën”, nuk mund të pasqyrojë një sjellje. P.sh., nëse unë përpiqem të jem i drejtë, kjo vjen se drejtësia për mua është vlerë. Konceptimi i drejtësisë si vlerë më detyron të jem i drejtë. Si rrjedhojë, faktori themelor në përpjekjen time për të qenë i drejtë është vlerësimi i “drejtësisë” si “vlerë”. Edhe nëse përpiqem të jem i ndershëm dhe ndërkohë jam optimist, kjo rrjedh nga konceptimi i ‘ndershmërisë’ dhe ‘mirësisë’ si një vlerë.

Sipas Halsteadit (Halstedit), (2000, f. 169) vlera përkufizohet si standarte të pranuar nga njeriu në cilësimin e mendimeve dhe sjelljeve si të mira ose të këqija.

Sipas Theodorsonit, (1979, f. 455) “vlerat janë sjellje parimore të përgjithësuara dhe abstrakte, të cilat dalin në pah nga ndjenja të forta pozitive të anëtarëve të grupit shoqëror, për krijimin e një standarti të veçantë, për qëllime dhe vepra të veçanta.”

Morrisi (1956, f. 9) pohon se fjala vlerë përmban kuptime të komplikuar dhe të shumëanshme, për të cilën mund të bëhen përkufizime sipas shkencës, artit, fesë, etikës dhe filozofisë.

Haydoni (Hejdoni) (2007, f. 6) nuk e koncepton vlerën si një term teknik. Sipas tij, vlera nuk është gjë tjetër vetëm se disa eksperiencia, të cilat i bën çdonjëri prej nesh në jetën e tij.

Sipas Aydınit (Aydın M., 2011, f. 39) fjala “vlerë” rrjedh nga rrënja “valere” që do të thotë “të jesh i rëndësishëm, i fortë”. Sigurisht që për këtë term ekzistojnë përkufizime të ndryshme, ngaqë përdoret në fusha të ndryshme, si filozofi, antropologji, psikologji, sociologji dhe teologji, por, këtu nuk është e rëndësishme të përcaktojmë se çfarë është vlera, por çfarë mund të bëjmë me të.

Topçuoğlusë (Topçuollusë) (2010, f. 11) qëndron mbi faktin se vlerat mund t’u mësohen të tjerëve dhe njëkohësisht mësohen. Një pjesë e rëndësishme e politikave arsimore të shekullit XXI u kanë kushtuar rëndësi vlerave në edukimin e individit. Si rrjedhojë, po bëhen shumë studime në lidhje me përfitimin që u japin vlerat brezave të rinj. Që tani kanë filluar të zhvillohen programe edukuese, të cilat përmbajnë tema, si: dashuria, respekti, ndershmëria, solidariteti, bashkëpunimi, toleranca, afrimi pa paragjykime, qëndrimi larg dhunës etj.

Sipas Hökelekliut (Hëkelekliut), (2010, f. 4) vlerat janë rregullat dhe besimet, të cilat na udhëzojnë dhe u tregojnë rrugën sjelljeve tona. Janë standarde, të cilat përcaktojnë nëse sjelljet dhe veprimet tona janë të mira, të gabuara, etike apo jo etike.

Ndërsa Şişman (Shishmani), (1994, f. 79) pohon se vlerat mund të cilësohen edhe si komponentë kulturorë, të dalë në pah, si një standard në mendimet dhe sjelljet e individit.

Sipas Taşözit, (2012, f. 10) vlerat janë fenomene të subjektivizuara si objekte ideale për nga cilësitë që ngërthejnë , me anë të një intuitede të veçantë parësore , të pavarura nga bota materiale dhe të shfaqura me sjelljet e njeriut. Nisur nga ky aspekt, Taşözi është përpjekur t'i shpjegojë vlerat nga pika të caktuara. Disa nga këta pika mund t'i radhisim si më poshtë:

- Vlera është marrëdhënia kuptim-rëndësi.
- Zotëron një ekzistencë të pavarur.
- Ekziston në mënyrë të pavarur.
- Pasqyron cilësinë e ekzistencës.
- Nuk mund të perceptohet me shqisa.
- Mund të dallohet me anë të shqisave të brendshme.
- Përkufizohet si zotëruese e cilësisë mendore, por edhe objektive.
- Çdo njeri kur vepron diçka e bën sipas një qëllimi të caktuar. Objektet e synuara nga ai gjatë këtij veprimi i lidh me nevojat e tij individuale ose shoqërore.
- Vlerat janë përcaktuese në kuptimin e problematikës së vlerës në marrëdhënien e thurur me veten, ku njeriu është edhe subjekt edhe objekt, krahas marrëdhënies së thurur me shoqërinë apo natyrën, ku ai paraqitet si një subjekt, ose kolektiv.

Özeni (2012, f. 174) e përkufizon vlerën si një gjë, e cila shfaqet në lidhjen e njeriut me objektin, si një qenie, një gjendje për të cilën njeriu ndjen nevojë. Mënyra e shfaqjes së një nevoje te njeriu dhe kërkesat e llojllojshme mund të plotësohen me

lloje të panumërta vlerash. Krahas kësaj, një vlerë, e cila për një person mund të duket shumë e rëndësishme, për një tjetër është e parëndësishme.

Sipas Köknelit, (2007, f. 17) vlera është “fjala, e cila tregon rëndësinë e koncepteve, ngjarjeve, të qenieve të gjalla dhe të vdekura, një njësi matëse subjektive, e cila shërben në përcaktimin e rëndësisë së koncepteve objektive apo subjektive.”

Ndërsa Çelikkaya (1996, f. 168) “e ka cilësuar vlerën si rregull, sjellje, mendim, ndjesi me burim hyjnor apo ideologjik, njerëzor, shoqëror, i pranuar, përvetësuar nga një shoqëri, një besim, ideologji apo nga njerëzit.”

Sipas Uysalit, (2003, f. 52) vlera mund të përkufizohet edhe si koncept i shenjtë, i cili reflekton shenjtëri. Drejtësia, ndershmëria, pozitiviteti janë të shenjta dhe e lartësojnë njeriun, i cili i zotëron ato, kur krahasohet me personat, të cilët nuk i zotërojnë. Këto vlera e pajisin individin me virtyte në fushën e ekzistencës së tij. Thënë ndryshe, “Vlera është çdo gjë që i sjell dobi dhe i mbron vlerat e njeriut”.

Aslantürk (Asllanturku) (2001, f. 225) i përcakton vlerat si komponentë të rëndësishëm, të cilët krijojnë jetën shoqërore të njeriut. Sipas tij, vlera është një tërësi e krijuar nga gjërat më të rëndësishme materiale dhe shpirtërore të një shoqërie, përmban të gjitha llojet e sjelljes, mendimet, qëndrimin e përgjithshëm, masat e vlerësimit, zakonet, interesin dhe çdo lloj informacioni të pranishëm në shoqëri. Të gjitha bashkë përbëjnë një stil jetese të ndarë nga shoqëritë e tjera dhe të ndryshëm për anëtarët e asaj shoqërie.

Sipas Aydınit, (Aydın M. Z., 2010, f. 1) vlera është një superioritet, si individual ashtu dhe shoqëror, i caktuar ndonjë objekti apo gjallese. Për këtë mund të jepen si shembull ritualet fetare. Vendet e shenjta të besimet e ndryshme nuk rezultojnë me vlerë si objekte fizike, ato të fitojnë vlerë bashkë me ndryshimin e pikëpamjeve të njerëzve.

Sipas Kaçuradisit, (1995, f. 8) vlerë është ajo që e bën njeriun njeri, i jep mundësinë e ndarjes nga krijesat e tjera, e bën më unik me të gjithë cilësitë e tij dhe e ndihmon në realizimin e qëllimeve. Pra, vlera na ndihmon të kuptojmë njohjen e së drejtës, mendimin e drejtë, vlerësimin e drejtë dhe sjelljen e duhur.

Sipas Okumuşit (Okumushit), (2010, f. 28) vlerat, si një e vërtetë shoqërore, krijohen bashkë me miratimin e përbashkët të anëtarëve të grupit. Ato sjellin një standart në vlerësimin e sjelljeve dhe janë bazë themelore për ekzistencën e institucioneve shoqërore. Duke mësuar vlerat e shoqërisë ku jetojnë njerëzit mësojnë se si të sillen përballë të tjerëve.

Ndërsa sipas Kılıçit (Kiliçit), (Kılıç M., 2011, f. 52) vlera mund të shprehet si një parim apo normë përcaktuese e veprimeve dhe sjelleve të individit në jetën shoqërore. Normat ose vlerat mund të cilësohen si parime sjelljeje të përgjithshme, të pranuara si “më i miri” dhe “më i drejti”. Këto norma sjelljeje nuk janë një fushë e mbështetur në dënime pozitive, por janë një fushe autonome.

Si përfundim mund të themi se vlerat janë pjesë e jetës sonë. Në disa raste ato janë si një manual, i cili na tregon mënyrën e veprimit e ndonjëherë janë ana kuptimplotë e jetës, shija e saj.

2. 1. 6. 1. Klasifikimi i vlerave

Klasifikimi i vlerave është bërë në fusha të ndryshme. Nëse u hedhim një sy studimeve të realizuara në këtë, fushë shohim se është bërë një klasifikim vlerash në disiplinat themelore. Filozofia, sociologjia dhe teologjia janë disa prej tyre. Secila prej këtyre disiplinave ka bërë klasifikimin e saj sipas fushës përkatëse.

Sipas Erenit, (2007, f. 298-299) njerëzit që në fillimet e historisë kanë ndjekur rrugën e klasifikimit të gjërave si “të mira” ose “të këqija”. Problemi këtu qëndron në

pikën se sipas kujt sjelljet janë përcaktuar si “të mira”, apo “të këqija”. Sipas mendimtarëve, të cilët merren me këtë temë, kjo gjendje mund të shpjegohet në dy mënyra. Ndërkohë që njëra prej tyre e sheh burimin e sjelljeve morale të “feja”, qëndrimi tjetër sheh si burimin kryesor faktorët jofetarë si: “mendja, intuita dhe ndjenja”. Sipas një mendimi të përhapur në Francë në vitet 1880 thuhet se njerëzit mund të zhvillojnë disa sjellje të përshtatshme me strukturën shoqërore, me anë të disa ndjenjave të lindura dhe pa nevojën e Perëndisë, por, filozofë të tjerë si Sartri, të cilët marrin për bazë teorinë e ekzistencializmit, mendojnë se njerëzit e kanë shumë të vështirë të gjejnë të drejtën pa drejtimin e Perëndisë.

Şentürk (Shenturk), (2010, f. 53) pohon se vlerat mund t'i klasifikojmë si materiale dhe shpirtërore, kombëtare dhe universale, objektive dhe subjektive, pozitive dhe negative në vija të përgjithshme, por mund të ndahen edhe në grupe, si: vlera fetare, morale, shkencore, ekonomike, sociale, politike dhe estetike.

Sipas Aydınit, (Aydın M., 2003, f. 243) “çdo lloj vlere e ka një anë objektive të brendshme dhe një anë superiore (të zgjatur përtej kornizës fizike). Kjo anë superiore bazohet në dy burime: shoqërore dhe mbishoqërore. Vlerat fetare janë vlera të mbështetura në burimin mbishoqëror (në burimin hyjnor). Ndërsa vlerat e përgjithshme sociale të cilësuar nga Durkheim si vetëdije e ndaluar apo kolektive shoqërore janë prodhim i komunikimit shoqëror edhe nëse mbështeten në një superioritet. Me një shpjegim më të thjeshtë, vlerat janë ose me burim hyjnor, ose shoqëror. Kjo pikë e fundit na shpie në llojet e vlerave dhe klasifikimin e tyre. Duke u bazuar edhe në burimet e mësipërme, vlerat mund të ndahen në sociale, profane dhe fetare. Vlerat sociale dalin në pah si domosdoshmëri e disa nevojave dhe shprehin humanizmin e pastër. Si shembull mund të japim dashurinë për vendlindjen dhe barazinë. Vlerat sociale mund t'i ndajmë në “kombëtare” dhe “universale”. Me vlera kombëtare kuptojmë ditët e caktuara historike, të cilat kufizohen me shoqërinë ku jeton personi. Ndërsa vlerat universale janë vlera të pakufizuara me një shoqëri, si: drejtësia, barazia etj.”

Göz (Göz), (2014, f. 94) i analizon vlerat në forma të ndryshme. Ai pohon se të drejtat e njeriut janë vlerat më të rëndësishme. Krahas kësaj, ai pohon se liria e jetës, të drejtat politike, liria e pronës, liria e udhëtimit, liria e besimit dhe e ndërgjegjes, liria e shprehjes dhe mendimit janë vlera të lidhura me të drejtat e njeriut.

Aydın (Aydın M. Z., 2010, f. 16) i ka radhitur kështu disa vlera kryesore të përdora shpesh në jetën tonë:

“Në krye të vlerave shoqërore vjen respekti, dashuria dhe përgjegjësia. Disa nga vlerat e pranueshme për të gjitha vendet e kohërat janë këto: drejtësi, thjeshtësi, mirëkuptim, miqësi, tolerancë, paqe, guxim, bujari, urtësi, ndjesi (empati), siguri, vendosmëri, bashkëpunim, bindje, optimizëm, mbështetje, udhëheqje, mëshirë, mirësjellje, vetëbesim, ndarje me të tjerët, durim, besnikëri, respekt, dashuri, përgjegjësi, falenderim, ndershmëri, humanizëm, virtyt, përshpirtshmëri, gëzimi i jetës, disiplina, qëndrueshmëria në fjalë dhe në vepra janë vlerat më primare.”

Klasifikimi i vlerave sipas Rokeach, Spranger dhe Schwartz është treguar në tabelën e mëposhtme.

Klasifikimi i vlerave sipas Rokeach

Rokeach (1973, f. 5) i ka klasifikuar vlerat në dy tituj kryesorë. Vlerat themelore janë ato , të cilat çdo njeri kërkon t’i arrijë. Ato janë të domosdoshme për t’u quajtur njeri. Vlerat e tërthorata (indirekte) janë në trajtën e mjeteve, të cilat përdoren në arritjen e qëllimit. Rokeach i ka ndarë vlerat e tërthorta në morale dhe të mjaftueshme. Vlerat morale lidhen më shumë me mënyrat e sjelljes sesa me qëllimin e jetës. Ndërsa, vlerat e mjaftueshme, janë më shumë individuale sesa sociale dhe zotërojnë një ndikim mbi sjelljet.

Tabela3: Klasifikimi i vlerave nga Rokeach

Vlerat themelore	Përmbajnë vlerat e dëshiruara përfundimtare	Sukses, zgjedhje e lirë, barazi, maturi, etj.
Vlerat indirekte	Shprehin mënyra sjelljeje që përdoren në arritjen e vlerave themelore	Guxim, përgjegjësi, drejtësi, vendosmëri, etj.

Klasifikimi i vlerave sipas Sprangerit

Sipas Akbaşit (Akbashit) (2004, f. 30-31) Sprangeri ka bërë më shumë një klasifikim të bazuar në vijat e përgjithshme të vlerave.

Tabela4: Klasifikimi i vlerave sipas Sprangerit

Vlerat shkencore	Vlerëson të vërtetën, njohuritë, gjykimin dhe mendimin kritik. Njeriu, i cili zotëron vlerat shkencore është kritik, racional dhe intelektual.
Vlera ekonomike	Vlerëson anën e dobishme dhe praktike. Thekson rëndësinë e përvetësimit të vlerave ekonomike në jetë.
Vlera estetike	Vlerëson simetrinë, përshtatshmërinë dhe formën. Individit e sheh jetën si llojshmëri ngjarjesh. Arti mendohet të jetë pjesë e domosdoshme e shoqërisë.
Vlera sociale	E rëndësishme është t'i duash, t'i ndihmosh të tjerët dhe të mos tregohesh egoist. Vlera më e madhe është dashuria për njeriun. Ky njeri ua shpreh dashurinë të tjerëve. Është i sjellshëm dhe i dashur. Nuk është egoist.
Vlera politike	Mbi çdo gjë qëndron fuqia individuale, ndikimi dhe pushteti. Lidhen me forcën e personit.
Vlera fetare	E koncepton universin si një të tërë dhe e lidh veten me tërësinë e tij. Sakrifikon gjërat e kësaj bote për hir të fesë.

Klasifikimi i vlerave sipas Schwartz

Sipas Kağıtçıbaşı'së dhe Kuşdilit (Kushdilit), (2000, f. 60-61) Schwartzi ka bërë më tepër një klasifikim rreth konceptimit të ndjenjave, shqisave të brendshme dhe pasqyrimin e tyre jashtë. Schwartzi i ndan vlerat në dy grupe sipas niveleve: vlerat në nivelin individual dhe vlerat në nivelin shoqëror. Veçoria më e madhe, e cila ndan vlerat e nivelit individual me ato të nivelit shoqëror, është tipi i qëllimit motivues që shprehin. Tipet motivuese të qëllimit janë këto:

Tabela 5: Klasifikimi i vlerave sipas Schwartz

Shpjegimi	Vlerat	Burimet
Fuqia (power): fuqia vepruese mbi qëndrimin shoqëror, njerëzit dhe burimet	Të jesh zotërues i një fuqie sociale, i një autoriteti social, të jesh i pasur. Të ruash paraqitjen tënde në shoqëri.	Grupi ndikues
Suksesi (Achievement): prirja e suksesit individual, duke marrë parasysh standartet shoqërore.	Të jesh i sukseshëm, efektiv, kërkues, një person që i ecën fjala (Të jesh i zgjuar).	Grupi ndikues
Hedonizmi: prirje ndaj pasioneve individuale.	Të shijosh jetën	Organizëm
Stimulim (Stimulation): kërkimi i emocionit dhe i risive.	Të jesh guximtar dhe të jetosh një jetë ndryshe. Të zotërosh një jetë plot emocione.	Organizëm
Vetëdrejtim (Self direction): pavarësi në mendim dhe veprim	Të jesh kreativ, kureshtar, i lirë. Të zgjedhësh qëllimet, të jesh i pavarur (Të respektosh veten).	Ndikues organizmi
Universalizëm: mirëkuptim, tolerancë dhe vëzhgim i mirësisë së të gjithë njerëzve e natyrës.	Të jesh i hapur në mendime, i matur, drejtësi sociale, barazi dhe të kërkosh paqen në botë. Të dëshirosh një botë plot mirësi, të bëhesh një me natyrën dhe të ruash ambientin.	Grupi b organizëm
Bamirësi (Benevolence): vëzhgimi i të mirës së personave të afërt dhe zhvillimi i	Të jesh bamirës, i ndershëm, falës, besnik, i përgjegjshëm (miqësi e vërtetë, dashuri e pjekur,	Organizëm, grup ndikues

saj.	një jetë shpirtërore, një jetë plot kuptim).	
Tradicionaliteti (Tradition): respekti dhe lidhja me zakonet kulturore, kufizimi i veprimeve, të cilat mund të dëmtojnë të tjerët dhe pritshmëritë sociale.	Të jesh modest, fetar, të pranosh ato që të jep jeta, të respektosh zakonet. Të jesh i sjellshëm, i bindur, të vlerësosh nënën, babain dhe të moshuarit, të provosh veten.	Grup ndikues
Siguri (security): vazhdimësia e marrëdhënieve ekzistente dhe qetësisë së personit e të shoqërisë.	Siguri kombëtare, të dëshirosh vazhdimin e rregullit shoqëror, të jesh i pastër. Siguria familjare, t'i përgjigjesh të mirës (ndjenja e lidhjes, të jesh i shëndetshëm).	Organizëm, grup ndikues
Shënim : Organizëm: nevojat universale të individëve si një organizëm biologjik. Ndikim: Parakushtet e një komunikimi të përshtatshëm shoqëror. Grup: domosdoshmëritë universale për vazhdimësinë e grupeve dhe funksioneve të tyre. a. Vlerat, të cilat nuk kanë dhënë rezultat në krahasimin ndërmjet kulturave, janë përcaktuar brenda parantezës. b. Mendohet se del në pah atëherë kur njerëzit krijojnë marrëdhënie me njerëz të tjerë, jashtë grupeve të tyre, pranojnë lidhjen mes grupeve dhe pranojnë kufizimin e burimeve natyrore.		

Ndërsa Özlem (Ëzlem) (2004, f. 169) i ka klasifikuar vlerat në 5 grupe kryesore në trajtën e vlerave pozitive-negative, e mirë-e keqe, e bukur-e shëmtuar, shpërblim-mëkat.

1. Vlerat hedonistikee (pozitive: pasioni, negative: dhimbja).
2. Vlerat njohëse (pozitive: e drejtë, negative: e gabuar).
3. Vlerat morale (Pozitive: e mirë, negative: e keqe).
4. Vlerat estetike (Pozitive: e bukur, negative: e shëmtuar).
5. Vlerat fetare (pozitive: shpërblimi, negative: mëkati)

Göz (2014, f. 89) i ka radhitur disa nga vlerat themelore shoqërore të lidhura me të drejtat e njeriut si më poshtë:

1. Dashuri, respekt

2. Mirëkuptim (Tolerancë)
3. Liri, përgjegjësi
4. Drejtësi dhe barazi
5. Vëllazëri, solidaritet, mbështetje
6. Drejtësi, punë
7. Mikëpritje, mirësi, optimizëm
8. Sakrificë
9. Dhembshuri, mëshirë
10. Modesti, përshëndetje me të tjerët
11. Të respektosh trashëgiminë kulturore

Uysal (2003, f. 53) bën një klasifikim të tillë vlerash: i mirë apo i keq dhe i bukur apo i shëmtuar. Ndërkohë, klasifikimi i vlerave në e mirë dhe e keqe mund të kuptohet si një vlerë morale, klasifikimi i vlerave në e bukur dhe e shëmtuar kuptohet si një vlerë estetike. E mira dhe e keqja janë cilësi që i përkasin njeriut. Gjendja e të mirës dhe e të keqës në këndvështrimin e fenomeneve natyrore është një gjendje caktuar. Përndisë në mënyrë direkte. Megjithëse kjo gjendje është shqetësuese për persona me ndjeshmëri fetare, imensioni fetar i të keqes dhe i të mirës sjell në mendje një klasifikim vlerash në aspektin fetar. Ky klasifikim vlerash mund të vështrohet më shumë në aspektin fetar. Nga ana tjetër, dhënia e çmimeve të ndryshme për një vepër arti tregon vlerën e saj ekonomike. Nisur nga ky fakt, mund të flasim për vlera morale, fetare, estetike, ekonomike, shkencore, politike dhe sociale. Pika ku duhet tërhequr vëmendja këtu është mospërcaktimi i saktë i kufijve të vlerave, sepse, ashtu si liria e shprehjes pranohet nga vlerat demokratike, mund të numërohet edhe si një vlerë shkencore.

2. 1. 6. 2. Vlera nga aspekti sociologjik

Zakonet, tradita dhe të gjitha të vërtetat, të mirat dhe të këqija, të gjendura brenda jetës, vlerësohen në fushën e sociologjisë. Kur shihet nga ky aspekt, gjithçka e cilësuar si vlerë duhet vlerësuar nga pikëpamja sociologjike.

Sipas Halsteadit dhe Taylorit (2000, f. 169) vlera është diçka që shpreh konceptimet dhe parimet tona si rezultat i objekteve rreth nesh, njerëzve, ideve që hasim, gjendjeve dhe lëvizjeve për të mirën, të keqen, të dëshiruarat dhe të padëshiruarat.

Sipas Smelserit, (1965, f. 26) specialistët socialë analizojnë vlerat pranë fushave të përgjegjësisë së tyre. Në këtë analizim, specialistët përdorin dy metoda: e para, janë të dhënat e vëzhguesit, vëzhgimi i ardhur nga analiza direkte e dokumenteve të shkruara, ndërsa tjetra është analizimi tërthor (indirekt) i bërë mes sugjerimeve empirike të vlerave.

Korkmazi, (Korkmaz A. , 2013, f. 56) pohon se Georg Simmel është një nga emrat më të njohur të teorisë së vlerave sociologjike. Korkmazi thekson se Simmeli, një pjesë të veprës së tij, *The philosophy of money* (1907), ia ka kushtuar analizës së vlerave. Në këtë vepër, Simmeli ka qëndruar mbi llojet e vlerave, ndikimet e parasë te kultura dhe vlerat, marrëdhëniet në mes mendimit botëror, mënyrës së jetesës dhe vlerave, ndikimi i shfaqur te vlerat dhe procesi kulturor gjatë kalimit nga stili tradicional i jetës tek ai modern, ndikimet e teknologjisë në kulturë dhe vlerat, kthimi i parasë nga një mjet në qëllim dhe ndikimi i këtij fakti në kulturën dhe vlerat, marrëdhënia në mes parasë dhe individualitetit, parasë dhe lirisë etj.

Sipas Simmelit, (2004, f. 63-76) njerëzit krijojnë vlera duke bërë disa objekte, pastaj vendosin distancë me këto objekte dhe më pas përpiqen t'i fitojnë ato objekte. Objektet e lehta për t'u arritur ose të pamunduruarat nga ky aspekt nuk janë të

rëndësishme. Veçoritë të cilat merren parasysh në përcaktimin e vlerave janë faktorë, si: vështirësitë e kaluara në përfitimin e objektit dhe koha që duhet për ta marrë atë.

Topçuoğlu, (2010, f. 12) qëndron mbi të gjykimin nëse vlerat janë një e vërtetë sociologjike, duke theksuar se krahas përcaktimit të veprave si morale, fetare apo estetike, ato formohen nga veprat e njeriut. Për sa kohë njerëzit i shohin disa gjëra si të rëndësishme, do të vazhdojnë t'i pranojnë si vlera. Sipas Topçuoğlusë:

“Kjo gjendje mund të duket se bie në kundërshtim me mendimin se vlerat janë universale dhe nuk ndryshojnë as me kalimin e shekujve e as sipas kushteve shoqërore. Por, parë nga aspekti shoqëror, vlerat ndikohen nga proceset reciproke të prodhimit në mes njeriut dhe shoqërisë. P.sh. në një shoqëri ku feja qëndron në qendër të jetës shoqërore, ajo do të bëhet dhe burimi i vlerave të shoqërisë. Nëse ndryshon vendi i fesë në shoqëri, do të ndryshojë dhe praktika e jetës dhe konceptimi i vlerave. Lidhur me këtë situatë, do të përjetohej një periudhë kërkimi e mbështetjes dhe unitetit shoqëror dhe me kalimin e kohës do të shfaqen vlera të tjera.”

Sjelljet janë një nga gjërat që ndikojnë direkt te vlerat. Ndryshimet e bëra në strukturën sociale do të ndikojnë direkt te disa sjellje dhe te kallëpet e sjelljeve. Në vitin 1922, policet femra amerikane masnin gjatësinë e kostumeve të banjës në plazh. Tani kjo gjë mund të duket e pakuptueshme nga amerikanët. Giddens jep një shembull të ndryshëm në këtë pikë. Bashkëjetesa mes çifteve para dasmës shihej si diçka e papranueshme në vitet '80 ose vitet '90, por në ditët tona pranohet si diçka normale. Madje, bashkëjetesa tani shihet si një parakusht për njohjen më të mirë të njerëzve me njëri-tjetrin para martesës.

2. 1. 6. 3. Vlera nga aspekti filozofik

Vlera është koncept i rëndësishëm për njeriun, e përdorur për çdo gjë. Ashtu siç është i rëndësishëm ky univers, i cili drejtohet sipas mendimeve e veprimeve të njeriut, aq i rëndësishëm është edhe kuptimi që përmban fjala vlerë nga ana filozofike.

Veçanërisht nuk duhet harruar se çdo veprim, fjalë, sjellje apo mendim i shprehur si vlerë hyn në fushën e interesit të filozofisë. Njeriu është tema parësore e filozofisë me vetë ekzistencën dhe njohuritë e tij.

Koncepti vlerë është analizuar në mënyra dhe kohëra të ndryshme nga filozofët e parë. Özlemi, (2004, f. 284-289) e shpjegon kështu qëndrimin e mbajtur ndaj vlerave gjatë historisë: “Nëse i hedhim një vështrim çështjes së vlerave në shekullin antik, shohim pasqyrimin e një filozofie subjektiviste me qendër njeriun. Kjo kuptohet edhe nga sugjerimi i një prej sofistëve më të njohur, Protogorasit. Ai shprehet se “Njeriu është masa e çdo gjëje”. Filozofitë kristiane dhe islame të mesjetës që flasin për vlerat kanë ndjekur gjurmët e Platonit dhe Aristotelit. Mendimi i myslimanëve dhe i të krishterëve për vlerat përkufizohet si: “Ekzistenca ka lindur bashkë me vlerën”. Ndërkohë, që Augustinus (Agustini), një nga filozofët e Mesjetës, zhvillon një hierarki të ngjashme me atë të Platonit. Ai pohon se krijesat zotërojnë vlera unike. Sipas tij, qenia më me vlerë, Perëndia, gjendet në majë. Nën të, zënë vend engjëjt dhe pas tyre objektet fizike. Mendimet e ‘shekullit të ri’ vatërzohen te mendja dhe shkenca, siç është humanizmi dhe iluzionizmi. Shkenca merret vetëm me faktet, fenomenet kurse ana e vlerave mbetet një aktivitet i paanshëm dhe neutral. Një studim shkencor realizohet i pavarur nga morali, politika, feja, ideologjia dhe si rrjedhojë, edhe nga vlerat. Shkenca përshkruan vetëm fenomenet, vetë asnjëherë nuk dhuron, apo prodhon një gjykim vlerash.

Uysal (2003, f. 54) e përshkruan kështu këndvështrimin e Sokratit dhe të Platonit rreth vlerave: “Sokrati besonte se ekziston një lloj uniteti në mendimet e njerëzve rreth vlerave si: drejtësi, guxim, bujari, etj. Megjithëse në fillim njerëzit mund të përmendin gjëra të ndryshme në lidhje me këta koncepte, apo vlera kur ato gjykohen me mënyrën sokratike, vihet re se sjellin në kujtesë gjëra të ngjashme,

madje të njëjta. Sipas tij ekziston diçka e njohur si drejtësi dhe kjo ekziston pavarësisht ndjenjave dhe prirjeve të njeriut. Megjithëse në fillim mund të mendojnë ndryshe, pjesa më e madhe e njerëzve do të shprehë të njëjtin mendim në fund të një kërkimi të planifikuar. Si rrjedhojë vlerat sipas Sokratit ekzistojnë në mënyrë objektive. Edhe Platoni ndan të njëjtin mendim, me një këmbëngulje, vendosmëri dhe qartësi më të madhe. Sipas tij, vlerat ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga mendimi, apo prirja e dikujt tjetër. Një gjykim moral, si p.sh: “vrasja e një personi është diçka e keqe” është një gjykim i prerë dhe i qartë, po aq sa pohimi “dy plus dy bëjnë katër”, epse të vërtetat, të cilat përbëjnë temën e këtij gjykimi janë të vërteta objektive.

2. 1. 6. 4. Vendi dhe rëndësia e vlerave në edukim.

Krahas formimit të njerëzve të përshtatshëm me nevojat e vendit, objektivi i edukimit është të formojë breza të aftë, të cilët mund të integrohen në botën moderne, respektues të ligjeve, të ambientit dhe të përputhur me vlerat e vendit. Ky është një objektiv i vlefshëm edhe për vendin tonë, sepse edhe për sistemin arsimor të Shqipërisë, e rëndësishme është të edukojë individë të dobishëm për familjen dhe shoqërinë ku jetojnë. Për këtë arsye, duhet të bëhen përpjekjet maksimale në plotësimin e mangësive të kuadrove arsimorë dhe në trajnimin e mësuesve në përfitimin e eksperiencave të reja. Jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende, sipas Hökeleklit, (2010, f. 9) si Amerika, pjesën më të rëndësishme të reformave e përbën fusha e “edukimit të karakterit”.

Zhvillimet e realizuara në fushën e teknologjisë gjatë viteve të fundit ndikojnë direkt në kulturat e vendeve si në zhvillimin e mjeteve komunikuese, ashtu edhe në përhapjen e tyre. Gjendja më e përhapur e me të cilën mund të përballemi në këtë periudhë është dobësimi apo zhdukja tërësore e moralit, e vlerave të vendit apo

shoqërisë. Këtu e rëndësishme është që ky ndikim, i cili nuk mund të ndalohet të kufizohet në kufij të pranueshëm dhe t'u transmetohen brezave të ardhshëm në nivele maksimale vlerat kombëtare dhe kulturore. Ndodh kështu sepse edhe pozicionimi ynë nga pikëpamja gjeografike apo të qenit një vend i vogël bashkë me objektivin e hyrjes në Evropë nuk duhet të na pengojë në transmetimin te brezat e ardhshëm të vlerave kombëtare dhe kulturore, apo në formimin e një jete të sigurtë e të besueshme në këtë gjeografi.

Për realizimin e këtij synimi duhen riorganizuar programet edukuese dhe arsimore në linjat e përfitimit të vlerave kombëtare dhe kulturore. Nuk duhet harruar se shkollat nuk janë për ngarkimin e njohurive, por për shndërrimin e njohurive në sjellje.

Sipas Hökeleklit, (2010, f. 9) të mësuarit duke e përjetuar është metoda më efektive edhe në fushën e moralit dhe të vlerave, studentët mësojnë më mirë kur e praktikojnë diçka. Për zhvillimin e një karakteri të mirë, studentët kanë nevojë për diskutime të përditshme. Studentët pjesëtarë të një mësimi të përbashkët përfitojnë eksperiencë më praktike, përsa i përket ndarjes së punëve, apo mënyrës së parandalimit të grindjeve në shkollë.

Një nga komponentët më të rëndësishëm, i cili do të shpjerë drejt suksesit në transmetimin e vlerave te brezat e ardhshëm është rregullimi i sistemit arsimor duke filluar që nga kopshti deri në universitet, në çdo etapë të aktiviteteve edukuese, sipas vlerave të kulturës dhe vlerave universale njerëzore.

2. 1. 6. 5. Disa veçori të vlerave

Për të kuptuar më mirë vlerat duhen analizuar më mirë tema, si: Çfarë shprehin vlerat, si përkufizohen, veçoritë, rëndësia e tyre? Veçanërisht në kohën, kur

pasqyrohet një kompleksitet konceptimesh të ndryshme, kërkohet realizimi i një studimi, duke marrë mendimet e palëve dhe duke arritur me aq sa është e mundur në një mendim të përbashkët.

Janë dhënë mendime të ndryshme rreth veçorive të vlerave dhe pyetjes se çfarë janë ato. Ato mund t'i radhisim kështu:

Kağıtçıbaşı dhe Kuşdili, (2000, f. 60) shprehen se, Schwartzi i ka renditur veçoritë e vlerave në këtë mënyrë:

1. Vlerat janë besime. Ato nuk mbartin një cilësi mendimi të pastruar nga ndjenjat. Kur aktivizohen bashkëpunojnë ngushtë me ndjenjat.

2. Vlerat lidhen me qëllimet e individit dhe me mënyrat e sjelljes së tij në realizimin e tyre.

3. Vlerat qëndrojnë mbi veprimet dhe situatat specifike. P.sh. vlera e bindjes është e vlefshme në shtëpi, punë, shkollë dhe në marrëdhëniet me personat e panjohur.

4. Vlerat funksionojnë si standarde, të cilat drejtojnë ndryshimin apo zgjedhjen e sjelljeve, njerëzve dhe ngjarjeve.

5. Vlerat radhiten mes tyre sipas rëndësisë që kanë. Kjo radhitje krijon një sistem, i cili përcakton përparësitë e vlerave. Kulturat dhe individët mund të përshkruhen me sistemet e përparësive të vlerave.

6. Vlerat janë të hapura ndaj ndryshimeve.

7. Vlerat mund të tregojnë ndryshime sipas kulturës. Madje mund të kenë ndryshime edhe brenda kulturës së tyre.

Fichter (Fikter), (1990, f. 150) shprehet kështu në lidhje me disa veçori të vlerave:

1. Vlerat janë fakte bashkuese të përvetësuara nga individit apo shoqëria.

2. Vlerat ekzistojnë për të mirën e njeriut dhe janë masa themelore për të përballuar disa nevoja të shoqërisë.

3. Vlerat janë instikte të cilat drejtojnë sjelljet e individit.

4. Vlerat luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin, formësimin dhe drejtimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të njeriut duke ndikuar te sjelljet dhe qëndrimet e mbajtura nga ai.

5. Ndjesitë sociale të krijuara në shkollë apo brenda klasës krijojnë bazën e zhvillimit të vlerave, të cilat mësohen me anë të praktikimit.

6. Në edukimin e vlerave është shumë i rëndësishëm përvetësimi i sistemit moral dhe i koncepteve të vlerave.

Doğani (Doani), (2000, f. 411-413) i radhit kështu disa veçori të vlerave:

1. Vlerat ndikohen nga gjykimet për to .

2. Vlerat janë burime të sjelljeve.

3. Vlerat janë relative, janë ideale të përvetësuara nga çdo lloj shoqërie.

4. Vlerat zotërojnë një përmbajtje emocionale. Ashtu siç mund të krijohen nga një etapë mendore, ashtu mund të krijohen edhe në mënyrë të befasishme, momentale.

5. Vlerat kanë një strukturë hierarkike.

Korkmaz (Korkmaz A., 2013, f. 54) i radhit kështu disa veçori të vlerave, mbi të cilat bashkohen dhe një pjesë e rëndësishme e sociologëve të vlerave:

1. Janë një fenomen i fokusuar mbi sjelljen shoqërore.

2. Vlerat janë sjelljet e bëra me vetëdije dhe dëshirë nga njerëzit.

3. Vlerat janë fenomene që drejtojnë sjelljet e njerëzve.

4. Vlerat nuk është e thënë të përputhen me njëra-tjetrën.

5. Ato mund të tregojnë ndryshueshmëri sipas shoqërive.

6. Vlerat themelore mundësojnë vazhdimësinë e vendosmërisë dhe solidaritetit.

Sipas Aydnit, (Aydn M., 2011, f. 40) vlerat janë një pasuri e përbashkët e shoqërisë, si rrjedhojë janë një pjesë e pandarë e jetës së njeriut. Ekzistojnë vlera të ndryshme, si: vlerat ekonomike, fetare, familjare, politike dhe të ngjashme. Sipas Aydnit, ekzistojnë disa pika të përbashkëta, përsa u përket veçorive të vlerave përcaktuar nga studiuesit. Ato mund t'i radhisim kështu si më poshtë:

1. Vlerat janë fenomene, të cilat të japin mundësinë e racionalizimit dhe përvetësimit. Ashtu siç e thekson dhe Rokeach, vlera e çfarëdo lloji qoftë, i jep individit mundësinë e zgjedhjes e të krahasimit. Ato krijojnë një standard duke e mundësuar këtë.

2. Ashtu siç e pohon dhe Schwartzi, vlerat janë fenomene, të cilat mbartin besime dhe si rrjedhojë mbartin dhe superioritete. Çdo vlerë përmban një besim. Pra, në çdo vend ku ndodhet vlera ekziston një pranim, përvetësim. P.sh. fjalia “Unë besoj se miku im thotë të vërtetën” pasqyron besimin e patundur në domosdoshmërinë e thënies së të vërtetës.

Nga gjithë këto vlerësime dhe analiza kuptojmë se koncepti vlerë është një fenomen, i cili na shfaqet në çdo fushë të jetës. Kjo e vërtetë e pajisur me gëzim, hidhërim, dhimbje jeton me njeriun deri sa të vdesë.

Përcaktimi i veçorive, i përmbajtjes dhe gjykimi se çfarë janë vlerat në ditë e sotme duhet të shpjegohet me anë të përcaktimit të vlerave në botën moderne dhe qëndrimeve të mbajtura të njeriut përballë tyre, sepse, bashkë me hedhjen e hapave drejt botës moderne, ka filluar dhe diskutimi se cilat janë vlerat më të rëndësishme në jetën tonë. Dukuritë e gjykuara si vlera nga një pjesë e njerëzve nga një pjesë tjetër janë vlerësuar si jetë individuale apo të drejta njerëzore. Për këtë arsye, duhen

realizuar studime dhe kërkime për vlerat e kulturës sonë dhe rreth mënyrës së transmetimit të tyre te brezat e rinj.

2. 1. 6. 6. Funksionet e vlerave

Njeriu është një krijesë sociale e detyruar të jetojë në bashkësi. Si rrjedhojë, i duhet të vendosë një sistem me rregulla dhe ligje brenda jetës shoqërore. Këto rregulla apo ligje të pranuara si vlera janë shumë të rëndësishme për jetën shoqërore, jo vetëm në rregullimin e jetës tonë, por edhe në përdorimin e tyre si një mjet socializues natyral. Këtu mund të jepet si shembull përfitimi i zakoneve dhe traditës së vendit, apo shoqërisë ku jetojnë.

Sipas Gözit, (2014, f. 98) shoqëritë e krijuara nga individë, të cilët kanë përvetësuar vlerat, krijojnë një botë më pak problematike përsa u përket të drejtave themelore dhe lirive.

Për këtë arsye, duhen vazhduar në mënyrë efektive dhe të shëndetshme të gjitha studimet në transmetimin e vlerave te brezat e rinj.

Është shumë e rëndësishme të ndjesh përgjegjësinë për jetën tënde dhe ta vazhdosësh këtë. Në kuadrin e matjeve globale vihen re shumë probleme, të cilat kërcënojnë njerëzimin. Vlerat janë fenomeni më i rëndësishëm që mundëson një këndvështrim dhe vlerësim të shëndetshëm të të drejtave themelore dhe lirive. Në këtë botë të globalizuar, vlerat shihen si mbështetësit më objektiv që mbajnë në këmbë shoqërinë. Parë nga ky aspekt, vlerat e civilizimeve janë shumë të rëndësishme.

Aydini (Aydın M., 2011, f. 41) e shpreh funksionin e vlerave në trajtën e formulës “përcaktuese në realizimin e të gjitha ngjarjeve njerëzore”. Çdo gjë që hyn në fushën e interesit të njeriut mbështetet te një vlerë. Vlerat luajnë një rol aktiv duke filluar që nga politika, feja e deri te jeta familjare.

Sipas Topçuoğlusë (Topçuollusë), (2010, f. 9) vlerat luajnë rolin e udhëzuesit për njeriun, drejt një zgjedhjeje të caktuar në jetë. Duke qenë e vetmja pikë referimi për njeriun, në dallimin e të mirës nga e keqja, ato përmbajnë një funksion shumë të rëndësishëm në jetën e tij.

Ndërsa te Hökelekli, (2010, f. 5) e shohim se vlerat janë një lloj libri udhëzues. Personat, të cilët veprojnë sipas tij, do të mund të bëhen individë të dobishëm për shoqërinë. Sipas tij, vlerat janë kushti më i rëndësishëm i të qenit një qytetar i mirë, produktiv dhe i përshtatshëm. Ato na ndriçojnë rrugën tonë duke na treguar se si dhe çfarë duhet të jemi si njerëz, por në ditët e sotme po përjetohej një krizë e madhe vlerash. Fenomeni bazë, i cili ndikon në harresën e vetes nga ana e njeriut, në zhvlerësimin e vlerave morale është braktisja e individëve dhe shoqërive në zgjedhjet politike e ideologjike të qeverive. Janë zhvlerësuar vlera të rëndësishme, si: mëshira, solidariteti, përgjegjësia, toleranca, durimi, ndershmëria. Zhvlerësimi i vlerave në një shoqëri i lë individët e saj larg një zhvillimi të shëndetshëm. Te personat, të cilët nuk e dinë qëllimin e vërtetë të jetës, zhvillohen ndjenjat e stresit, e mërzisë dhe e absurditetit. Në këtë rast, mund të flasim për “indiferentizmin e njeriut ndaj natyrës, për ngrirjen e jetës dhe kthyerjen e njeriut në një robot.”

Gözi (2014, f. 91) i sheh vlerat, si një parakusht në shfaqjen e kulturës së tolerancës në mendime, në shikimin e ndryshimeve të njëri-tjetrit si pasuri të njerëzimit dhe në vazhdimin e jetës në paqe e qetësi.

Fichter, (1990, f. 139) i radhit disa funksione të vlerave si më poshtë:

1. Vlerat përdoren si mjete në vlerësimin e mendimeve dhe veprimeve.
2. E drejtojnë vëmendjen e personave drejt temave të dëshiruara, të dobishme dhe të rëndësishme.
3. Tregojnë rrugët e mendimit dhe veprimit ideal.

4. Luajnë rolin e udhëzuesit në përvetësimin dhe realizimin e roleve sociale.
5. Përdoren si mjet i presionit dhe i kontrollit social.
6. Mundësojnë solidaritetin në shoqëri.

Zotërimi brenda jetës sociale i harmonisë dhe marrëdhëniet e ngushta mes njerëzve ua shtojnë edhe më shumë rëndësinë e vlerave. Vlerat janë argumentet më të rëndësishme të përdora dhe për të cilat kemi nevojë në rastet, kur uniteti vlerësohet.

Sipas Gözit, (2014, f. 93) vlerat janë elementë, që mbajnë në këmbë shoqëritë. Të cilësuar si sjellje të virtytshme, të cilat drejtojnë marrëdhëniet mes individëve të shoqërisë, vlerat luajnë një rol të rëndësishëm në fitimin dhe praktikimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Një nga funksionet më të rëndësishme të vlerave është strukturimi i jetës shoqërore. Të gjitha njësitë e jetës shoqërore kanë nga një komponent vlere. P.sh. marrja e vendimeve të drejta në fushën e drejtësisë nxjerr në pah disa vlera, si e drejta, drejtësia. Bërja e punës në mënyrën e duhur nga punonjësit e fushës së shëndetësisë mundëson formimin e vlerave në lidhje me rëndësinë e jetës së njeriut.

Nga ana tjetër, jep njohuri të rëndësishme në lidhje me vlerat shoqërore të mësuara më shumë në mënyrë verbale dhe jo të shkruar. Na ndihmon të njohim njerëzit, nivelin e tyre të jetesës, të preferuarat, frikën dhe jetën fetare.

2. 1. 6. 7. A janë universale vlerat?

Universaliteti i vlerave ka qenë një temë diskutimi që në kohërat e mëparshme. Në ditët e sotme, bashkë me shtimin e të drejtave dhe lirive demokratike, dalja në plan të parë e lirive individuale, domosdoshmëria dhe universaliteti i vlerave, janë diskutuar në këndvështrime të ndryshme.

Ja si i prek diskutimet rreth universalitetit të vlerave një nga filozofët e parë, Rebouli, (1995, f. 364). Ai refuzon universalitetin e vlerave të sofistëve në Greqinë e lashtë dhe pohon se çdo vlerë i takon personit, që e pranon atë. Sipas sofistëve, vlerat dhe të vërtetat mund të ndryshojnë sipas mendimeve të personave që i aprovojnë. E vërteta është e bukur dhe e drejtë për atë që e interpreton si të tillë. Për dikë tjetër, mund të jetë krejt e kundërta. Si rrjedhojë besohet se vlerat janë subjektive. Antropologjia kulturore e aprovon këtë tezë duke treguar se vlerat ndryshojnë sipas kulturave. Nga ana tjetër, Sokrati e pyet Euthfronin: “Një njeri besimtar quhet i tillë, ngaqë i do perënditë, apo i do perënditë ngaqë është besimtar? ” Përgjigjja padyshim është: “Sepse është besimtar.” Të njëjtat pyetje bëhen edhe për bukurinë, të drejtën dhe të gjitha vlerat e tjera.

Uysali (2003, f. 54) pohon se Sokrati mendonte se ekzistonte një mendim i përbashkët i njerëzve, përse u përket vlerave, si: drejtësi, guxim, etj. Sipas tij, ekziston diçka që quhet drejtësi, e drejtë dhe kjo ekziston pavarësisht prirjeve të njerëzve. Platoni mendonte se vlerat ekzistojnë të pavarura nga mendimi dhe prirja e dikujt. Gjykimi ‘të vrasësh një njeri është diçka e keqe’ është një gjykim i prerë dhe objektiv, po aq sa është e prerë ‘dy dhe dy bëjnë katër’.

Nga filozofët e parë nuk ka pasur një mendim të tretë në lidhje me diskutimin rreth universalitetit të vlerave. Diskutimi i filluar shekuj më parë nga filozofët e parë vazhdon akoma sot. Çdo njeri i interesuar me këtë temë bën shpjegimin, analizën dhe jep mendimin e tij të lidhur me bagazhin e njohurive, kulturën dhe këndvështrimin e tij.

Sipas Dervishit, (Dervishi Z. , Vlerat, 2015) një pjesë e konsiderueshme e vlerave dhe normave morale, kulturore janë universale, por ato përthyhen konsiderueshëm në veçoritë e modelimit psiko-kulturor të çdo populli, pra kanë edhe

ngjyresë kombëtare. Vlen të theksohet se përforcimi i prirjeve globalizuese përgjithësisht i zbeh nuancat kombëtare edhe në këto fusha.

Briseida Mema i mëshon idesë se çdo njeri me përpjekjet dhe mundimet e tij mund të arrijë vlera universale morale dhe sociale. Sipas Memës (2015):

Çdo njeri pa dallim kombësie, feje, pozicioni shoqëror apo ideje politike, mund të kultivojë respektin për veten, për tjetrin si dhe për mjedisin ku jeton. Në këtë këndvështrim ne mund të themi se ekziston një moral dhe vlera shoqërore universale të arritshme nga çdo individ. Them “të arritshme” pasi morali dhe vlerat shoqërore janë gjithashtu edhe një kod jetese, por edhe një status ndërgjegjeje. Pra morali dhe vlerat mbartin edhe një nocion subjektiv që sigurisht ecën, zhvillohet dhe ndryshon edhe nga individ në individ, edhe nga shoqëria në shoqëri.

Sipas Xhaferajt, (2015) krahas moralit universal që është i aplikueshëm tek të gjithë pavarësisht kulturës, fesë, racës, seksit apo kombësisë ne kemi edhe moralin nihilist apo relativist. Relativizmi moral përpiket të shpjegojë se vlerat morale ndryshojnë jo vetëm nga koha në kohë, por edhe nga një shoqëri në një tjetër. Shqipëria, për shembull, ka lënë mbas krahëve shumë sjellje të etikës normativiste të së kaluarës, që frymëzoheshin nga morali doktrinarist.

Sipas Mustafajt, (2015) marrëdhënia e individit me paranë dhe vlerësimi i punës si krijuese e mirëqenies, vlerësimi i familjes si qeliza ripërtëritëse e shoqërisë apo vlerësimi i solidaritetit ndaj të dobët, mendoj se janë universale. Por mënyra e shfaqjes së tyre në realitet mund të ndryshojë nga një shoqëri te tjetra, në përputhje me gjurmët që ka lënë historia nëpër të cilën ka kaluar njëra apo tjetra shoqëri. Për shembull, tabutë morale, që ka trashëguar shoqëria shqiptare nga e kaluara e vet, në shumicën e tyre nuk janë të njëjta me tabutë morale që ekzistojnë në Francë apo me të tjera tabu, që ekzistojnë në Turqi.

Sinani, (2015) shprehet se nuk ka dyshim se ka disa vlera universale, pa të cilat do të ishte i pamundur dialogu ndërmjet individëve në një shoqëri dhe ndërmjet shoqërive të ndryshme. Këto vlera universale, përbëjnë atë

bashkësi vlerash, që në qoftë se do të shpreheshim me gjuhën e Kantit, përbëjnë ligjin moral më të rëndësishëm të çdo shoqërie. Ndërsa rregullat dhe vlerat që karakterizojnë shoqëri të caktuara, janë rezultat i faktorëve lokalë të bashkësive të caktuara, rezultat i evolucionit shoqëror dhe politik të këtyre bashkësive. Një nga vlerat, në mos më e rëndësishmja, është ajo e dinjitetit të personit njerëzor. Në këtë kuadër, çdo shoqëri duhet të përpunojë norma dhe ligje që shkojnë në favor të lulëzimit të dinjitetit të personit njerëzor. Shoqëritë që dalin nga regjimet totalitare e kuptojnë më së miri rëndësinë e një vlere të tillë.

Tushi, (2015) shprehet se nuk beson më në mundësinë e moralit universalist, të përbashkët dhe autetntik për të gjithë kombet, popujt, racat. Pa mohuar një sistem të ngjashëm vlerash dhe një dimension të përbashkët human të moralit, unë besoj se morali i kohës postmoderne është “moral kontekstual” që përshtatet me traditat, zakonet, rrugën e zhvillimit historik, klimën etj. Diversifikimi i sistemit të vlerave morale është veti universale e shoqërisë së hapur. Në këto kushte madje unë besoj se në të ardhmen do të flasim akoma më shumë për “moralin e personalizuar”, sepse njeriu i lirë nuk ka dëshirë të jetë konformist dhe të nënshtrohet nga tirania e disa rregullave të caktuara tërësisht nga jashtë. Megjithatë diçka do mbesë e përbashkët në kuptimin e përcaktimit të një lloji kufiri human për të moralshmen dhe të pamoralshmen, të mirën dhe të keqen.

Sipas Arslanoğlusë (Arslanollusë), (2005, f. 5) të njohësh konceptimin e vlerave të shoqërisë ku jeton apo ta analizosh atë është një kusht i rëndësishëm në emër të marrëdhënieve të asaj strukture. Ja si e shpreh Arslanollu reagimin dhe përcaktimin e një gazetari amerikan, i cili viziton vendin e tij: “Në Ankara, Stamboll dhe Izmir kam parë shumë meshkuj, të cilët ecnin dorë për dore dhe të përqaftuar, kjo do të thotë se homoseksualiteti është koncept normal në Turqi.” Vlerësimi nga gazetari amerikan i marrëdhënieve të meshkujve të vendit, sipas vlerave evropiane ka dhënë një rezultat të gabuar. Në të vërtetë, shëtitja dorë për dore nga meshkujt e këtij vendi është një koncept krejt natyral. Nëse para se të krijonte këtë mendim do të pyeste pak rreth e rrotull nuk do të arrinte në një konkluzion të gabuar.

Një mospërputhje në sipërfaqen konceptuale sipas Poyrazit (Pojrazit), (1997, f. 145) mund ta zgjidhim me anë të diskutimeve të bëra në lidhje me vetë konceptin. Për të zgjidhur çështjen nëse Toka është apo jo rrumbullake mund të përdorim disa të dhëna nga gjeografia. Por pyetja “se çfarë vlere ka toka” do të sjellë me vete shumë përgjigje. P.sh. pyetjes “pse njeriu ka dy sy” mund t’i japim disa përgjigje, nga këndvështrimi i vlerave estetike, i vlerave ekonomike, i vlerave fetare etj. Për nga aspekti artistik, ekzistenca e dy syve është e nevojshme për simetrinë e fytyrës sonë të bukur. Përkundrazi, simetria e syve do të prishej dhe ne do të ishim të shëmtuar. Sipas specialistit të ekonomisë, nëse njëri sy do ishte i verbër, do të na duhej syri tjetër për të shikuar. Sipas këndvështrimit të klerit fetar, ekzistenca e dy syve shpjegohet nga bërja e mëkateve të tepërta. Kemi aq shumë mëkate, saqë nuk mjafton një sy për të qarë.

Sipas episkopit të Krujës, Andoni, (2015), kisha mëson se ekziston mëkati dhe virtyti, të dyja kanë shprehjet e tyre brenda çdo konteksti kulturor dhe shoqëror. Kufiri mes tyre në shumë raste është tepër i qartë dhe i përcaktuar, siç është zbuluar nga Shkrimet e Shenjta përmes urdhërimeve dhe porosive të ndryshme, në disa raste të tjera ai mund të jetë pak më i vështirë për t’u dalluar dhe përcaktuar, por sigurisht që ekziston.

Sipas Uysalit, (2003, f. 60) ndryshimi i zakoneve dhe i traditave, mundësive sociale dhe kushteve të jetës nga një shoqëri në tjetrën, ndryshimi i eksperiencave të njerëzve dhe edukimi që marrin i hap rrugë dhe ndryshimit të gjykimeve morale. Ndryshimi në vlerat morale të cilësuar si vlerat universale të mendjes së njeriut sjell dhe ndryshimin e mënyrës së konceptimit dhe hedhjes në praktikë. Megjithëse vlerat, si: drejtësia, humanizmi, bujaria etj. janë nga një vlerë morale më vete, secili prej tyre i koncepton dhe i jeton nën dritën e këndvështrimit që zotëron, pasi i ka menduar.

Ndërsa ajo që mund të thuhet nga ne është se vlera është universale. Padyshim që për çdo popull dhe për çdo shoqëri ekziston një zgjidhje e mirë dhe një zgjidhje e keqe. Por, në çdo vend të botës, koncepte, si: drejtësi, familje, atdhe dhe ndershmëri pasqyrojnë një kuptim të përgjithshëm. Kjo na tregon se mund të flasim rreth vlerave në kuptim universal, por pa lënë pas dore dhe ndryshimin që mund të vihet re në formën e tyre.

2. 1. 6. 7. Shkaqet e largimit nga vlerat sociale

2. 1. 6. 7. 1. Jeta e metropolit

Bashkë me industrializimin e shoqërive të shekullit tonë dhe për shkak të rritjes së kërkesës për punë, njerëzit kanë filluar të largohen nga fshatrat apo qytetet e vogla dhe të jetojnë në qytetet më të mëdha, të njohura ndryshe si metropole. Njerëzit, të cilët bënin një jetë më të kufizuar në fshatrat apo qytetet e tyre, janë të detyruar të komunikojnë me masa më të gjera në metropole.

Marrëdhëniet në mes miqve e të afërmeve me kalimin e kohës janë dobësuar, ndoshta nga kushtet e vështira të punës, ose ndoshta nga mungesa e kohës, vendit apo problemeve të transportit. Si rrjedhojë, kjo situatë ka lindur një lloj largimi, ftohje mes njerëzve. Brezi i rritur në këto kushte ka filluar të gjejë veten aty ku ndihet më mirë, duke u larguar nga vlerat e vetes. Kjo ndodh nën ndikimin e kulturave dhe eksperiencave të ndryshme.

Ndërkohë që ky ndryshim është realizuar më shpejt për njerëzit, të cilët jetojnë në metropole të mëdha, në vendet apo qytetet e vogla ka ndodhur më ngadalë. Një njeri i shkëputur nga kultura dhe vlerat e tij e ka shumë të vështirë të kthehet edhe një herë mbrapa. Tashmë ata njerëz dhe ato shoqëri do t'i japin një drejtim tjetër jetës së tyre, me një këndvështrim tjetër vlerash brenda kushteve ekzistente.

2. 1. 6. 7 .2. Bashkëpunimi social dhe kulturor

Veçanërisht pas gjysmës së dytë të shekullit XX kanë filluar të shfaqen përparime të mëdha në fushën e teknologjisë. Këta ndryshime janë bërë shkak të një gare të dimensioneve të ndryshme, në mes shteteve, në trajtën e prezantimit të kulturës së tyre. Shembulli më i thjeshtë është përhapja e të gjithë e kulturës amerikanë nëpërmjet filmave amerikanë. Brezat, të cilët e shihnin si diçka të ulët të qenit çoban janë rritur me nostalgjinë e *kaubojsve*. Nga ana tjetër, bashkë me zhvillimin e internetit, kjo kulturë bashkëpunimi e ka shndërruar botën në një fshat të vogël, duke i dhuruar një dimesion të veçantë bashkëpunimit ndërkulturor.

Sipas Mahirogullarit (Mahiroullarit), (2005, f. 1280) bashkë me përhapjen e teknologjisë së telekomunikacionit, shtetet kanë filluar të informohen rreth gjendjes së njëri-tjetrit duke shtuar kështu mundësinë e bashkëveprimit. Veçanërisht pas vitit 1980, ky bashkëveprim është zhvilluar më shumë në anën perëndimore, duke u shndërruar në një mbështetje kulturore për popujt e tjerë. Kjo situatë është bërë shkak e ndryshimeve kulturore të shteteve, të cilat nuk zotërojnë politika të kulturës kombëtare. Për këtë arsye, në shoqëri është krijuar një strukturë heterogjene.

Ç'është e vërteta, nuk ekziston një popull apo shtet i pandikuar nga ky ndryshim. Të gjitha shoqëritë janë ndikuar pak a shumë nga kjo dukuri. Nuk ekziston një shtëpi që të mos ketë hyrë "coca-cola". Madje "coca-cola" është futur aq shumë në jetën tonë, sa që edhe kur kërkojmë diçka të ngjashme të dyqani pranë shtëpisë, e kërkojmë duke përdorur emrin e kësaj pijeje. Kultura e "Mc Donalds" ekziston në të gjithë botën. Shembuj të tillë mund t'i shtojmë, duke filluar nga veshja, mënyra e jetesës, reklamat, moda etj. Pika që kërkoj të nënvizoj këtu dhe qëllimi i dhënies së këtyre shembujve është pasqyrimi i realitetit dhe jo të tregoj nëse ky bashkëveprim është i drejtë apo i gabuar.

Sipas Çelikut, (2012, f. 22) në pikën ku ka ardhur sot njerëzimi, kulturat botërore ose do të globalizohen, ose do të zhduken, duke u përqendruar në një pikë. Kuptimi i kësaj është: njerëzit ose do të integrohen bashkë me botën duke pranuar kulturën, që u serviret, ose do të veçohen nga bota duke mos e pranuar kulturën e huaj. Kjo do të thotë se do të luftojnë për mbijetesën e kulturës së tyre. Për ata, të cilët nuk duan të jenë pjesë e këtij procesi zgjedhës, ekziston një proces edhe më i vështirë, sepse në shoqëritë liberale, me përzgjedhjen e një kulture në fusha të caktuara, do të shkaktohet përballja me një rezultat, i cili nxit krizën kulturore për njerëzit e atij vendi.

Sipas Xhaferajt, (2015) shoqëria shqiptare ka një nevojë në rritje për më shumë etikë. Media na prezanton gjithmonë e më shumë një tendencë në rritje të problematikave morale të dhunës, mungesës së qytatarisë dhe deri diku një farë nervozizmi social. Nga këtu buron domosdoshmëria se individit duhet të mësohet jo vetëm lidhur me kodet universale të sjelljes, por edhe me më shumë parime të sjelljes dhe etikës individuale. Kjo do të thotë se konsolidimi i vlerave morale dhe shoqërore tek të rinjtë shqiptarë më shumë se strategji është një proces që kërkon si të domosdoshme dhe nuk mund të kryhet me cilësinë e duhur pa kontributin e të gjithë aktorëve që nisin me familjen, shoqërinë civile, institucionet fetare dhe ato qeveritare.

Sipas Dervishit aktori kryesor për përcjelljen e vlerave tona brezave tonë fillon nga familja dhe duke u nisur nga kjo media dhe institucionet fetare duhet të marrin përgjegjësinë që u takon në lidhje me këtë temë. Sipas Dervishit, (Dervishi L. , 2015) në radhë të parë mungon një debat për “vlerat e shoqërisë”. Kapitali moral befas u zëvendësua me kapitalin financiar dhe është ky i fundit që ushtron trysni negative. Debati i munguar nis me shkollën (tekstet), me median, me institucionet fetare, me OJF-të dhe përfundon te partitë politike.

Sipas sociologut Dervishi, (Dervishi Z., Vlerat, 2015) detyra e përgjegjësisë sociale më e rëndësishme e brezave tanë do të arrijë suksesin me punën e

përbashkët të institucioneve. Sipas Dervishit, rol të rëndësishëm në edukimin me moral të shëndoshë të të rinjve mund dhe duhet të luajë familja, sistemi shkollor me të gjithë përbërësit e tij (programe, tekste, mësues, pedagogë etj.), institucionet fetare, institucionet kulturore e artistike shtetërore, televizionet, botimet e ndryshme etj. Ndërsa e ashtuquajtura shoqëri civile në Shqipëri deri tani ka ndikuar fare pak ose nuk ka ndikuar për mirë. Madje në ndonjë rast ka ndikuar për keq. Urojmë që në të ardhmen të ndikojë për mirë.

Ndërsa sipas Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Bruçaj, (2015) strategjitë duhen ndërtuar nga politikat shtetërore nëpërmjet shkollave dhe arsimit publik dhe jopublik, por në këtë rast edhe shkollat që përmbajnë lëndë fetare, siç janë medresetë luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e vlerave, vërtetuar kjo edhe nga studime të ndryshme sociologjike, të cilat vënë në pah ndryshimin e perceptimit të problemeve nga nxënësit e shkollave të ndryshme me atë të medreseve.

Sipas Tushit, (2015) detyra e përgjegjësisë sociale më e rëndësishme që mund të bëjmë ndaj brezave tanë, që të mos hallkatemi me këtë çështje është e nevojshme të ndërtojmë atë sistem që i mëson dhe edukon njerëzit jo me dogma dhe ideologji të mëdha, por me një sistem vlerash humane, që e ndihmojnë njeriun në jetë “TË LUAJË ROLIN SIPAS POZICIONIT SOCIAL”. Kjo do të thotë që duhet të mësojmë fëmijët të sillen si fëmijë, që prindërit të bëjnë prindin dhe të dinë të prindërojnë, mësuesi të bëjë mësuesin dhe jo vagabondin në shkollë, që klerikët (myslimanë e katolikë) të punojnë në përgatitjen shpirtërore të njeriut për të përballuar rreziqet dhe vështirësitë e jetës.

2. 1. 6. 7. 3. Media

Nëse do të bëhej pyetja: “Cili është më i fuqishëm se shtetet dhe qeveritë në shekullin XX” Padyshim që një pjesë e madhe e njerëzve do të jepnin përgjigjen: “Media”. Tashmë, njerëzit mund ta shikojnë luftën direkt nga shtëpitë e tyre dhe të marrin informacion rreth vendeve të tjera brenda një kohe të shkurtër. Me ndihmën e medias, tashmë asgjë nuk mund t’i fshihet popullit. Madje, ruajtja e jetës private është

një temë shumë e përfolur në media prej njerëzve të njohur. Me ndihmën e kësaj fuqie, konceptet e shoqërive kanalizohen sipas mënyrës së dëshiruar, edhe ekuilibrat botërore krijohen me anën e kësaj fuqie.

Sipas Memës (2015), media ka një rol të madh në promovimin e personazheve që nuk përbëjnë vlera morale të një shoqërie, por mishërojnë pasurimin e shpejtë, imazhe të rreme të një luksi të rremë e jo të një pune të fituar me djersë, në rrjetet sociale gjen pak të rinj që përpiqen e luftojnë, por gjen të rinj që pozojnë në makina të shtrenjta e vajza që vishen me marka të shtrenjta. Një moral fallco i krijuar e që kontraston me jetën reale të shoqërisë shqiptare.

Sipas Tezcanit, (1985, f. 207) funksionet e mjeteve masive komunikuese janë shumë të rëndësishme në nxjerrjen në pah të veçorive të kulturave të ndryshme. Nga ana tjetër, fuqia e mjeteve masive të komunikimit është e fortë, përse i përket prezantimit të modeleve të marra shembull. Yjet e sportit, apo yjet e filmave përfaqësojnë një simbol apo status me të cilin identifikohen fëmijët e sotëm. Në këtë mënyrë, fëmijët fillojnë të mësojnë shumë role, profesione dhe modele sjelljeje pa arritur një moshë të caktuar. Tezcani pohon se një gjendje të tillë socializimi, sociologu i njohur Robert Merton e ka quajtur “Anticipatory SocializationSocializim paraprak”, i cili pritet të ndodhë në të ardhmen, socializim që paraprin së ardhmes.

Një nga politikat më të rëndësishme të qeverive është mbajtja gjallë e kulturës së popullit dhe transmetimi i vlerave të brezave të rinj. Detyra kryesore në realizimin e këtij qëllimi u përket institucioneve arsimore. Ndërkohë që institucionet arsimore marrin përsipër anën formale të kësaj detyre, nga ana tjetër elementë të tjerë ndihmës i ndihmojnë në mënyrë informale institucionet arsimore. Madje në pikën ku ka arritur sot teknologjia e komunikimit, mund të themi se këta elementë janë më të fuqishëm në strukturimin e njerëzimit dhe brezave, sesa institucionet arsimore. Ja, pra, një nga këto elemente ndihmës është edhe media.

Cunbur, (Xhunbur), (1990, f. 360) pohon se media ndikon te njeriu dhe masa me anë të rrugës vizive, leximit dhe shikimit. Ky ndikim fillon që nga njësitet më të vogla, siç është familja, e vazhdon deri në nivel kombëtar, madje përfshin dhe gjithë botën. Detyrat e përbashkëta të mjeteve të komunikimit, sipas Cunburit janë këto:

1. Të informojë.
2. Të edukojë.
3. Të mbajë gjallë, ta bëjë të dashur dhe pjesë të popullit kulturën kombëtare.
4. Të zhvillojë kulturën kombëtare me të gjithë elementët.
5. Të përhapë dhe të prezantojë kulturën kombëtare.
6. T'ua transmetojë kulturën kombëtare brezave të rinj pa e prishur, por duke e zhvilluar më shumë.
7. Të mbrojë kulturën kombëtare nga efektet degjeneruese të kulturave të huaja.
8. Të vlerësojë kohën e lirë.
9. Të mundësojë mbrojtjen e paqes shoqërore.
10. Të zbavitë ose çlodhë relaksojë.

2. 1. 6. 7. 4. Kërkimi i identitetit

Identiteti na jep informacion rreth një personi. Megjithëse mund të konceptohet si një term sociologjik, në të vërtetë është një fjalë, ana psikologjike e së cilës peshon më shumë, sepse identiteti është unik dhe i përket një personi. *Identiteti është personaliteti apo strukturimi i botës së brendshme të një personi.*

Sipas Özdemirit (Ëzdemirit), (2001, f. 108): “Filozofia e vjetër greke është e mbushur me tema, si: qytetar i mirë, njeri i mirë, virtyt etj. Lidhja e sociologjisë me konceptin identitet është shumë e re. Në psikologji, nënvizohet më shumë aftësia e

individit për të qenë një subjekt, ndërsa në sociologji, koncepti përdoret në kuptimin e marrëdhënieve mes individëve dhe shoqërisë.”

Sipas Özdemirit, (2001, f. 108) krahas anës psikologjike, koncepti “identitet” shpreh shumë gjërësi edhe në sociologji. “Shoqëria pozitive” e Kantit, “Aktori” i Parsonsit, “Unë, individualisti” i Medit, “Klasa shoqërore” e Marksit mund të futen brenda diskutimeve të identitetit shoqëror. Identiteti shoqëror shpreh ndërgjegjësimin e personit për ndjenjën e përkatësisë ndaj vlerave, normave, gjykimeve, artit, gjuhës, fesë, traditës, zakoneve dhe institucioneve të tjera të shoqërisë, ku jeton individi.

Bilgini (Bilgin N., 2007, f. 14) pohon se identiteti formohet brenda kulturës dhe merr formë nën ndikimin e familjes dhe ambientit. Sipas Bilginit, identiteti është një strukturë e ndryshueshme. Identitetet individuale janë të shumanshme, si te shembujt e familjes, e seksualitetit, e klasës, e zonës, e fesë dhe e popullit. Ajo ndryshon sipas shkallës së rëndësisë, ndërsa identitetet kolektive janë përfshirëse, duke e shfaqur veten në trajtën e lidhjeve etnike dhe kombëtare.

Njerëzit ndryshojnë gjatë jetës. Ky proces ndryshimi fillon me lindjen e njeriut, vazhdon në fëmijëri dhe adoleshencë. Më pas, ndodhin ndryshime në jetën e njerëzve, sipas strukturës sociale, në të cilën gjenden dhe sipas stilit të jetesës. Këto ndryshime kanë lidhje të drejtpërdrejtë me “identitetin”. Megjithëse, akoma nuk dihet se kur ka filluar problemi i identitetit për njeriun, mund të themi se ky problem ekzistonte që kur u krijua njeriu i parë dhe do të vazhdojë të ekzistojë, përse kohë të ekzistojë njeriu.

Veçanërisht sot, teknologjia dhe globalizimi i saj ka përparuar ndjeshëm. Kjo ka bërë që njerëzit të komunikojnë duke sfiduar dimensionet e vendit dhe të kohës. Si rrjedhim, bota është shndërruar në një fshat të vogël. Është e vërtetë se nuk mund të

qëndrohet përballë këtij realiteti, të cilin nëse doni quajeni globalizim, e nëse doni universalizëm, si nga ana individuale, ashtu edhe nga ajo shoqërore.

Akdemiri (2004, f. 46) na tërheq vëmendjen te problemet e sotme të identitetit dhe sesa ndikohen ato nga globalizmi. Sipas Akdemirit, “në globalizëm, identiteti kulturor ka prirjen e masivizimit. Në këtë prirje, vendin e ndjenjave ideale e zënë konceptet vepruese, vendin e qëllimeve e zënë mjetet. Individët kalojnë në konceptin e ftohjes nga vlerat shoqërore, pjesëmarrja politike dhe kulturore.” Individët ndryshojnë shumë gjëra në jetën e tyre, nën ndikimin e medias dhe fuqive të ndryshme. Zakone si: vartësia ndaj konsumimit, ndaj zbavitjes, ndaj modës dhe ndaj botës virtuale e tërheq një pjesë të mirë të popullit drejt një ndërlikimi kulturor.

2. 1. 6. 8. Transmetimi i familjes dhe vlerave në botën moderne

Familja është guri më i vogël i shoqërisë dhe njësia më e vogël e saj. Ajo mundëson vazhdimësinë e një populli. Sipas Topçuoğlusë (Topçuollusë), (2010, f. 9) mund të përkufizohet si njësia më e vogël socio-ekonomike e shoqërisë e formuar nga gra, meshkuj, fëmijë e të afërm, të lidhur me lidhje gjaku ose farefisnie mes tyre.

Në shekullin ku jetojmë, vëmë re ndryshime serioze në çdo fushë, duke filluar nga ato të nivelit *makro* e deri tek ato të nivelit *mikro*. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, zhvillimet në mjetet e komunikacionit kanë shtuar edhe disa herë më shumë shpejtësinë e këtij ndryshimi. Pas revolucionit francez, vendin e perandorive e zunë shtetet dhe në të gjithë botën të drejtat e njerëzve dhe demokratizimi filluan të forcohen me shpejtësi. Bota kishte filluar të merrte një pamje tjetër brenda një kohe të shkurtër, në heqjen e kufijve kulturorë mes shteteve. Pra, tashmë kishte filluar të ndihej atmosfera e “popullit botëror”.

Sipas Bayerit (Bajerit), (2013, f. 104) një anë tjetër e këtij ndryshimi është përjetuar në institucionin familjar. Bashkë me jetën moderne, është bërë kalimi nga familja tradicionale në familjen bërthamë. Si rrjedhojë, është pakësuar numri i anëtarëve të familjes, kanë ndodhur ndryshime në strukturën dhe funksionet e saj, në rolet e femrës dhe të mashkullit. Pra, në shoqëritë ku mbizotëron familja tradicionale kanë ndodhur ndryshime në rolet e statusin e mashkullit dhe të femrës. Nga një strukturë me një rol të caktuar është kaluar në strukturë, ku rolet ndahen me marrëveshje. Burri ndihmonte bashkëshorten në kuzhinë dhe në përkujdesjen e fëmijës, ndërsa gruaja kishte filluar t'i përshtatej kohës. Ajo u bë anëtare e familjes, e cila sjell të ardhura në shtëpi.

Topçuoğlu (2010, f. 9) bën një koment të tillë për këtë ndryshim: “Veçanërisht në shoqëritë tradicionale është krijuar një strukturë, e cila nxit bashkimin e marrëdhënieve farefisnore, të cilat janë më të theksuara. Kur shohim shoqëritë moderne vëmë re ndryshime në numrin e anëtarëve të saj dhe të detyrave funksionale, ka marrë një trajtë bërthame, por e ka ruajtur ekzistencën. Megjithëse nga njëra anë, ky unitet është i nevojshëm për vazhdimësinë e shoqërisë, ndarjet e përjetuara në familje dhe ndryshimet strukturore e kanë treguar veten edhe në ndryshimin e shoqërisë.”

Ndërkohë që procesi i kalimit nga modeli i familjes tradicionale tek ajo moderne u ka dhuruar femrave statuset e të drejtës ka sjellë me vete shumë probleme. Bayeri (2013, f. 112) flet kështu në lidhje me këtë problem,

“Zënia e një vendi më të madh në jetën shoqërore nga femrat bashkë me theksimin e tepërt të lirisë dhe individualitetit ka nxjerrë në pah forma të ndryshme marrëdhëniesh, duke përfshirë këtu dhe marrëdhëniet jashtëmartesore. Ka nxitur shtimin e mesatares së fëmijëve të jashtëligjshëm, madje vendin e familjes e ka zënë lidhja mes dy personave, të cilët nuk janë të martuar. Kjo situatë na shpie në një përkufizim të ri të konceptit “familje” ose e bën të detyrueshëm analizimin konceptual të situatës së re të krijuar.”

Sipas Şengünit, (2007, f. 204-205) burimi i parë dhe më i rëndësishëm autoritar moral në procesin e zhvillimit moral, si te familja tradicionale, ashtu dhe tek ajo moderne, është familja. Veçanërisht në vitet e para të fëmijërisë, familja mundëson modelin dhe shembullin e nevojshëm për t'i transmetuar fëmijës vlerat morale dhe normat e shoqërisë në të cilën jeton. Ajo e nxit fëmijën drejt sjelljes së drejtë. Metoda e dënimit dhe e shpërblimit ka një rëndësi të veçantë në rezultate efektive, të përdorura nga nëna dhe babai në fitimin e sjelljeve të drejta. Nga ana tjetër, veçanërisht qëndrimet e nënës dhe babait në modelin familjar, të lindur si pasojë e botës moderne janë shumë të rëndësishme. Nënat dhe baballarët demokratë janë ata prindër, të cilët i duan fëmijët, i kultivojnë, i mbështesin marrëdhëniet në dashuri e respekt, zgjidhin problemet duke folur dhe u japin të drejtën e fjalës fëmijëve të tyre. Nënat dhe baballarët autoritarë i mbajnë fëmijët vazhdimisht nën kontroll, presin që të zbatojnë rregullat me përpikmëri, marrin çdo vendim në lidhje me fëmijët dhe presin që fëmija t'i përshtatet çdo vendimi të marrë prej tyre. Nënat dhe baballarët shumëmbrojtës lidhen me fëmijët me një dashuri të madhe, e sistemojnë jetën sipas fëmijëve, e presin me shumë tolerancë çdo sjellje të fëmijëve. Nënat dhe baballarët e painteresuar janë ata prindër, të cilët qëndrojnë të painteresuar ndaj nevojave materiale dhe emocionale të fëmijës, janë të pamjaftueshëm në dashuri e dhembshuri dhe nuk i kontrollojnë fare fëmijët.

Roli i familjes është shumë i rëndësishëm, përse i përket edukimit të fëmijëve me norma shoqërore. Sipas Tezcanit (1985, f. 159-160), vendi ku fëmija mëson normat brenda 5 viteve është familja. Ky proces i realizuar në familje, i cilësuar si socializim shfaq veten në trajtën e të mësuarit, të udhëzimit, të përgjigjes ndaj veprimeve të fëmijës dhe të pjesëmarrjes së tij në aktivitetet e familjes. Pra, përjetimi i

këtij procesi në një ambient natyral pasqyron edhe një herë rëndësinë e rolit themelor të familjes në edukim.

Shqipëria rreshtohet mes vendeve, të cilat po e përjetojnë shpesh kalimin nga familja tradicionale në familjen moderne. Ndoshta nxitur nga modernizimi, apo nga emigracioni, Shqipëria po përballlet me një kalim nga familja tradicionale në familjen moderne. Por sot, nuk mund të themi se familja shqiptare e ka mbyllur plotësisht procesin e kalimit në familjen bërthamë. Ashtu si ndodh në shoqëritë, të cilat ndryshojnë, edhe në familjen shqiptare, e cila po përjeton procesin e kalimit nga tradita tek modernia mund të rastisim edhe me tipin e familjes tradicionale edhe me atë moderne. Ndërkohë që në zonat rurale familja tradicionale ruan akoma ekskluzivitetin e saj, në qytetet e mëdha shohim një kalim në masë në familjen bërthamë.

Nga ana tjetër sipas Memës (2015) shumë familje nuk zotërojnë informacionin dhe eksperiencën e duhur për të zgjidhur problemet me të cilat janë përballur.

Megjithëse duhet të flitet e të zhvillohen politika dhe të organizohen trajnime të ndryshme rreth këtij ndryshimi, nuk mund të mohohet e vërteta se prindërit janë ata të cilët bëjnë transmetimin e vlerave universale e kombëtare te brezat e rinj. Sipas Topçuoğlu, (2010, f. 9) edukimi fillon në familje. Si rrjedhojë, detyra e transmetimit të vlerave u përket prindërve. Gjendja e prindërve në botën e sotme moderne është më e vështirë se më parë. Në periudhat e mëparshme, shoqëria luante një rol mbështetës ndaj rolit të nënës dhe babait, ndërsa sot, përpjekjet e vetme të familjes duken të pamjaftueshme për të arritur këtë qëllim, sepse sot familja nuk është i vetmi faktor ndikues te fëmija.

2. 1. 6. 9. Rinia dhe vlerat

Rinia është periudha, e cila fillon nga adoleshenca e shkon deri në të 30-tat. Të rinjtë janë të rëndësishëm në formimin e të ardhmes së popujve. Ata pasqyrojnë një strukturë dinamike, ngaqë akoma janë në një periudhë zhvillimi dhe ndryshimi. Shkaku i ndryshimit të gjendjeve psikologjike dhe biologjike, zë vend në njësinë më të rëndësishme të strukturës sociale.

Ndryshimi i shpejtë i strukturave psikologjike dhe biologjike, familja, ambienti dhe mësuesit, pra ndryshimi i strukturës sociale me përjashtim të grupit të shokëve, zotërimi i koncepteve të ndryshme kulturore bëhen shkak i shfaqjes së problemeve të ndryshme, si socializimi, mosshprehje e vetes, probleme psikologjike, kërkimi i identitetit dhe krijimit të humnerave mes këtyre strukturave. Gjëja që duhet bërë këtu në zgjidhjen e problemeve të të rinjve, në zotërimin e të rinjve dhe në dëshmimin e tyre si një pjesë shumë e rëndësishme e shoqërisë, është organizimi i aktiviteteve të dobishme për shoqërinë, duke u treguar të rinjve të jenë individë të dobishëm në shoqëri. Nuk duhet harruar se këto aktivitete përmbajnë vlera shoqërore dhe universale. Një rini e edukuar në këtë mënyrë është larguar nga problemet sociale e psikologjike dhe e kalon në mënyrë të ekuilibruar këtë periudhë kritike.

Sipas Xhaferajt, (2015) rinia shqiptare po lëviz gradualisht nga një nihilizëm pasiv që shkatërron traditën për llogari të kohës moderne drejt një nihilizmi aktiv që është selektiv dhe përpiqet jo vetëm të largojë moralin doktrinar të kultivuar nga regjimi totalitar, por njëkohsisht përpiqet të moderojë traditën dhe të ndërtojë një etikë që përshtatet me ndryshimet shoqërore.

2. 1. 6. 10. Krijimi i vlerave në arsimin e lartë dhe procesi i zhvillimit

Krijimin e vlerave në periudhën e arsimit të lartë nuk duhet ta mendojmë ndryshe nga krijimi i vlerave në kushte normale. Të gjitha vlerat shfaqen si rezultat i një veprimi. Sigurisht që është e mundur të flasim për krijimin e vlerave të çdo periudhe dhe çdo ambienti.

Sipas Poyrazit (Pojrazit), (2011, f. 65) për të kuptuar strukturën dhe formimin e një vlere duhet të kuptojmë këto tre aktivitete, për të cilat flet dhe Aristoteli, njeriu i cili e ka krijuar dhe vlerësuar këtë strukturë: *teoria, praxis dhe poesis* (njohuritë, morali dhe arti), të cilat kanë fushat përkatëse. Sipas Poyrazit, vlerat janë të pavarura nga personi dhe shfaqen në fund të një veprimi. Vlerat e ndërtojnë veten brenda një kulture.

Si rrjedhojë, krijimi i vlerave realizohet në çdo periudhë të jetës së njeriut sipas kohës dhe vendit. Edhe periudha e universitetit është një nga këta periudha kritike. Periudha e arsimit të lartë shfaqet para nesh si një periudhë e rëndësishme e plotësimit të formimit të identitetit, fitimit të këndvështrimeve ndaj botës dhe ngjarjeve. Nga ana tjetër, fitimi i aftësive të nevojshme në fushën profesionale, formimi i personaliteteve dhe sjelljeve mund të përmenden si disa nga zhvillimet më të rëndësishme të kësaj periudhe. I riu, i cili jeton në një ambient ku gjendet një botëkuptim i caktuar kulturor, në universitet është i detyruar të shoqërohet dhe të jetë bashkë me shokë të ardhur nga kultura dhe vlera të ndryshme. Dhe pikërisht në këtë pikë, universiteti mbart detyrën e një mjeti harmonizues dhe unifikuesi shoqëror.

Sipas Demirelit dhe Kayas, (2009, f. 4) mësimi i kulturës së shoqërisë ku jeton njeriu përkufizohet si kulturizim. Periudha e universitetit është periudha më e përshtatshme, ku kultura dhe vlerat e shoqërisë të përvetësohen në mënyrën më të

shëndetshme dhe logjike. Nisur nga ky aspekt, periudha e universitetit duhet analizuar shumë mirë, të zhvillohen programe edukuese në përfitimin e vlerave dhe të ndiqet ecuria e brezave të rinj.

Sipas Gahramanovës, (2012, f. 316) universitetet konsiderohen si institucione të veçanta sociale, të cilët ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë. Universitetet kanë marrë përsipër detyrën e transmetimit të vlerave kulturore dhe janë pika fillestare e zhvillimit mendor të personalitetit. Arsimi i lartë zhvillon disa funksione dhe na jep mundësinë e zhvillimit individual, i cili e ndihmon individin në përdorimin dhe zhvillimin në mënyrën më efektive të aftësive të tij.

Gahramanova (2012, f. 318-319) i radhit pikat më të rëndësishme në formimin e gjykrimeve morale të studentëve si më poshtë:

1. Ambienti sociokulturor i studentëve: Studentët e ardhur nga zona më të vogla në qytete të mëdha, pas një farë kohe, përjetojnë disa probleme në botëkuptimet dhe stilin e jetesës nën ndikimin e rrethit shoqëror si dhe nën ndikimin e kushteve të vështira të lindura nga jeta në qytet. Megjithëse ngjarjet mund të jenë të pakta, ka raste kur ato realizohen në mënyrë krejtësisht të kundërt, sepse kushtet e tjera të qyteteve të mëdha ndonjëherë i sjellin njerëzit në pika të ndryshme dhe si rrjedhojë, para njerëzve shfaqen mundësi të ndryshme.

2. Komunikimi: Kultura mbi sjelljen në universitete formon një student komunikues. Me anë të sistemit të rregullave dhe ndalesave në universitete, studenti mëson rregullat e sjelljes në vende shoqërore. Universitetet zotërojnë mundësinë e krijimit të veçorive në sistemin e marrëdhënieve reciproke.

3. Aktiviteti edukues: Aktiviteti edukues mundëson zhvillimin e përgjithshëm, zhvillimin shpirtëror të studentit, shtimin e ndjenjave shpirtërore dhe përvetësimin e aftësive dhe njohurive në lidhje me fushën e edukimit.

4. Mundësitë e edukimit të arsimit të lartë: Qëndrimi i dijetarëve në këtë pikë duhet mbajtur shënim. Këndvështrimi i gjerë shkencor-filozofik i pedagogëve të universitetit, autoriteti akademik, mjeshtëria e mësimdhënies dhe veçoritë personale janë një shkollë edukimi për studentit.

Sipas Xhaferajt (2015) në lidhje me problemin e të rinjve si çdo fushë tjetër, u bë një kohë e gjatë që po përpiqemi t'i zgjidhim edhe në fushën politike. Në thelb të këtyre përpjekjeve qëndron ideja e përfshirjes së të rinjve në mënyrë më aktive në jetën sociale.

Por Xhaferaj (2015) shtron mendimin se, gjithmonë ka ekzistuar një hendek i madh midis retorikës politike për vlerat që duhet të mbartë rinia dhe produktit real të krijuar nga politika në favor të rinisë. Rinia ka qenë një term i mbipërdorur bukur në deklarata dhe fjalime politike, por asnjëherë nuk ka arritur të formësohet si prioritet i politikës. Sidoqoftë është pozitiv fakti se gjatë dekadës së fundit kemi krijuar një kahje ku institucionet shtetërore në bashkëpunim me shoqërinë civile kanë hartuar në vitin 2007 “Strategjinë Kombëtare të Rinisë (2007-2013)”. Së fundmi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) hartoi “Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë (2015 – 2020)”, i cili u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015. Këto janë iniciativa konkrete që duke promovuar jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike dhe vendimarrjen politike, por edhe vullnetarizmin dhe aktivizime të tjera kulturore, sociale dhe sportive, krijojnë shtratin e nevojshëm për kultivimin dhe përsosjen e vlerave morale.

KAPITULLI III

SKELETI TEORIK + MODELI ANALITIK I TEMES

3. 1. Bazat teorike të konceptit të moralit

Që në fillimet e para të historisë e deri në ditët e sotme janë servitur mendime të ndryshme në lidhje me konceptin “moral, etikë”, si edhe me konceptet përmbajtje, burim, nxënie, etj. Shumë mendimtarë, apo filozofë, si: Sokrati, Kanti, Piageti e deri te Kohlbergu kanë dhënë mendimet e tyre, duke realizuar studime rreth moralit. Nga ana tjetër, shumë degë shkencore, si: filozofia, psikologjia dhe sociologjia kanë bërë shpjegime të ndryshme për moralin, sipas këndvështrimeve të tyre. Të gjithë studiuesit e vlerësojnë rëndësinë e moralit në jetën individuale dhe shoqërore të njeriut duke e konsideruar një koncept të nevojshëm për ekuilibrimin e shoqërisë dhe faktor të pazëvendësueshëm në vendosjen e rregullit.

Sipas Kayas, (Kaya M., 1993, f. 22-23) një nga filozofët e parë, Sokrati, e cilëson moralin si “nuk ia vlen të jetosh një jetë të pakontrolluar”. Aristoteli pohon se “e rëndësishme është të jetosh me virtyte. Njeriu mund të arrijë lumturinë vetëm duke përdorur mendjen.” Ndërsa Spinoza thekson se çdo gjë, e cila ekziston në gjithësi është pjesë e Perëndisë dhe e natyrës, prandaj duhet t’i përshtatet këtij sistemi. Marxi (Marksi) shprehet se problemet etike mund të zgjidhen. Natyra e njeriut mund të ndryshojë vetëm nëse hiqet prona private. Nga ana tjetër, Nietzsche (Niçejja) sugjeron një stil jetese të lirë, të pavarur nga shoqëria. Pas viteve 60-të filluan të diskutoheshin nën këndvështrimin etik tema, si: barazia racore, shtimi i lëvizjeve feministe, mbrojtja e të drejtave të kafshëve, aborti, transplantimi i organeve dhe fekondimi artificial.

Zhvillimi moral është një komponent i rëndësishëm i zhvillimit të karakterit të njeriut. Studimet e bëra në lidhje me zhvillimin e moralit tregojnë se çdo individ ka një zhvillim moral unik, që i përket vetëm atij. Në lidhje me zhvillimin moral gjenden disa teori të ndryshme shkencore. Ato radhiten si më poshtë:

1. Teoria psikanalitike;
2. Teoria etike;
3. Teoria e të mësuarit social;
4. Teoria e zhvillimit mendor.

3. 1. 1. TEORIA PSIKANALITIKE

Teoria psikanalitike shpjegon lidhjen mes mendjes së njeriut dhe zhvillimit mendor të tij. Freudi (Frojd) dhe Eriksoni janë përfaqësuesit më të rëndësishëm të teorisë psikanalitike, analizues të sjelljeve të njeriut sipas metodës së “shkakësisë”.

Sipas Strangomit, (2011, f. 52) në bazën e teorisë psikanalitike gjendet mendimi i kontrollimit më të mirë të sjelljeve tona kur njohim rrënjët e vetëdijes.

Ndërsa sipas Özenit, (2011, f. 203) një nga elementët kryesore të teorisë psikanalitike janë situatat dhe gjendjet e pazgjidhura dhe të mbartura tek individi i maturuar që nga fëmijëria. Sado që këto probleme të trajtohen, problemet në lidhje me vetëvlerësimin, respektimin dhe idealet në lidhje me veten tonë do të vazhdojnë gjithë jetën.

Padyshim, Freudi (1856-1939) është themeluesi i teorisë psikanalitike. Sipas Güngörit, (1993, f. 59) pikë së pari, Freudi ka pasqyruar mendimin se morali është një çështje e të mësuarit social, e palidhur me instiktet e lindura morale. Së dyti, mënyra e

të mësuarit me anë të përngjasimit është bërë objekt i studimeve më të larmishme, nën dritën e mendimeve të vlefshme të Freudit. Së fundmi, Freudi ka zhvilluar një botëkuptim krejtësisht tjetër në lidhje me zhvillimin moral të fëmijët dhe me marrëdhëniet mes dënimit fizik e ndërgjegjesimit, fuqisë së ndërgjegjes dhe moralit.

Sipas Tuzcuoğlu (Tuzxhuollusë), (1995, f. 279) Freudi e shikon njeriun nën dritën e vendosmërisë. Sipas tij, njeriu drejtohet nga disa fuqi të jashtëzakonshme, nxitës të pakontrolluar dhe fuqi biologjike dhe instiktive. Për këtë arsye, njeriu duhet mbajtur nën kontroll. Gjithashtu, njeriu zotëron një energji të kufizuar. Çdo sistem, i cili formon personalitetin, lufton për ta zotëruar këtë energji. Dhe si rrjedhojë, shfaqen çrregullimet psikologjike, si mosmarrëveshje në ndarjen e energjisë.

Ekzistojnë dy prirje të fuqishme, të cilat formojnë mendimin moral të Freudit: seksualiteti dhe agresiviteti. Sipas Freudit, te njeriu zhvillohet morali, nëse arrin të kontrollojë këto dy prirje. Në zhvillimin moral të Freudit gjejmë tre faktorë themelorë : “id, egon dhe superegon”.

Sipas Kağıtçıbaşı, (2004, f. 327-329) *id* përfshin të gjithë instiktet natyrale të lindura bashkë me njeriun. Instikti seksual dhe ai i agresivitetit janë më të theksuar se të tjerët. Id kërkon vazhdimisht plotësimin e dëshirave. *Egoja* kënaq dëshirat e id-it. Për këtë arsye, idi ushtron presion mbi egon për plotësimin e dëshirave të tij. Ky presion është përpjekja e daljes në pah të dëshirave të fshehura në vetëdije të id-it, ndërsa superegoja përcakton se cilat dëshira duhet të dalin në pah dhe cilat dëshira duhen mbajtur të fshehura në vetëdije.

Gürhani (Gyrhani) (2002, f. 114) thekson se Id-i luan një rol shumë efektiv te personat, të cilët kanë përvetësuar jetesën pa rregulla. Përkundrazi, te personat që e jetojnë jetën sipas rregullave të caktuara, egoja qëndron në plan të parë. Ndërsa tek

ato që e jetojnë jetën sipas rregullave dhe marrin për bazë sjelljen e moralshme mbizotëron superegoja. Për krijimin e një personaliteti të shëndetshëm duhet që situata të kontrollohet nga egoja në këtë marrëdhënie tredimensionale.

Kağıtçıbaşı (2004, f. 327-329) pohon se sipas mendimit të Freudit, fëmijët janë më të dhënë ndaj prindërve të seksit të kundërt me ta dhe se mbartin ndjenja negative ndaj prindërve me seks të njëjtë me ta. Pikërisht në këtë pikë fillon formimi i ndërgjegjes dhe konceptimi moral. Fëmija ndihet fajtor për shkak të këtyre ndjenjave negative. Ai mund të shpëtojë nëse arrin të identifikohet me prindin e të njëjtit seks me të. Kjo ndjenjë fajësie është shumë efektive në krijimin e ndërgjegjes te fëmija. Këto ndryshime ndodhin gjatë pesë viteve të para.

Güngöri (Gyngori) (1993, f. 57) pohon se te fëmijët formohet koncepti etik: identifikimi i tij me prindin e të njëjtit seks dhe marrja si shembull e tij. Në këtë mënyrë, fëmija fillon t'u bindet rregullave të përcaktuara, të cilat drejtojnë jetën e nënës dhe të babait. Ai mëson të dënojë veten, kur nuk i zbaton këta rregulla. Më parë dënimi i jepej nga nëna dhe babai, por tani luan rol ndërgjegjja, e cila e dënon pa qenë nevoja e ndërhyrjeve të jashtme. Në skemën njohëse (konjitive) të Freudit, ndërgjegjja përfaqëson superegon. Superegoja e detyron njeriun të veprojë sipas rregullave etike të shoqërisë dhe e largon nga sjelljet e papërshtatshme. Në këtë pikë, kriteret e paragjykitimit janë standartet etike.

Güngöri (1993, f. 58) na tërheq vëmendjen edhe te diçka tjetër gjatë procesit të identifikimit. Sipas tij, fëmija nuk ndikohet thjesht nga ndërgjegjja, apo këndvështrimi moral, por edhe nga vlerat kulturore, zakonet dhe tradita. Edhe të rriturit, të cilët zënë vendin e nënës dhe babait, përfshihen në superegon e tyre bashkë me besimin dhe vlerat që kanë.

Themeluesi tjetër i psikanalitikës është Eriksoni. Megjithëse është studenti i Freudit, ai ka mjaft pikëpamje të kundërta me të. Ai mendon se njeriu nuk është thjesht një krijesë biologjike, por një krijesë sociale, e cila e plotëson zhvillimin e saj në bashkëpunim me njerëzit e tjerë përreth. Sipas Eriksonit, njeriu vazhdimisht komunikon me njerëzit e tjerë. Veçanërisht ambienti social, si p.sh. familja, shkolla dhe shoqëria luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin psiko-social të individit.

Sipas Santrockit, (2001) kemi tre etapa të zhvillimit etik. Mësimi moral gjatë fëmijërisë, shqetësimet ideologjike në adoleshencë dhe bashkimi etikë-traditë në moshë të rritur. Sipas Eriksonit, gjatë adoleshencës individët janë në kërkim të identitetit të tyre. Shumë përfitime morale dhe fetare të marra gjatë fëmijërisë do ta ndihmojnë atë në faqen më të rëndësishme të jetës, në adoleshencë. Në të kundërt, adoleshentët do të rendin pas kërkimeve të ndryshme materiale dhe emocionale. Përfitimet e fëmijërisë i bëjnë më të qarta dhe të kuptueshme situatat e panjohura, me të cilat përballet adoleshenti. Në pranimin e ideologjive dhe situatave të reja kërkohet përputhshmëria mes argumenteve dhe aftësive gjyquese të adoleshentit. Nëse këtë ideologji e ndan me të tjerët, ndihet shqisa e frymës së bashkësisë. Për Eriksonin ideologjia gjatë periudhës së adoleshencës përfshin sipërfaqen, si një mbrojtëse e identitetit, sepse mundëson një ndjenjë, qëllimi i së cilës i jep kuptim jetës dhe mundëson lidhjen e të kaluarës me të ardhmen.

Kilavuz (Këlavuz), (2011, f. 154) pohon se Eriksoni nënvizon rëndësinë e një lidhjeje mes fuqive të lindura të fëmijës dhe pjekurisë së të rriturit. Por nga ana tjetër, etapat e zhvillimit gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës mund të ndikojnë në sjelljet e të rriturit.

Sipas një studimi të Ministrisë së Arsimit të Turqisë, (2009, f. 13) Eriksoni e ndan jetën e individit në tetë etapa zhvillimi. “Secila prej këtyre etapave të paralelizuara me periudhat e zhvillimit të Freudit dhe përmbajtëse të dimensioneve pozitive e negative përcaktohen sipas problemeve përkatëse dhe ndikohen ndjeshëm nga shoqëria dhe kultura, në të cilën jeton individi. Sipas Eriksonit, personaliteti vazhdon të zhvillohet gjatë këtyre 8 etapave dhe një ekuilibër i përjetuar negativisht në një etapë mund të shndërrohet në nota pozitive në etapën pasuese. Një fëmijë, i cili nuk i beson ambientit përreth, mund ta fitojë ndjenjën e besimit nëse në etapën pasardhëse i ofrohet përkujdesje dhe interes.”

Kılavuzi, (2011, f. 154-155) mbështet mendimin e Eriksonit, i cili pohon se njeriu përballët me debatet dhe rrëmujën në çdo periudhë zhvillimi dhe realizimi i qëllimeve të përcaktuara nga ai lidhet me zgjidhjen e suksesshme të debateve apo grindjeve. Nga ana tjetër, nëse të rriturit arrijnë të komunikojnë me fëmijët duke marrë parasysh etapat e zhvillimit, do të përftojnë rezultate më të shëndetshme. Sipas Güngörit, këto etapa zhvillimi janë shumë të rëndësishme për të nënvizuar rëndësinë e krijimit të marrëdhënieve të shëndetshme mes brezave, të kalimit të më shumë kohe së bashku dhe të marrjes pjesë bashkërisht në aktivitete të përbashkëta.

Etapat e zhvillimit të Eriksonit (1984, f. 39) mund t’i radhisim si më poshtë:

3. 1. 1. 1. Mungesa e sigurisë ndaj sigurisë themelore (0-1 vjeç)

Kjo periudhë cilësohet nga Freud si periudha orale dhe vazhdon deri në moshën 1 vjeç. Cilësia dalluese e kësaj periudhe është zhvillimi ose jo i ndjenjës së sigurisë. Formimi i kësaj ndjenje lidhet në mënyrë direkte me plotësimin apo jo të nevojave themelore të fëmijës. Si nevojë themelore mund të japim si shembull

ushqyerjen dhe gjumin. Nëse nevojat e fëmijës plotësohen nga persona (nëna, babai, apo persona të tjerë që përkujdesen për të), i krijojnë fëmijës një ambient të sigurtë. Në këtë mënyrë, fëmija fiton ndjenjën e sigurisë themelore. Në të kundërt, ai do të ndihet i pasigurt.

3. 1. 1. 2. Ndjenja e turpits dhe dyshimit përballë pavarësisë (1-3 vjeç)

Në këtë periudhë të ardhur si rezultat i periudhës anale, fëmija në moshën 2-3 vjeç fillon të hajë, të ecë, të flasë dhe të shkojë vetë në tualet. Ai është i ndërgjegjësuar për gjërat që duhen dhe nuk duhen bërë. Pika më kritike e kësaj periudhe është motivimi, nxitja e fëmijës të veprojë i lirë. Në këtë mënyrë, fëmijës i mundësohet një ambient, ku mund të lëvizë lirisht, duke mundësuar formimin e ndjenjës së pavarësisë. Në të kundërt, nëse prindërit ndërhyjnë shumë në sjelljet e fëmijës, atëherë ai do të bjerë në dyshim në lidhje me sjelljet e tij, do t'i krijohet ndjenja e turpits dhe gjatë gjithë jetës do të përjetojë dyshime në lidhje me zgjedhjet e bëra.

3. 1. 1. 3. Ndjenja e fajit përballë iniciativës (3-6 vjeç)

Sipas Freudit kjo përkon me “stadin falik”, i cili vazhdon deri në moshën 6 vjeçare. Fëmija fillon të përdorë bashkë me të rriturit vendet sociale. Qendrat tregtare, rrugët, kopshti, parashkollori janë ambientet e tij të vëzhgimit dhe aktivitetit. E vëzhgon çdo gjë nga bota e tij dhe kohë pas kohe ndërmerr nisma (inicitiva). Pikërisht në këtë pikë duhen mbështetur iniciativat e filluara nga fëmija dhe duhet qëndruar larg kritikave, sepse kritika do të thyejë guximin e fëmijës dhe do të ngjallë tek ai ndjenjën

e fajit. Veçanërisht nënat, baballarët dhe mësuesit duhet të mbështesin këto sjellje, të cilat nxisin ndjenjën e zbulimit të fëmija dhe të mos ndërhyjnë, kur është e mundur.

3. 1. 1. 4. Ndjenja e pamjaftueshmërisë përballë suksesit (7-11vjeç)

Kjo periudhë përputhet me “stadin latent” të Freudit. Është periudha kur fëmija fillon shkollën dhe vazhdon deri në përfundim të ciklit fillor. Gjatë kësaj kohe, fëmija fillon të mendojë rreth jetës dhe të nxjerrë ca përfundime. Krijon shoqërinë e tij dhe fillon të krahasojë sjelljet dhe veprimet e tij me sjelljet dhe veprimet e të tjerëve. Fëmija, i cili ndihet i pamjaftueshëm dhe i paaftë, do të ndihet inferior, duke prishur kështu edhe strukturën e personalitetit të tij. Për këtë arsye duhen vlerësuar dhe lavdëruar sjelljet e drejta të fëmijëve, rezultatet e nxjerra nga ato dhe të qëndrohet larg fjalëve apo sjelljeve, të cilat vrasin shpresat dhe instiktet e tyre. Veçanërisht shkolla dhe familja duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, sepse si shkolla ashtu dhe familja janë ambiente ku përjetohe shqetësime të tilla. Fëmija, i cili ndihet i pavlerësuar në familje apo shkollë, më vonë, preket nga probleme serioze të personalitetit.

3. 1. 1. 5. Çrregullimi i personalitetit përballë fitimit të personalitetit (11-17 vjeç)

Në këtë periudhë, fëmija hyn në adoleshencë dhe në jetën e tij ndodhin ndryshime serioze. Bashkë me ndryshimet fizike fillon dhe formimi i personalitetit. Përpjekja për të kërkuar identitetin e tij e shtyn atë në imitimin e personit, apo personave që merr si shembull. Kjo mungesë vendosmërie e përjetuar të rinjtë dhe ndjenja e kërkimit bëhet shkak i krijimit të grupeve mbështetëse. Në këtë periudhë, të

rinjtë përjetojnë një dilemë në mes rregullave të mësuara në fëmijëri dhe vlerave gjykuese të të rriturve. Në këtë pikë, nëna, babai, mësuesit apo personat e gjendur pranë adoleshentit duhet ta ndihmojnë atë në kërkimin dhe gjetjen e roleve të reja dhe në shpëtimin nga dilema. Ndërkohë që të rinjtë, të cilët e kalojnë me sukses këtë periudhë, fitojnë një personalitet të fortë. Ata të cilët dështojnë, do të vazhdojnë të përjetojnë probleme me personalitetin e tyre.

3. 1. 1. 6. Abstraksionimi përballë afrimit (17-30 vjeç)

I riu tashmë ka gjetur personalitetin e tij, kërkon të jetë më aktiv dhe të komunikojë me të tjerët. Bashkë me hedhjen e hapave drej periudhës së universitetit, punës dhe martesës, i riu ka hedhur hapa të rëndësishëm të dimensioneve të tjera në jetën e tij. Të rinjtë, të cilët arrijnë ta kalojnë me sukses këtë periudhë tranzicioni, krijojnë marrëdhënie të shëndetshme, por ata që përjetojnë probleme mbesin të vetmuar dhe të përjashtuar nga shoqëria. Familja dhe ambienti i afërt luan rol shumë të rëndësishëm, përse i përket realizimit të kalimit të periudhës së tranzicionit.

3. 1. 1. 7. Qetësia përballë produktivitetit (30-60 vjeç)

Në këtë periudhë të moshës së mesme, njeriu përjeton një dilemë mes produktivitetit dhe qetësisë. Nga njëra anë kemi një individ, i cili përpiqet të punojë dhe të jetë i dobishëm për shoqërinë, dhe nga ana tjetër individë të tjerë që jetojnë në kurriz të shoqërisë dhe së cilës nuk i sjellin asnjë dobi. Personat që nuk arrijnë të gjejnë një punë apo të krijojnë familje mund të mendojnë se janë të padobishëm për shoqërinë, prandaj, personat që shoqërohen me individë të tillë duhet të tregojnë përpjekjet maksimale për t'u bërë pjesë aktive dhe produktive e shoqërisë.

3. 1. 1. 8. Dëshpërim, humbje shprese ndaj tërësisë së personalitetit (+ 60 vjeç)

Gjatë kësaj periudhe, individi përjeton dilemën e të jetuarit në mënyrë pozitive apo negative të eksperiencave të mëparshme. Ndërkohë që personat, të cilët kanë përjetuar pa probleme periudhat e mëparshme ndihen të lumtur, ato të cilët kanë përjetuar probleme në çdo periudhë ndihen të dëshpëruar. Individet që kanë përqaftuar tërësinë e personalitetit të tyre ndjejnë kënaqësinë dhe lumturinë e të qenit të dobishëm për shoqërinë dhe njerëzit përreth. Ata ndihen të gatshëm për t'u larguar nga kjo jetë me këtë lumturi e kënaqësi.

Si përfundim, sipas Eriksonit, familja, shoqëria dhe shkolla luajnë një rol shumë të rëndësishëm në formimin e personalitetit të njeriut. Një shoqëri e shëndetshme lidhet me edukimin e individëve të shëndetshëm. Për këtë arsye, individi duhet të sigurojë mbështetje në secilën prej këtyre periudhave.

3. 1. 2. TEORIA ETIKE

Studiuesit e zhvillimit moral sipas metodës etike përpiqen ta shpjegojnë këtë sipas reagimeve të dhëna nga personi përballë nxitësve të jashtëm. Metoda e mësimit etik është themeluar nga John B. Watson. Ndërsa Ivan Petrovich Pavlov, Edward L. Thorndike, Edwin R. Guthrie, Clark L. Hull dhe Skinner janë disa nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të saj. (Özen, 2011, f. 66)

Sipas Taylit (Tajlit), (2013, f. 177) në metodën etike është shumë e rëndësishme marrëdhënia ambient-nxitës. Sjelljet e dukshme të individëve janë pika më e rëndësishme dhe vlerësimi do të bëhet sipas tyre. Për ta nuk kanë rëndësi funksionet e brendshme. Studiuesit e etikës e cilësojnë ndryshe dhe si lidhja “nxitës-

reagim”. Studiuesit e etikës kanë analizuar reagime të lindura si pasojë e nxitësve, dënimeve dhe shpërblimeve të dhëna nga individit.

Sipas metodës së mësimit etik (Skinner, 1976, f. 24-29) “analizohen sjelljet e vlerësuara në mënyrë objektive, të qarta, të matura me metoda shkencore dhe refuzohen të gjitha veçoritë emocionale apo eksperiencat e brendshme, si ndjenjat, ndërgjegjja, mendimi etj., të pavlerësuara objektivisht nga metodat shkencore.”

Sipas Gültekinit (Gyltekinit), (2007, f. 504) metoda etike është shumë e dobishme në rast se dëshirohet të mësohet apo ndryshohet një sjellje dhe kur përmbajtja mësimore është pozitive dhe e pandërprerë. Nisur nga ky fakt, në metodën e mësimit etik kanë shumë rëndësi rregullimi i ambientit dhe kushteve të të mësuarit gjatë procesit mësimor, nëse dëshirohet të arrihet një rezultat pozitiv.

Sipas Özerit, (2005, f. 106) në biheviorizëm nuk ka rëndësi se çfarë është njeriu, apo se nga kush rrethohet ai, sepse sido që të jetë, gjithnjë mendohet të arrihet rezultati i dëshiruar, nëse aplikohen kriteret bazë. Për ta i rëndësishëm është rezultati dhe procesi.

Sipas Ersanlës (Ersanllës), (2014, f. 198-199) studiuesit e etikës krijojnë një analogji mes mendjes së njeriut dhe një kutie të zezë. Atyre nuk u interesojnë ato që ndodhin në mendje, por kontrollojnë dhe ekuilibrojnë çfarë hyn dhe del nga mendja e njeriut. Studiuesit e etikës e nënvizojnë edhe një herë rëndësinë e ambientit për realizimin e sjelljeve të dëshiruara. Sipas tyre, një nga shkaqet e çrregullimeve në sjellje është mësimi i gabuar. Për këtë arsye, ata janë fokusuar te të rinxënurit, duke krijuar kushte të reja për të pasur një proces më efektiv mësimi.

Sipas psikologëve etikë, qëllimi i sjelljeve është të plotësojnë apo minimizojnë kërkesat e instikteve. Këto instikte, ashtu siç mund të jenë fiziologjike (uria, etja), mund të jenë edhe të kultivuara, të dimensioneve më të përparuara (instikti i suksesit, mbizotërimi). Këto instikte bëhen shkak për sjelljet e njeriut. Sa më shumë të plotësohen dhe pakësohen kërkesat e instikteve, aq më e lartë është mundësia e përsëritjes së sjelljes.

Özeni (2011, f. 66) pohon se sjelljet morale janë sjellje të mësuara si rezultat i ndikimit social dhe kushtëzimit. Ambienti përreth luan një rol shumë efektiv në zhvillimin e moralit. Sipas studiuesve etikë Pavlov dhe Skinner, morali mësohet si rezultat i kushtëzimit dënim-shpërblim, pra sipas kushtëzimit funksional (operant).

Binbaşioğlu (1992, f. 259) i shpjegon në këtë mënyrë principet bazë të edukimit të psikologëve etikë:

1. Psikologët etikë gjatë gjithë proceseve të të nxënies shohin mekanizmin e kushtëzimit. Sipas psikologëve etikë, barra më e rëndë në edukim i bie mësuesit.
2. Metoda etike pranon ndryshimet individuale dhe zhvillimin e brendshëm.
3. Sipas metodës etike, një mësues në një shkollë përpiqet maksimalisht për krijimin e një ambienti të mirë mësidhënjeje.

3. 1. 3. TEORIA E TË MËSUARIT SOCIAL

Sipas Bayrakçës (2007, f. 198-210) teoria e nxënies sociale përmban rregulla më të rrepta sesa teoria etike dhe është zhvilluar si një qasje, e cila nuk arrin të shpjegojë plotësisht principet themelore të sjelljeve të njeriut. Ata, të cilët e përkrahin

këtë metodë, gjykojnë se mendimi, konceptimi dhe mënyrat e të besuarit janë shumë të rëndësishme në procesin e të nxënit.

Sipas Kılıçit (Këllëçit), (2013, f. 10) konceptet në lidhje me të nxënit social kanë filluar të analizohen në lidhje me psikologjinë, mësimdhënien dhe sjelljet nga studiues të ndryshëm (Watson, 1913-1930, Freudi, 1905-1939 etj.), që në fillim të viteve 90-të. Këto koncepte janë emërtuar ndryshe që nga viti 1940. Pas kësaj date, ato janë analizuar si pjesë e “metodës së të nxënit social”. “Metoda e të nxënit” social është zhvilluar me ndihmën e studimeve dhe kontributeve të ndryshme, deri në vitin 1986 dhe pas kësaj date ka marrë emrin “Metoda e njohjes sociale” me ndihmën e studimeve të realizuara nga Bandura.

Sipas metodës së të nxënit social në bazë të sjelljeve të individëve qëndron vëzhgimi i imtësishëm i tyre, sepse njerëzit reagojnë ndaj sjelljeve të njëri-tjetrit me anë të miratimit ose dënimit. Sipas Bayrakçës, (2007, f. 199-203) si rrjedhojë, themeluesit e metodës së të nxënit social e cilësojnë zhvillimin moral si një dukuri, e cila shfaqet si rezultat i sjelljeve të aprovuara ose të kritikuar brenda shoqërisë, pjesë e së cilës është njeriu. Për këtë arsye, themeluesit e metodës së të nxënit social mendojnë se ky nuk është thjesht një vëzhgim, por një dimension shkencor i nxëniesfituar nga njeriu.

Sipas Bayrakçës, (2007, f. 200) themeluesit e të nxënit social theksojnë se shembujt e parë të këtij komunikimi pasqyrohen në familje. Nëna dhe babai janë modelet e para. Fëmijët (vajza apo djem) mësojnë të sillen duke parë modelin e nënës dhe babait. Ky vëzhgim apo perceptim fillon që nga mënyra e veshjes, skuadrës së preferuar (të futbollit), shijes në ushqime etj. Si rrjedhojë, mund të themi që njerëzit

nuk janë qenie pasive, të cilët formohen sipas dukurive të jashtme, por pjesëmarrës aktivë të ecurisë së tyre jetësore.

Sipas Kılıçit (2013, f. 2) duke përcaktuar rëndësinë e rolit të mekanizmave shkencore në procesin e lidhur me shkaqet dhe rezultatet e sjelljeve, Bandura ka nxjerrë në plan të parë proceset njohëse të individit, duke dalë jashtë përcaktimit “nxënie sociale” e shkollës etike. Nisur nga ky fakt, Bandura që nga viti 1986 ka filluar të përdorë termin “Metoda e njohjes sociale” në vend të termit “Metoda e të nxënës social”. Ky ndryshim koncepti apo specifikimi është pranuar edhe nga studiues të tjerë. Sipas Bandurës, në bazë të të nxënës qëndron vëzhgimi dhe perceptimi i modeleve të sjelljeve të tjerëve.

Sipas Bandurës, (2001, f. 266) njerëzit, nuk janë vetëm organizma reaguese në formë dhe formim nga ngjarje mjedisore apo forca të brendshme, janë dhe të vetëorganizuar, proaktive, vetëreflektues dhe vetërregullues. Vetëzhvillimi njerëzor, përshtatja dhe ndryshimi janë mishëruar në sistemet shoqërore. Prandaj, agjencia personale vepron brenda një rrjeti të gjerë të ndikimeve socialokulturore. Në këto transaksione njerëzit janë prodhues si dhe produktet e sistemeve sociale. Agjencia personale dhe struktura sociale veprojnë si përcaktues në një strukturë të integruar rastësore më shumë sesa si një njësim (dualitet) pa trup.

Nga ana tjetër Bandura mendon se (2001, f. 266) këto sisteme të avancuara nervore të specializuara për përpunimin, mbajtjen, dhe përdorimin e informacioneve të koduara sigurojnë kapacitetin për aftësitë që janë të dukshme njerëzore, si: simbolizimi gjenerues, matura, vetë-rregullimi vlerësues, vetëdije reflektuese, dhe komunikimi simbolik. Këto aftësi janë të adresuara në seksionet në vijim.

a. Aftësia simbolizuese

Perspektiva interacionale, teoria e njohjes sociale i kushton shumë vëmendje origjinës sociale të mendimit dhe mekanizmave përmes të cilave faktorët socialë ushtrojnë ndikimin e tyre në funksionimin njohës . Kapacitetet e tjera dalluese të njeriut janë të bazuara në këtë kapacitet të avancuar për simbolizimin. (Bandura, 2001, f. 267)

b. Aftësia e vetëkontrollit

Vet-rregullimi njerëzor mbështetet në prodhimin e mospërputhjeve, si dhe reduktimin e tyre. Njerëzit e motivuar drejtojnë veprimet e tyre përmes kontrollit proaktiv, duke i vënë vetes qëllime sfiduese, mobilizimin e burimeve të aftësive dhe përpjekjeve të tyre, për t'i përmbushur ato. (Bandura, 2001, f. 267)

c. Aftësia e vetëreflektimit

Aftësia për të reflektuar mbi veten, përshtatshmëria e mendimeve dhe veprimeve me dikë është një tipar i dukshëm njerëzor që shfaqet në teori të njohura sociale. (Bandura, 2001, f. 269)

d. Aftësia deleguese

Njerëzit kanë evoluar aftësinë e avancuar për vëzhgimin e të mësuarit që u mundëson atyre zgjerimin e njohurive dhe aftësive të tyre me shpejtësi përmes informacionit që bartet nga shumëllojshmëritë e pasura të modeleve të ofruara përreth tyre. (Bandura, 2001, f. 270)

e. Struktura sociale e realitetit

Përfaqësitë televizive të realiteteve sociale pasqyrojnë prirjet ideologjike në portretizimin e tyre në natyrën njerëzore, marrëdhëniet shoqërore dhe normat e strukturën e shoqërisë. (Bandura, 2001, f. 281)

f. Promovimi social i natyrës njerëzore

Veprimet e të tjerëve mund të shërbejnë gjithashtu si promovime sociale për sjelljet e mësuara më parë nga vëzhgimet që mund të jenë kryer, por nuk e kanë bërë këtë jo për shkak të kufizimeve, por për shkak të nxitjeve të pamjaftueshme. Efektet e promovimit social dallohen nga mësimi vëzhgues dhe frenimi, sepse asnjë sjellje e re nuk është fituar dhe proceset e frenimit nuk janë përfshirë për shkak se sjellja e shkaktuar është e pranueshme nga shoqëria dhe nuk ka kufizime. (Bandura, 2001, f. 282)

Sipas Bayrakçës, (2007, f. 207) metoda e të nxënës social i afrohet studentit duke përdorur shkaqet, të cilat të çojnë në arritjen e suksesit. Nëse njihet shkakun pse njerëzit duan të arrijnë suksesin, atëherë studentëve mund t'u jepet motivacioni i duhur, i cili i afron më shumë drejt qëllimit. Në metodën e të nxënës social, modeli i pasqyruar në auditor nga lektori lidhet me formimin e tij. Nëse pedagogu paraqet marrëdhënie të mira me studentët, atëherë mund të bëhet një model shumë i mirë për ta. Në të kundërt, studentët do të jenë në kërkim të një modeli jashtë shkollës.

Sipas Rotterit (Rotterit), (1966, f. 1-3) një nga themeluesit më të rëndësishëm të të nxënës social, nxitësit apo përforcuesit luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e sjelljeve, dhe si rrjedhojë të moralit të njeriut. Përforcuesit i ndajmë në dy grupe: të fokusuar në eksperiencat e brendshme dhe të fokusuar në eksperiencat e jashtme.

Njerëzit e fokusuar në eksperiencat e brendshme mendojnë se përforcimi lidhet me sjelljen e tyre dhe kështu ndihen përgjegjës për jetën e tyre. Si rrjedhojë, mundohen të shfaqin sjellje të përshtatshme me eksperiencat e brendshme. Ndërsa njerëzit e fokusuar në eksperiencat e jashtme mendojnë se përforcimi lidhet me fuqitë e jashtme dhe besojnë se mund të ndryshojnë shumë pak gjëra nga aftësitë apo sjelljet që zotërojnë. Për këtë arsye, nuk përpiqen shumë për të ndryshuar gjendjen.

Sipas Bayrakçës, (2007, f. 201) (themeluesit e metodës së të nxënurit social), përforcuesit me burim të brendshëm e të jashtëm i ndajnë në tre grupe:

1. Përforcuesit socialë (social reinforcement): faktorët, të cilët ndikojnë në sjelljen e njeriut lidhen jo vetëm me nevojat personale të personit, por edhe me nevojat e tij psikologjike. Këtyre mund t'u shtohen dhe përforcuesit socialë, si p.sh.: motivimi, buzëqeshja, përkujdesja, lavdërimi dhe mbështetja emocionale, që janë shumë të rëndësishëm në përfitimin e sjelljes së dëshiruar.

2. Përforcuesit vetjake (self reinforcement): përforcues vetjak është ndjesia pozitive e brendshme e ndjerë krahas motivimit, që mund t'i bëjë njeriu vetes përballë disa sjelljeve pozitive. (p.sh. nëse marr notë të mirë në provim, do të dal me pushime)

3. Përforcues indirekt (vicarious punishment): vëzhgimi nga ana e individit e motivimit, apo dënimit të sjelljeve të personave të tjerë, sjell si rezultat përforcimin indirekt të sjelljes te personi vëzhgues.

Rutledge (Rutlexhe), (2000) shprehet se principet e përgjithshme të metodës së të nxënurit social radhiten në këtë mënyrë:

1. Njerëzit mund të mësojnë duke vëzhguar sjelljet e të tjerëve.

2. Nxënia mund të realizohet pa qenë nevoja e një ndryshimi në sjellje. Nxënia mund të sjellë ose jo një ndryshim në sjellje.

3. Konceptimi luan një rol të rëndësishëm në nxënie.

4. Metoda e të nxënit social mund të pranohet si urë lidhëse apo kalim mes metodave etike dhe atyre njohëse.

Bayrakçëja, (2007, f. 199) pohon se eksperimentet e metodës së të nxënit social janë provuar mbi kafshët. Themeluesit e metodës së të nxënit social pohojnë se rregullat e nxënies janë provuar mbi kafshët dhe tregojnë një lloj ngjashmërie me njeriun, por përsëri mbeten të pamjaftueshme për shkak të strukturës më të komplikuar të njeriut. Sipas themeluesve të kësaj metode, të menduarit, planifikimi, konceptimi dhe mënyrat e besimit janë faktorë të rëndësishëm në nxënie. Kjo është pika e nënvlerësuar nga themeluesit e etikës. Shumë përforcues, të cilët janë shkak të formimit të veprimeve të njeriut, përmbajnë nota sociale.

Bayrakçëja, (2007, f. 207) tërheq vëmendjen edhe nga dimensionet edukues të metodës së mësimin social. Ai thekson se nxënia sociale realizohet nën vëzhgimin dhe analizën e njëri-tjetrit. Këtu i rëndësishëm është faktori i krijimit të personalitetit individual brenda grupit.

3. 1. 4. TEORIA E NXËNIES NJOHËSE (ZHVILLIMI MENDOR)

Njeriu përpiqet të njohë botën e jashtme që nga momenti kur vjen në këtë jetë. Ai përdor shqisat e tij për të realizuar veprimin e njohjes. Psikologët e cilësojnë këtë proces, të filluar me lindjen e njeriut si procesin e zhvillimit njohës. Me ndihmën e fuqisë njohëse njeriu kupton ndryshimin mes krijesave. Me ndihmën e kësaj fuqie

prodhon mjete lehtësuese për jetën e tij, ndërton pallate të larta etj. Pra, ai përdor mirë informacionin, ose njohuritë e tij.

Njohja përfshin shumë procese mendore, si: përqendrimi, konceptimi, leximi, shkrimi, zgjidhja e problemit, mendimi, paragjykimi, krijimtaria etj. Zhvillimi njohës është fushëzhvillimi, i cili përfshin të gjitha proceset mendore në etapat vlerësuese, mundëson komunikimin me ambientin jashtë, përfitimin e njohurive, përdorimin, ruajtjen dhe analizimin e tyre. (T.C Milli Eğitim, 2014, f. 3)

Ahioglu (Ahiolluja), (2011, f. 1-2) shprehet se, sipas Piagetit,

“Zhvillimi nuk vjen si rezultat i mbushjes nga faktorët e jashtëm të një tabele të bardhë, në të kundërt, zhvillimi realizohet si rezultat i proceseve njohëse, në të cilat njeriu merr pjesë aktive. Si një organizëm i gjallë, njeriu arrin një ekuilibër përsa i përket zhvillimit njohës në fund të këtyre proceseve. Por, ky ekuilibër, nuk është i vazhdueshëm, njeriu në çdo periudhë të jetës së tij mund të përballet me situata të reja, me eksperiencat të papritura dhe të gjitha këto prishin ekuilibrin e sistemit njohës. Për këtë arsye, Piageti (1977) e përkufizon zhvillimin njohës si një kalim nga një gjendje e paekuilibruar në një shkallë më të lartë ekuilibrimi.”

Para se të kalojmë te themeluesit dhe përfaqesit më të njohur të zhvillimit njohës duhet të bëjmë ca sqarime terminologjike për kuptimin më të mirë të temës. Këto terma janë përgatitur nga Ministria e Arsimit e Turqisë (2014, f. 4-17) për t'i ndihmuar studentit në përfitimin sa më efektiv nga kjo fushë:

Forcë potenciale (e fshehtë) janë aftësi të trashëguara gjenetike të fëmijës. Ato mendohet se mund të shfaqen gjatë procesit të nxënies. Edukimi është një nga elementët që mund të zbardhë më së miri këto forca.

Aftësi, mjaftueshmëri është forca e pasqyrim, praktikimit, prodhimit të diçkaje me ndihmën e aftësive të tij. Mjaftueshmëria është shëndërrimi i aftësive njohëse, emocionale dhe motorike në gjendje aktive.

Konceptimi është përpjekja e njeriut për të kuptuar, analizuar ngjarjet, të cilat ndodhin rreth tij, që nga momenti kur lind dhe përpjekja për t'u adaptuar me kushtet që e rrethojnë. Ai përdor të gjithë shqisat për ta realizuar këtë. Në konceptim vlerësohen matura, eksperiencat, skema, imagjinata dhe simbolet. Skema shfaqet në mendjen e njeriut si rrjedhojë e komunikimit mes mendjes, mënyrave të sjelljes dhe mendimit, që mundësojnë përshtatjen me ambientin, ndërsa imagjinata përcaktohet si gjurmë të mbetura në tru nga ndjesitë e marra nga shqisat.

Vëmendje, përqendrim është procesi i përjetuar nga njeriu për të kuptuar diçka. Këtu ekzistojnë dy procese shumë të rëndësishme: koha e përqendrimit dhe përzgjedhja e përqendrimit. Koha e përqendrimit përkufizohet si koha që i duhet individit për t'u fokusuar në një pikë, ndërsa përzgjedhja e përqendrimit përkufizohet si njohje e nxitësit të fokusuar, përcaktim të cilësive të tij themelore e më të spikatura. Faktorë të jashtëm dhe të brendshëm ndikojnë në zgjimin e përqendrimit, apo vëmendjes. Faktor i brendshëm mund të jepet shembulli i ndjeshmërisë së shfaqur nga një person i uritur përballë erës së ushqimit. Si faktor i jashtëm jepet shembulli i dëgjimit në makinë të një zëri, të cilin nuk e keni dëgjuar më parë.

Krijimi i konceptit lidhet me sistemin e njohurive. Të gjitha gjërat që lidhen me njëra-tjetrën shprehen me koncepte. Nga ana tjetër, aftësia e krijimit të konceptit mundëson klasifikimin e objekteve. Mësimi i ngjyrave nga fëmijët, njohja e të afërmeve, njohja e gjërave të tyre vjen si rrjedhojë e klasifikimit të objekteve përreth. P.sh. fëmija koncepton funksionet e objekteve. Ai bën disa punë me anë të gjurmëve

të mbetura në mendjen e tij. Pas abstraksionimit grupohen gjurmët e ngjashme e me cilësi të përbashkëta. Këto grupe cilësohen si koncepte. P.sh. në formimin e konceptit nënë, fëmija koncepton pamjen, fytyrën, ngjyrën e flokëve, zërin, aromën e nënës etj. dhe kështu fillon ta dallojë atë nga të tjerët.

Kujtesa dhe fuqia e saj. Kujtesa mund të cilësohet si një aftësi, e cila mundëson ruajtjen e sigurt të eksperiencave të fituara nga personi, të njohurive të mësuara nga ai dhe përdorimin e tyre në momentin e dëshiruar.

Logjikimi dhe zgjidhja e problemit cilësohet si procesi i përdorimit të njohurive dhe eksperiencave të mëparshme në zgjidhjen e një problemi të ri. Mund të vlerësohet edhe si procesi i mposhtjes së vështirësive në arritjen e një zgjidhjeje.

Aftësia krijuese është një nga fuqitë e fshehta të lindura bashkë me njeriun. Ajo gjendet te të gjithë njerëzit, por ndryshon në varësi të nivelit të shfaqjes. Ndryshe mund të përkufizohet edhe si “nxjerrja e diçkaje të re nga diçka e njohur, arritja e një sinteze vetjake, gjetja e zgjidhjeve të reja për shumë probleme, thurja e marrëdhënieve të reja dhe nxjerrja në pah e eksperiencave, mendimeve dhe produkteve të reja brenda një skeme të re mendimi”. Me ndihmën e krijimit ne mund të zgjidhim problemet tona dhe ta bëjmë më të lehtë jetën. Te një njeri krijues mund të gjeni kureshtje, durim, aftësinë për të zbuluar, mendim të pavarur dhe origjinal, mundësinë e realizimit të eksperimenteve dhe studimeve dhe aftësinë e gjykimeve sintezë.

Ahioğlu (2011, f. 2-3) pohon fokusimin e Piagetit mbi disa faktorë që ndikojnë në zhvillimin njohës:

Pjekuria fizike. Njeriu vjen në jetë i pajisur me shumë aftësi. Këto aftësi mbartin ngjyra fizike, biologjike dhe gjenetike dhe përcaktojnë kufijtë e zhvillimit njohës të njeriut.

Eksperienca. Piaget pohon se krahas pjekurisë fizike, njeriu ndikohet edhe nga eksperiencat shoqërore në zhvillimin e metodës njohëse. Organizmi përfiton shumë njohuri dhe eksperienca si rrjedhojë e marrëdhënieve të krijuara me ambientin. Këto njohuri dhe eksperienca, ashtu siç përmbajnë edhe cilësi fizike, përmbajnë dhe veçori, të cilat ndihmojnë në njohjen e shoqërisë ku jeton.

Përcjellja, komunikimi shoqëror është kontakti me njerëzit. Me ndihmën e këtij komunikimi, njeriu mëson rregullat dhe ligjet e shoqërisë ku jeton.

Ekuilibrimi është kalimi i njeriut nga ekuilibri njohës, në të cilin gjendet në një gjendje më të lartë ekuilibrimi. Njeriu vazhdimisht gjendet brenda një procesi zhvillimi. Çdo etapë zhvillimi e shton njeriun në gjendje të reja njohëse dhe në këtë mënyrë arrin në etapa më të larta. Niveli më i zhvilluar ekuilibruar është etapa e mendimit subjektiv, apo gjendja a kur njeriu fillon të mendojë subjektivisht.

Sipas Gültekinit (Gyltekinit), (2007, f. 506) ana më e rëndësishme e metodës njohëse është zhvillimi i aktiviteteve të fokusuara në proceset, që mundësojnë të nxëniet e studentëve. Kur analizohen këto aktivitete shohim se ato përmbajnë veçori, si: konceptimi në mësim, ndjesi, kujtesë, lidhja e mësimi me zhvillimin e studentit, nënvizimin e gjërave të mësuara më parë dhe respektimin e shpejtësisë së të nxëniet të studentit.

Përfaqësuesit më të rëndësishëm të metodës njohëse janë: J. Dewey, Jean Piaget dhe Lawrence Kohlberg

3. 1. 4. 1. Teoria e zhvillimit moral sipas Dewey-it

Sipas Tekinit, (2005, f. 14) J. Dewey është filozof, psikolog dhe pedagog social, i cili ka punuar si pedagog i filozofisë në universitete të ndryshme. Ai është pragmatist i fuqishëm, ashtu si William James dhe (F.J. Schiller). Është përpjekur t'i masë punët dhe mendimet e tij në jetë duke u bazuar te domosdoshmëria e kuptimit pragmatist. J. Dewey ka vlerësuar strukturën biologjike të fëmijës, ka sugjeruar zhvillimin e një modeli edukues, i cili mundëson vetë edukimin pa trysinë apo detyrimin e jashtëm dhe ka nënvizuar domosdoshmërinë e lëvizjes sipas natyrës dhe personalitetit të fëmijës dhe jo faktorëve të jashtëm.

Sipas Benderit, (2005, f. 15-18) J. Dewey ka realizuar një sistem edukativ të transmetuar nga fëmija te mësuesi. Për këtë arsye ka vlerësuar më shumë praktikën se metodën. Në vend të disiplinës artificiale duhet të zbatohet disiplina natyrore. Me një qëndrim të tillë, duke rivlerësuar përmbajtjen mësimore, ai zhvilloi studime duke besuar se të gjitha profesionet mund të mësohen në shkollë.

Ky këndvështrim, i cili i përket J. Dewey, i ndikuar nga Benderi, nuk është gjë tjetër përveçse pragmatizëm. Sipas Erkılıçit (Erkëllëçit), (2009, f. 137) në bazë të edukimit pragmatist qëndron prirja e fitimit të sjelljeve dhe aftësive, të cilat lehtësojnë punët e individëve në jetën shoqërore. Kjo situatë, e cila është qëllimi i edukimit, është një domosdoshmëri e rëndësishme në përshtatjen e individëve me shoqërinë, sepse, ana praktike e programeve edukuese është e detyruar të bazohet në këndvështrimin filozofik, i cili vlerëson eksperimentin dhe vëzhgimin.

Sipas Benderit, (2005, f. 14) pragmatizmi përbën një sintezë, e cila përpiqet të mbledhë disa rryma filozofike. Si një korridor hoteli ekziston lidhja me secilën dhomë të tij. Duke vepruar sipas mendimit realist ekzistent në secilën prej rrymave filozofike

të kundërta me njëra-tjetrën, ai përpiqet të mbledhë të gjithë vlerat praktike të rrymave.

Sipas Bakirit, (2006, f. 57) si shprehje e mendimit pragmatist, filozofia e J. Dewey është një dobishmëri e të vepruarit për nga matja e mendimeve dhe veprimeve sipas rezultateve të tyre në jetë, instrumentalizëm për nga përcaktimi i tyre si mjete dhe eksperimentalizëm për nga mbështetja e veprimeve dhe njohurive në eksperimente.

Në një artikull tjetër, Bakır (Bakëri) (2008, f. 15) pohon se në thelb të filozofisë së edukimit të J. Dewey qendron studimi i hollësishëm i rezultatit të veprimeve tona. Faktorët, të cilët lehtësojnë jetën e përditshme dhe janë të dobishëm, pranohen si të vlefshme. Njohuritë janë shpjegimi në mendje i rezultatit të veprimeve të lidhura me principin e dobishmërisë dhe ndërtimin e tërësisë kuptimore. Në modelin edukues të J. Dewey, të fokusuar mbi praktikat sociale dhe vetë jetën, individi gjen një kuptim të shoqëria, si pjesë e tërësisë.

Güngöri (1993, f. 36) pohon se J. Dewey mendon t'ia përshtasë bazës shkencore dhe bazës eksperimentale të gjithë rregullat dhe vlerat morale. Po pyetja që del këtu është: “Si do të nxirreshin rezultatet normative nga faktet natyrore? Ose e thënë ndryshe, si do të mund të përfshinin të vërtetat shkencore detyrimet morale?” Ajo të cilën përpiqej të bënte ai ishte ta mbështeste moralin në shkencë.

Sipas Peterit (1952, f. 13) në teorinë e J. Dewey burimi i çdo njohurie është përvoja. Por, përvojë nuk do të thotë thjesht të bësh diçka pasive tek objekti apo ndryshime tek ai, apo thjesht ta vëzhgosh, por të punosh diçka mbi të apo të bashkëveprosh me të. Përvoja na mëson ndikimin e objektit mbi ne, mënyrën sesi të përshtasim lëvizjet tona me të dhe se çfarë mund të bëjmë me të. Me ndihmën e

përvojës, njohuria e përftuar nuk mbetet pasive, por shndërrohet në një njohuri aktive e mëshiruar në veprimet tona. Për këtë arsye, informacioni nuk ka asnjë lloj vlere, por bëhet i tillë vetëm nëse shndërrohet në një mjet të veprimeve të njeriut.

Rëndësinë, të cilën ia kushton J. Dewey ekperimentit dhe përvojës mund ta kuptojmë shumë me këtë histori të shkurtër. J. Dewey (2008, f. 39) shkon në një dyqan ku shiten artikuj shkollorë. Aty sheh për disa tavolina dhe karrige të mira, të përshtatshme, të shëndetshme për zhvillimin e fëmijëve, por nuk arrin të gjejë atë që dëshiron. Një nga shitësit në dyqan e kupton situatën dhe i thotë: “Kam frikë se në dyqanin tonë nuk gjenden ato që kërkon ju. Ju kërkon diçka, me të cilën të punoni me fëmijët, ndërsa këtu gjenden prodhime me të cilat mund t’i dëgjoni ata.”

Petersi, sipas Tavlanit (1952, f. 17) tregon se J. Dewey nuk vendos një kufi mes moralit dhe socializimit. Gjendjen tonë morale mund ta shfaqim me anë të veprimeve tona dhe sjelljeve të pasqyruara përballë të tjerëve. Të jesh i moralshëm do të thotë të veprosh sipas mënyrës së dëshiruar dhe të nevojshme për nga pikëpamja sociale. Por dukurinë e nevojshme apo të dëshiruar për nga pikëpamja sociale J. Dewey nuk dëshiron ta ndërtojë nga ideali i tij social. Ai kërkon të gjejë vlerat e gjendura brenda shoqërisë reale dhe me anë të tyre të kritikojë cilësitë e pavlera dhe joshoqërore (asociale) të një shoqërie tjetër. Cilësitë e vlefshme të një shoqërie janë ato të cilat ndihmojnë në forcimin dhe përsosjen e dy ndarjeve kryesore.

John Dewey është etiku i parë, i cili ka analizuar paralelisht zhvillimin moral dhe atë njohës. Ai mendon se zhvillimi moral lidhet me edukimin e personit dhe se edukimi mundëson zhvillimin e sistemit të vlerave tek ai. Në këtë proces, hidhen bazat e gjykitimit moral duke krijuar “mendime morale”, të cilat ndikojnë dhe

zhvillojnë sjelljet e individit. Zhvillimi moral ndahet në tre periudha sipas tij dhe ai i ka shpjeguar këto periudha teorikisht :

Periudha para moralit dhe traditës është koha e cila përfshin sjelljet morale të nxitura nga instiktet sociale dhe biologjike.

Periudha tradicionale është koha e përvetësimit të vlerave të grupit, brenda të cilit ndodhet.

Periudha e pavarësisë është koha kur personi merr vendimet e tij personale sipas gjykimeve të pavarura dhe kur përvetëson standardet e grupit ku ndodhet. (T.C.Milli Eëitim, 2013, f. 8)

3. 1. 4. 2. Teoria e zhvillimit moral sipas Piagetit (Piaxhetit)

Piageti është psikolog zviceran, i cili ka jetuar mes viteve 1896-1980. Ai ka hedhur mendime të ndryshme rreth zhvillimit moral të fëmijëve. Piageti e pranonte që zhvillimi gjuhësor dhe mendor të fëmija kalon në faza të ndryshme.

Sipas Günçesë (Gynçesë), (1971, f. 31) në thelb të mendimit të Piagetit gjendet ekuilibri i organizmit me mjedisin. Qoftë njerëzit, qoftë organizmat e tjera të gjalla me mjedisin e tyre janë të prirur ta formojnë këtë ekuilibër. Njerëzit, kur përballen me një situatë, mundohen ta kuptojnë atë sipas përvojave të vjetra dhe nëse nuk janë të suksesshëm ta bëjnë këtë formojnë një sjellje të re duke e shndërruar përvojën e vjetër. Rritja e numrit të situatave të tilla gjatë jetës është shkak për të fituar forma të reja sjelljeje.

Sipas Santrockut, (2001) Piageti përpiqet të vërtetojë se fëmijët mund të mendojnë në mënyrën më praktike rreth çështjeve sociale kur rriten dhe mund të marrin vendime më logjike. Shkaku i këtij mendimi të Piagetit është gjendja jep-merr

në marrëdhëniet ekzistuese mes bashkëmoshatarëve. Në grupet e një moshe dhe pozicioni flitet rreth planeve dhe mosmarrëveshjet zgjidhen duke diskutuar me njëritjetrit. Në fund të diskutimit merret një vendim. Ndërsa në rastin e marrëdhënieve prindër – fëmijë zakonisht rregullat vendosen nga prindërit dhe këtu vihet re një zhvillim më i ulët i gjykitimit moral.

Onuri (1979, f. 3-4) pohon mendimin e Piagetit. Ai thotë se edukimi moral duhet menduar ndryshe nga edukimi logjik apo ai matematikor. Si rrjedhojë, edukimi i mbështetur në një forcë të vetme autoritare, apo edukimi i njëanshëm, mund të krijojë probleme edhe morale, edhe mendore. Sipas Piagetit nuk ekziston asnjë ndryshim në mes studentit, i cili mëson përmendësh me një student, i cili nuk i përvetëson rregullat. Për këtë arsye, ashtu siç ndodh në edukimin mendor edhe në edukimin moral, duhen vlerësuar metodat efektive dhe marrëdhëniet shoqërore mes fëmijëve. Në këtë mënyrë mund të qëndrojmë larg botëkuptimit të edukimit autoritar dhe të njëanshëm.

Sipas Piagetit, (2007, f. 9) zhvillimi moral ecën paralelisht me zhvillimin njohës duke ndjekur disa periudha. Çdo njeri zë vend në periudha të ndryshme dhe me kalimin e kohës zhvillohet, përqet duke kaluar një periudhë më lart. Jo të gjithë individët mund të arrijnë deri në shkallët e fundit të zhvillimit, sepse, pjekuria biologjike dhe eksperiencat e të nxënës janë përcaktuese mbi nivelin e zhvillimit njohës. E njëjta gjë vlen edhe për zhvillimin moral. Sipas Piagetit, format e gjykimeve dhe interpretimeve të rregullave nga ana e fëmijëve në lidhje me të drejtën e të gabuarën ndryshojnë sipas moshës.

Sipas Writes dhe Croxenit, (1976, f. 293) gjykimi moral teorik dhe hipotetik i fëmijës te teoria e Piagetit interpretohet si ndërgjegjësim i gjykimeve. Gjykimi moral i

Piagetit përbën kontrollin autoritar të të rriturve, komunikimin mes grupmoshave të fëmijës. Ai e ka mbështetur strukturën e tij mendimore mbi këtë tezë. Në fund të saj ka nxjerrë ekzistencën e dy këndvështrimeve të kundërta morale: njëri është këndvështrimi *egocentrik* para periudhës së veprimit dhe këndvështrimi moral i mbështetur në bashkëpunim me periudhën e ndërveprimit.

Mendimi i Piagetit, (2013, f. 9) zhvillohet pavarësisht nga gjërat e mësuara nga jashtë në trajtën e një procesi, i cili avancon si rezultat i kureshtjes e interesit të brendshëm. Ky proces mundëson daljen në pah të etapave me ndihmën e disa ndryshimeve të brendshme. Sipas Piagetit, ekziston një lidhje mes zhvillimit emocional dhe atij njohës. Ai beson se të dy zhvillimet mund të përcaktohen me ndihmën e sistemit fazë.

Sipas Piagetit, (2007, f. 10) te fëmijët e moshës 0-6 vjeç nuk ekziston koncepti rregull, prandaj nuk mund të bëhet fjalë për moral. Për këtë arsye, zhvillimi moral fillon pas kësaj moshe, fëmijët u përshtaten rregullave pa ditur kuptimin e tyre të vërtetë. Por, kur nuk gjenden personat, të cilët i vendosin rregullat, ata priren të mos i zbatojnë. P.sh. një fëmijë, të cilit i është ndaluar çokollata nga nëna apo babai, mund të hajë çokollatë kur është vetëm.

Sipas Özenit, (2011, f. 5) Piageti mendon se zhvillimi moral ecën paralelisht me zhvillimin mendor dhe principet e vlefshme për zhvillimin mendor vlejné edhe për atë moral. “Piageti ka zhvilluar dy histori të shkurtra dhe ka vëzhguar lojërat e fëmijëve për të analizuar gjykimet e tyre morale. Ai u ka bërë pyetje fëmijëve të moshave të ndryshme rreth rregullave të lojës dhe historive të treguara dhe më pas ka analizuar përgjigjet e dhëna prej tyre.”

Duke përdorur lojën me bila të Piagetit, Wright dhe Croxen (1976, f. 290) kanë vëzhguar tendencën e fëmijëve për t'iu përshtatur rregullave. Gjatë periudhës së vëzhgimit, Piageti u ka bërë këto pyetje fëmijëve:

- a. A është e mundur të ndryshosh rregullat duke shpikur gjëra të reja?
- b. A është luajtur gjithmonë kështu kjo lojë?
- c. Nga rrjedhin rregullat?

Si rezultat i shumë studimeve të realizuara mbi fëmijët, Piageti është përpjekur të shpjegojë teorinë e zhvillimit moral duke e ndarë në faza të ndryshme. Ja si mund t'i radhisim këto faza:

3. 1. 4. 2. 1. Periudha e fluksit emocional (0-2 vjeç):

Kjo periudhë fillon me lindjen e njeriut dhe vazhdon deri në moshën 2-vjeçare. Fëmijët e njohin ambientin përreth duke përdorur aftësitë motorike dhe shqisat. Ata shfaqen shumë aktivë gjatë kësaj periudhe. (Kılıçgün, 2013, f. 26)

Piageti ka analizuar dy vitet e para të jetës dhe ka arritur në përfundimin se shenjat e zgjuarsisë shfaqen gjatë kësaj periudhe. Në lindje, fëmija shfaq vetëm refleksat e lindjes, ndërsa në moshën 2 vjeç fillon të flasë dhe të zhvillojë funksione mendore, siç janë mendimet simbolike. (T.C.Milli Eğitim, 2013, f. 10)

Në këtë periudhë, prindërit (nëna dhe babai) janë në rolin e modelit për fëmijën. Fëmijët e mendojnë si kusht të lumturisë së tyre veprimin, sipas dëshirave të prindërve, por nuk janë të vetëdijshëm rreth qëllimit të rregullave.

3. 1. 4. 2. 2. Periudha para veprimit (egocentrizmi) (2-7 vjeç)

Në këtë periudhë nuk është zhvilluar akoma mendimi logjik. Sipas Kılıçgünit (Këlëçgynit), (2013, f. 29) në këtë moshë fëmijët janë nën ndikimin e koncepteve vizive dhe mendojnë nën efektin e pamjes së jashtme të objekteve. Gjatë kësaj periudhe, shfaqen katër forma të ndryshme mendimi: mendimi egocentrik, animizmi, mendimi i mbështetur mbi funksionin simbolik dhe mendimi intuitiv. Te *mendimi egocentrik* ekzistojnë vetëm pikëpamjet e fëmijës. Ata besojnë se të gjithë e shohin, konceptojnë dhe ndjejnë botën ashtu siç e ndjejnë ata. *Animizmi* lidhet me mendimin egocentrik dhe shfaqet në momentet kur fëmijët u japin shpirt edhe sendeve. Mendimi i mbështetur te *funksioni simbolik* shfaqet në moshën 2-4 vjeç. Fëmijët që e pasqyrojnë këtë mendim përdorin një fjalë apo objekt simbolik për një njeri apo objekt, i cili nuk është prezent. *Mendimi intuitiv* shfaqet në moshën 4-7vjeç. Në këtë fazë fëmijët zhvillojnë një mendim më të thjeshtë përtej mendimit logjik.

Sipas një artikulli të përgatitur nga Ministria e Arsimit e Turqisë (2013, f. 10) bëhet e ditur se fëmijët i pranojnë rregullat si të shenjta, të vendosura nga të rriturit dhe Zoti. Edhe ndryshimet më të vogla i konceptojnë si thyerje të rregullave. Piageti e cilëson këtë periudhë si “faza e lidhjes”. Shkakun e kësaj lidhjeje me rregullat te fëmijët e moshës 2-7 vjeç, Piageti e shpjegon si imitim të sjelljeve të përshtatshme pa e kuptuar se çfarë kuptimi kanë dhe si rezultat të vëzhgimit të fëmijëve më të mëdhenj.

3. 1. 4. 2. 3. Periudha e veprimeve objektive (7-11 vjeç)

Është periudha kur fëmijët fillojnë të mendojnë në mënyrë më logjike, më objektive. Sipas Kılıçgünit, (2013, f. 30) mendimi logjik lidhet me sende objektive dhe situata të papritura. Në periudhën e veprimeve objektive fitohen struktura

mendimore, si identiteti, kompensimi, ndryshimi në të kundërtën etj. Në këtë periudhë pritet zhvillimi i dy koncepteve themelore: numrit dhe masës. Si masë zhvillohet pesha, gjatësia, vëllimi dhe sipërfaqja. Për të përfituar këto koncepte duhen realizuar identiteti, kompensimi, ndryshimi dhe transformimi.

Gjatë kësaj periudhe, fëmijët zotërojnë pikëpamje të ndryshme rreth një teme dhe fitojnë respektin ndaj mendimeve të të tjerëve, i mirëkuptojnë rregullat dhe diskutojnë rreth tyre. (T. C. Milli Eğitim, 2013, f. 11)

3. 1. 4. 2. 4. Periudha e veprimeve subjektive (11 vjeç e sipër)

Është një periudhë ku mbizotëron analizimi i anëve të ndryshme të ngjarjeve, mendimi subjektiv dhe konceptet. Kjo periudhë, e cila fillon pas moshës 10 vjeç, sipas Kılıçgünit (2013, f. 31) vazhdon edhe gjatë periudhës së adoleshencës. Veçoria më dalluese e kësaj periudhe është zhvillimi i mendimit relativ dhe analizimi i një problemi sipas mënyrave të ndryshme. Zhvillohen procese mendore si përgjithësimi, zbritja (deduksioni) dhe përfundimi logjik. Mund të kontrollohen të drejtat, duke thurur hipoteza. Nxirren mendime të ndryshme rreth një çështjeje, si rrjedhojë e zhvillimit të aftësisë së mendimit subjektiv, duke përdorur koncepte subjektive.

Sipas përmbledhjes së përgatitur nga Ministria e Arsimit e Republikës Turke (2013, f. 12) bëhet e ditur se fëmija në këtë periudhë e kupton mendimin apo pikëpamjen e tjetrit duke u larguar nga mendimi egocentrik. Nisur nga ky fakt, ai shpëton nga morali i varur dhe kalon tek morali i bashkëpunimit, duke fituar pavarësinë në lidhje me rregullat. Fëmija, i cili fiton pikëpamjen e mendimit relativ në mendimet e tij, mund të tregojë një lloj elasticiteti në aplikimin e gjykimeve dhe rregullave morale. Përsëri, ai mund të ndryshojë mendimin, apo pikëpamjen e tij, rreth rregullave gjatë kësaj periudhe. Ndryshe nga periudhat e tjera, rregullat tashmë nuk

konsiderohen si ligje të vendosura në mënyrë autoritare, por si produkt i tolerancës reciproke.

3. 1. 4. 3. Teoria e zhvillimit moral sipas Kohlbergut

Lawrence Kohlbergu lindi më 25 tetor 1927, në zonën Bronxville të Nju Jorkut, në një familje hebrenjsh. Në vitin (1984) ka filluar studimet në degën e psikologjisë në Universitetin e Çikagos dhe duke treguar një sukses të lartë akademik, i ka mbaruar studimet brenda një viti. Megjithëse pas mbarimit të universitetit mendonte të punonte në fushën e psikologjisë klinike apo drejtësisë, vëmendja e tij ishte tërhequr nga studimi i psikologut zviceran Piaget rreth gjykimit moral të adoleshentëve. Pas kësaj, ai vazhdon studimet pasuniversitare në të njëjtin universitet, duke zhvilluar studime e kërkime mbi këtë temë. Teza e tij e doktoraturës përfundoi në vitin 1958 dhe përfshinte dy periudha të zhvillimit moral të Piagetit. Më pas, ka punuar si pedagog në degën e psikologjisë në universitetet Yale dhe Çikago. Në vitin 1968 ka filluar të punojë në *Harvard Graduate School of Education*. Në vitin 1971, gjatë zhvillimit të studimeve ndërkulturore në Belize të Amerikës së Mesme, u prek nga një sëmundje tropikale dhe për shkak të kësaj sëmundjeje ka luftuar me shqetësimet fizike dhe depresionin e rëndë për 16 vite me radhë. Më 19 janar 1987 është larguar nga spitali i Massachussettes, ku kurohej dhe është vetëvrarë në oqeanin Atlantik. (Walsh, 2000, f. 36-41)

Megjithëse Kohlbergu ka marrë si pikë reference disa mendime të Dewejit, ai ka vlerësuar shumë dhe Platonin, një nga filozofët e parë përkrah teoricienëve të tjerë etikë. Me anë të shprehjes sipas Walshit (2000, f. 37) “në fund të studimeve të zhvilluara mbi përshtatjen e edukimit moral, me etapat e zhvillimit moral kuptova që

besimi i Platonit rreth forcës së të mirës racionale duhet vlerësuar dhe analizuar mirë”, Kohlbergu ka tërhequr vëmendjen rreth vlerës së të mirës në etapat e zhvillimit moral.

Wright dhe Croxeni (1976, f. 299) Kohlbergu e kanë parë si qëllim në praktimin e lidhjes mes fitimit të rolit seksual të teorisë njohëse me koncepte, si marrëdhënia prindër-fëmijë dhe përngjasimi mbi zhvillimin shoqëror.

Kohlbergu ka analizuar teorinë e Piagetit gjatë formimit të teorisë së zhvillimit moral. Ai e ka vëzhguar reagimin dhe veprimin e njerëzve përballë situatave të ndryshme. Sipas Kohlbergut, e rëndësishme, themelore këtu është analizimi i rolit që luajnë gjykimet morale në jetën e njeriut. (T. C. Milli Eëitim, 2013, f. 13)

Sipas Kohlbergut, (1977, f. 53-59) edukimi njohës moral është shumë kompleks, përmban një strukturë filozofike të shëndoshë dhe është informues për ata që bëjnë praktikë brenda kufijve të caktuar. Por, pavarësisht kësaj strukture të fortë, ai shprehet se qëndrimi njohës nuk është i mjaftueshëm në edukimin moral, duke pranuar kështu disa mangësi.

Kohlbergu (1977, f. 53-59) pohon se qëllimi kryesor i edukimit moral është aktivizimi i aftësisë së të menduarit të njerëzve në përshtatje me zhvillimin e tyre dhe përfitimi i aftësive të mendimit gjithëpërfshirës dhe të mjaftueshëm në zgjidhjen e problemeve morale.

Arıdağ dhe Yüksel (Arëdau dhe Jykseli), (2010, f. 689) shprehen se Kohlbergu e sheh zhvillimin moral si një zhvillim të thjeshtë, të krijuar paralelisht me maturimin, pjekjen e trurit. Për zhvillimin moral është shumë i rëndësishëm përftimi i perspektivave të ndryshme të një problemi dhe “përcaktimi i një roli në të”. Marrja e

një roli e avancon moralin në paragjykim. Nga ana tjetër, vë në lëvizje gjykimin moral.

Sipas Kohlbergut, (1966, f. 20) matura morale e fëmijëve bazuar në botëkuptimin tradicional moral përcaktohet sipas sjelljeve të treguara nga fëmijët përballë rregullave të vendosura nga të rriturit. Por fëmijët duhet të krijojnë vetë gjykimet e tyre morale dhe të formulojnë principet morale. Parë nga ky këndvështrim, qëllimi i edukimit moral është mundësimi i pjekurisë morale.

Onuri, (1979, f. 4) Kohlberg, ashtu si Dewey sugjeron mundësimin e zhvillimit të mendimit moral nga ana e mësuesve, duke përdoror diskutimet, të cilat përfshijnë dilemat e vërteta morale të dala nga ngjarjet e përditshme, letërsia, apo historia. Vetëm në këtë mënyrë, fëmijët do të fitojnë gjykimin e vërtetë moral, si rrjedhojë e dilemave të vështira. Këto shpjegime morale, të cilat nuk duhet të jenë as më poshtë e as më lart nivelit konceptues të fëmijëve, duhet të zotërojnë informacion shkencor dhe të formohen nga mësues, që arrijnë të kuptojnë nivelin e zhvillimit të studentëve. Në edukimin moral tradicional i rëndësishëm është lavdërimi, motivimi i sjelljeve të mira dhe jo prezantimi i dilemave të ndryshme. Ka qasje të ndryshme që ekzistojnë mes mendimeve të të rriturve mbi nivelin e zhvillimit të fëmijës me metodat dënuese-stimuluese nën nivelin e zhvillimit të fëmijës. Sipas Onurit, ajo gjë që përcakton bazën e konceptit moral të Kohlbergut është domosdoshmëria e prezencës së një mendimi më të shëndetshëm, i cili përfshin nivelin e zhvillimit të fëmijës, madje një nivel edhe më të lartë se ai ekzistues.

Nga ana tjetër, Aridağ, (2003, f. 60) pohon se Kohlbergu nuk i lë mënjane ndjenjat. “Ndryshe nga racionalizmi i Kantit, nuk i refuzon ndjenjat si përbërëse të gjyimit moral dhe të ndjenjës së drejtësisë. Ai e pranon që ndjenjat luajnë një rol të

rëndësishëm në rastet e respektimit të nderit të njeriut dhe përgjegjësisë ndërnjerëzore. Por, sipas tij, ndjenjat janë formuar gjatë proceseve njohëse. Një ndjenjë e strukturuar në mënyrë njohëse, p.sh. kur i kërkohet, ndjen simpati ndaj kurbanit dhe mund ta shfaqë veten në përpjekjen për t'u bërë mirë të tjerëve, apo të marrë përsipër përgjegjësi.”

Onuri (2000, f. 174) pohon se në strukturën mendimore të Kohlbergut gjenden koncepte të përbashkëta morale të kulturave botërore. Këto koncepte, si: drejtësi, barazi, dashuri, respekt dhe autoritet janë koncepte morale të vlerësuara nga të gjithë kulturat. Si rrjedhojë, edhe fazat e krijimit të gjykimit moral te njerëzit e kulturave të ndryshme janë të njëjta. Ndryshimi mes individëve shfaqet vetëm në aspektin e shpejtësisë së kalimit të fazave dhe vendit të arritur prej tyre.

Sipas Kohlbergut (1968, f. 24) i ka pasqyruar mendimet e tij në SHBA, Angli, Izrael, Bahama, Meksikë, Tajvan, Malejzi dhe Turqi duke nënvizuar kështu universalitetin e teorisë.

Sipas Çinemrës, (2013, f. 147) veçanërisht mendimi i shoqërisë së drejtë në fushën e edukimit të Kohlbergut është formësuar me sistemet e edukimit kolektiv të Durkheimit dhe Kibutzëve të Izraelit. Ndërkohë që analizonte sistemet e shkollës së Kibutzëve, Kohlbergu dalloi pikë së pari rolin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën shoqërore. Kjo pjesëmarrje kërkonte organizimin e një aktiviteti shoqëror e deri te mbajtja e përgjegjësisë për veprimet kolektive të shoqërisë. Në fund të kësaj, Kohlbergu pohon se ekziston një lloj ngjashmërie mes principeve edukuese marksiste të jetës së Kibutzëve me ideologjinë *burjuva* të Durkheimit, duke u bazuar te punimet rreth moralit të Durkheimit dhe vëzhgimet e Kibutzëve. Këto ngjashmëri mund t'i radhisim si më poshtë, në pjesë të ndara:

1. Nxjerrja në plan të parë e shoqërisë dhe jo e individit.
2. Mundësimi i disiplinës së grupit duke respektuar rregullat.
3. Çdo anëtar grupi duhet të zhvillojë përgjegjësinë shoqërore në veprimet e bëra në emër të grupit.

Güngöri (1993, f. 56) pohon se Kohlbergu vlerëson pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete që zhvillojnë të rriturit ose në aktivitete me bashkëmoshatarët, përsa i përket mësimi të rregullave, principeve dhe rolit të sistemit të shoqërisë. Në këto aktivitete të përbashkëta ku merr pjesë fëmija edhe grupet janë si një miniaturë e shoqërisë. Aty fëmija mëson rregullat dhe rolin e sistemit të shoqërisë. Gjendja socio-ekonomike e fëmijës brenda shoqërisë na jep një mendim rreth llojeve të grupeve, që mund të marrë pjesë dhe se çfarë mund të përfitojë prej tyre. Pavarësisht grupit që i përket njerëzit apo eksperiencës që fitojnë, mendohet se ky aktivitet pasqyron një sistem moral të nevojshëm për funksionimin e mirë të shoqërisë.

Sipas Clausës, (2000, f. 717) Kohlbergu ka qëndruar mbi funksionet mendore e intelektuale të shfaqura gjatë zhvillimit moral dhe sipas reagimeve të treguara ndaj historive, (të cilat përfshijnë dilemat morale) ka matur fazën e mendimit moral. Këto faza apo etapa nuk ndryshojnë, janë hierarkike dhe universale.

Sipas Wright dhe Croxenit, (1976, f. 299) Kohlbergu është specializuar në një fushë të ndryshme me Piagetin në traditën eksperimentale ortodokse. Sipas Kohlbergut, këndvështrimi moral njohës mundëson formimin e një tërësie konceptuale ngopëse me koncepte, si: kundërshtimi, faji, sakrifica, mendimi moral dhe marrja e vendimeve. Pika mbi të cilën qëndron Kohlbergu, krahas mendimit

njohës, është përcaktimi, formësimi i ndjenjave dhe sjelljeve. Për Kohlbergun, eksperimenti është thelbësor.

Kohlbergu (1977, f. 54) e ka përshkruar zhvillimin e gjykimit moral në 6 etapa të cilat i ka ndarë në 3 nivele themelore. Çdo nivel pasqyron një lloj të ndryshëm të marrëdhënies në mes pritshmërive, rregullave të shoqërisë dhe personalitetit të personit.

Sipas Clousës, (2000, f. 717) në mes të etapave të zhvillimit moral të Kohlbergut gjendet niveli tradicional, i cili përfshin etapën e tretë dhe të katërt. Nëse një person pasqyron gjykimin në etapën e tretë sillet mirë, beson se duhet t'i kënaqë të tjerët, t'i ndihmojë ata dhe për këtë arsye mendon se duhet të plotësojë pritshmëritë e njerëzve. Një person, i cili e ka gjykimin në etapën e katërt, është një njeri, i cili përulet me dëshirë përballë ligjeve, rregullave dhe marrëveshjeve. Nuk është e mundur të flitet për një shoqëri e cila nuk ka rregulla, nuk ka ligje të caktuara.

1. Niveli paratradicional (preconventional) përfshin etapat 1 dhe 2. Një person, i cili ndodhet në këto etapa e analizon të mirën e të keqen duke marrë për bazë rezultatet fizike të veprimit. Etapa e parë e Kohlbergut tregon një paralelizëm të qartë me trysninë e Piagetit ose mendimin moral heteronom. Ikja nga dënimi dhe bindja e verbuar ndaj autoritetit përbën një lloj vlere brenda koncepteve të tyre të drejta. Ndërsa në etapën e dytë, ai beson se e mira është gjendja, e cila plotëson nevojat e tij dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore thuren mbi parimin “nëse më bën mirë, edhe unë të bëj mirë”.

2. Niveli pastradicional (postconventional) është një periudhë, e cila përfshin të rriturit në një farë mënyre dhe përfshin etapat 5 dhe 6. Periudha pastradicionale zhvillohet si rrjedhim i katër etapave të mëparshme. Gjatë kësaj

periudhe, individët tashmë kanë fituar një këndvështrim vetjak rreth shoqërisë dhe familjes. Pra, ata kanë arritur pjekurinë e duhur për të marrë vendime të mbështetura në principet universale. Etapa e pestë të jep mundësinë e zgjedhjes racionale në mes sistemeve sociale alternative dhe mundëson një lloj udhëzuesi në realizimin e ligjeve, rregullave të reja. Gjykimi në etapën e gjashtë është i lidhur detyrimisht me zgjedhjen personale të vlerësuar nga çdo njeri dhe sipas principeve etike të respektuara, pa qenë nevoja të shikojë racën, popullin, gjendjen socio-ekonomike, apo shoqërinë që i përket.

Santroku (Santrock), (2001): “Kohlbergu beson se ky nivel bashkë me etapat e tij jetohej i lidhur me jetën. Para moshës 9 vjeç, fëmijët arsyetojnë në nivelin e paramendimit tradicional rreth dilemave morale. Në vitet e para të adoleshencës gjykojnë në format e mendimit tradicional. Mënyra e të menduarit e shumicës së adoleshentëve përmban gjurmë të fazës së 2-të dhe të 4-ët, por në përgjithësi pasqyron fazën e 3-të. Bashkë me fillimin e viteve të para të pjekurisë, një numër i pakët njerëzish fillojnë të jetojnë nivelin e pasmendimit tradicional.”

Lawrence Kohlberg, (1977, f. 54) thekson se një teori e saktë duhet të mbartë këto tri cilësi:

1. Në strukturat, të cilat zënë vend në pika të caktuara të zhvillimit të teorisë fazë, shfaqen ndryshime kualitative.
2. Këto struktura të ndryshme nuk ndryshojnë, në zhvillimin individual mund të përshpejtojnë, ngadalësojnë ose ndalojnë zhvillimin e faktorëve të njëpasnjëshëm, por asnjëherë nuk ndryshojnë radhën.
3. Fazat tregojnë një plotësim hierarkik. Fazat më të larta zënë vendin e fazave më të ulëta, ose bashkohen me to.

Sipas Wright dhe Croxenit, (1976, f. 305) Kohlbergu shprehet se krahas ndjekjes së stadeve sipas radhës, fëmijët janë të detyruar ta ndjekin këtë radhë. Asnjë fëmijë nuk mund të kapërcejë etapat. Vërtetësinë e kësaj situatë Kohlbergu e ka provuar në eksperimentet e realizuara. Megjithëse kalimi kohor mes etapave në kultura të ndryshme është i ndryshëm, të gjithë fëmijët janë të detyruar të kalojnë të njëjtat etapa .

Kohlbergu fokusohet mbi historitë në përcaktimin e këtyre niveleve. Në këtë pikë, Kohlbergu ka marrë si shembull Piagetin, por përsëri ekzistojnë disa ndryshime mes tyre në mënyrën e konceptimit. Sepse, ndërkohë që Piageti nuk vëren ndonjë dallim në mes veprimit dhe mendimit të historitë e treguara, Kohlbergu tregon histori hipotetike për të kuptuar përplasjet në tru të pjesëmarrësit. Për këtë arsye, Kohlbergu ka përcaktuar zhvillimin moral të njerëz, fëmijë apo të rritur qofshin ata, duke u bazuar te përgjigjet e dhëna pyetjeve, të cilat i zhysnin në dilemë. (T.C.Milli Egitim, 2013, f. 13)

Sipas Onurit, (1979, f. 5) tensionimi i shfaqur përballë dilemës morale zgjidhet me anë të etapës më të lartë të zhvillimit moral. Në edukimin tradicional moral, kjo përbën stimulimin dhe shpërblimin e sjelljeve të matura dhe moskrijimin e mundësive të tensionimit. Por, dyshimi i krijuar në çdo etapë të zhvillimit të teorisë morale të Kohlbergut merr formën e kuptimeve morale të fëmijëve në fund të diskutimit. Nga ana tjetër, fëmijët në edukimin tradicional moral gjenden përballë formave të ndryshme të sjelljes në mes niveleve të zhvillimit. Në edukimin moral të Kohlbergut, çdo fëmijë arrin suksesin me anë të etapës së tij dhe të një etape më sipër.

Në materialin e përgatitur nga Ministria e Arsimit e Republikës Turke (2009, f. 13) është kërkuar nga persona të moshave dhe niveleve të ndryshme ekonomike të

japin vendimet e tyre në lidhje me gjendjen e treguar në histori të ndryshme, për të krijuar një ide rreth teorisë morale të Kohlbergut. Këtu nuk ka rëndësi nëse vendimi është i drejtë apo i gabuar. Të rëndësishme janë justifikimet dhe vlerësimet e përdorura nga personi gjatë gjetjes së zgjidhjes për problemin e treguar në histori.

Güngöri (1993, f. 53) transmeton se Piagetit e ka fokusuar teorinë e tij te fëmijët, veçanërisht bazuar te vëzhgimet e fëmijëve të tij. Megjithatë studimet e Piagetit mund të duken të largëta në periudhën e parë të psikologjisë moderne, bashkë me Kohlbergun është arritur në një pikë, ku çdo njeri mund të përfitojë diçka dhe mund të thotë mendimet e tij rreth teorive të tyre. Pika ku Kohlbergu ndahet me Piaget është përpjekja e Kohlbergut për të riparuar etapat e Piagetit dhe në të kundërt, te Piagetit zgjatja e zhvillimit moral shkon deri në moshën 16 vjeç.

Pika mbi të cilën duhet të qendrojmë është pikëpamja krejt ndryshe, të cilën e solli Kohlbergu. Ana më e rëndësishme e modelit të Kohlbergut është mënyra e ndikimit të dy elementëve në çdo periudhë. Në çdo periudhë mund të flasim për një pikëpamje të lidhur me mënyrën e marrjes së një vendimi moral. P.sh. në etapën e parë, fëmija është egocentrik dhe të gjitha situatat i sheh nga këndvështrimi i tij. Me rritjen e tij, ai fillon të përjetojë dilemën, se cila zgjedhje është më e mirë, zgjedhjet e bëra nën ndikimin e këndvështrimit të të tjerëve apo të bëra për shoqërinë. Të gjitha këto ndryshime mendohet të jenë të lidhura me zhvillimin njohës të personit dhe bazës biologjike. (T. C. Milli Egitim, 2013, f. 16)

Më parë, pohuam se Kohlbergu ka përdorur shembuj të ndryshëm në përcaktimin e nivelit të gjykimit moral të njerëzve dhe këta shembuj janë krijuar nga dilemat morale. Kohlbergu jep si shembull të historive të tij të krijuara nga dilemat, këta dy shembuj:

Shembulli 1: Një grua evropiane është buzë vdekjes për shkak të një sëmundjeje të rrallë kanceroze. Një farmacist, i cili jeton në qytetin e saj ka gjetur ilaçin, i cili mund ta shpëtojë, por kërkon 2000 dollarë për të, 10-fishi i vlerës së vërtetë të ilaçit. Bashkëshorti i gruas Heinzi arrin të mbledhë 1000 dollarë duke kërkuar borxh nga të afërmit. Heinzi i kërkon farmacistit t'ia shesë më lirë ilaçin për shkak të rëndimit të gjendjes së gruas së tij dhe t'i japë mundësinë e pagesës më vonë. “Këtë ilaç e kam gjetur unë, dua të fitoj para me të”, - i përgjigjet farmacisti, duke refuzuar kështu propozimin e tij. Pas kësaj Heinzi hyn fshehurazi në farmaci për të vjedhur ilaçin. Çfarë duhet të bënte bashkëshorti i gruas së sëmurë? Pse? (Kohlberg, 1963, f. 17)

Shembulli 2: Babai i Joenit i ka premtuar atij se do ta çojë në kamp, nëse fiton 50 dollarë. Por më pas ndryshon mendim dhe kërkon nga Joeni , që paratë e fituara t'ia dorëzojë atij. Ai e gënjen babanë e tij duke i thënë se kishte fituar vetëm 10 dollarë, ndërkohë që 40 dollarët e tjerë i kishte ndarë për kampin. Joeni i tregon vëllait të tij, Aleksit, për gënjeshtren dhe i tregon sasinë e parave të fituara. A duhet t'i tregojë Aleksi babait të tij për këtë? (Kohlberg, 1963, f. 12)

Sipas Kohlbergut, zgjedhjet me të cilat përballet personi mbi një problem moral janë radhitur si më poshtë: (T. C. Milli Eëitim, 2013, f. 14)

1. Të mbroresh sipas rregullave të vendosura (Të kesh të drejtë). P.sh. nuk duhet të vjedhësh ilaçin, sepse vjedhja nuk është një gjë e mirë.
2. Të mbroresh sipas pasojave materiale të vendimit.
3. Të mbroresh nga pikëpamja e përshtatshmërisë.

4. T'i japësh të drejtë vetes nga aspekti i vlerës së drejtësisë, barazisë dhe jetës.

Kohlbergu (1977, f. 54-55) thekson se çdo fëmijë bën pjesë në një nga 6 fazat, sipas pikëve të marra, përsa u përket cilësive morale. Këto faza apo nivele përfaqësojnë tri mënyra morale të menduari. Pikë së pari, individi fokusohet në zgjedhjen e rezultateve dobiprurëse të sjelljeve të tij. Më pas identifikohet me pritshmëritë shoqërore e ndërnjerëzore dhe në fund arrin në nivelin e përdorimit të principeve të tij morale. Ky proces zhvillimi pranohet si universal dhe i pandryshueshëm. Kohlbergu i përcakton kështu tre nivelet morale të mendimit dhe 6 fazat e zhvillimit:

3. 1. 4. 3. 1. Periudha paratradicionale (mendimi tradicional–*preconventional reasoning*)

Është qëndrimi egocentrik moral, në të cilin nuk perceptohet mirë ekzistenca e rregullave të përcaktuara nga të tjerët. Zgjat deri në moshën 10 vjeç, por ka raste kur edhe disa të rritur zotërojnë një konceptim të tillë moral.

Etapa e parë: prirja e dënimit dhe bindjes (periudha e moralit heteronom). Një njeri i këtij niveli i vlerëson ngjarjet sipas rezultateve. Vlerësimi i një sjelljeje si të drejtë apo të gabuar lidhet me këndvështrimet e të rriturve. Këtu bëhet fjalë për një lidhje të verbuar ndaj autoritetit. Nëse sjellja e fëmijës dënohet nga të rriturit, është e gabuar dhe nëse nuk dënohet, është e drejtë. Fëmijët i binden autoritetit për të shpëtuar nga dënimi fizik dhe material, qëndrojnë larg dëmtimit të njerëzve apo objekteve dhe si rrjedhojë respektojnë ato në duart e të cilëve qëndron fuqia. Sipas personave të kësaj periudhe Heinzi është fajtor. Policët e kapin dhe e dënojnë.

Ndërsa, Güngöri (1993, f. 53-54) pohon se vlerat morale mund të ndryshojnë sipas nevojave dhe këndvështrimeve të të gjithëve. Në sjelljen morale ekzistojnë ndershmëria, barazia dhe ndihma reciproke, por individ i sheh këta jo si besnikëri, mirënjohje apo drejtësi, por sipas dobive praktike.

Etapa e dytë: Priorja e interesit. Në këtë periudhë, rregullat zbatohen nëse plotësohen nevojat e personit. Shkakun e veprimit në mënyrë të drejtë e kënaq me interesat dhe dëshirat personale. Ata janë të ndërgjegjshëm edhe për nevojat e të tjerëve, por përsëri mbajnë në plan të parë kërkesat e tyre. Kur individ e kupton që çdo njeri shikon interesin e vet, fillon të mendojë interesin e tij duke parë se çfarë përfiton nga veprimi. Veprimi më i rëndësishëm këtu është të bëhet një shitblerje e drejtë. Ata bëjnë shitblerje të drejta të bazuara në ndryshimin objektiv. Sipas personave të kësaj etape, Heinzi është i pafajshëm, ka vjedhur për bashkëshorten e tij. Njeriu duhet të sillet kështu për burrin \ gruan e tij, sepse edhe grua \ burri do të vepronte në të njëjtën mënyrë për të.

3. 1. 4. 3. 2. Periudha tradicionale (mendimi tradicional– *conventional reasoning*)

Fëmijët e kësaj periudhe shfaqin dëshirën për t'iu përshtatur pritshmërive të njerëzve të tjerë, ose pritshmërive të përgjithshme shoqërore. Gjykimi moral dhe paragjykimet bëhen sipas rregullit shoqëror. Mendohet rreth efektit apo ndikimit të një sjelljeje në rregullin shoqëror. Personi është i vetëdijshëm për pritshmëritë, ndjenjat e përbashkëta, të cilat dalin para interesave personale. Pjesa më e madhe e njerëzve janë pjesë e kësaj etape.

Etapa e tretë: Përshtatshmëria mes njerëzve. Qëllimi i kësaj etape është të bëhesh i mirë. Këtu shfaqet dëshira për të qenë një njeri i mirë para vetes dhe para

njerëzve të tjerë. Ata lumturohen kur sillen mirë, apo ndihmojnë të tjerët. Është e drejtë të veprohet sipas pritshmërive të njerëzve të afërt, si: vëllezërit, fëmijët apo miqtë, sepse individ i kërkon miratimin e grupit brenda të cilit ndodhet. Për këtë arsye, ata sillen sipas rregullave të grupit. Nuk dalin jashtë grupit për hir të mbrojtjes së sigurisë, lidhjes dhe mirënjohjes. Sipas personave të kësaj etape Heinz i është fajtor, sepse shoqëria nuk i pranon ose ndryshe i kritikon personat që bëjnë vjedhje.

Etapa e katërt: Ligji dhe prirja për të vendosur rregull. Rregulli i vendosur social pranohet pa u kritikuar. Qëllimi i kësaj etape është mbrojtja e rregullit shoqëror. Në të njëjtën kohë, drejtësia është në shërbim të shoqërisë, grupit dhe institucioneve. Për funksionimin e duhur të institucioneve dhe parandalimin e shkatërrimit të sistemit, ndërgjegjja jonë duhet të na zgjojë, të na nxisë me pyetjen “çfarë do të ndodhte nëse të gjithë veprojnë kështu?”. Diskutimi i ligjeve apo rregullit shoqëror është si një tentativë për zhdukjen e tyre, për një person të kësaj etape. Zotëron mendimi “mbyll sytë dhe bëj detyrën time”. Sipas etapës së marrëveshjes shoqërore dhe personave që marrin pjesë, Heinz i është fajtor, sepse ka vepruar në kundërshtim me ligjet. Ligjet mundësojnë mbrojtjen e rregullit shoqëror dhe Heinz i sjelljen e tij ka prishur rregullin shoqëror.

3. 1. 4. 3. 3. Periudha pastradicionale (periudha e mendimit pastradicional–*postconventional reasoning*).

Në këtë periudhë mbrohen rregullat morale, vlerat universale dhe marrëveshjet ligjore. Ky nivel i cilësuar si një nivel i pavarur nga grupet apo njerëzit që vendosin principet dhe vlerat morale mund të arrihet në adoleshencë ose nuk arrihet asnjëherë.

Kohlbergu thekson se mosha 14 vjeç është limiti, ose niveli i fundit i arritjes së periudhës pastradicionale. Studimet e zhvilluara kanë treguar se jo të gjithë të rriturit mund ta arrijnë këtë nivel pastradicional. (T. C. Milli Eëitim, 2013, f. 16)

Etapa e pestë: Prirja e marrëveshjes sociale. Në këtë etapë, njeriu u përshtatet principeve të pranuar, të analizuara nga ana e shoqërisë duke vëzhguar dobinë shoqërore dhe të drejtat e njeriut. Rregullat mbrohen edhe nëse u bien ndesh rregullave të grupit. Këtu arrihet përshtatja me rregullat e vendosura për të parandaluar papajtueshmëritë shoqërore. Personi beson se ligjet mund të ndryshojnë për t'i sjellë më shumë të mira shoqërisë bashkë me pranimin e mendimit ligjor. Ligji dhe rregulli është vendosur për të mirën e njeriut. Këtu shfaqet përpjekja për të gjykuar konceptet si jeta dhe liria në ndryshimin e një ligji, i cili nuk i shërben njeriut. Sipas personave të kësaj etape, Heinzi është fajtor, sepse ka kundërshtuar marrëveshjen e vendosur nga shoqëria. Krahas kësaj, njerëzit janë të detyruar të respektojnë sendet private të njëri-tjetrit.

Etapa e gjashtë: Prirja e parimeve morale universale. Kjo është pika e fundit që mund të arrihet në zhvillimin moral. Personi ndjek gjurmët etike të zgjedhura nga vetë ai dhe pasqyron sjellje të përshtatshme me rregullat e përgjithshme morale. Në këtë periudhë, e rëndësishme është sjellja e përshtatshme me parimet morale të zhvilluara nga ndërgjegjja e vetë personit dhe jo sjellja e përshtatshme me rregullat dhe ligjet e rregullit shoqëror të drejtë ose të gabuar. Këto parime përfshijnë parimet e drejtësisë, të të drejtave të njeriut dhe të respektit ndaj njeriut. Njeriu jeton në bazë të ligjeve dhe rregullave. Ai përpiqet të arrijë të mirën dhe të bukurën universale. Sipas personave të kësaj etape, Heinzi është i pafajshëm, sepse jeta e njeriut është më e rëndësishme se çdo gjë tjetër. Mund të bëhet edhe vjedhje, nëse bëhet fjalë për jetën e një njeriu.

3. 1. 4. 3. 4. Vlerësimi i teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut

Megjithëse Kohlbergu ka nxjerrë në pah një pikëpamje morale, duke pranuar si bazë teorinë e Piagetit dhe ka arritur ta realizojë atë në shtete të ndryshme, ai është përballur me shumë kritika. Këto kritika mund t'i përmbledhim si më poshtë:

1. Sipas Ekşiut (Ekshiut), (2006, f. 31) megjithëse Kohlbergu është munduar të bëjë studime në vende të ndryshme, si: Meksikë, Turqi, Angli dhe Tajvan për të treguar universalitetin e teorisë së tij, ai është kritikuar për pasqyrimin e traditës së filozofisë perëndimore paratradicionale dhe mospasqyrimin e ndryshimeve kulturore.

2. Nga ana tjetër, në teorinë e zhvillimit moral të Kohlbergut (1977, f. 54) vihet re një strukturë, e cila ndjek një nga një etapat e zhvillimit. Për të kaluar në një etapë më të lartë duhet të përvetësohet struktura mendimore e një niveli më poshtë. Në botë gjenden struktura shumë të ndryshme kulturore. Kalimi ndërmjet etapave nuk mund të japë të njëjtin rezultat në çdo kulturë.

3. Zhvillimi i studimeve të Kohlbergut vetëm mbi meshkujt është bërë objekt kritike. Më pas, duke vepruar sipas rregullit të mospërgjithësimin të femrave janë krijuar teori të reja. (Narvaez, 2005, f. 121-124)

4. Realizimi i teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut në jetën reale nuk është shumë i lehtë.

5. Një tjetër pikë e kritikuar në teorinë e Kohlbergut është lidhja mes ndryshimit të mendimit moral me sjelljen morale. Sipas Özerit, (2004, f. 81) megjithëse neve na jep njohuri rreth mënyrës së zhvillimit të mendimit moral kritikant

kanë ardhur, përse i përket mospasqyrimit përherë të mendimit moral në sjellje. Studiuesit, të cilët e mbrojnë këtë mendim mbështesin gjykimin “njeriu mund të sillet ndryshe, kur pyetet për mendimin e tij dhe ndryshe kur pyetet për realizimin e mendimit”.

6. Sipas Clousës, (2000, f. 725) Kohlbergu është kritikuar edhe për mosvlerësimin e duhur të ndjenjave dhe emocioneve gjatë zhvillimit moral. Sipas këtyre kritikave, ai nuk duhet të nënvlerësojë ndjenjat. Nuk është e mundur ekzistenca e një mendimi moral ku nuk llogariten ndjenjat. p.sh. gëzimi ndaj fatkeqësisë që mund t’i ndodhë dikujt tregon një mangësi, përse i përket pjekurisë morale, pa marrë parasysh se çfarë përgjigjeje mund t’i japë ai person.

Sipas Clousës, (2000, f. 724) Kohlbergu është kritikuar në tregimet e krijuara prej tij për përcaktimin e zhvillimit moral, sepse shprehet se te individë të cilët përdorin gjuhë të rrjedhshme dhe të mirë marrin rezultate më të mira se ato që kanë një aftësi më të ulët shprehjeje.

KAPITULLI IV

ANALIZA EMPIRIKE

Bazuar në hipotezën kryesore dhe në tematikën e këtij studimi, në këtë pjesë janë dhënë tabela që përmbajnë të dhëna statistikore. Si fillim është bërë një vlerësim i përgjithshëm i rezultateve të gjykimit moral të studentëve ku janë realizuar anketat në Universitetin e Tiranës, “Aleksander Moisiut” Durrës, “Aleksandër Xhuvanit” Elbasan, “Luigj Gurakuqit” Shkodër dhe “Fan S. Nolit” Korçë. Jemi munduar të pasqyrojmë nivelin e moralit të studentëve të universiteteve shqiptare bazuar në qasjen e gjykimit moral të Kohlbergut. Më pas janë analizuar pikat e gjykimit moral në mënyrë krahasimore sipas universiteteve dhe rezultatet e këtij studimi janë pasqyruar në tabela.

Me qëllim analizimin e ndikueshmërisë që kanë variablat e pavarur që përmbajnë të dhënat personale të studentëve te niveli i qasjes së gjykimit dhe vlerave morale në analizimin e anketave, për çdo variabël të pavarur janë dhënë tabela që përmbajnë numrin e studentëve, pikët e gjykimit dhe shmangiet standarde.

Të dhënat personale që përbëhen nga variablat e pavarur të studentëve janë pasqyruar në këtë mënyrë në tabelë: (N) numri i studentëve, (%) të dhëna në përqindje, (X) të dhëna mbi nivelin e gjykimit moral, (STD) shmangie (devijime) standarde.

P pikët, kur formojmë gjykimet morale si rrjedhojë e renditjes së pikëve të rëndësishme të inventarit të gjykimeve morale tregojnë se përkon me fazën e pestë dhe të gjashtë (niveli përtej traditës) ashtu siç është përcaktuar edhe në pjesën e metodës së këtij studimi. Pikët e fazës së tretë dhe të katërt tregojnë nivelin e gjykimit moral të “nivelit tradicional”.

Me qëllim matjen e përshtatshmërisë të zhvillimit moral të periudhës tradicionale dhe periudhës pastradicionale të studentëve të universiteteve të Shqipërisë janë përfshirë në këtë vlerësim pikët P të përfutuara si rezultat i mbledhjes së pikëve të fazës 5A, 5B dhe fazës së 6- të si dhe pikët e periudhës tradicionale të përfutuara si rezultat i mbledhjes së pikëve të fazës së 3-të dhe fazës së 4-t.

Sipas Restit, (1986, f. 4.4) disa studiues i kanë ndarë lëndët në dy grupe: lëndë që kanë rezultat të pikës P me 50% ose më shumë dhe lëndë që kanë rezultat të pikës P me 49% ose më pak. Këto grupe janë rindarë në nëngrupe, të cilat përbëjnë gjykimin moral, kryesisht mbi bazën e konsideratave parimore morale dhe nëngrupe që s’e bëjnë gjykimin moral në këtë mënyrë.

Sipas Restit, (1986, f. 4.1) përdorimi i rezultatit të pikës P me 50%, si pikëprerje është teorikisht interesante. Shumë nga studimet nuk do të gjejnë lëndë me rezultat mbi 50%. Në fakt, në shembujt tanë prej 1080 lëndësh, mesatarja e % të pikës P ishte vetëm 35%. Në eksperiencën tonë të ndarjes së rezultateve të pikës P dhe D, rekomandoj që pikëprerja e dhënë në tabelë të përdoret për formimin e grupeve nga rezultatet DIT. Nëse kërkuesit përdorin pikëprerje të përbashkëta, atëherë krahasimi midis studimeve do të ishte i mundur, sepse përkufizimi i zhvillimit “të ulët” dhe “të lartë” në gjykimin moral do të ishte i mundur.

Limitet minimale dhe maksimale të pikës P të përgatitura sipas dy grupeve të ilustrimeve të Restit (1979, f. 6.3) janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: Pikëprerjet e rekomanduara në treguesit e % të pikave P dhe D

Rezultati i	Ndarja 1	Ndarja 2	Ndarja 3	Ndarja 4
% të pikës P	0-22	23-24	35-46	47 e sipër
% të pikës D	Deri në 13	14-20	21-27	28 e sipër

Tabela7: Pikëprerjet e rekomanduara në treguesit e % të pikave P dhe D

Rezultati i	Niveli më i ulët	Niveli i mesëm	Niveli i lartë
% të pikës P	Deri në 27	28-41	42 e sipër
% të pikës D	Deri në 16	17-25	26 e sipër

4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve të universiteteve në përgjithësi

Hipoteza 1 : Sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut, konceptimet morale të studentëve në vija të përgjithshme janë në nivelin tradicional.

Tabela8: Niveli i pjekurisë morale të studentëve të universiteteve në përgjithësi

Universiteti	Numri i studentëve	Mesatarja e pikëve	Devijimi standart
Total	1799	23.84	9.95

Për të vërtetuar saktësinë e kësaj hipoteze në 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë është llogaritur niveli i pjekurisë morale dhe devijimet standarte të 1851 studentëve të zgjedhur me metodën Random. Sipas testit të përcaktimit të vlerave të Restit, ata që i janë përgjigjur gabim testit dhe në një fletëpërgjigje, pikët M të studentëve janë 8 ose më shumë nuk përfshihen në këtë vlerësim. Kemi 52 studentë të papërfshirë në këtë vlerësim. Si rrjedhojë, është llogaritur niveli i pjekurisë morale dhe devijimet standarde të 1799 studentëve dhe pikët e gjykimeve të vlerave morale të studentëve të këtyre pesë universiteteve janë 23.84.

4. 2. Pikët e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit të pjekurisë morale

Tabela9: Pikët e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit të pjekurisë morale

Niveli	Numri i studentëve	Përqindja e studentëve (%)	Mesatarja e pikëve	Devijimi standart
Totali i nivelit tradicional	1777	98.78	23.48	9.47
Totali i nivelit pastraditional	22	1.22	52.61	3.81

Në testin e përcaktimit të vlerave, ku në vlerësim morën pjesë 1799 persona, 98.78% e studentëve bëjnë pjesë në nivelin tradicional të qasjes morale. Pjesa e mbetur, 1.22% e studentëve bëjnë pjesë në nivelin pastraditional.

4. 3. Variablat e pavarur që mendohet se kanë ndikim në formësimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve

Hipoteza 2: Në procesin e zhvillimit moral të studentëve variablat e pavarur si; *gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, qëndrimet e prindërve ndaj fëmijëve, niveli arsimor i prindërve, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, lidhja e prindërve me fëmijë dhe lidhja e studentëve me fëmijë, a i kanë prindërit në jetë apo jo, vendi ku studenti ka kaluar pjesën më të madhe të tij kanë ndryshime më të theksuara se variablat e tjerë. Përfundimet e përfutuara sipas këtyre variablave të pavarur janë si më poshtë:*

4. 3. 1. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër

Tabela 10: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër

Gjinia	N Total	% Total	X Total	Std Total
Femër	1461	80.66	23.87	9.97
Mashkull	338	18.45	23.71	9.87
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj hipoteze janë zgjedhur studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë, me anë të metodës Random. Nga 1851 studentë, 52 prej tyre janë lënë jashtë vlerësimit për shkak të llogaritjeve të gabuara dhe si rrjedhojë e llogaritjes së niveleve të pjekurisë morale të 1799 studentëve është parë se edhe me një diferencë të vogël, studentet paraqitën një mesatare prej 23,87, ndërsa studentët arritën mesataren 23,71.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfuara janë pasqyruar në tabelën 11.

Tabela 11: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	8,501168	2	4,250584	0,042816	0,958089	3,000735
Within Groups	178299,4	1796	99,27583		P >05 (parëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i parëndësishëm midis niveleve të

pjekurisë morale të studentëve sipas ndarjeve mashkull-femër. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se *“niveli i pjekurisë morale të studentëve vajza është më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve djem”*.

Pas analizimit një nga një të universiteteve, është vërtetuar se te të gjitha universitetet, përveç universitetit “Aleksandër Moisiu”, niveli i pjekurisë morale të studenteve femra është më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve meshkuj. Në tabelën e mëposhtme kjo gjendje është paraqitur në mënyrë më të hollësishme.

4. 3. 1. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve, sipas shpërndarjes në universitete të vajzave dhe të djemve, në universitetet e studiuara

Tabela 12: Niveli i pjekurisë morale të studentëve, sipas shpërndarjes në universitete të vajzave dhe të djemve, në universitetet e studiuara

Gjinia	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tirana	
	No.of Subj.	P average	No.of Subj.	P average	No.of Subj.	P average	No.of Subj.	P average	No.of Subj.	P average
F	296	23.13	305	25.10	176	22.01	335	24.27	343	23.97
M	40	25.59	96	25.00	99	21.75	57	23.51	50	23.43
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të djemve shfaqen më të larta se ato të vajzave. (25,59-23,13). Në universitetet e tjera pikët shfaqen kështu: Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët e vajzave janë 25,10, ndërsa të djemve 25.00. Në universitetin ‘Fan Noli’, pikët e vajzave ishin 22.01 ndërsa të djemve 21,75. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët e vajzave ishin 24,27, ndërsa të djemve 23,51. Në universitetin e Tiranës, pikët e vajzave ishin 23,97, ndërsa të djemve 23,43.

Nëse bëhet një krahasim gjinor midis universiteteve, studentet vajza të universitetit “Aleksandër Xhuvani” paraqesin një nivel më të lartë pjekurie morale se studentet e universiteteve të tjera. Pikët e nivelit të pjekurisë morale të studenteve vajza të universitetit “Aleksandër Xhuvani” janë 25,10. E studenteve vajza të universitetit “Luigj Gurakuqi” janë 24,27. E studenteve vajza të universitetit të Tiranës janë 23,97 dhe e studentëve vajza të universitetit “Aleksandër Moisiu” janë 23,13.

Në krahasimin e bërë ndërmjet pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve djem është vërtetuar se niveli më i lartë i pikëve shfaqet te studentët e universitetit “Aleksandër Moisiu”. Pikët e nivelit të nivelit të pjekurisë morale të studentëve djem të universitetit “Aleksandër Moisiu” janë 25,59. Të studentëve të universitetit “Aleksandër Xhuvani” janë 25,00. Të studentëve të universitetit “Luigj Gurakuqi” janë 23,51. Të studentëve të Universitetit të Tiranës janë 23,43 dhe të studentëve të universitetit “Fan Noli” janë 21,75.

4. 3. 2. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës

Tabela 13: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës

Mosha	N Total	% Total	X Total	Std Total
17	14	0.78	18.21	6.22
18	183	10.17	23.72	9.15
19	439	24.40	22.86	9.69
20	472	26.24	23.56	9.47
21	386	21.46	24.05	10.22
22	173	9.62	24.17	10.55
23	132	7.34	27.84	11.26
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Kur analizojmë nivelin e pjekurisë morale të studentëve sipas moshës përgjithësisht me rritjen e moshës vërehet një rritje edhe në nivelin e pjekurisë morale të tyre. Niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 23-vjeçare me 27.84 pikë, e pason grupmosha 24-vjeçare me 24.17 dhe në fund grupmosha 21-vjeçare me 24.05 pikë. Mes grupmoshave të ndryshme, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 17-vjeçare me 18.21 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas moshës është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përftuara janë pasqyruar në tabelën 14.

Tabela 14: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas moshës

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	3057,461	6	509,5768	5,210609	0.000025	2,103634
Within Groups	175250,4	1792	97,796		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas moshës. Ky rezultat i përfutur vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se *“niveli i pjekurisë morale të studentëve që janë në moshë më të madhe është më i lartë”*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas moshës dhe universitetit në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 2. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës dhe universitetit

Tabela15: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas moshës dhe universitetit

Moshë	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
17	2	25.00	4	16.63	0	0.00	7	17.64	1	15.00
18	32	21.63	30	25.00	31	22.50	39	22.97	51	25.61
19	123	24.21	28	25.64	102	20.73	67	23.43	119	22.29
20	90	24.28	83	23.23	85	22.35	141	24.00	73	23.58
21	51	22.82	91	22.81	44	22.61	77	25.48	123	25.09
22	33	20.91	74	24.78	12	28.13	31	25.68	23	22.78
23	5	22.00	91	29.50	3	18.33	30	24.60	3	29.17
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Nëse do analizonim nivelin e pjekurisë morale të studentëve midis universiteteve do të arrihej në këto rezultate: Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 17-vjeçare me 25.00 pikë, ndërsa niveli më i ulët i pjekurisë morale i përket grupmoshës 22-vjeçare me 20.91 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 23-vjeçare me 29.50 pikë, ndërsa niveli më i ulët i pjekurisë morale i përket grupmoshës 17-vjeçare me 16.53 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 22-vjeçare me 28.13 pikë, ndërsa niveli më i ulët i pjekurisë morale i përket grupmoshës 23-vjeçare me 18.13 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 22-vjeçare me 25.68 pikë, ndërsa niveli më i ulët i pjekurisë morale i

përket grupmoshës 17-vjeçare me 17.64 pikë. Në Universitetin e Tiranës, niveli më i lartë i pjekurisë morale i përket grupmoshës 23-vjeçare me 29.17 pikë, ndërsa niveli më i ulët i pjekurisë morale i përket grupmoshës 17-vjeçare me 15.00 pikë.

Kur analizojmë nivelin e pjekurisë morale të studentëve sipas moshës midis universiteteve vërejmë se pikët më të larta i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” të grupmosha 23-vjeçare me 29.50 pikë, më pas Universiteti i Tiranës të grupmosha 23-vjeçare me 29.17 pikë dhe më pas universiteti “Fan S. Noli” të grupmosha 22-vjeçare me 28.13 pikë. Niveli më i ulët i pjekurisë morale i përket Universitetit të Tiranës të grupmosha 17-vjeçare me 15.00 pikë, më pas universitetit “Aleksandër Xhuvani” të grupmosha 17-vjeçare me 16.63 pikë dhe më pas Universitetit “Luigj Gurakuqi” të grupmosha 17-vjeçare me 17.64 pikë.

4. 3. 3. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike

Tabela 16: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike

Viti i studimit	N Total	% Total	X Total	Std Total
I parë	862	47.92	23.40	9.98
I fundit	937	52.08	24.24	9.93
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. 52 prej tyre janë lënë jashtë vlerësimit për shkak të llogaritjeve të gabuara. Nga vlerësimi i niveleve të pjekurisë morale të 1799 studentëve është arritur në këtë përfundim: Mes niveleve të pjekurisë morale të studentëve të viteve të ndryshme ekzistojnë ndryshime të dukshme. Ndërkohë që niveli i pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë është 23.40 pikë, i studentëve të vitit të fundit është 24.24 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfuara janë pasqyruar në tabelën 17.

Tabela17: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	48,35533	1	48,35533	0,487461	0,485153	3,846639
Within Groups	178259,5	1797	99,19841		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërimit se *“qasja e gjykimit moral dhe vlerave të studentëve lidhet me procesin edukativo-arsimor të universitetit dhe nivelet e pjekurisë morale të studentëve të vitit të fundit janë më të larta se nivelet e pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë”*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 3. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike në universitetet e studiuara

Tabela 18: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas viteve akademike universitetet e studiuara

Viti i Studimit	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
I parë	137	22.97	197	24.92	144	21.45	194	23.95	200	23.03
I fundit	199	23.24	204	25.23	133	22.63	198	24.36	193	24.81
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Sipas vlerësimit të bërë, duke u bazuar në klasifikimin e klasave ku gjenden studentët, është arritur në këtë përfundim: Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë të universitetit “Aleksandër Moisiu” është 22,97, i studentëve të vitit të fundit është 23.24 pikë. Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë të universitetit “Aleksandër Xhuvani” është 24.92 pikë, ndërsa i studentëve të vitit të fundit është 25.23 pikë. Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë të universitetit “Fan Noli” është 21.45, ndërsa i studentëve të vitit të fundit është 22.63 pikë. Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë të universitetit “Luigj Gurakuqi” është 23.95 pikë, ndërsa i studentëve të vitit të fundit është 24.36 pikë. Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të vitit të parë të studentëve të universitetit të Tiranës është 23.03 pikë, ndërsa i studentëve të vitit të fundit është 24.81 pikë.

Nëse bëjmë një krahasim mes universiteteve arrijmë në këtë përfundim: Nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale të viteve të para e arrin universiteti “Aleksandër Xhuvani me 24.92 pikë, pasohet nga universiteti “Luigj Gurakuqi” me

23.95 pikë, më pas Universiteti i Tiranës me 23.03 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 22.97 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 21.45 pikë. Nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale të studentët e viteve të fundit e arrin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25.23 pikë, pasohet nga universiteti i Tiranës me 24.81 pikë, më pas universiteti ‘Luigj Gurakuqi ‘ me 24.36 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.74 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 22.63 pikë.

4. 3. 4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve

Tabela 19: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve

Nëna dhe babai	N Total	% Total	X Total	Std Total
Bashkë	1750	97.28	23.91	10.05
Të martuar, por jetojnë të ndarë	17	0.94	20.76	4.17
Të ndarë	32	1.78	21.47	5.63
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Të dhënat statistikore të arritura nga anketa e zhvilluar me qëllim përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërvetregojnë se pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që i kanë prindërit bashkë janë 23.91, të atyre që i kanë prindërit të divorcuar janë 21.47, ndërsa të atyre që nuk e kanë nënën dhe babain të divorcuar, por jetojnë të ndarë janë 20.76.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 20.

Tabela 20: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	350,0691	2	175,0345	1,766497	0,171227	3,000735
Within Groups	177957,8	1796	99,08565		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se *“niveli i pjekurisë morale të studentëve që prindërit u jetojnë bashkë është më i lartë”*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes civile të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 4. 2. Niveli i pjekurisë morale dhe gjendjes civile të prindërve në

universitetet e studiuara

Tabela 21: Niveli i pjekurisë morale dhe gjendjes civile të prindërve në universitetet e studiuara

Nëna dhe babai	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Bashkë	326	23.50	392	25.12	273	22.07	376	24.28	383	23.98
Të martuar por jetojnë të ndarë	7	22.50	3	20.00	0	0.00	3	17.50	4	20.75
Të ndarë	3	16.50	6	25.00	4	18.75	13	22.12	6	20.83
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve rreth nivelit të pjekurisë morale sipas gjendjes civile të prindërve është arritur në këto përfundime: Në universitetin “Aleksandër Moisiu” pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale u përkasin studentëve që i kanë prindërit bashkë me 23.50 pikë, e pasojnë atë studentët që nuk i kanë prindërit të divorcuar, por jetojnë të ndarë me 22.50 pikë, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që i kanë prindërit të divorcuar janë 16.50. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale u përkasin studentëve që i kanë prindërit bashkë me 25.12 pikë, e pasojnë atë studentët që i kanë prindërit të divorcuar me 25.00 pikë dhe në fund renditen studentët që nuk i kanë prindërit të divorcuar, por jetojnë të ndarë me 20.00 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale u përkasin studentëve që i kanë prindërit bashkë me 22.07 pikë, e pasojnë atë studentët që nuk i

kanë prindërit të divorcuar, por jetojnë të ndarë, duke qenë se nuk ka të dhëna nuk janë përfshirë në këtë vlerësim, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale studentët që i kanë prindërit të divorcuar janë 18.75 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi” pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që i kanë prindërit bashkë me 24.28 pikë, e pasojnë atë studentët që i kanë prindërit të divorcuar me 22.12 pikë dhe në fund renditen studentët që nuk i kanë prindërit të divorcuar, por jetojnë të ndarë me 17.50 pikë. Në universitetin e Tiranës, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale u përkasin studentëve që i kanë prindërit bashkë me 23.98 pikë, e pasojnë atë studentët që i kanë prindërit të divorcuar me 20.83 pikë dhe në fund renditen studentët që nuk i kanë prindërit të divorcuar, por jetojnë të ndarë me 20.75 pikë.

4. 3. 5. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve

Tabela 22: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve

Cili është raporti që keni me familjen (Babai)	N Total	% Total	X Total	Std Total
Autoritar	608	33.80	23.30	9.85
Indiferent	87	4.84	22.50	7.02
Tolerant	1104	61.37	24.24	10.19
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Tabela 23: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave

Cili është raporti që keni me familjen (Nëna)	N Total	% Total	X Total	Std Total
Autoritare	268	14.90	22.65	9.96
Indiferente	94	5.23	22.55	9.02
Tolerante	1437	79.88	24.15	9.99
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. Nga këta, 52 prej tyre nuk janë vlerësuar për shkak të llogaritjeve të gabuara. Nga vlerësimet e 1799 studentëve është arritur në përfundimin se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsiderojnë qëndrimin e prindërve si tolerant, është më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsiderojnë qëndrimin e prindërve si autoritar apo indiferent. Ndërkohë që niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e shikonin babain e tyre si tolerant ishte 24.24 pikë, i atyre që e shihnin babain si indiferent ishte 22.50 pikë, i atyre që e shihnin babai si autoritar ishte 23.30 pikë. Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të cilët e shikonin nënën e tyre si tolerante ishte 24.15, i atyre që e shihnin si indiferente ishte 22.55 pikë dhe i atyre që e shihnin si autoritare ishte 22.65 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përftuara janë pasqyruar në tabelën 24-25.

Tabela 24: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	512,4824	2	256,2412	2,58842	0,075419	3,000735
Within Groups	177795,4	1796	98,99522		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Tabela 25: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	668,8237	2	334,4118	3,381033	0,034229	3,000735
Within Groups	177639,1	1796	98,90817		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këto tabela është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërimit se *“nivelet e pjekurisë morale të studentëve të cilët e konsideronin qëndrimin e prindërve të tyre si tolerant janë më të larta se nivelet e pjekurisë morale të studentëve të cilët e konsideronin qëndrimin e prindërve si autoritar apo indiferent.”*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 5. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të

prindërve në universitetet e studiuara

Tabela 26: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të baballarëve në universitetet e studiuara

Cili është raporti që keni me familjen (Babai)	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Autoritar	131	22.94	118	24.34	113	22.07	149	23.43	97	23.75
Indferent	5	19.40	17	23.09	11	19.32	38	23.30	16	23.13
Tolerant	200	23.83	266	25.53	153	22.18	205	24.85	280	24.00
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Tabela 27: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas qëndrimeve të nënave në universitetet e studiuara

Cili është raporti që keni me familjen (Nëna)	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Autoritare	61	23.45	51	22.77	37	22.77	76	22.10	43	22.24
Indiferente	13	22.46	21	20.95	20	22.50	27	24.74	13	20.77
Tolerante	262	23.46	329	25.70	220	21.85	289	24.65	337	24.23
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Rezultatet statistikore në lidhje me nivelet e pjekurisë morale të studentëve në varësi me qëndrimet e mbajtura nga prindërit janë si më poshtë: ndërkohë që niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin qëndrimin e babait si tolerant tek universiteti “Aleksandër Moisiu” ishte 23.83 pikë. Niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin qëndrimin e babait të tyre indiferent ishte 19.40 dhe ato që e konsideronin qëndrimin e babait të tyre si autoritar paraqitën një nivel

pjekurie morale prej 22.94 pikësh. Tek universiteti “Aleksandër Xhuvani”, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin qëndrimin e babait të tyre si tolerant ishte 25.53 pikë, ato që e konsideronin indiferent janë 23.09 dhe ato që e konsideronin autoritar ishte 24.34 pikë. Në universitetin “Fan Noli”, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin qëndrimin e babait tolerant ishte 22.18 , ato të cilët e konsideronin indiferent ishte 19.32 pikë dhe ato që e konsideronin si autoritar paraqiten 22.07 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin si tolerant qëndrimin e babait të tyre ishte 24.85, ato që e konsideronin si indiferent ishte 23.30, ndërsa ata që e konsideronin si autoritar ishte 23.43. Tek universiteti i Tiranës, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e konsideronin si tolerant qëndrimin e babait të tyre ishte 24.00, ata që e konsideronin si indiferent ishte 23.13 dhe ata që e shihnin si autoritar ishte 23,75 pikë.

Niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve të universitetit “Aleksandër Moisiu”, të cilët e shikonin si tolerant qëndrimin e nënës së tyre ishte 23.46, ata që e shihnin si indiferent ishte 22.46 pikë dhe ata që e shihnin si autoritar ishte 23.45 pikë. Tek universiteti “Aleksandër Xhuvani”, niveli i pikëve të pjekurisë morale për studentët, të cilët e shihnin babain si tolerant ishte 25.70, ata që e shihnin nënën si indiferente ishte 20.95 pikë dhe ata që e shihnin nënën si autoritare paraqitën 22.77 pikë. Tek universiteti “Fan Noli”, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e shihnin babain e tyre si tolerant ishte 21.85 pikë, ata që e shihnin nënën si indiferente paraqitën 22.50 pikë dhe ato që e shihnin nënën si autoritare paraqitën 22.77 pikë. Tek universiteti “Luigj Gurakuqi”, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët e shihnin babain e tyre si tolerant ishte 24.65 pikë, ata që e shihnin nënën si indiferente ishte 24,74 pikë dhe ato që e shihnin si autoritare paraqitën 22.10

pikë. Tek universiteti i Tiranës, niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e shihnin nënën e tyre si tolerante ishte 24.23 pikë, ata që e shihnin si indiferente ishte 20.77 pikë dhe të ata që e shihnin si autoritare ishte 22.24 pikë.

Nëse bëjmë një krahasim mes universiteteve përsa i përket lidhjes mes pjekurisë morale të studentëve me qëndrimet e prindërve ndaj tyre rezultatet janë si më poshtë: nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale e marrin studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të cilët e shohin babain e tyre si tolerant me 25.53 pikë, më pas vjen universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.85 pikë, Universiteti i Tiranës me 24.00 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23,83 pikë dhe universiteti “Fan Noli” me 22.18 pikë.

Nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale e marrin studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të cilët e konsideronin qëndrimin e nënës së tyre si tolerant, me 25.70 pikë, më pas vjen universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.65 pikë, universiteti i Tiranës me 24.23 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.46 pikë dhe universiteti “Fan Noli” me 21.58 pikë.

Tabela 28: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, sipas nivelit arsimor të baballarëve

Niveli i arsimimit të babait tuaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Nuk di shkrim-lexim	21	1.17	20.24	4.19
Ka mbaruar vetëm filloren	195	10.84	23.08	9.85
Ka mbaruar të mesmen	1215	67.54	23.77	9.93
Ka mbaruar universitetin	368	20.46	24.67	10.26
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Tabela 29: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave

Niveli i arsimimit të nënes suaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Nuk di shkrim-lexim	38	2.11	19.37	8.43
Ka mbaruar vetëm filloren	206	11.45	23.68	10.48
Ka mbaruar të mesmen	1268	70.48	23.65	9.87
Ka mbaruar universitetin	287	15.95	25.40	9.89
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e këtij punimi janë zgjedhur 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë 52 persona për shkak të llogaritjeve të gabuara dhe si rrjedhojë janë analizuar nivelet e pjekurisë morale të 1799 studentëve. Në fund është vënë re një lidhje mes nivelit arsimor të prindërve me nivelin e pjekurisë morale të studentëve. Studentët të cilët vinin nga familje me prindër me nivel të lartë akademik paraqesin nivele më të larta të pjekurisë morale sesa studentët me prindër me nivel të ulët akademik. Niveli i pjekurisë morale të studentëve, që i kanë nënat me arsim të lartë ishte 25,40, ndërsa i studentëve, që i kanë nënat me arsim të mesëm ishte 23,65. Niveli i pjekurisë morale i studentëve, që i kanë nënat me arsim fillor ishte 23,68 dhe niveli i pjekurisë morale i atyre që i kanë nënat analfabete ishte 19.37. Studentët, që i kanë baballarët me arsim të lartë, pikët e nivelit të pjekurisë morale ishin 24,67. Studentët, që i kanë baballarët me arsim të mesme, niveli i pikëve ishte 23,77. Studentët, që i kanë baballarët me arsim fillor ishte 23,08 dhe të studentët, që i kanë baballarët analfabetë ishte 20.24.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfuara janë pasqyruar në tabelën 30-31.

Tabela 30: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të baballarëve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	646,1363	3	215,3788	2,176073	0,088948	2,60986
Within Groups	177661,8	1795	98,97591		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Tabela 31: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	1511,596	3	503,8654	5,115709	0,001588	2,60986
Within Groups	176796,3	1795	98,49376		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këto tabela është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve. Ky rezultat i përfutur vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se *“studentët e familjeve me prindër me një nivel më të lartë akademik zotërojnë një nivel më të lartë të qasjes së gjykimit moral dhe të vlerave”*.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4.3.6.2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të prindërve në universitetet e studiuara

Tabela 32: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të baballarëve në universitetet e studiuara

Niveli i arsimimit të babait tuaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Nuk di shkrim-lexim	4	22.13	1	25.00	1	22.50	14	19.07	1	22.00
Ka mbaruar vetëm filloren	28	23.75	52	24.24	36	21.61	51	22.67	28	22.91
Ka mbaruar të mesmen	228	23.00	282	24.96	206	22.19	237	24.67	262	23.59
Ka mbaruar universitetin	76	24.62	66	26.27	34	21.40	90	24.44	102	24.98
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Vlerësimet në lidhje me baballarët janë si më poshtë: Studentët, që e kanë babain me arsim të lartë nga universiteti “Aleksandër Moisiu” arritën pikët më të larta me 24,62 pikë. Ata, që e kanë babain me arsim të mesëm morën 23.00 pikë. Ata, që e kanë babain me arsim fillor morën 23,75 pikë dhe ata, që e kanë babain analfabet morën 22, 13 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, studentët që e kanë babain me arsim të lartë morën 26,27 pikë, ata që e kanë babain me arsim të mesëm morën 24,96 pikë, ata, që e kanë babain me arsim fillor morën 24.24 pikë dhe ata, që e kanë babain analfabet morën 25.00 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, niveli i pjekurisë morale të studentëve, që e kanë babain me arsim të lartë ishte 21,40 pikë, i atyre, që e kanë babain me arsim të mesëm ishte 22,19 pikë, i atyre, që e kanë babain me arsim fillor ishte 21,61 pikë dhe i atyre, që e kanë babain analfabet ishte 22,50 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli i pjekurisë morale të studentëve, që e

kanë babain me arsim të lartë ishte 24,44 pikë, i studentëve, që e kanë babain me arsim të mesëm ishte 24,67 pikë, i atyre, që e kanë babain me arsim fillor ishte 22,67 pikë dhe i atyre, që e kanë babain analfabet ishte 19,07 pikë. Në universitetin e Tiranës, niveli i pjekurisë morale të studentëve, që e kanë babain me arsim të lartë paraqitet si niveli më i lartë me 24,98 pikë, i atyre, që e kanë babain me arsim të mesëm ishte 23,59 pikë, i atyre, që e kanë babain me arsim fillor është 22,91 pikë dhe i atyre, që e kanë babain analfabetë ishte 22.00 pikë.

Nëse na duhet të bëjmë një krahasim midis universiteteve për sa i përket nivelit arsimor të baballarëve, nivelin më të lartë të pjekurisë morale të studentëve, që i kanë baballarët me arsim të lartë, e ka universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 26,27 pikë, më pas ndiqet nga “Universiteti i Tiranës” me 24,98 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 24,62 pikë, më pas universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24,44 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 21,40 pikë.

Tabela 33: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas nivelit arsimor të nënave në universitetet e studiuara

Nveli i arsimimit të nënës suaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Nuk di shkrim-lexim	5	19.90	12	21.08	3	27.50	14	17.21	4	15.00
Ka mbaruar vetëm filloren	34	21.81	60	24.98	33	22.05	55	23.57	24	25.58
Ka mbaruar të mesmen	252	23.52	282	24.69	218	22.17	243	24.57	273	23.05
Ka mbaruar universitetin	45	24.46	47	28.55	23	19.89	80	24.54	92	26.38
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Nëse na duhet të bëjmë një vlerësim brenda universiteteve, vëmë re se hipoteza e mësipërme është e vërtetë. Vetëm universiteti “Fan Noli” nuk e vërteton hipotezën e mësipërme, si te nënat ashtu dhe te baballarët. Rezultatet e përftuara nga arsimi i nënës janë si më poshtë: ndërkohë që studentët e universitetit “Aleksandër Moisiu, që i kanë nënat me arsim të lartë kanë arritur pikët më të larta, me një nivel pikësh prej 24,46. Ata që i kanë nënat me arsim të mesëm kanë marrë 23,52 pikë. Studentët që i kanë nënat me arsim fillor kanë marrë 21,81 pikë dhe ata, që i kanë nënat analfabete kanë marrë 19,90 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani” studentët, që i kanë nënat kanë marrë 28,55 pikë, ata, që i kanë nënat kanë marrë 24,69 pikë. Studentët, që i kanë nënat me arsimin fillor kanë marrë 24,98 pikë dhe me 21,08 pikë janë studentë, që i kanë nënat analfabete. Ndërkohë që studentët e universitetit “Fan Noli” që i kanë nënat me arsim të lartë morën pikët më të ulëta në nivelin e pjekurisë morale me 19,89 pikë. Studentët, që i kanë nënat me arsim të mesëm morën 22,17 pikë, ata, që i kanë nënat me arsim fillor morën 22,05 pikë dhe ata, që i kanë nënat analfabet morën 27.50 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, studentët, që i kanë nënat me arsim të lartë arritën pikët më të larta me 24,54 pikë. Studentët, që i kanë nënat me arsim të mesëm morën 24,57 pikë, ata, që i kanë nënat me arsim fillor morën 23,57 pikë dhe ata, që i kanë nënat analfabetë morën 17.21 pikë. Në universitetin e Tiranës, studentët, që i kanë nënat me arsim të lartë arritën pikët më të larta në nivelin e pjekurisë morale me 26,38 pikë, ata, që i kanë nënat me arsim të mesëm morën 23,05 pikë, studentët, që i kanë nënat me arsim fillor morën 25,58 pikë dhe ata, që i kanë nënat analfabetë morën 15.00 pikë.

Nëse do të na duhej të bënim një krahasim midis universiteteve, universiteti “Aleksandër Xhuvani” paraqet pikët më të larta të pjekurisë morale të studentëve, që i kanë nënat me arsim të lartë, me 28,55 pikë, më pas vjen universiteti i Tiranës me

26,38 pikë, më pas universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24,54 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 24,46 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 19,89 pikë.

4. 3. 7. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar

Tabela 34: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar

Lloji i gjimnazit	N Total	% Total	X Total	Std Total
I përgjithshëm	1564	86.94	23.63	10.00
Privat	130	7.23	25.98	9.58
Profesional	105	5.84	24.31	9.39
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. 52 prej tyre nuk janë vlerësuar për shkak të llogaritjeve të gabuara. Nga vlerësimet e gjykimit moral të 1799 studentëve është arritur në përfundimin se studentët, të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme private pasqyrojnë një nivel më të lartë pjekurie morale, sesa studentët të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme të përgjithshme apo profesionale. Ndërkohë që niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme private është 25.98 pikë. Niveli i pjekurisë morale të studentëve të ardhur nga shkolla profesionale është 24.31, ndërsa i atyre të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme është 23.63 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar është

zbatuar uar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përftuara janë pasqyruar në tabelën 35.

Tabela 35: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	687,6107	2	343,8053	3,476373	0,031128	3,000735
Within Groups	177620,3	1796	98,89771		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se “*studentët e ardhur nga shkollat e mesme private paraqesin një nivel më të lartë pjekurie morale, sesa studentët e ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme apo ato profesionale*”.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas llojit të shkollës së mesme ku kanë studiuar, në universitetet e studiara, janë si më poshtë.

4. 3. 7. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në llojin e shkollës së mesme ku kanë mbaruar, në universitetet e studiuara

Tabela 36: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në llojin e shkollës së mesme ku kanë mbaruar, në universitetet e studiuara

Lloji i gjimnazit	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
I përgjithshëm	307	23.30	349	24.98	257	21.82	315	23.71	336	23.84
Privat	17	28.12	12	24.79	4	26.25	53	27.13	44	24.07
Profesional	12	19.71	40	26.06	16	24.22	24	23.46	13	24.85
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Rezultatet statistikore të cilat tregojnë lidhjen midis gjykimit moral të studentëve me llojin e shkollës së mesme ku kanë studiuar janë si më poshtë: në universitetin “Aleksandër Moisiu”, të diplomuarit nga shkollat e mesme private marrin 28.12 pikë, ato të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme marrin 23.30 pikë dhe ata të ardhur nga shkollat profesionale marrin 19.71 pikë. Tek universiteti “Aleksandër Xhuvani”, studentët e ardhur nga shkollat e mesme private marrin 24,79 pikë, ata të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme marrin 24.98 pikë dhe ata të ardhur nga shkollat e mesme profesionale marrin 26.06 pikë. Tek universiteti “Fan Noli”, studentët e ardhur nga shkollat e mesme private marrin 26.25 pikë, ata të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme marrin 21.82 pikë dhe ata të ardhur nga shkolla e mesme profesionale marrin 24.22 pikë. Tek universiteti “Luigj Gurakuqi”, studentët e ardhur nga shkollat e mesme private marrin 27.13 pikë, ata të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme marrin 23.71 pikë dhe ata të ardhur nga shkollat e

mesme profesionale marrin 23.46 pikë. Tek universiteti i Tiranës, studentët e ardhur nga shkollat e mesme private marrin 24.07 pikë, ata të ardhur nga shkollat e mesme të përgjithshme marrin 23.84 pikë dhe ata të ardhur nga shkollat e mesme profesionale marrin 24.85 pikë.

Në krahasimin e bërë mes universiteteve arrihen këto rezultate: pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i marrin studentët e ardhur nga shkollat e mesme private tek universiteti “Aleksandër Moisiu” me 28.12 pikë për t’u ndjekur më pas nga universiteti “Luigj Gurakuqi” me 27.13 pikë, universiteti “Fan Noli” me 26.25 pikë, universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 24.79 pikë dhe universiteti i Tiranës me 24.07 pikë.

Nga studentët e diplomuar nga shkollat e mesme e përgjithshme, pikët më të larta i morën studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 24.98 pikë. Më pas është universiteti i Tiranës me 23.84 pikë, universiteti “Luigj Gurakuqi” me 23.71 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.30 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 21.82 pikë.

Nga studentët e ardhur nga shkollat e mesme profesionale, pikët më të larta të pjekurisë morale i paraqitën studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 26.06 pikë, më pas vjen Universiteti i Tiranës me 24.85 pikë, më pas universiteti “Fan Noli” me 24.22 pikë, më pas universiteti “Luigj Gurakuqi” me 23.46 pikë dhe në fund universiteti “Aleksandër Moisiu” me 19.71 pikë.

4. 3. 8. 1. Gjendja e besimit fetar të studentëve dhe nivelet e pjekurisë

morale

Tabela 37: Gjendja e besimit fetar të studentëve dhe nivelet e pjekurisë morale

Sa të lidhur jeni me fenë	N Total	% Total	X Total	Std Total
Shumë	356	19.79	28.02	10.65
Konsiderueshëm	679	37.74	22.92	9.49
Pak	559	31.07	22.80	9.62
Aspak	205	11.40	22.47	9.25
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. Nga këto, 52 studentë nuk janë vlerësuar për shkak të llogaritjeve të gabuara. Nga vlerësimet e 1799 studentëve është arritur në përfundimin se studentët e lidhur fort me fenë e tyre paraqesin një nivel më të lartë pjekurie morale se studentët e tjerë. Ndërkohë që niveli i pjekurisë morale të studentëve të lidhur fort me fenë e tyre paraqitet me 28.02 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm me fenë ishte 22,92 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë ishte 22,80 pikë dhe i atyre të palidhur me fenë ishte 22,47 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të studentëve është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përftuara janë pasqyruar në tabelën 38.

Tabela 38: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të studentëve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	7801,313	3	2600,438	27,37598	0.0000000000000000261	2,60986
Within Groups	170506,6	1795	94,98974		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të studentëve. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se “ekziston një lidhje pozitive midis nivelit të pjekurisë morale të studentëve dhe gjendjes së tyre fetare”.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të studentëve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 8. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve dhe gjendja e besimit fetar të tyre në bazë të universiteteve të studiuara

Tabela 39: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve dhe gjendja e besimit fetar të tyre në bazë të universiteteve të studiuara

Sa të lidhur jeni me fenë	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Shumë	56	28.02	56	34.00	37	24.54	149	26.36	58	28.77
Konsider ueshëm	123	22.10	117	24.64	115	22.33	177	22.62	147	23.04
Pak	110	23.06	158	23.56	102	20.81	55	24.16	134	22.63
Aspak	47	22.23	70	22.11	23	21.74	11	19.09	54	24.14
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Rezultatet statistikore në lidhje me gjendjen e studentëve me besimin fetar në bazë të universiteteve janë si më poshtë: Niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët ndihen shumë të lidhur me fenë te universiteti “Aleksandër Moisiu” është 28,02 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm është 22,10 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë është 23.06 pikë dhe i atyre të palidhur fare është 22.23 pikë. Tek universiteti “Aleksandër Xhuvani”, niveli i pjekurisë morale të studentëve të lidhur fort me fenë është 34.00 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm me fenë paraqitet 24,64 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë paraqitet 23,56 pikë dhe i atyre të palidhur me fenë paraqitet 22.11 pikë. Në universitetin “Fan Noli” niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët ishin shumë të lidhur me fenë paraqitet 24,54 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm me fenë është 22,33 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë është 20.81 pikë dhe i atyre të palidhur fare paraqitet 21,74 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët kanë lidhje të forta me fenë është 26,36 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm me fenë paraqitet 22,62 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë është 24,16 pikë dhe i atyre të palidhur me fenë paraqitet 19.09 pikë. Tek universiteti i Tiranës, niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët ndihen më të lidhur me fenë është 28.77 pikë, i atyre të lidhur mjaftueshëm me fenë është 23.04 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë është 22.63 pikë dhe i atyre të palidhur me fenë është 24,14 pikë.

Në rezultatet ndëruniversitare, nivelin më të lartë të pikëve e arrin universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 34.00 pikë, pastaj universiteti i Tiranës me 28,77 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 28.02 pikë, më pas universiteti “Luigj Gurakuqi” me 26.36 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 24.54 pikë.

4. 3. 9. 1. Gjendja e besimit fetar të prindërve dhe nivelet e pjekurisë

morale të studentëve

Tabela 40: Gjendja e besimit fetar të prindërve dhe nivelet e pjekurisë morale të studentëve

Sa të lidhur janë prinderit tuaj me fenë	N Total	% Total	X Total	Std Total
Shumë	221	12.28	28.89	10.72
Konsiderueshëm	755	41.97	23.59	9.75
Pak	606	33.69	22.64	9.53
Aspak	217	12.06	22.91	9.48
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. Nga këto, 52 nuk janë vlerësuar për shkak të llogaritjeve të gabuara. Nga vlerësimet e 1799 studentëve është arritur në përfundimin se niveli i pjekurisë morale të studentëve të ardhur nga familje me një lidhje të fortë me fenë është më i lartë në krahasim me studentët e tjerë. Ndërkohë që niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët ndiheshin më të lidhur me fenë ishte 28,89 pikë, i atyre që ndiheshin mjaftueshëm të lidhur ishte 23,59 pikë, i atyre të lidhur pak ishte 22,64 pikë dhe i atyre të cilët nuk ndiheshin fare të lidhur me fenë ishte 22,91 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të prindërve është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përftuara janë pasqyruar në tabelën 41.

Tabela 41: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të prindërve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	6756,489	3	2252,163	23,56514	0.00000000000000586	2,60986
Within Groups	171551,4	1795	95,57181		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të prindërve. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se “ekziston një lidhje pozitive midis gjendjes të besimit fetar të familjeve me nivelin e pjekurisë morale të studentëve”.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes së besimit fetar të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 9. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes fetare të prindërve në universitetet e studiuara

Tabela 42: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes fetare të prindërve në universitetet e studiuara

Sa të lidhur janë prinderit tuaj me fenë	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Shumë	30	31.08	42	32.60	14	26.61	102	27.07	33	28.79
Konsider ueshëm	144	22.48	124	26.22	124	22.75	201	22.95	162	24.02
Pak	116	22.79	155	23.71	111	20.08	79	24.15	145	22.50
Aspak	46	22.95	80	22.03	28	24.20	10	18.75	53	24.30
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Rezultatet statistikore në lidhje me nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes fetare të prindërve janë si më poshtë: Në universitetin “Aleksandër Moisiu” niveli më i lartë i pikëve të pjekurisë morale paraqitet te studentët, të cilët vijnë nga familje të lidhura fort me fenë me 31.08 pikë, më pas vijnë studentët e familjeve të lidhura mjaftueshëm me fenë me 22,48 pikë, ato të cilët e ndjejnë veten të lidhur pak me fenë me 22,79 pikë dhe ato që nuk e shohin veten të lidhur me fenë me 22,95 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani” niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve me familje të lidhura fort me fenë paraqitet 32.60 pikë, i atyre të lidhura mjaftueshëm me fenë paraqitet 26.22 pikë. I atyre të lidhur pak me fenë paraqitet 23,71 pikë dhe i atyre të palidhur me fenë paraqitet 22.03 pikë. Në universitetin “Fan Noli” niveli i pjekurisë morale të studentëve të ardhur nga familje të lidhura fort me fenë është 26,61 pikë, i atyre të ardhur nga familje të lidhura mjaftueshëm me fenë është 22,75 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë është 20.08 pikë dhe i atyre të cilët nuk e shohin veten të lidhur me fenë është 24.20 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi” niveli më i lartë i pjekurisë morale është te studentët e ardhur nga familje të lidhura fort me fenë me 27.07 pikë, për t’u ndjekur nga ato të lidhur mjaftueshëm me fenë me 22,95 pikë, i atyre të lidhur pak me fenë me 24,15 pikë dhe i atyre të palidhur fare me fenë me 18.75 pikë. Në universitetin e Tiranës, nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale e arrijnë studentët e ardhur nga familje të lidhura fort me fenë me 28.79 pikë, më pas vijnë studentët nga familje të lidhura mjaftueshëm me fenë me 24.02 pikë, studentët nga familje të lidhura pak me fenë me 22.50 pikë dhe studentët e palidhur me fenë me 24.30 pikë.

Nëse na duhet të bëjmë një krahasim midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve me gjendjet e besimit fetar të familjeve të tyre midis universiteteve arrihen këto rezultate: pikët më të larta të pjekurisë morale i merr universiteti “Aleksandër

Xhuvani” me 32.60 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 31.08 pikë, universiteti i Tiranës me 28.79 pikë, universiteti “Luigj Gurakuqi” me 27.07 pikë dhe universiteti “Fan Noli” me 26.61 pikë.

4. 3. 10. 1. Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse i kanë prindërit në jetë ose jo

Tabela 43: Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo

Babai juaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Jeton	1710	95.05	23.83	10.02
Ka vdekur	89	4.95	23.94	8.68
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Tabela 44: Niveli i pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo

Nëna juaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Jeton	1791	99.56	23.86	9.96
Ka vdekur	8	0.44	20.31	7.49
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Të dhënat statistikore të arritura nga anketa e zhvilluar me qëllim përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve të universiteteve bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë apo jo tregojnë se pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve të universiteteve që e kanë babain në jetë janë 23.83, ndërsa të atyre që nuk e kanë babain në jetë janë 23.94.

Të dhënat statistikore të arritura nga anketa e zhvilluar me qëllim përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve të universiteteve, bazuar në faktin nëse e

kanë nënën në jetë apo jo tregojnë se pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve të univeristeteve që e kanë nënën në jetë janë 23.86, ndërsa të atyre që nuk e kanë nënën në jetë janë 20.31.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse i kanë prindërit në jetë ose jo është aplikuar testi statistikor anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 45-46.

Tabela 45: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	1,010957	1	1,010957	0,010189	0,919611	3,846639
Within Groups	178306,9	1797	99,22475		P > 05 (parëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Tabela 46: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	99,98566	1	99,98566	1,008228	0,315463	3,846639
Within Groups	178207,9	1797	99,16968		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në tabelën 45 është arritur në përfundimin se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo. Ky rezultat i përfutur nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se “*niveli i pjekurisë*

morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo është më i lartë”.

Ndërsa sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në tabelën 46 është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo. Ky rezultat i përfutur vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se “*niveli i pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo është më i lartë”.*

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas faktit nëse i kanë prindërit në jetë ose jo në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 10. 2. Niveli i pjekurisë morale dhe faktit nëse i kanë prindërit në jetë ose jo në universitetet e studiuara

Tabela 47: Niveli i pjekurisë morale dhe faktit nëse e kanë babain në jetë ose jo në universitetet e studiuara

Babai juaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Jeton	320	23.37	376	25.22	273	22.09	365	24.11	376	23.84
Ka vdekur	16	24.34	25	22.98	4	17.50	27	24.81	17	25.12
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve rreth nivelit të pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë babain në jetë ose jo është arritur në këto përfundime: Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë janë 23.37, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë

morale të studentëve që nuk e kanë babain në jetë janë 24.34. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë janë 25.22, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë babain në jetë janë 22.98. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë janë 22.09, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, që nuk e kanë babain në jetë janë 17.50. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë janë 24.11, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë babain në jetë janë 24.81. Në universitetin e Tiranës, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë janë 23.84, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë babain në jetë janë 25.12.

Nëse do të bënim një krahasim midis universiteteve, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë babain në jetë i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25.22 pikë, e pason atë universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.11 pikë, më pas vjen universiteti i Tiranës me 23.84 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.37 pikë dhe në fund renditet universiteti “Fan S. Noli” me 22.09 pikë. Në krahasimin e bërë rreth studentëve që nuk e kanë babain në jetë, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin universitetit të Tiranës me 25.12 pikë, e pason atë universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.81 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Moisiu” me 24.34 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 22.98 pikë dhe në fund renditet universiteti “Fan S. Noli” me 17.50 pikë.

Tabela 48: Niveli i pjekurisë morale sipas faktit nëse e kanë nënën në jetë ose jo në universitetet e studiuara

Nëna juaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Jeton	336	23.42	399	25.13	273	22.06	390	24.14	393	23.90
Ka vdekur	0	0.00	2	15.00	4	19.38	2	27.50	0	0.00
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve rreth nivelit të pjekurisë morale bazuar në faktin nëse e kanë nënën në jetë ose jo është arritur në këto përfundime: Në universitetin “Aleksandër Moisiu” dhe në universitetin e Tiranës duke qenë se të gjithë studentët e kanë nënën në jetë nuk kemi mundur të bëjmë një krahasim. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë nënën në jetë janë 25.13, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë nënën në jetë janë 15.00. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë nënën në jetë janë 22.06, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë nënën në jetë janë 19.38. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë nënën në jetë janë 24.14, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që nuk e kanë nënën në jetë janë 27.50.

Nëse do të bënim një krahasim midis universiteteve, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale të studentëve që e kanë nënën në jetë i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25.13 pikë, e pason atë universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.14 pikë, më pas vjen universiteti i Tiranës, me 23.90 pikë, e pason atë universiteti

“Aleksandër Moisiu” me 23.42 pikë dhe në fund renditet universiteti “Fan S. Noli” me 22.06 pikë. Në krahasimin e bërë rreth studentëve që nuk e kanë nënën në jetë, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin universitetit “Luigj Gurakuqi” me 27.50 pikë, e pason atë universiteti “Fan S. Noli” me 19.38 pikë dhe në fund renditet universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 15.00 pikë. Nuk janë përfshirë në këtë vlerësim universiteti “Aleksandër Moisiu” dhe universiteti i Tiranës, duke qenë se të gjithë studentët e kanë nënën në jetë.

4. 3. 11. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale

Tabela 49: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale

Ku e keni kaluar kohën me te gjatë të jetës tuaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Qytet	1124	62.48	24.05	9.84
Zona Rurale	675	37.52	23.49	10.14
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të testuar vërtetësinë e kësaj teze janë vlerësuar 1851 studentë nga 5 universitet të rëndësishme të Shqipërisë. Nga këta, 52 studentë janë përjashtuar nga vlerësimi për shkak të llogaritjeve të gabuara. Si rezultat i vlerësimit të 1799 studentëve është parë se studentët, të cilët pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytet paraqesin një nivel më të lartë pjekurie morale se ato të cilët pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në zona rurale. Ndërkohë që niveli i pikëve të pjekurisë morale të studentëve, të cilët pjesën më të madhe të jetës e kishin kaluar në qytete ishte 24,05 pikë, niveli i pjekurisë morale të studentëve që kishin jetuar në zona rurale ishte 23,49 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin se pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfthuara janë pasqyruar në tabelën 50.

Tabela 50: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin se pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	133,1183	1	133,1183	1,342578	0,246734	3,846639
Within Groups	178174,8	1797	99,15124		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në tabelën 50 është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve bazuar në faktin se pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete ose zona rurale. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit se *“studentët, të cilët pjesën më të madhe të jetës së tyre e kishin kaluar në qytete paraqisnin një nivel më të lartë pjekurie moral se studentët, të cilët pjesën më të madhe të jetës e kishin kaluar në fshat”*.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve të cilët pjesën më të madhe të jetës së tyre e kishin kaluar në qytete ose zona rurale në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 3. 11. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, të cilët pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në qytete ose zona rurale në bazë të universiteteve të studiuara

Tabela 51: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, të cilët pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në qytete ose zona rurale në bazë të universiteteve të studiuara

E keni kaluar kohën më të gjatë të jetës tuaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Qytet	240	23.05	218	25.64	149	22.78	236	24.27	281	24.17
Z.Rurale	96	24.35	183	24.41	128	21.14	156	23.99	112	23.23
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në universitetet e studiuara, nëse bëhet një krahasim midis vlerave të studentëve që kanë jetuar në qytet me ato të cilët kanë jetuar në zona rurale janë përftuar këto rezultate: në universitetin “Aleksandër Moisiu” studentët që kishin jetuar në zona rurale arrijnë nivelin prej 24,35 pikësh, ndërsa ata që kishin jetuar në qytete arritën nivelin prej 23,05 pikësh. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani” niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë jetuar në qytet është 25,64 pikë ndërsa i atyre që kanë jetuar në zona rurale është 24,41 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë jetuar në qytet është 22.78 pikë, ndërsa i atyre që kanë jetuar në zona rurale është 21.14 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë jetuar në qytet është 24,27 pikë, ndërsa i atyre që kanë jetuar në zona rurale është 23,99 pikë. Në Universitetin e Tiranës, niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë jetuar në qytet është 24,17 pikë, ndërsa i atyre që kanë jetuar në zona rurale është 23.23 pikë.

Nëse na duhet të bëjmë një krahasim mes vlerave të arritura mes universiteteve. Vëjmë re se nivelin më të lartë të pikëve të pjekurisë morale e arrijnë studentët që kanë kaluar pjesën më të madhe në qytet nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 25,64 pikë, pastaj vjen universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24,27 pikë, pastaj universiteti i Tiranës me 24,17 pikë, pastaj universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23,05 pikë dhe universiteti “Fan Noli” me 22,78 pikë.

Nivelin më të lartë të pjekurisë morale të studentëve, që kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në zona rurale e kanë arritur studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 24,41 pikë, pastaj vijnë studentët e universitetit “Aleksandër Moisiu” me 24,35 pikë, pastaj universiteti ‘Luigj Gurakuqi’ me 23,99 pikë, pastaj universiteti i Tiranës me 23,23 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 21,14 pikë.

4. 4. Variablat e pavarur që mendohet se nuk kanë ndikim në formësimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve

Hipoteza 3: Në formësimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve nuk kanë ndikueshmëri variablat e pavarur si, *universitetet, departamentet, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë*. Sipas variablave të pavarur, edhe pse mund të ekzistojnë ndryshime midis nivelit të pjekurisë morale të grupeve ilustruese, ata janë në një strukturë heterogjene.

4. 4. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve

Tabela 52: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve

Universiteti	Numri i studentëve	Mesatarja e pikëve	Devijimi standart
Aleksandër Moisiu	336	23.42	10.00
Aleksandër Xhuvani	401	25.08	10.78
Fan S. Noli	277	22.02	9.64
Luigj Gurakuqi	392	24.16	9.52
Tiranës	393	23.90	9.51

Për të vërtetuar saktësinë e kësaj hipoteze në 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë është llogaritur niveli i pjekurisë morale dhe devijimet standarte të 1851 studentëve të zgjedhur me metodën Random. Duke përjashtuar ata që janë përgjigjur gabim dhe ata që kanë marrë pikë M, të cilët nuk janë përfshirë në vlerësim. Si rrjedhojë është llogaritur niveli i pjekurisë morale dhe devijimet standarte të 1799 studentëve dhe pikët e gjykimeve të vlerave morale të studentëve të këtyre pesë universiteteve. Midis universiteteve, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25.8 pikë. Ndiqet nga universitetet “Luigj Gurakuqi” me 24.16 pikë, “Universiteti i Tiranës” me 23.90 pikë, “Aleksandër Moisiu” me 23.42 dhe “Fan S.Noli” me 22.00 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve është zbatuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 53.

Tabela 53: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	1634,503075	4	408,625768	4,14932109	0,00238433	2,37688795
Within Groups	176673,3913	1794	98,4801512		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,8944	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, por nga ana tjetër rezultati e përftuara *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene*.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve për periudhën para tradicionale dhe pastradicionale është pasqyruar në tabelën 54.

4. 4. 2. Pikët dhe niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve

Niveli i qasjes së gjykitimit dhe vlerave morale të studentëve të Shqipërisë sipas universiteteve do të pasqyrohet në mënyrë të detajuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 54: Pikët dhe niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve

Universitetet	Numri i studentëve	Përqindja e studentëve (%)	Mesatarja e pikëve	Devijimi standart
Aleksandër Moisiu - Tradicionale	332	98.81	23.08	9.58
Aleksandër Moisiu - Pastradicionale	4	1.19	51.25	1.44
Aleksandër Xhuvani -Tradicionale	391	97.51	24.37	9.91
Aleksandër Xhuvani -Pastradicionale	10	2.49	53.00	4.37
Fan S. Noli - Tradicionale	274	98.92	21.70	9.17
Fan S. Noli - Pastradicionale	3	1.08	51.67	2.88
Luigj Gurakuqi - Tradicionale	390	99.49	24.00	9.27
Luigj Gurakuqi - Pastradicionale	2	0.51	55.00	7.07
Tiranës - Tradicionale	390	99.24	23.68	9.21
Tiranës - Pastradicionale	3	0.76	52.50	4.33

Nëse do të krahasonim pikët e gjykitimit moral tradicional dhe atij pastraditional midis universiteteve do të vërehet një gjendje heterogjene. Në nivelin moral tradicional pikët më të larta i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me

24.37 pikë. Ndiqet nga universitetet “Luigj Gurakuqi” me 24.00 pikë, universiteti i Tiranës me 23.68 pikë, “Aleksandër Moisiu” me 23.08 dhe “Fan S. Noli” me 21.70 pikë. Në nivelin moral pastraditional, pikët më të larta i përkasin universitetit “Luigj Gurakuqi” me 55.00 pikë. Ndiqet nga universitetet “Aleksandër Xhuvani” me 53.00 pikë, universiteti i Tiranës me 52.50 pikë, “Fan S. Noli” me 51.67 dhe “Aleksandër Moisiu” me 51.25 pikë.

4. 5. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve

Tabela55: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve

Departamenti	N Total	% Total	X Total	Std Total
Mësuesi për arsimin fillor	434	24.12	23.41	10.29
Psikologji	256	14.23	24.13	9.33
Anglisht	497	27.63	24.83	9.93
Sociologji	297	16.51	24.27	10.11
Gjuhë dhe letërsi	268	14.90	22.51	9.95
Gazetari	47	2.61	20.64	7.87
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Në një vështrim të përgjithshëm, pikët më të larta të gjykimit moral janë arritur në departamentin e anglishtes me 24.83 pikë, me sociologjinë 24.27 pikë, me psikologjinë 24.13 pikë, me mësuesi për arsimin fillor 23.41 pikë, me gjuhë dhe letërsi 22.51 pikë, dhe ndiqet nga departamenti i gazetarisë me 20.64 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 56.

Tabela 56: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	1602,167	5	320,4335	3,251379	0,006303	2,219088
Within Groups	176705,7	1793	98,55311		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas departamenteve. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, por nga ana tjetër rezultaltet e përfthuara *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene*.

Nga ana tjetër është arritur në përfundimin se departamentet nuk janë efektive në përcaktimin e procesit të zhvillimit të moralit të studentëve dhe se departamentet e kanë të pamundur përcaktimin e elementëve parësor për formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve. Sepse departamentet si mësuesi për arsimin fillor, anglisht, sociologji, gjuhë dhe letërsi nuk i përkasin vetëm një universiteti, por u përkasin universiteteve të ndryshme, që janë pjesë e grupeve ilustruese të kërkimit dhe janë departamente në të cilat është zbatuar testi.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas universitetit dhe departamentit në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 5. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universitetit dhe departamentit

Tabela 57: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas universitetit dhe departamentit

Departm.	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Mësuesi për arsimin fillor	200	23.05	153	25.01	81	21.27	0	0.00	0	0.00
Psikologji	0	0.00	0	0.00	0	0.00	256	24.13	0	0.00
Anglisht	62	23.93	207	25.88	0	0.00	109	25.06	119	23.28
Sociologji	74	23.99	0	0.00	79	23.48	0	0.00	144	24.85
Gjuhë dhe letërsi	0	0.00	41	21.33	117	21.55	27	20.83	83	24.99
Gazetari	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	47	20.64
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Sipas vlerësimeve të marra në departamentet e universiteteve ku u zbatua testi i përkufizimit të vlerave, shohim se pikët e nivelit të pjekurisë morale nga studentët janë heterogjen. Në universitetin “Aleksandër Mosiu” pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i ka departamenti i sociologjisë me 23.99, ndiqet me 23.93 pikë nga departamenti i anglishtes, dhe 23.05 pikë nga departamenti i mësuesi për arsimin fillor. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i ka departamenti i anglishtes me 25.88, ndiqet me 25.01 pikë nga departamenti i mësuesi për arsimin fillor dhe 21.33 pikë nga departamenti i gjuhës dhe letërsisë. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i ka departamenti i sociologjisë me 23.48, ndiqet me 21.55 pikë nga

departamenti i gjuhës dhe letërsisë dhe 21.27 pikë nga departamenti i mësuesi për arsimin fillor. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët më të larta të gjykimit moral i ka departamenti i anglishtes me 25.06, ndiqet me 24.13 pikë nga departamenti i psikologjisë dhe 20.83 pikë nga departamenti i gjuhës dhe letërsisë. Në universitetin e Tiranës, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i ka departamenti i gjuhës dhe letërsisë me 24.99, ndiqet me 24.85 pikë nga departamenti i sociologjisë dhe 23.28 pikë nga departamenti i anglishtes.

Nga ana tjetër, nga vlerësimi i departamenteve midis universiteteve, shohim se niveli i pjekurisë morale të studentëve është heterogjen. Pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale për departamentin e mësuesisë për arsimin fillor janë në universitetin “Aleksandër Xhuvani” me 25.01 pikë, i ndjekur nga universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.05 pikë dhe universiteti “Fan S. Noli” më 21.27 pikë. Për departamentin e psikologjisë nuk kemi një krahasim për shkak se është zhvilluar anketa vetëm në universitetin “Fan S. Noli”. Pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale për departamentin e anglishtes janë në universitetin “Aleksandër Xhuvani” me 25.88 pikë, i ndjekur nga universiteti “Fan S. Noli” me 25.06 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” më 23.93 pikë dhe Universiteti i Tiranës me 23.28 pikë. Pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale për departamentin e sociologjisë janë në Universitetin e Tiranës me 24.85 pikë, i ndjekur nga universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.99 pikë dhe universiteti “Fan S. Noli” më 23.48. Pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale për departamentin e gjuhës dhe letërsisë janë në Universitetin e Tiranës me 24.99 pikë, i ndjekur nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 21.33 pikë dhe universiteti “Fan S. Noli” më 20.83. Ndërsa për departamentin e gazetarisë nuk u gjet mundësia e krahasimit, për shkak të kryerjes së anketimit vetëm në universitetin e Tiranës.

4. 6. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë

ardhur

Tabela 58: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur

Nga cila zonë e Shqipërisë jeni	N Total	% Total	X Total	Std Total
Shqipëria e veriut	611	33.96	23.59	9.71
Shqipëria e jugut	606	33.69	22.84	9.75
Shqipëria e mesme	582	32.35	25.14	10.29
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Sipas vlerësimit të bërë studentëve rreth pjekurisë morale në bazë të vendlindjes, kemi arritur në rezultate të ndryshme. Niveli i pjekurisë morale e studentëve për studentët nga Shqipëria e mesme vlerësohet me 25.14 pikë, për studentët nga Shqipëria e veriut vlerësohet me 23.59, dhe për studentët nga Shqipëria e jugut vlerësohet me 22.84.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur është aplikuar testi statistikor anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 59.

Tabela 59: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	1633,852	2	816,9262	8,304556	0,000257	3,000735
Within Groups	176674	1796	98,37085		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur. Ky rezultat i përfutur nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, por nga ana tjetër rezultaltet e përfutura *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve në bazë të universiteteve sipas zonës nga kanë ardhur në universitetet e studiuara janë si më poshtë:

4. 6. 2. Niveli i pjekurisë morale në bazë të universiteteve sipas zonës nga kanë ardhur studentët

Tabela 60: Niveli i pjekurisë morale në bazë të universiteteve sipas zonës nga kanë ardhur studentët

Nga cila zone e shqipërisë jeni	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Shqipëria e veriut	112	21.81	27	21.85	7	20.00	370	24.37	95	23.43
Shqipëria e jugut	75	23.84	89	23.72	265	22.03	12	19.13	165	23.48
Shqipëria e mesme	149	24.42	285	25.81	5	24.50	10	22.50	133	24.75
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Nëse do të duhet të bënim një vlerësim brenda strukturës së universiteteve, në universitetin “Aleksandër Moisiu” niveli më i lartë i pjekurisë morale është i studentëve nga Shqipëria e mesme me 24.42 pikë, i ndjekur nga studentët nga Shqipëria e jugut me 23.84 pikë dhe studentët nga Shqipëria e veriut me 21.81 pikë.

Në universitetin “Aleksandër Xhuvani” niveli më i lartë i pjekurisë morale është i studentëve të Shqipërisë së mesme me 25.81 pikë, i ndjekur nga studentët nga Shqipëria e jugut me 23.72 pikë dhe studentët nga Shqipëria e veriut me 21.85 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, niveli më i lartë i pjekurisë morale të studentëve nga Shqipëria e mesme me 24.50 pikë, i ndjekur nga studentët nga Shqipëria e jugut me 22.03 pikë dhe studentët nga Shqipëria e veriut me 20.00 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, niveli më i lartë i pjekurisë morale të studentëve nga Shqipëria e veriut me 24.37 pikë, e ndjekur nga studentët nga Shqipëria e mesme me 22.50 pikë dhe studentët nga Shqipëria e jugut me 19.13 pikë. Në Universitetin e Tiranës, niveli më i lartë i pjekurisë morale të studentëve nga Shqipëria e mesme me 24.75 pikë, e ndjekur nga studentët nga Shqipëria e jugut me 23.48 pikë dhe studentët nga Shqipëria e veriut me 23.43 pikë.

Nëse do të bëjmë një klasifikim të nivelit të pjekurisë morale të studentëve në bazë të vendlindjes midis universiteteve, do të kemi këto përfundimeve: Niveli më i lartë i pjekurisë morale për studentët nga Shqipëria e mesme është në universitetin “Aleksandër Xhuvani” me 25.81 pikë, i ndjekur nga universiteti i Tiranës me 24.75 pikë, universiteti “Fan S. Noli” me 24.50 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” me 24.42 pikë dhe universiteti “Luigj Gurakuqi” me 22.50 pikë.

Niveli më i lartë i pjekurisë morale për studentët nga Shqipëria e veriut është në universitetin “Luigj Gurakuqi” me 24.37 pikë, i ndjekur nga universiteti i Tiranës me 23.43 pikë, universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 21.85 pikë, universiteti “Aleksandër Moisiu” me 21.81 pikë dhe universiteti “Fan S. Noli” me 20.00 pikë.

Niveli më i lartë i pjekurisë morale për studentët nga Shqipëria e jugut është në universitetin “Aleksandër Moisiu” me 23.84 pikë, i ndjekur nga universiteti

“Aleksandër Xhuvani” me 23.72 pikë, universiteti i Tiranës me 23.48 pikë, universiteti “Fan S. Noli” me 22.03 pikë dhe universiteti “Luigj Gurakuqi” me 19.13 pikë.

4. 7. 1. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të

vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë

Tabela 61: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë

Mendoni se të rinjtë në moshën e universitetit, i kanë përvetësuar vlerat e shoqërisë ku jetojnë	N Total	% Total	X Total	Std Total
Po	907	50.42	24.21	9.86
Jo	892	49.58	23.46	10.04
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Të dhënat statistikore mbi përvetësimin e vlerave të shoqërisë, ku studentët jetojnë; pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përqafuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.21, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përqafuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 23.46.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfthuara janë pasqyruar në tabelën 62.

Tabela 62: Rezultatet statistikore anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	255,0886	1	255,0886	2,574485	0,108775	3,846639
Within Groups	178052,8	1797	99,08336		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit.

Nga ana tjetër nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë, në universitetet e studiara janë si më poshtë.

4. 7. 2. Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë, në universitetet e studiara

Tabela 63: Niveli i pjekurisë morale të studentëve sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë, në universitetet e studiara

Mendoni se të rinjtë në moshën e universitetit kanë përvetësuar vlerat e shoqërisë ku jetojnë	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Po	175	24.22	202	25.33	117	22.47	251	24.08	162	24.28
Jo	161	22.55	199	24.82	160	21.69	141	24.29	231	23.63
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Të dhënat sipas vlerësimeve të brendshme të universiteteve: Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.22, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 22.55. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 25.33, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.82. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 22.47, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 21.69. Në universitetin “Luigj Gurakuqi” pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.08, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.29. Në universitetin e Tiranës, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 24.28, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se brezi i ri nuk i ka përvetësuar vlerat e shoqërisë ku ata jetojnë janë 23.63.

4. 8. 1. Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar

Tabela 64: Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar

Sipas jush, a duhet të përfshihet në kurrikulën e arsimit parauniversitar një lëndë mbi vlerat humane	N Total	% Total	X Total	Std Total
Po	1681	93.44	23.91	10.00
Jo	118	6.56	22.82	9.29
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Të dhënat statistikore të mësipërme janë arritur bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar. Pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që janë përgjigjur pozitivisht janë 23.91, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 22.82. Sipas këtyre të dhënave mund të arrijmë në përfundimin se studentët e universiteteve e shikojnë pozitivisht përfshirjen e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar është aplikuar testi statistikor anova dhe të dhënat e përfthuara janë pasqyruar në tabelën 65.

Tabela 65: Rezultatet statistikore anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	130,8387	1	130,8387	1,31957	0,250822	3,846639
Within Groups	178177,1	1797	99,15251		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, por nga ana tjetër rezultati e përftuara *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene*.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar në universitetet e studiuara, janë si më poshtë.

4. 8. 2. Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar në universitetet e studiuara

Tabela 66: Niveli i pjekurisë morale bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar në universitetet e studiuara

Sipas jush, a duhet të përfshihet në kurrikulën e arsimit parauniversitar një lëndë mbi vlerat humane	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Po	310	23.29	367	25.44	270	21.94	362	24.26	372	24.00
Jo	26	24.92	34	21.19	7	25.00	30	22.88	21	22.05
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Të dhënat sipas vlerësimeve në universitetet e studiuara; Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme janë 23.29, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 24.92. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme janë 25.44, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 21.19. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme janë 21.94, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 25.00. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”,

pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme janë 24.26, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 22.88. Në universitetin e Tiranës, pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme janë 24.00, ndërsa pikët e nivelit të pjekurisë morale të studentëve që mendojnë se nuk është e nevojshme prania e një lënde të tillë janë 22.05.

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve mund të arrijmë në këto përfundime: pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale të atyre që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane është e nevojshme i përkasin universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25.44 pikë, e pason atë universiteti “Luigj Gurakuqi” me 24.26 pikë, më pas vjen Universiteti i Tiranës me 24.00 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23.29 pikë, e pason atë universiteti “Fan S. Noli” me 21.94. Pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale të atyre që mendojnë se prania e një lënde mbi vlerat humane nuk është e nevojshme i përkasin universitetit “Fan S. Noli” me 25.00 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Moisiu” me 24.92 pikë, më pas vjen universiteti “Luigj Gurakuqi” me 22.88 pikë, e pason atë universiteti i Tiranës me 22.05 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 21.19 pikë.

4. 9. 1. Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të prindërve

Tabela 67: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të babait

Cila është puna që bën babai	N Total	% Total	X Total	Std Total
Punëtor	869	48.30	24.04	10.18
Punonjës shteti	594	33.02	23.77	10.00
Fermer	159	8.84	23.50	9.34
Pa punë	113	6.28	22.74	9.20
Profesion i lirë	64	3.56	24.52	9.22
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Në këtë kategori, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që babai u punon në profesione të lira, me 24.52 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain punëtor, me 24.04 pikë, më pas vijnë studentët që e kanë babain nëpunës (punonjës shteti), me 23.77 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain fermer me 23.50 pikë dhe në fund renditen studentët që e kanë babain të papunë me 22.74 pikë.

Tabela 68: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të nënës

Cila është puna që bën nëna	N Total	% Total	X Total	Std Total
Punëtore	413	22.96	24.71	9.90
Punonjëse shteti	304	16.90	24.63	8.86
Fermere	132	7.34	22.50	9.90
Shtëpiake	943	52.42	23.42	10.29
Profesion i lirë	7	0.39	20.36	8.09
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Në këtë kategori, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë nënën punëtore më 24.71 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën punonjës shteti me 24.63 pikë, më pas vijnë studentët që e kanë nënën shtëpiake me 23.42 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën fermere me 22.50 pikë dhe në fund renditen studentët, që nëna u punon në profesione të lira me 20.36 pikë.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të prindërve është aplikuar testi statistikor Anova dhe të dhënat e përfuara janë pasqyruar në tabelën 69 - 70.

Tabela 69: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të babait

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	221,7222	4	55,43056	0,558395	0,692913	2,376888
Within Groups	178086,2	1794	99,26765		P >05 (parëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Tabela 70: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të nënës

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	995,1785	4	248,7946	2,517234	0,039654	2,376888
Within Groups	177312,7	1794	98,83652		P < 05 (i rëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në tabelën 69 është arritur në përfundimin se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të babait. Ky rezultat i përftuar vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, njëkohësisht edhe rezultartet e përftuara *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene.*

Nga ana tjetër, sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në tabelën 70 është arritur në përfundimin se ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të nënës. Ky rezultat i përftuar nuk vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, por nga ana tjetër rezultartet e përftuara *tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene.*

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 9. 2. Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të prindërvenë

universitetet e studiuara

Tabela 71: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të babait në universitetet e studiuara

Cila është puna që bën babai	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Punëtor	155	22.47	174	25.98	156	22.28	192	24.96	192	24.05
Punonjës shteti	132	24.35	128	25.23	69	21.21	125	22.89	140	23.95
Fermer	17	22.94	46	22.99	34	23.24	28	24.48	34	23.91
Pa punë	16	23.56	37	23.76	13	21.54	34	23.32	13	18.54
Profesion i lirë	16	25.28	16	23.16	5	18.00	13	25.96	14	26.21
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve rreth nivelit të pjekurisë morale sipas profesionit të babait është arritur në këto përfundime: Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që babai u punon në profesione të lira me 25.28 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain nëpunës (punonjës shteti) me 24.35 pikë dhe në fund renditen studentët që e kanë babain të papunë me 23.56 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë babain punëtor me 25.98 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain punonjës shteti me 25.23 pikë dhe në fund renditen studentët që e kanë babain të papunë me 23.76 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë babain fermer me 23.24 pikë, e

pasojnë atë studentët që e kanë babain punëtor me 22.28 pikë, dhe në fund renditen studentët që e kanë babain të papunë me 21.54 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që babai u punon në profesione të lira me 25.96 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain punëtor me 24.96 pikë, dhe në fund renditen studentët që e kanë babain të papunë me 23.32 pikë. Në universitetin e Tiranës, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që babai u punon në profesione të lira me 26.21 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë babain punëtor me 24.05 pikë, dhe në fund renditen studentët që e kanë babain punonjës shteti me 23.95 pikë.

Nëse do të bënim një krahasim midis universiteteve sipas profesionit të babait, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin universitetit të Tiranës dhe konkretisht studentëve, që babai u punon në profesione të lira me 26.21 pikë, e pason atë universiteti “Aleksandër Xhuvani” me studentët që e kanë babain punëtor me 25.98 pikë dhe në fund, renditet universiteti “Luigj Gurakuqi” me studentët që babai u punon në profesione të lira me 25.96 pikë.

Tabela 72: Niveli i pjekurisë morale sipas profesionit të nënës në universitetet e studiuara

Cila është puna që bën nëna	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Punëtore	85	22.62	72	25.66	72	26.51	74	24.24	110	24.84
Punonjëse shteti	49	25.59	54	25.95	26	21.94	86	24.47	89	24.26
Fermere	17	21.76	46	23.53	27	20.74	29	22.66	13	23.08
Shtëpiake	185	23.36	228	25.07	148	20.15	201	24.18	181	23.21
Profesion i lirë	0	0.00	1	10.00	4	19.38	2	27.50	0	0.00
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Në një vlerësim krahasues midis universiteteve rreth nivelit të pjekurisë morale sipas profesionit të nënës është arritur në këto përfundime: Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë nënën punonjëse shteti me 25.59 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën shtëpiake me 23.36 pikë, dhe në fund renditen studentët që e kanë nënën punëtore me 22.62 pikë. Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë nënën punonjëse shteti me 25.95 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën punëtore me 25.66 pikë dhe në fund, renditen studentët që e kanë nënën shtëpiake me 25.07 pikë. Në universitetin “Fan S. Noli”, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përkasin studentëve që e kanë nënën punëtore me 26.51 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën punonjëse shteti me 21.94 pikë dhe në fund, renditen studentët që e kanë nënën fermere me 20.74 pikë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, pikët më të larta të nivelit

të pjekurisë morale i përketin studentëve, që nëna u punon në profesione të lira me 27.50 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën punonjëse shteti me 24.47 pikë dhe në fund, renditen studentët që e kanë nënën punëtore me 24.24 pikë. Në universitetin e Tiranës, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përketin studentëve që e kanë nënën punëtore me 24.84 pikë, e pasojnë atë studentët që e kanë nënën punonjëse shteti me 24.26 pikë dhe në fund, renditen studentët që e kanë nënën fermere me 23.08 pikë.

Nëse do të bënim një krahasim midis universiteteve sipas profesionit të nënës, pikët më të larta të nivelit të pjekurisë morale i përketin universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe konkretisht studentëve, që nëna u punon në profesione të lira me 27.50 pikë, e pason atë universiteti “Fan S. Noli” me studentët që e kanë nënën punëtore me 26.51 pikë dhe në fund, renditet universiteti “Aleksandër Xhuvani” me studentët që nëna u punon sipunonjëse shteti me 25.95 pikë.

4. 10. 1. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve

Tabela 73: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve

Sa janë te ardhurat mesatare në familjen tuaj	N Total	% Total	X Total	Std Total
Me pak se 30.000 lekë	565	31.41	23.80	10.83
40.000 - 60.000 lekë	718	39.91	23.99	9.75
60.000 - 100.000 lekë	335	18.62	23.59	8.80
Me shumë se 100.000 lekë	136	7.56	24.10	10.07
Me shumë se 200.000 lekë	45	2.50	23.08	9.85
Total	1799	100.00	23.84	9.95

Për të provuar vërtetësinë e kësaj hipoteze, me anë të metodës random kemi zgjedhur 1851 studentë nga 5 universitete të rëndësishme të Shqipërisë. Nga këta studentë, 52 prej tyre nuk janë vlerësuar për shkak të llogaritjeve të gabuara. Pikët e nivelit të pjekurisë morale të fëmijëve, të cilët vinin nga familje me të ardhura mujore mesatarisht 100.000 lekë ishte 24,10. Ata të cilët vinin nga familje me të ardhura mujore 40-60.000 shfaqnin pikët 23,99. Pikët e atyre me të ardhura më pak se 30.000 ishin 23,80. Pikët e fëmijëve që vinin nga familje me të ardhura në mes 60-100.000 ishin 23,59 dhe ato me më shumë se 200.000 paraqisnin pikët 23,08.

Me qëllim zbulimin nëse ka ndryshime apo jo midis pikëve të nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve është aplikuar testi statistikor anova dhe të dhënat e përfutuara janë pasqyruar në tabelën 74.

Tabela 74: Rezultatet statistikore Anova mbi nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve

Source of Variation	SS	Df	MS	F	P-value	F crit
Between Groups	73,28039	4	18,3201	0,184399	0,94658	2,376888
Within Groups	178234,6	1794	99,3504		P > 05 (parëndësishëm)	
Total	178307,9	1798				

Sipas rezultateve statistikore Anova që janë pasqyruar në këtë tabelë është arritur në përfundimin se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm midis niveleve të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve. Ky rezultat i përfutur vërteton hipotezën e hedhur para kërkimit, njëkohësisht edhe rezultatat e përfutuara tregojnë se variabli në fjalë ndodhet në një strukturë heterogjene.

Nga ana tjetër, nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve në universitetet e studiuara janë si më poshtë.

4. 10. 2. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike

të prindërve në universitetet e studiuara

Tabela 75: Nivelet e pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve në universitetet e studiuara

Sa janë të ardhurat mesatare në familjen tuaj	Aleksandër Moisiu		Aleksandër Xhuvani		Fan S. Noli		Luigj Gurakuqi		Tiranës	
	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average	No. of Subj.	P average
Me pak se 30.000 lekë	104	23.46	157	25.14	109	21.20	116	25.12	79	23.25
40.000 - 60.000 lekë	129	23.62	154	25.01	119	21.71	135	25.47	181	23.78
60.000 - 100.000 lekë	67	23.44	54	24.55	29	23.98	90	22.59	95	23.97
Me shumë se 100.000 lekë	27	23.98	25	25.80	20	25.50	32	19.45	32	26.64
Me shumë se 200.000 lekë	9	18.33	11	26.23	0	0.00	19	24.34	6	20.42
Total	336	23.42	401	25.08	277	22.02	392	24.16	393	23.90

Çdo universitet i analizuar më vete pasqyron një tabelë shpërndarjeje heterogjene. Ndërkohë që fëmijët e familjeve me të ardhura mbi 100.000 të universitetit “Aleksandër Moisiu” kanë marrë pikët më të larta me 23,98, ata me 40-60.00 lekë të ardhura kanë marrë 23,62 pikë. Ata, të cilët vinin nga familje me të ardhura më pak se 30.000 morën pikët 23,46. Ato me të ardhura në mes 60-100.000 morën 23,44 pikë dhe fëmijët që vinin nga familje me të ardhura më shumë se 200.000 lekë morën 18,33 pikë. Ndërkohë që në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, pikët më të larta prej 26,23 i morën studentët të cilët vinin nga familje me të ardhura më shumë se 200.000 lekë. Ata studentë që vinin nga familje me më shumë se 100.00

morën 25,80. Ata me më pak se 30.000 morën 25,14. Ata me të ardhura në mes 40-60.000 lekë morën 25,01. Ata me të ardhura 60-100.000 morën 24,55. Në universitetin “Fan Noli”, pikët më të larta prej 25,50 i morën studentët të cilët vinin nga familje me të ardhura më shumë se 100.000 lekë, duke u ndjekur nga 23,98 pikë nga studentët e familjeve me të ardhura 60-100.000 lekë. 21,71 pikë i morën familjet me të ardhura 40-60.000 lekë dhe 21,20 pikë ishin nga studentët e familjeve me të ardhura më pak se 30.000 lekë. Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, nivelin më të lartë të pikëve, 25,47 e morën studentët, të cilët vinin nga familje me ardhura 40.60.000 lekë. Me 25,12 pikë ishin studentët e familjeve me të ardhura më pak se 30.000 lekë. 24,34 pikë u morën nga studentë nga familjet me të ardhura më shumë se 200.000 lekë, 22,59 pikë i morën ata me të ardhura në mes 60-100.000 lekë dhe 19,45 pikë i morën studentët nga familjet me të ardhura më shumë se 100.000 lekë. Te universiteti i Tiranës, pikët më të larta prej 26,64 pikësh i morën studentët e familjeve me të ardhura më shumë se 100.000 lekë, 23,97 pikë u morën nga studentë nga familje me të ardhura në mes 60-100.000 lekë. 23,78 pikë u morën nga familje me të ardhura në mes 40-60.000 lekë. 23, 25 pikë u morën nga ato me të ardhura më pak se 30.000 lekë dhe 20,42 pikë nga studentët e familjeve me të ardhura më shumë se 200.000 lekë.

Nëse universitetet analizohen një nga një, vihen re ndryshime në mes universiteteve përsa i përket nivelit të të ardhurave. Ndërkohë që pikët më të larta të pjekurisë morale prej 25,14 i morën studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të ardhur nga familje me të ardhura më pak se 30.000 lekë. Më pas janë studentët me 25,12 pikë nga universiteti ‘Luigj Gurakuqi’, më pas me 23,46 pikë nga universiteti “Aleksandër Moisiu”, më pas me 23,25 pikë nga universiteti i Tiranës dhe në fund me 21,20 pikë nga universiteti “Fan Noli”. Ndërkohë që pikët më të larta të pjekurisë morale të studentëve të familjeve me të ardhura 40-60.000 lekë ishin studentët e

universitetit “Luigj Gurakuqi” me 25,47. Më pas ishin universiteti “Aleksandër Xhuvani” me 25,01 pikë, më pas universiteti i Tiranës me 23,78 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23,62 pikë dhe në fund universiteti “Fan Noli” me 21,71 pikë. Te studentët e ardhur nga familje më të ardhura në mes 60-100.000 lekë, pikët më të larta u arritën nga studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 24,55 pikë, më pas ishin studentët e universitetit “Fan Noli” me 23,98 pikë, më pas universiteti i Tiranës me 23,97 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23,44 pikë dhe në fund universiteti “Luigj Gurakuqi” me 22,59 pikë. Te studentët e familjeve me të ardhura më shumë se 100.000 lekë, pikët më të larta i arritën studentët e universitetit të Tiranës me 26,54 pikë, pasohen nga studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 25,80 pikë, më pas universiteti “Fan Noli” me 25,50 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 23,98 pikë dhe më pas universiteti “Luigj Gurakuqi” me 19,45 pikë. Te studentët e ardhur nga familjet me të ardhura më shumë se 200.000 lekë, pikët më të larta i morën studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” me 26,23 pikë, më pas ishin studentët e universitetit “Luigj Gurakuqi” me 24,34 pikë, më pas universiteti i Tiranës me 20,42 pikë, më pas universiteti “Aleksandër Moisiu” me 18,33. universiteti “Fan Noli” nuk është futur në këtë vlerësim për shkak të mungesës së të dhënave.

KAPITULLI V

KONKLUSIONE

Objekti i studimit është ekzistenca e një lidhjeje në mes ndjenjës, mendimit dhe sjelljeve morale me disa faktorë psiko-socialë efektivë, si: universitetet, departamentet, gjinia, mosha, viti i studimit, statusi i prindërve, nëse prindërit janë në jetë apo jo, niveli arsimor i prindërve, qëndrimet e prindërve ndaj fëmijëve, gjendja financiare e prindërve, profesioni i prindërve, zona nga ka ardhur studenti, faktit se ku e ka kaluar studenti pjesën më të madhe të jetës, në qytet ose zona rurale, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë, lidhja e prindërve me fenë dhe lidhja e studentëve me fenë në procesin e zhvillimit moral të studentëve të universitetit.

Duke u bazuar në këto rezultate do të përcaktohet niveli i gjykimit moral dhe konceptimit të vlerave të studentëve të universiteteve shqiptare.

Ashtu sikurse është përmendur edhe më lart, në këtë studim jemi fokusuar në 18 variabla të ndryshme personale, që do të na ndihmojnë në përcaktimin e nivelit të gjykimit moral të studentëve. Është arritur në konkluzionin se disa nga këto variabla janë përcaktuese në formimin e qasjes së vlerave morale të studentëve.

Në përfundim të studimit është përcaktuar se niveli i pjekurisë morale të studentëve që studiojnë në universitetet shqiptare, sipas teorisë së gjykimit moral të Kohlbergut, ***është në nivelin tradicional.***

Gjithashtu, vërehet ekzistenca e një lidhjeje midis ndjenjës, mendimit dhe sjelljeve morale me disa faktorë psiko-socialë efektivë në procesin e zhvillimit moral të studentëve. Midis këtyre, variablat e pavarur, si: universitetet, departamentet, moshë, viti i studimit, statusi i prindërve, qëndrimet e nënës dhe të babait, niveli arsimor i nënës dhe i babait, nëse prindërit janë në jetë apo jo, lloji i shkollës së mesme që ka përfunduar, zona nga ka ardhur studenti, faktit se ku e ka kaluar studenti pjesën më të madhe të jetës, në qytet ose zonë rurale, përfshirja e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, sa i kanë përvetësuar të rinjtë vlerat e shoqërisë ku jetojnë, lidhja e prindërve dhe studentëve me besimin fetar kanë ndryshime më të theksuara se variablat e tjerë.

Nga ana tjetër, është arritur në konkluzionin se variablat e pavarur, si: gjinia, gjendja financiare e prindërve, pjesërisht profesioni i prindërve janë faktorë psiko-socialë që nuk kanë ndikueshmëri në procesin e zhvillimit moral të studentëve.

1. Sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut, konceptimet morale të studentëve në vijë të përgjithshme janë në *nivelin tradicional*.

Studimi i realizuar me qëllim përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlbergut, na tregoi se konceptimet morale të studentëve në vijë të përgjithshme janë në nivelin tradicional. (Tabela:8-9) Rezultatet e arritura në këtë studim na konfirmojnë vërtetimin e kësaj hipoteze.

Në universitetet që është zhvilluar studimi, 98.78 % e studentëve janë në nivelin tradicional të pjekurisë morale, ndërsa 1.22 % janë në nivelin pastraditional të pjekurisë morale. Vetë Kohlbergu (1977, f. 54-55) shprehet se këtë fazë, kur u kushtohet rëndësi parimeve dhe vlerave morale universale, përse u përket sjelljeve dhe gjykimit moral dhe kur sjelljet e individit kontrollohen nga ndërgjegjja e vet, e kanë arritur shumë pak persona. Prandaj përfundimet e arritura, duke u bazuar në

përfundimet e arritura nga Kohlbergu, janë në një nivel normal të pranueshëm. Nga ana tjetër, është vënë re se studentët me të cilët është zhvilluar studimi, janë të prirur t'i pranojnë rregullat dhe gjykimet morale të shoqërisë, pa i kundërshtuar .

2. Bazuar në konstatimet që kemi arritur në studim sipas disa variablave, *ekziston* një lidhje në mes ndjenjës, mendimit dhe sjelljeve morale me disa faktorë psiko-socialë efektivë në procesin e zhvillimit moral të studentëve. Ndërsa sipas disa variablave të tjerë, nuk ekziston një dallim i rëndësishëm në formësimin e procesit të zhvillimit moral të studentëve.

a. Niveli i pjekurisë morale i vajzave është më i lartë se ai i djemve, përse i përket gjinisë.

Në studimin e realizuar në lidhje me dallimin midis gjinisë dhe nivelit të pjekurisë morale të studentëve, vërejmë se ndryshimi midis pjekurisë morale të të dy gjinive nuk është i madh. (Tabela: 10-11) Rrjedhimisht, hipoteza e ngritur përpara studimit nuk është vërtetuar. Në 22 studimet e realizuara në Amerikë, në lidhje me testin e vlerësimit të vlerave, vetëm në dy prej tyre ka dalë një diferencë e madhe midis femrave dhe meshkujve. (Rest, 1986, f. 6.5)

Siç e kemi veçuar edhe në hipotezë, mendimi se pjekuria morale e vajzave është më e madhe se e djemve rrjedh nga fakti se zhvillimi social, emocional, mendor dhe fizik i vajzave në krahasim me djemtë fillon në një fazë më të hershme. Megjithatë arsyeja e rezultatit të vlerave të barabarta për të dyja gjinitë, rrjedh nga mënyra e rritjes së djemve në Shqipëri.

Vetëbesimi i lartë, guximi, vendimmarrja dhe tipari i të vepruarit të meshkujt mund të jenë burim për ndikimin pozitiv në zhvillimin e personalitetit dhe nivelin e pjekurisë.

b. Niveli i pjekurisë morale të studentëve më të mëdhenj në moshë, krahasuar me studentët më të vegjël, është më i madh.

Sipas përfundimeve të marra nga studimi i realizuar, në lidhje me vërtetimin e nivelit të pjekurisë morale në bazë të moshës, është vërtetuar se pjekuria morale e studentëve më të mëdhenj në moshë, në krahasim me studentët më të vegjël, është më e madhe (Tabela: 13-14) dhe hipoteza është vërtetuar.

Megjithëse Resti, (1986, f. 6.1) në manualin e tij tregon se edhe pse moshë ndikon në nivelin e pjekurisë morale, midis të rriturve ky nivel është i ulët. Në veçanti, te studentët në moshë të vogël, për shkakë, si: moskalimi i përshtjellimit të adoleshencës, mosformimi i personalitetit dhe i sjelljeve dhe moskrijimi i një mendimi rreth shoqërisë etj., pikët e aftësisë së gjykimit moral priten të jenë më të ulëta. Nga ana tjetër, në lidhjen midis nivelit të grupmoshave dhe pjekurisë morale, mund të thuhet se ka një ndikim pozitiv përfitimi i vlerave që kanë studentët gjatë viteve të arsimimit në universitet.

c. Niveli i pjekurisë morale të studentëve të vitit të fundit është më i lartë se gjykimi moral dhe konceptimi i vlerave të studentëve të vitit të parë.

Përfundimet e marra si rezultat i studimit në lidhje me vërtetimin e nivelit të pjekurisë morale, në bazë të kluseve të studentëve, ka rezultuar se gjykimi moral dhe konceptimi i vlerave të studentëve të vitit të fundit është më i lartë se gjykimi moral dhe konceptimi i vlerave të studentëve të vitit të parë dhe është vërtetuar hipoteza. (Tabela: 16-17)

Kjo hipotezë është e lidhur me hipotezën e kaluar. Rritja e nivelit të pjekurisë morale paralelisht me rritjen e moshës dhe arsimimit, përbën një parashikim të përshtatshëm me testin e njohjes së vlerave, sepse rritja e nivelit të klasës është në përpjesëtim të

drejtë me ndikimet e ardhura nga këndvështrimi mbi jetën, eksperiencën, rritjen e aftësive për marrjen e përgjegjësisë dhe zhvillimin e aftësive të arsytimit. Ndikimi që kanë këta faktorë në nivelin e pjekurisë morale është një e vërtetë.

d. Studentët, prindërit e të cilëve jetojnë bashkë, kanë një nivel më të lartë të qasjes së pjekurisë morale dhe vlerave.

Sipas përfundimeve të marra nga studimi i bërë në lidhje me vërtetimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, sipas gjendjes civile të prindërve, është vërtetuar se qasja e pjekurisë morale dhe vlerave të studentëve, prindërit e të cilëve jetojnë bashkë, është më e madhe dhe hipoteza është vërtetuar. (Tabela: 19-20)

Ky përfundim tregon në një mënyrë të fuqishme rëndësinë që ka qëndrimi i nënës dhe i babait së bashku në zhvillimin psikologjik dhe social të fëmijës.

Sidomos në ditët e sotme, një ndër rregullat kryesore për fitimin e një personaliteti të shëndoshë shpirtëror dhe mendor të fëmijës, është rritja në një strukturë familjare të rregullt. Ndryshimi i mënyrës së rritjes, ndarja e prindërve, prishja e strukturës familjare të fëmijës ndikojnë në krijimin e problemeve psikologjike. (Serin dhe Öztürk, 2007, f. 118-119)

Në studimin tonë ndarja e prindërve për pjesën më të madhe të studentëve ka ardhur si rezultat i vdekjes së njërit prej tyre; vdekja e njërit prej prindërve ka sjellë si rezultat përballjen me vështirësi ekonomike dhe shpirtërore të prindit tjetër, sepse e vërteta e problemeve nuk qëndron në vështirësitë psikologjike dhe ekonomike të ardhura pas vdekjes së nënës ose babait, por si pasojë e përballjes me lëmshin e problemeve të rritura me kalimin e kohës. Veçanërisht, vendet në zhvillim, si Shqipëria, janë duke u përballur me probleme të forta familjare për shkak të mungesës së strukturës dhe specialistëve, lidhur me këtë drejtim.

Nga ana tjetër, nëse në shoqërinë tonë lidhjet familjare të individëve dhe lidhjet faqefisnore janë të forta, atëherë këto probleme mund të ulen në minimumin e tyre. Përballimi i problemeve të botës moderne nga ana e familjeve klasike është një temë për të cilën duhet menduar gjatë.

e. Niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e vlerësonin qëndrimin e nënës dhe babait si demokratik (tolerant) ishte më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e cilësonin qëndrimin e prindërve të tyre si autoritar ose indiferent.

Sipas përfundimeve të marra nga studimi i realizuar, në lidhje me vërtetimin e nivelit të pjekurisë morale të fëmijëve, të cilët kanë kontrollin e prindërve, rezulton se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e vlerësonin qëndrimin e nënës dhe babait si demokratik (tolerant) ishte më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve, të cilët e cilësonin qëndrimin e prindërve të tyre si autoritar ose indiferent dhe hipoteza është vërtetuar. (Tabela: 22-23-24-25)

Sipas Kayas, (Kaya M. , 1997, f. 198) në mesin e një familje demokratike ka tolerancë brenda kufijve normalë të besimit dhe mbështetjes. Në të tilla familje respektohen ndjenjat dhe mendimet e fëmijës brenda familjes dhe fëmija zotëron të drejtën e fjalës. Në këto lloj familjesh, mbajtja e nevojave të fëmijës në plan të parë, bën të mundur marrjen e dashurisë dhe vëmendjes së nevojshme nga familja. Fëmijët e rritur në këtë mënyrë, zhvillojnë aftësinë e marrjes së vendimeve, të arsytimit të mendimit dhe sipërmarrjes.

Ndërsa sipas Tanhanit (Tanhanit), (2011, f. 6) prindërit autoritarë e humbasin vetëbesimin e fëmijës së tyre, mbajnë një qëndrim i cili nuk e përfill personalitetin e fëmijës. Fëmijët e rritur me këtë qëndrim në moshë madhore vijnë në një gjendje të

ngarkuar, të mbyllur në vetvete, shumë emocionale dhe të bindur ose rebelë, nuk përshtaten lehtë, nuk i njohin rregullat e shoqërisë ku jetojnë.

Ndërsa sipas Yağmurlusë dhe Kodalakut (Jamurllusë dhe Kodallakut), (2010, f. 299-309) prindërit që kanë një qëndrim demokratik, vendosin rregulla duke vlerësuar moshën dhe temperamentin e fëmijës si rrjedhojë ua shpjegojnë këto rregulla fëmijëve dhe presin zbatimin e tyre nga ata. Këto lloj familjesh, pas vendosjes së këtyre rregullave, i zbatojnë ato në mënyrë konsekuente, por kur është e nevojshme këto rregulla lehtësohen ose ndryshohen. Ndërsa në llojet e familjeve autoritare, prindërit japin direktiva të shkurtra, mund të thuhet se përdorin shprehje të cilat nuk presin shpjegime. Si përfundim, për një periudhë afatshkurtër kjo sjell ndalimin e fëmijës për të bërë veprime që nuk i pëlqen. Vetëm se kjo marrëdhënie nuk mbështet zhvillimin e asaj që është qëllim për të parë përfundimin e sjelljeve, ose kuptimin e asaj që ndiejnë ose mendojnë të tjerët.

Sipas Yağmurlusë dhe Kodalakut, (2010, f. 300-309) prindërit që tregohen tolerantë ndaj fëmijëve të tyre, nxjerrin shpjegime për sjelljet pozitive dhe negative të fëmijës së tyre, përfshijnë ndjenjat në fjalimet e tyre; të folurit rreth ndjenjave dhe mendimeve të tyre dhe të tjerëve ndihmon në përshpejtimin e zhvillimit të ndjenjave të fëmijës, aftësia për ta vënë veten në vendin e tjetrit dhe sjelljet sociale të ndjeshme dhe pozitive do të ketë një ndikim përforcues. Kuptimi i rëndësisë së sjelljeve sociale, si bashkëbisedimi dhe shkëmbimi i mendimeve, por edhe tregimi i sjelljeve shoqërore pozitive të vetë prindërve, do të jetë një model i mirë për fëmijën.

Fakti se në përfundim të studimit, niveli i pjekurisë morale të fëmijëve që i kanë prindërit tolerant doli më i lartë në krahasim me të tjerët është tregues se përgjithësisht

në vendin tonë qasja e prindërve (të paktën e njërit prej prindërve) është e prirur të jetë tolerante.

f. Fëmijët, të cilët i kanë prindërit me një nivel më të lartë arsimor zotërojnë nivele më të larta pjekurie morale.

Bazuar në të dhënat e arritura në përfundim të studimit të zhvilluar, me qëllim përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, sipas gjendjes së arsimimit të familjeve, është arritur në konkluzionin se fëmijët të cilët i kanë prindërit me një nivel më të lartë arsimor , zotërojnë gjykime më të larta morale dhe hipoteza është vërtetuar. (Tabela: 28-29-30-31)

Niveli i interesimit me fëmijët dhe ndryshimet që kanë në qasjet e tyre prindërit që e kanë nivelin e arsimimit më të lartë, mund të jenë faktorë ndikues që përfundimi të dalë kështu. T'i ndash kohë fëmijës, t'u përmbushësh kërkesat në përputhje me zhvillimin e tyre, të ndihmosh zhvillimin e modeleve të sjelljes shembullore që janë të përshtatshme me moshën dhe nivelin e ecurisë së shoqërisë , përveç interesimit për fëmijën, është një situatë që ka lidhje të drejtpërdrejtë me të paturit dëshirë dhe njohuri të mjaftueshme mbi prindërimin. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se shembulli më i afërt dhe efektiv në zhvillimin e gjendjes shpirtërore të fëmijëve janë prindërit.

g. Niveli i pjekurisë morale të studentëve të ardhur nga shkollat e mesme private është më i lartë se niveli i pjekurisë morale të studentëve të ardhur nga shkolla të mesme të përgjithshme apo profesionale.

Në studimin e realizuar për përcaktimin e pikëve të nivelit të pjekurisë morale, sipas llojit të shkollës së mesme që kanë përfunduar studentët, na rezulton se niveli i pjekurisë morale i studentëve që kanë përfunduar shkollën e mesme private është më i

lartë se i studentëve që kanë përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme apo shkollën e mesme profesionale dhe hipoteza është vërtetuar. (Tabela: 34-35)

Në studimin tonë, arsyeja që niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë përfunduar shkollën e mesme private është më i lartë, është se prindërit u kërkojnë llogari drejtuesve të shkollave private dhe mekanizmi i të dhënit llogari në këto shkolla administrohet mirë. Gjithashtu, një nga arsyet e tjera, për sa u përmond më sipër, është se drejtuesit e shkollës duke marrë shkas nga kjo, përveç përmirësimit të gjendjes së arsimimit të nxënësve, realizojnë edhe kër kime për zhvillimin psikologjik dhe social të tyre.

- h. Ekziston një lidhje pozitive midis besimit fetar të studentëve me nivelet e pjekurisë morale.
- i. Ekziston një lidhje pozitive midis gjendjes të besimit fetar të prindërve dhe nivelit të pjekurisë morale të studentëve.

Në studimin e realizuar për përcaktimin e marrëdhënies së nivelit të pjekurisë morale të studentëve dhe lidhjes që kanë ata dhe familja e tyre me besimin fetar është arritur në përfundimin se niveli i pjekurisë morale të studentëve që kanë lidhje me besimin fetar ose kur familja e tyre ka edukatë fetare është më i lartë dhe hipoteza është vërtetuar. (Tabela: 37-38-40-41)

Duke u bazuar në përfundimet e arritura, mund të thuhet se ndjenjat, mendimet dhe veprimtaria fetare përbën një faktor ndikues në formësimin e drejtimeve psiko-sociale të njerëzve. Sipas Günayit (Gynajit) (2012, f. 426) thelbin e moralit e përbën *mirësia*. Për arsye të kësaj veçorie ka ngjashmëri midis temave të moralit dhe fesë. Edhe pse në qytetërimin e vjetër grek haset shembulli i nxjerrjes së moralit nga feja, duke marrë një gjendje më racionale, gjë që e hasim më shpesh në shoqëritë moderne, nuk e hedh

poshtë këtë dallim, njerëzit, si rezultat i problemeve që po hasin kohët e fundit, këto të dy elemente kanë filluar t'i analizojnë në të njëjtin rrafsh përsëri.

Sipas Uysalit (2005, f. 44) kur vërejmë disa veprime është e mundur që të shikojmë më qartë se feja dhe morali janë vlerësuese me njëra-tjetrën. Për shembull: vjedhja, korrupsioni, vrasja e njeriut, marrëdhëniet seksuale të paligjshme, pijet alkolike, kumari etj. janë veprime që janë të ndaluara nga feja, por që edhe moralisht janë veprime të këqija. Respekti ndaj të rriturve, bamirësia (altruizmi), mbajtja e fjalës, drejtësia etj. janë sjellje që feja i urdhëron, por që edhe moralisht janë sjellje të mira. Në këtë mënyrë në jetën e besimtarit do të integrohen tiparet që ai beson se janë të “shenjta” me ato tipare që morali i ka cilësuar si të “mira” ose të “këqija”.

Sipas Çilingirit, (2014, f. 714) feja dhe morali përmbajnë pika të përbashkëta qasjeje që i përkasin njeriut. Disa prej këtyre mund t'i rendisim në këtë mënyrë:

- a. Të dyja janë struktura normative që mundohen të rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, duke marrë si bazë *këshillën*.
- b. Të dyja investigojnë kuptimin e jetës me një qasje objektive.
- c. Të dyja mbartin idealin për ta dërguar njeriun drejt lumturisë.

Sipas Mckayit (Mekkeit) dhe Whitehousit (Uhajthausit), (2014) në kundërshtim me pretendimet e shumë komentuesve modernë, marrëdhënia midis moralit dhe fesë nuk është kuptuar plotësisht.

Kur të kuptohen mësimet fetare me të vërtetë, nuk ka dyshim që do ta çojnë njeriun drejt së drejtës dhe së mirës. Pika që duhet sqaruar këtu është fakti se edhe njerëzit që nuk kanë lidhje me besimin fetar mund të jenë të moralshëm.

Në këtë pikë ne nuk po diskutojmë se kush do të jetë i moralshëm, por po diskutojmë nëse feja ndikon në një mënyrë pozitive te morali apo jo. Vetë morali mund të jetë një fushë e pavarur. Ju mund të vëreni se njerëzit jobesimtarë i respektojnë vlerat morale më tepër se njerëzit besimtarë.

Si përfundim, kur vërejmë rezultatet e studimit dhe shpjegimet që janë bërë, në lidhje me këtë temë, mund të arrihet në konkluzionin se feja mbështet pozitivisht vlerat morale.

j. Niveli i pjekurisë morale të studentëve që i kanë prindërit në jetë është më i lartë se i studentëve që nuk i kanë prindërit në jetë. (Tabela: 43-44-45-46)

Në studimin e realizuar për përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, duke u bazuar në faktin nëse i kanë prindërit në jetë apo jo, në të kundërt të asaj që është theksuar në hipotezë sipas rezultateve të përfutuara për studentët që i kanë nënat në jetë është vërtetuar, ndërsa sipas rezultateve të përfutuara për studentët që i kanë baballarët në jetë nuk është vërtetuar.

Veçanërisht, në vlerat që i përkasin nënës është konstatuar se niveli i pjekurisë morale të studentëve, që i kanë nënat në jetë, është më i lartë dhe kjo tregon rëndësinë e nënës në familje për edukimin e fëmijëve të tyre. Edhe pse në shoqëritë moderne nëna dhe babai në jetën shoqërore marrin pjesë në nivele të barabarta, në edukimin e fëmijës nëna zë një pozicion shumë të ndryshëm nga ai i babait. Kur bëhet fjalë për fëmijët që janë vajza, kjo ndjeshmëri rritet edhe një shkallë më shumë. Duke u nisur nga fakti se 80% e studenteve që kanë marrë pjesë në studim janë vajza, ky rezultat i përfutur përbën një rëndësi të veçantë.

Ndërsa në vlerat që i përkasin babait nuk ka ndonjë ndryshim dhe kjo përbën pengesë që ne të bëjmë një vlerësim lidhur me rezultatet.

k. Nivelet e pjekurisë morale të studentëve, që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në qytete, është më i lartë se nivelet e pjekurisë morale të studentëve, që pjesën më të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar në zona rurale.

Sipas përfundimeve të studimit të kryer, në lidhje me vërtetimin e nivelit të pjekurisë morale sipas zonës në të cilën studentët kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës, siç u tha dhe në hipotezë, u vërtetua se variabël ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve. (Tabela: 49-50)

Në këtë mënyrë nxjerrja e këtij përfundimi tregon se studentët që e kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në qytete marrin një arsimim më cilësor se studentët që e kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në zona rurale.

Nga ana tjetër, përfundimi i migrameve të bëra pas fillimit të proceseve demokratike në Shqipëri solli mosformimin e një kulture të mirëfilltë nga ana e popullatës që jetonin në qytet; kjo vjen si përfundim i lëvizjes së njerëzve që migronin nga fshatrat ose nga qendra rurale edhe më të vogla, duke formuar jetesën në hapësira pranë të afërmeve të tyre, si rrjedhojë solli mosndryshimin e mënyrës të jetesës në zonat rurale. Bazuar në rezultatet e përftuara mund të mendohet se institucionet arsimore në qytete funksionojnë në mënyrë më sistematike, mekanizmat kontrolluese përdoren në mënyrë më efektive dhe programet mësimore realizohen në mënyrë më serioze nga ana e mësuesve.

3. Bazuar në rezultatet e hipotezës së tretë të studimit dhe në konstatimet që kemi arritur, sipas disa variablave, nuk ekziston një dallim i rëndësishëm në formësimin e procesit të zhvillimit moral të studentëve, por nga ana tjetër, sipas disa variablave të tjerë, ekziston një dallim i rëndësishëm në formësimin e procesit të zhvillimit moral të

studentëve. Gjithashtu, nga rezultatet e përfutuara është arritur në përfundimin se disa variabla janë heterogjene.

- a. Në përfundim të studimit të realizuar për përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas universiteteve dhe departamenteve ku ata studiojnë, në të kundërt të asaj që është theksuar në hipotezë, edhe pse ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, rezultatet e përfutuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 52-53-54-55-56)

Në tabelën 57, ku janë pasqyruar krahasime në bazë departamenti midis universiteteve, vërehet se departamente të ndryshme në universite kanë nivele të ndryshme të pjekurisë morale. Duke marrë parasysh se përveç lëndëve që u përkasin departamenteve kurrikula që aplikohet në universitetet shqiptare është e njëjtë, përfundimi i këtyre konkluzioneve është normal. Në testet që mund të zhvillohen në departamente të tjera, duke përdorur mjete të tjera matëse, është e mundur të arrihet në përfundime të ndryshme.

- b. Në studimin e realizuar për përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas zonës nga kanë ardhur, në të kundërt të asaj që është theksuar në hipotezë, edhe pse ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, rezultatet e përfutuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 58-59)

Në krahasimin e bërë sipas zonave nga kanë ardhur studentët dhe sipas universiteteve (Tabela: 60) është vërtetuar se studentët nga Shqipëria e Mesme kanë një nivel të pjekurisë morale më të lartë se studentët nga Shqipëria e Veriut dhe e Jugut.

- c. Në studimin e realizuar për përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, sipas përvetësimit të vlerave të shoqërisë ku ata jetojnë, në të kundërt të asaj që është theksuar në hipotezë, edhe pse ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të

pjekurisë morale të studentëve, rezultatet e përftuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 61-62)

Sipas variablit të pavarur për përfshirjen e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar dhe këtij variabli, nënkuptohen shqetësimet e studentëve në lidhje me largimin nga vlerat e tyre dhe si zgjidhje të këtij problemi shikojnë pikërisht përfshirjen në kurrikula të kësaj lënde.

d. Niveli i pjekurisë morale, bazuar në përfshirjen ose jo të një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, në të kundërt të asaj që është theksuar në hipotezë, edhe pse ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, rezultatet e përftuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 64-65)

Nga ana tjetër, fakti se 93 % (1681 studentë) e studentëve dëshironin përfshirjen e një lënde mbi vlerat humane në kurrikulat e arsimit parauniversitar, perceptohet si një pikëpamje pozitive për kërkesën në lidhje me përfshirjen në program të një lënde të tillë.

e. Niveli i pjekurisë morale, sipas profesionit të prindërve, ashtu siç është theksuar në hipotezë, ndërkohë që për baballarët është vërtetuar, ndërsa për nënat edhe pse ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve nuk është vërtetuar, por rezultatet e përftuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 67-68-69-70)

Në fillimet e një studimi të tillë, gjykimi i parë që mendojmë se sjellim është se niveli i pjekurisë morale të fëmijëve, që i kanë prindërit në profesione, si: mjek, avokat etj., me arsim të lartë dhe me të ardhura të larta financiare, është i lartë. Por, ashtu siç u

theksua edhe më lart, mund të themi hapur se kjo hipotezë nuk është e përshtatshme për kushtet e Shqipërisë, sepse shumica e familjeve që i kanë fëmijët në moshën universitare e kanë përfunduar arsimimin në periudhën e fundit të komunizmit ose në periudhën e parë të kalimit në demokraci. Duke u nisur nga ajo periudhë, rreth arsimit universitar në vend, mendojmë se nuk ka dallime shumë të theksuara.

Nëse pas 5-10 vitesh do të bëhej një studim, në lidhje me përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas profesionit të prindërve, do të përftonim të dhëna më të qarta dhe të sakta.

f. Në studimin e realizuar për përcaktimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve sipas gjendjes ekonomike të prindërve, ashtu siç është theksuar në hipotezë, edhe pse nuk ka ndikueshmëri në formësimin e nivelit të pjekurisë morale të studentëve, rezultatet e përftuara janë në një strukturë heterogjene. (Tabela: 73-74)

Në studimet e tjera, në lidhje me këtë pikë, studiuesit edhe pse e kanë zbatuar hipotezën “Gjendja ekonomike ndikon në pjekurinë morale”, një qasje e tillë nuk është e përshtatshme për vendin tonë, sepse një pjesë e madhe e studentëve, ashtu siç është pasqyruar edhe te rezultatet, vijnë nga familje me të ardhura mesatare apo nga familje me të ardhura të ulëta. Prandaj, për një marrëdhënie të drejtë midis nivelit të pjekurisë morale dhe gjendjes ekonomike familjare, mund të jetë një qasje e përshtatshme për vendet që i kanë standardet e jetesës të larta, por të paktën për këtë periudhë nuk është një hipotezë e drejtë për Shqipërinë. Gjithsesi, edhe themeluesi i testit matës Resti (1986, f. 6.4) në testet që ka bërë nuk ka rastisur një marrëdhënie midis “gjendjes ekonomike familjare dhe nivelit të pjekurisë morale të fëmijëve”.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në përfundimet e këtij studimi, për t'i shpënë në nivele më të larta gjykimet morale të studentëve të universiteteve, mund të japim sugjerimet e mëposhtme:

1. Rritja e brezit tonë në një mënyrë të shëndetshme është në proporcion të drejtë me përmbushjen plotësisht të nevojave biologjike, psikologjike dhe sociale të tyre. Fëmijët që nuk i plotësojnë këto nevoja në faza të ndryshme të zhvillimit në një periudhë të jetës së tyre mund të shkaktojnë probleme si në komunitetin ku ata jetojnë ashtu edhe për familjet e tyre. Për këtë arsye, duhet që të plotësohen nevojat psikologjike, biologjike dhe sociale të fëmijëve. Mjediset sociale që do t'ua plotësojnë këto nevoja janë familja: nëna dhe babai dhe institucionet arsimore. Prandaj, si nëna dhe babai, ashtu edhe institucionet arsimore paralelisht me zhvillimin intelektual të fëmijëve duhet të zhvillojnë aktivitete për t'u ardhur në ndihmë atyre në formimin e personalitetit.
2. Në thelb të rritjes së individëve të shëndoshë, si nga ana sociale, ashtu edhe nga ana psikologjike, qëndron sjellja në mënyrë demokratike ndaj fëmijëve dhe të rinjve. Qasja e prindërve dhe mësuesve duhet të jetë logjike dhe konstruktive. Familja duhet të jetë një port, ku i riu të strehohet në kohët e vështira të tij dhe jo të largohet prej saj.
3. Veçanërisht në periudhën e adoleshencës, nevojat e të rinjve duhet të identifikohen në kohë dhe duhet të kërkohen zgjidhje të përshtatshme. Familja dhe institucionet arsimore duhet t'i udhëzojnë të rinjtë për arritjen e një personaliteti të shëndoshë dhe formësimin e identitetit seksual të tyre.
4. Nuk duhet harruar që çdo periudhë ka perceptimin e saj të vlerave dhe mënyrën e jetesës së saj. Nuk duhet harruar që së bashku me ndryshimin e kohës mund të

- ndryshojë edhe një sërë ndjenjash dhe mendimesh. Bota e të rinjve të sotëm nuk është e njëjtë me botën kur prindërit e tyre ishin të rinj. Duhet të zhvillohen sjellje për të kuptuar brezat tanë pa u shmangur nga të vërtetat universale dhe për të fituar vlerat kombëtare dhe universale.
5. Veçanërisht, duhet të organizohen seminare dhe kurse prindërisht ku çiftet e sapomartuar të marrin pjesë për zgjerimin e njohurive mbi rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre të ardhshëm.
 6. Duhet të organizohen aktivitete për formimin sa më të mirë të personelit që punon në institucionet arsimore zyrtare. Seminaret, në të cilat mësuesit duhet të marrin pjesë çdo vit, duhet t'i nxjerrim nga struktura formale e tyre dhe t'i bëjmë të orientuara më shumë drejt rezultateve efektive që të jenë sa më funksionale.
 7. Përmbajtja e kurrikulave të shkollave duhet organizuar në mënyrë të tillë që të ofrojë si vlera kombëtare ashtu edhe vlera universale. Kjo përmbajtje, më shumë se të shpjegohet teorikisht, duhet të zbatohet për të përfutur sjellje në dobi të studentëve dhe të shoqërisë.
 8. Në formësimin e gjykimeve morale të fëmijëve, rëndësia e rrethit shoqëror është e madhe. Prindërit dhe mësuesit duhet t'i ndihmojnë fëmijët në përzgjedhjen e shoqërisë.
 9. Pushtetin e medias, në formësimin e jetës së njerëzve, është një çështje që nuk e kundërshton askush, prandaj, duke përdorur pushtetin e medias si duhet, brezat tanë mund t'i rrisim të shëndoshë etikisht dhe moralisht. Duhet të organizohen programe që të ofrojnë si vlera kombëtare, ashtu edhe vlera universale. Veçanërisht, masmedia duhet të mundësojë që programet me përmbajtje dhune dhe seksualiteti, të cilat ndikojnë në zhvillimin mendor dhe psikologjik të të rinjtë, t'i transmetojë në mënyra të tjera dhe me kontrollin e duhur.

10. Duke analizuar me përkushtim proceset që kanë jetuar në lidhje me këtë temë shtetet e zhvilluara, ne duhet të përfitojnë nga përvoja e tyre në emër të rritjes së brezave dhe mund të hidhen hapa më të saktë në kohën e duhur.
11. Një nga faktorët më të rëndësishëm dhe i pranuar nga të gjithë, që ndikon te niveli i gjykimeve morale të shoqërive dhe individëve, është besimi fetar (feja_. Prandaj, në shkolla mund të organizohen veprimtari informative dhe edukative që përmbajnë argumente fetare.
12. Në shkollat tona mund të zhvillohen metoda të ndryshme për të matur nivelet e gjykimit moral të studentëve. Të dhënat që do t'i përftojmë, do të na ndihmojnë në çështjen e përcaktimit të politikave edukuese të brezava tanë.

SHTOJCA I

Ky pyetësor ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit të çështjeve në një problem social. Do t'ju paraqiten disa tregime rreth një problemi social. Pas çdo tregimi, do të ketë një listë me pyetje. Këto pyetje përfaqësojnë çështje të ndryshme që mund të ngrihen rreth secilit problem. Me fjalë të tjera, pyetësi shpreh mënyra të ndryshme të të gjykuarit se çfarë është më e rëndësishme në marrjen e vendimeve rreth problemit social në fjalë. Juve do t'iu kërkohet të vlerësoni dhe të rendisni pyetjet sipas rëndësisë që ka për ju secila prej tyre.

Ky pyetësor është i ndarë në 2 pjesë: pjesa e parë përmban instruksionet dhe tregimet që paraqesin problemet sociale; pjesa tjetër përmban pyetjet (çështjet) dhe fletën e përgjigjeve ku shkruhen përgjigjet. Më poshtë është një shembull i pyetësit.

Zgjedhjet presidenciale:

Imagjinoni se do të votoni kandidatin për president të Shteteve të Bashkuara dhe përpara se të votoni, ju jepen disa pyetje, me anë të së cilave ju kërkohet se cila çështje është më e rëndësishme për të vendosur se për cilin kandidat do të votoni. Në këtë shembull, ju jepen 5 mundësi përgjigjeje. Në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5 (1-Jam shumë dakord, 2-Jam dakord, 3-Jam neutral, 4-Nuk jam dakord, 5-Nuk jam aspak dakord) ju lutemi të vlerësoni rëndësinë e secilës çështje, duke mbushur me laps kutinë përkatëse në fletën e përgjigjeve.

Më pas, pyetësi do t'ju kërkojë t'i rendisni çështjet sipas rëndësisë. Numrat 1 deri në 12 përfaqësojnë numrin e çështjes. Me radhë, juve do t'ju kërkohet të mbushni kutinë krahas çështjes, duke e vlerësuar në bazë të rëndësisë që ka për ju.

Kujdes se disa çështje mund t'ju duken të parëndësishme ose të pakuptimta. Në këtë rast, zgjidhni variantin “nuk jam aspak dakort”. Vini re se në tregimet në vazhdim, ju paraqiten 12 çështje për çdo tregim. Ju lutemi, sigurohuni që t'i merrni parasysh të gjitha çështjet.

Ju lutem, lexoni tregimin dhe më pas plotësoni përgjigjet në fletën e përgjigjeve.

Shënim: Për plotësimin e anketës nuk nevojitet mjet identifikimi, as të dhënat tuaja personale, dhe çdo informacion në lidhje me ju nuk do të përdoret jashtë këtij studimi. Faleminderit për pjesëmarrjen në plotësimin e anketës.

HISTORIA 1

Në Tiranë, një grua ndodhet në prag të vdekjes nga një lloj i veçantë kanceri. Ekziston një mjekim që sipas mjekëve mund të shpëtojë jetën e gruas. Mjekimi në fjalë është me material radiumi dhe është zbuluar së fundmi nga një farmacist në qytet. Ilaçi kushton shumë për t'u përgatitur. Mbi të gjitha, farmacisti kërkon dhjetë herë më shumë se kostoja e prodhimit të ilaçit. Ndonëse ai kishte paguar 200€ për radiumin, kërkon 2000€ për një dozë të vogël të ilaçit. Bashkëshorti i gruas së sëmurë, Henri, edhe pse shkoi te të gjithë personat që ai njihte për të marrë hua, arriti të siguronte vetëm rreth 1.000€, sasi e cila ishte sa gjysma e asaj që kushtonte ilaçi. Ai i tha farmacistit se gruaja e tij ishte duke vdekur dhe i kërkoi t'i ulte çmimin ose ta paguante një pjesë më vonë, por farmacisti nuk pranoi. Ai këmbënguli në përfitimin monetar të tij. Henri u dëshpërua dhe filloi kështu të mendonte mundësinë e hyrjes me forcë në dyqanin e farmacistit dhe të vjedhjes së ilaçit për gruan e tij. A duhet Henri të vjedhë ilaçin? (zgjidh një nga përgjigjet)

.....Duhet ta vjedhë

.....(nuk jam i/e sigurt)

.....Nuk duhet ta vjedhë

RËNDËSIA:

Zgjidh rëndësinë që sipas jush mbart secila nga shprehjet fragmentare të mëposhtme (sipas shkallës Lickert, nga më e rëndësishmja në më pak e rëndësishmja) për çështjet e moralit. Sipas modelit të testit DIT 1 shprehjet e përdorura dhe të shkurtuara mbi moralin formulohen në formën e pyetjeve apo në formën e pohimeve.

Jam shumë dakord	Jam dakord	Jam neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	
					1. Respektimi i ligjeve të një shoqërie.
					2. Është më se e natyrshme për një bashkëshort që dashuron gruan e tij të vjedhë për të.
					3. Henri duhet të jetë i gatshëm të rrezikojë jetën duke u vrarë si hajdut ose të shkojë në burg për vjedhjen e ilaçit, që në këtë rast është i dobishëm.
					4. Henri duhet të ishte i fuqishëm (i fortë) ose duhet të kishte shokë të tillë.
					5. A duhej të vidhte Henri për veten e tij apo ta bënte këtë vetëm për të ndihmuar dikë tjetër?
					6. Respektimi i të drejtës së pronësisë intelektuale të farmacistit mbi zbulimin e ilaçit.
					7. Jeta në aspekt individual dhe shoqëror është më domethënëse se vdekja.
					8. Gjakimet mbi vlerat shoqërore përbëjnë bazën e mënyrës së sjelljes së njerëzve ndaj njëri-tjetrit.
					9. A është e drejtë që farmacisti të fshihet pas një ligji që mbron vetëm të pasurit?
					10. A është ligji në këtë rast pengesë për përmbushjen e të drejtave themelore të çdo anëtari të shoqërisë?
					11. Farmacisti meriton të grabitet për arsye se është materialist dhe mizor.
					12. Vjedhja në një rast të tillë do të kishte pasoja pozitive për shoqërinë.

Nga lista e mësipërme e 12 pohimeve fragmentare përzgjidhni katër nga ato që ju duken më të rëndësishmet dhe renditini nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja.

SHUMË E RËNDËSISHME E RËNDËSISHME MË PAK E RËNDËSISHME DISI E RËNDËSISHME

--	--	--	--

HISTORIA 2

Një burrë, dënuar me 10 vjet burg, pasi arratiset nga burgu, zhvendoset në një zonë tjetër të vendit dhe e ndërron emrin në Luan. Për 8 vjet ai punon shumë dhe gradualisht ai kursen të holla të mjaftueshme për të hapur biznesin e tij. Në marrëdhënie pune ai është i drejtë me klientët e tij. U jepte punonjësve të vet paga të larta dhe dhuronte shumicën e fitimeve për bamirësi. Një ditë, znj. Laureta, një fqinje e vjetër, e njeh atë si të arratisurin që kishte ikur nga burgu 8 vjet më parë dhe të cilin e kërkonte policia. A duhet ta raportojë znj. Laureta Luanin në polici dhe ta dërgojnë përsëri në burg? (zgjidh një nga përgjigjet)

.....duhet ta denoncojë(nuk jam i/e sigurt)nuk duhet ta denoncojë

RËNDËSIA:

Zgjidh rëndësinë që sipas jush mbart secila nga shprehjet fragmentare të mëposhtme (sipas shkallës Lickert, nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja) për çështjet e moralit. Sipas modelit të testit DIT 1, shprehjet e përdorura dhe të shkurtuara mbi moralin formulohen në formën e pyetjeve apo në formën e pohimeve.

Jam shumë dakord	Jam dakord	Jam neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak	
					1. Zoti Luan ka jetuar një jetë të rregullt aq sa të provojë se ai nuk është një person i keq.
					2. Nëse çdo i dënuar do t'i shmangej ndëshkimit, kjo do të ishte shkak për kryerjen e më shumë krimeve.
					3. Ne do të ishim më mirë nëse nuk do të egzistonin burgjet apo ndëshkimi nga aktet ligjore.
					4. Zoti Luan në të vërtetë i ka shlyer detyrimet e tij ndaj shoqërisë.
					5. Shoqëria është sjellë drejt ndaj zotit Luan.
					6. Veçimi dhe mbajtja mbyllur në burg e njerëzve dhe sidomos e një njeriu bamirës është e dobishme.
					7. Njerëzit nuk duhet të tregohen aq mizorë, sa të mund të dërgojnë zotin Luan në burg.
					8. Lënia e lirë e zotit Luan do të ishte padrejtësi për të burgosurit e tjerë.
					9. Znj. Laureta ishte një shoqe e mirë e z. Luan.
					10. Denoncimi i një kriminelit të arratisur pavarësisht rrethanave është detyrë e çdo qytetari të mirë.
					11. Interesat e individëve duhet të përputhen me interesat e komunitetit.
					12. Hyrja në burg e Z. Luan është në të mirën e tij dhe të shoqërisë.

Nga lista e mësipërme e 12 pohimeve fragmentare përzgjedhni katër nga ato që ju duken më të rëndësishmet dhe renditini nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja.

SHUMË E RËNDËSISHME	E RËNDËSISHME	MË PAK E RËNDËSISHME	DISI E RËNDËSISHME

HISTORIA 3

Një grua ndodhet në prag të vdekjes nga njëkancer i pashërueshëm dhe ka vetëm gjashtë muaj kohë për të jetuar. Ndonëse ajo ka dhembje të tmerrshme, organizmi i saj është aq i dobët, saqë një dozë e plotë qetësuesish si morfina do t'i shkaktonte vdekjen. Në një prej momenteve të saj të qeta, ajo i kërkon mjekut që t'i japë morfina të mjaftueshme sa për t'i marrë jetën, duke u shprehur se nuk mund ta duronte më dhimbjen dhe se gjithsesi ajo do të vdiste disa muaj më vonë.

Çfarë duhet të bënte doktori? (zgjidh një nga përgjigjet)

.....duhet t'i japë zonjës mbidozën(nuk jam i/e sigurt)nuk

duhet t'ia japë zonjës mbidozën

RËNDËSIA:

Zgjidh rëndësinë që sipas jush mbart secila nga shprehjet fragmentare të mëposhtme (sipas shkallës Lickert, nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja) për çështjet e moralit. Sipas modelit të testit DIT 1, shprehjet e përdorura dhe të shkurtuara mbi moralin formulohen në formën e pyetjeve apo në formën e pohimeve.

Jam shumë dakord	Jam dakord	Jam neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	
					1. Duhet të merret parasysh mendimi i familjes së pacientes së sëmurë.
					2. Mjeku duhet të ishte subjekt hetimi nëse legjislacioni në fuqi e konsideron dhënien e mbidozës si vepër penale që synon vrasjen.
					3. Do të ishte më mirë nëse njerëzit do të vendosnin për jetën dhe vdekjen e tyre pa u ndikuar nga shoqëria.
					4. Do të ishte më mirë nëse doktori do ta paraqiste situatën duke e treguar si një aksident.
					5. Shteti duhet të ketë të drejtë për t'u bërë presion, në lidhje me vazhdimësinë e jetës, atyre që nuk duan të jetojnë.
					6. Vlerat humane të pranuar nga shoqëria duhet të kenë epërsi ndaj mendimeve personale të individit.
					7. Mjeku duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi vuajtjeve të gruas, sesa mendimit të shoqërisë.
					8. Ndhimja/bashkëpunimi për t'i dhënë fund një jete tjetër është një akt i përgjegjshëm.
					9. Vetëm Zoti duhet të vendosë mbi fundin e jetës së një personi.
					10. Vlerat që mjeku ka zgjedhur si pjesë e kodit të tij personal të sjellje s'janë të rëndësishme.
					11. Shoqëria mund të lejojë ndërprerjen e jetës për të gjithë ata që duan vdekjen dhe nuk e duan më jetën. (ose pranojë)
					12. Shoqëria mund të lejojë vetëvrasjet apo vrasjet për mëshirë dhe në të njëjtën kohë të mbrojë jetën e individëve që duan të jetojnë. (ose pranojë)

Nga lista e mësipërme e 12 pohimeve fragmentare përzgjedhni katër nga ato që ju duken më të rëndësishmet dhe renditini nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja.

SHUMË E RËNDËSISHME E RËNDËSISHME MË PAK E RËNDËSISHME DISI E RËNDËSISHME

--	--	--	--

HISTORIA 4

Z. Erlis ishte pronari dhe administratori i një servisi makinash. Ai dëshironte të punësonte edhe një mekanik tjetër, por gjetja e një mekaniku të mire ishte e vështirë. I vetmi person, i cili mund të quhej një mekanik i mirë, ishte z. Florian, por ai ishte rom. Vet z. Erlis nuk kishte ndonjë gjë kundër romëve, por frikësohej të punësonte z. Florian, sepse shumica e klientëve të tij nuk i pëlqenin romët. Klientët e tij mund të shkonin të kryenin shërbimet e tyre diku tjetër, në rast punësimi të z. Florian.

Kur z. Florian e pyeti z. Erlis nëse mund të punësohej, z. Erlis iu përgjigj se kishte punësuar dikë tjetër, kur në të vërtetë z. Erlis nuk kishte punësuar asnjë tjetër, sepse nuk mund të gjente një mekanik më të mire se z. Florian.

Si duhet të vepronte z. Erlis? (zgjidh një nga përgjigjet)

.....duhet të punësonte z. Florian(nuk jam i/e sigurt)Nuk duhet ta punësonte

RËNDËSIA:

Zgjidh rëndësinë që sipas jush mbart secila nga shprehjet fragmentare të mëposhtme (sipas shkallës Lickert, nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja) për çështjet e moralit.

Sipas modelit të testit DIT 1 shprehjet e përdorura dhe të shkurtuara mbi moralin formulohen në formën e pyetjeve apo në formën e pohimeve.

Jam shumë dakord	Jam dakord	Jam neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	
					1. Drejtuesi i biznesit ka të drejtë të bëjë zgjedhjet e tij.
					2. Duhet të ketë një ligj që ndalon sjelljet raciale dhe diskriminuese për punësimin.
					3. Erlisi vet është paragjykses ndaj romëve.
					4. Për biznesin, punësimi i një mekaniku të mirë është më i rëndësishëm se plotësimi i dëshirave të klientëve.
					5. Për të vendosur mbi vlerat e pranuar komunitare, duhet të merren në konsideratë veçoritë individuale.
					6. Sistemi kapitalist është i pangopur ndaj duhet braktisur plotësisht.
					7. Pjesa më e madhe e shoqërisë që rrethon punëdhënësin mendon se dëshira e klientit ka përparësi mbi paragjykimet.
					8. Mospërdorimi i talentëve të aftë si mekaniku i mësipërm do të ishte humbje për shoqërinë?
					9. Mospunësimi i mekanikut do të ishte në kundërshtim me vlerat morale të punëdhësit .
					10. Punëdhësi do të ishte aq zemërgurtë sa të mos punësonte mekanikun duke e ditur nevojën e tij për gjetjen e një pune.
					11. Në këtë rast vlen koncepti fetar për të dashur të tjerët.
					12. Një njeri në nevojë duhet punësuar pavarësisht pasajove që do të ketë.

Nga lista e mësipërme e 12 pohimeve fragmentare përzgjidhni katër nga ato që ju duken më të rëndësishmet dhe renditini nga më e rëndësishmja te më pak e rëndësishmja.

SHUMË E RËNDËSISHME E RËNDËSISHME MË PAK E RËNDËSISHME DISI E RËNDËSISHME

--	--	--	--

SHTOJCA-II

Të nderuar studentë,

Ky studim është bërë për të vene ne dukje idetë ne lidhje me Vlerat shoqërore ne komunitetin shqiptar të studentëve të universitetit. Qëllimi i këtij studimi është të njohë më mirë brezin e ri dhe për t'i ardhur në ndihmë atij.

Studimi nuk do asnjë lloj mjet identifikimi. Rezultatet e hulumtimit do te vlerësohen ne një kornizë të përgjithshme pa bërë asnjë deshifrim. Anketa është e përbërë nga dy pjesë. Në pjesën e parë gjenden disa pyetje në lidhje me ju dhe familjen tuaj. Në pjesën e

dytë kërkohet që të jepni vlerësimin tuaj në lidhje me një histori që do ju jepet të lexoni.

Ne këtë pjesë, ju lutem shënoni me (x) opsionin të cilin mendoni qe është me i përshtatshëm. Në qofte nuk keni opsion të përshtatshëm, atëherë zgjidhni atë i cili është me i përafërt për ju. Ju lutem mos harroni që duhet ti përgjigjeni të gjitha pyetjeve te formularit në mënyrë që rezultatet e studimit të jenë sa më të besueshme.

Ju faleminderit për kohën e kushtuar.

Universiteti	 Departamenti.....		
Gjinia	☐ Femër	☐ Mashkull	
Mosha	☐ 17	☐ 18	☐ 19 ☐ 20 ☐ 21 ☐ 22 ☐ 23
Viti i studimit	☐ i parë	☐ i fundit	
Nëna dhe babai	☐ Bashke	☐ Te martuar por jetojnë te ndare	☐ Te ndare
Nëna juaj	☐ Jeton	☐ Ka vdekur	
Niveli i arsimimit te nënës suaj	☐ Nuk di shkrim-lexim	☐ Ka mbaruar vetëm filloren	
	☐ Ka mbaruar te mesmen	☐ Ka mbaruar universitetin	
Babai juaj:	☐ Jeton	☐ Ka vdekur	
Niveli i arsimimit te babait tuaj	☐ Nuk di shkrim-lexim	☐ Ka mbaruar vetëm filloren	
	☐ Ka mbaruar te mesmen	☐ Ka mbaruar universitetin	
Nga cila zonë e Shqipërisë jeni?	☐ Shqipëria e Veriut	☐ Shqipëria e Jugut	☐ Shqipëria e Mesme
Ku e keni kaluar kohën më të gjatë të jetës tuaj?	☐ Qytet	☐ Fshat	
Cila është puna qe bëjnë nena dhe babai?	Punëtor/e : ☐ Babai ☐ Nëna Punonjës shteti : ☐ Babai ☐ Nëna Fermer : ☐ Babai ☐ Nëna Shtëpiake, pa pune : ☐ Babai ☐ Nëna		
Sa janë te ardhurat mesatare ne familjen tuaj?	☐ Me pak se 30,000 lekë ☐ 40,000 - 60,000 lekë ☐ 60,000 -100,000 lekë ☐ Me shume se 100,000 lekë ☐ Me shume se 200,000 lekë		
Cili është raporti qe keni me familjen?	Autoritar/e : ☐ Babai ☐ Nëna Indiferent/e : ☐ Babai ☐ Nëna Tolerant/e : ☐ Babai ☐ Nëna		
Lloji i gjimnazit?	☐ I përgjithshëm	☐ privat	☐ profesional
Sipas jush, a duhet të përfshihet në kurrikulën e arsimit parauniversitar një lëndë mbivlerat humane?	☐ po	☐ jo	
A mendoni që të rinjtë në moshën e universitetit, i kanë përvetësuar vlerat e shoqërisë ku jetojnë?	☐ po	☐ jo	
Sa të lidhur jeni me fenë?	☐ shumë	☐ konsiderueshëm	☐ pak ☐ aspak
Sa të lidhur janë prindërit tuaj me fenë?	☐ shumë	☐ konsiderueshëm	☐ pak ☐ aspak

SHTOJCA III

INTERVISTË-1

Emri – Mbiemri : Prof. Dr. Briseida Mema

Profesioni : Pedagoge- Gazetare e AFP

Datë: 21 /07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljen e të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Trendi ka qenë pozitiv, por njëkohësisht edhe shumë konfuz. Rrethanat politike, sociale, ekonomike, kulturore, kalimi nga një regjim në tjetrin, zhvendosjet e popullësisë, emigrimi, hapja e menjëhershme, kalimi nga një vend teje i izoluar me një kufizim ekstrem lirie në një liri pa kufij, përballja me shumë situata e fenomene të panjohura më parë (droga, prostitucioni, krimi etj.) vunë në pikëpyetje vlerat, identitetin dhe personalitetin individual, duke ndikuar dhe krijuar edhe një konfuzion shoqëror të kushtëzuar nga mjaft faktorë.

2. *A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Çdo njeri çfardo qoftë kombësia, feja, pozicioni shoqëror, idetë politike mund të kultivojë respektin për veten, për tjetrin, për mjedisin ku jeton. Në këtë këndvështrim ne mund të themi se ekziston një moral dhe vlera shoqërore universale të arritshme nga çdo individ. Them “të arritshme”, pasi morali dhe vlerat shoqërore janë gjithashtu edhe një kod jetese, por edhe një status ndërgjegjje. Pra, morali dhe vlerat mbartin edhe një nocion subjektiv, që sigurisht ecën, zhvillohet e që ndryshon edhe nga individ në individ, edhe nga shoqëria në shoqëri.

Morali shoqëror dhe vlerat shoqërore edhe pse mund të jenë në thelb universale kushtëzohet nga mjaft faktorë të jashtëm, që ushtrojnë presion duke modifikuar sjelljet individuale. Kjo duket se ka ndodhur edhe në shoqërinë shqiptare, që u gjend papritur përballë disa fenomeneve të panjohura për normat tradicionale të saj e të ruajtura në mënyrë shumë skematike nga regjimi komunist i kohës, që kishte krijuar formalizimin skematik midis së mirës e së keqës, sipas normave ideologjike të kohës. Edhe normat tradicionale në regjimin komunist kanë qenë norma të formalizuara nga ideologjia.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Gjatë një tranzicioni të gjatë, e gjithë shoqëria shqiptare duket se u gjend në një udhëkryq vlerash, identitetesh të kushtëzuara nga rrethanat ekonomike, sociale, psikologjike, politike. Në këto kushte edhe vetë familja si një bërthamë e fortë e dikurshme e shoqërisë pësoi një lëkundje mjaft të fuqishme në statusin e saj të vlerave.

Shumë vlera morale tradicionale u vunë në pikpyetje, vlerat e familjes duket se u tronditën ndjeshëm. Shoqëria e pati edhe ajo vetë të vështirë të krijonte sistemin e vlerave të reja, duke qenë se ishte tërësisht e papërgatitur për të krijuar balanca midis nocionit të së mirës dhe së keqës që shpesh u vunë në funksion të rrethanave ekonomike dhe sociale duke lëkundur ndjeshëm sistemin e vlerave dhe sjelljeve të të rinjve shqiptarë.

4. Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)

Sigurisht familja, shkolla, institucionet e arsimit, por edhe shoqëria civile dhe media, institucionet fetare gjithashtu luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në konsolidimin e vlerave shoqërore të të rinjve shqiptarë.

Deri më sot duket se është bërë pak ose aspak në këtë drejtim. Në shumë raste familja ka qenë e papërgatitur për të përballuar problematikën sociale me të cilën është vënë përballë në kushtet e reja të hapjes, nga ana tjetër niveli i edukimit në sistemin arsimor ka qenë mjaft i ulët e i paaftë për të ngritur strategji edukimi, po ashtu edhe veprimet e shoqërisë civile kanë qenë të shkëputura për të pasur një reagim aktiv mbi brezat e rinj. Të njëjtën gjë do thoja edhe për institucionet fetare që pak janë marrë me formimin e konsolidimin e vlerave shoqërore universale apo problemeve të tjera me të cilën u ndesh shoqëria shqiptare e pa përgatitur.

5. Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?

Duhet një bashkërendim i punës së gjithë aktorëve: familja, shkolla, institucionet fetare, shoqëria civile dhe institucionet qeveritare. Pra, duhen strategji globale

(sigurimi i mundësisë së punësimit, reduktimi i varfërisë, problemet e pronës, drejtësia, dënimi i krimit dhe rrugëve të paligjshme të fitimit, mosrespektimi i ligjit).

Pasurimi i shpejtë dominoi në shumë raste vlerat e familjes. Media ka një rol të madh në promovimin e personazheve që nuk përbëjnë vlera morale të një shoqërie, por mishërojnë pasurimin e shpejtë, imazhe të rreme të një luksi të rremë e jo të një punë të fituar me djersë, në rrjetet sociale gjen pak të rinj që përpiqen e luftojnë, por gjen të rinj që pozojnë në makina të shtrenjta e vajza që vishen me marka të shtrenjta. Një moral fallco i krijuar e që kontraston me jetën reale të shoqërisë shqiptare. Edhe shoqëria civile, por edhe shkolla nuk kanë mundur të krijojnë strategji të përbashkëta për të mos folur për familjen kryesisht të zonave rurale nga vjen edhe pjesa më e madhe e shoqërisë që nuk ka gjetur ende ekuilibrin e vlerave.

INTERVISTË-2

Emri – Mbiemri : Andon Merdani

Profesioni : Episkop i Krujës

Datë: 23 /07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Nga një ëndërr dhe padurim për të ndryshuar sa më shpejt drejt mirëqenies dhe vlerave më të përparuara evropiane dhe perëndimore gjerësisht, drejt një lloj zhgënjimi kundrejt institucioneve shtetërore lidhur me fenomenin e korrupsionit dhe neglizhencës si dhe të pasigurisë për të ardhmen.

- 2. A mendoni se morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Sigurisht që po, duke u nisur kryesisht nga parimet e besimit të krishterë, morali dhe normat e vlerave shoqërore shprehen dhe interpretohen nën frymën që kisha orthodhokse i beson dhe interpreton ato. Ato vijnë si parime të frymëzuara të Perëndisë për njeriun dhe janë universale dhe të përhershme.

Sigurisht këtu nuk bëhet fjalë për kultura dhe tradita njerëzore të marrëdhënieve shoqërore, të cilat nuk kanë asgjë të keqe ose të mirë ekskluzive, por janë thjesht zhvillime dhe shprehje të caktuara të ndjenjave, historisë dhe kushteve të caktuara dhe shprehje e marrëdhënieve njerëzore.

E thënë me fjalë të tjera, kisha mëson se ekziston mëkati dhe virtyti, të dyja kanë shprehjet e tyre brenda çdo konteksti kulturor dhe shoqëror. Kufiri mes tyre në shumë raste është tepër i qartë dhe i përcaktuar, siç është zbuluar nga shkrimet e shenjta përmes urdhërimeve dhe porosive të ndryshme, në disa raste të tjera ai mund të jetë pak më i vështirë për t'u dalluar dhe përcaktuar, por sigurisht që ekziston.

3. Cili është opinionimi juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?

Mendoj se ka një tendencë globale për t'i sfiduar normat tradicionale nga brezat e rinj, që në periudhën e sotme kjo dukuri bëhet edhe më e dukshme dhe më e fortë. Ndryshimet dhe zhvillimet e njëpasnjëshme teknologjike dhe mediatike i kanë përshpejtuar këto procese, duke e bërë më të madh dallimin mes brezave. Ky fenomen pasqyrohet gjithashtu edhe në shoqërinë shqiptare. Duket sikur ende ekzistojnë disa tradita të mira që ruhen, të cilat kanë lidhje me familjen dhe kombin ose besimin fetar.

4. Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh. familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)

Mendoj se aktorët e përmendur më lart janë të domosdoshëm në formimin dhe kultivimin e vlerave shoqërore tek të rinjtë.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Sjellja gjithnjë e më shumë në vëmendje nga të gjithë aktorët e rolit dhe rëndësisë së madhe që kanë të rinjtë dhe nevojën e madhe për miredukimin e tyre, angazhime konkrete me ta, por edhe angazhim dhe motivimi i vetë tyre, pra të rinjve, ndaj përballjes me fenomene dhe tendenca negative dhe inkurajimin drejt vlerave pozitive

INTERVISTË-3

Emri – Mbiemri : Dr. Ferdinand Xhaferaj

Profesioni : Politikan, Ish-ministri i Kulturës

Datë: 25 /07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljen e të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Mbas shembjes së regjimit totalitar, shoqëria shqiptare u ballafaqua me një tranzicion të dyfishtë. Nga njëra anë duhej të transformonte ekonominë e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë dhe ndërkohë duhej të garantonte rritjen ekonomike. Kjo do të thotë se shumë angazhime të tjera që kanë të bëjnë edhe me formësimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore dhe demokratike kanë mbetur në periferi të objektivave të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Gjatë dekadës së parë të tranzicionit, institucionet shtetërore nuk e konceptonin si angazhim të tyre parësor problematikën e kultivimit në shoqëri të vlerave morale dhe shoqërore, ndërsa shoqëria civile ishte inekzistente. Gjatë kësaj dekade në fushat e jetës morale ne u

ballafaquam me një situatë të shpërthimit të nihilizmit moral. Kjo sepse për më shumë se gjysmë shekulli të regjimit diktatorial, shoqëria shqiptare pranoi apo u detyrua të pranojë si parime morale ca dogma antihumane, të cilat duke nëpërkëmbur dinjitetin njerëzor ndihmuan në shkatërrimin e vlerave të trashëguara të shoqërisë shqiptare. Vetëm vitet e fundit mund të themi se si shoqëria civile, ashtu edhe institucionet shtetërore janë angazhuar dhe kanë bashkëpunuar së bashku për të krijuar infrastrukturën e nevojshme për të trajtuar me cilësinë e duhur problematikën e kultivimit në shoqëri të vlerave morale.

Nëse kthejmë kokën pas në këto 25 vite mund të themi se politika ka folur shumë për rininë dhe vlerat që ajo duhet të mbart. Gjithmonë ka ekzistuar një hendek i madh midis retorikës politike për vlerat që duhet të mbart rinia dhe produktit real të krijuar nga politika në favor të rinisë. Rinia ka qënë një term i mbipërdorur bukur në deklarata dhe fjalime politike, por asnjëherë nuk ka arritur të formësohet si prioritet i politikës. Sidoqoftë është pozitiv fakti se gjatë dekadës së fundit kemi krijuar një trend ku institucionet shtetërore në bashkëpunim me shoqërinë civile kanë hartuar në vitin 2007 Strategjinë Kombëtare të Rinisë (2007-2013). Së fundmi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) hartoi Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë (2015 – 2020), i cili u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015. Këto janë inisiativa konkrete, që duke promovuar jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike dhe vendimarrjen politike, por edhe vullnetarizmin dhe aktivizime të tjera kulturore, sociale dhe sportive krijojnë shtratin e nevojshëm për kultivimin dhe përsosjen e vlerave morale.

2. *A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Kjo është një pyetje që i mbart të dyja përgjigjet brenda. Krahas moralit universal që është i aplikueshëm te të gjithë pavarësisht kulturës, fesë, racës, seksit apo kombësisë ne kemi edhe moralin nihilist apo relativist. Relativizmi moral përpiqet të shpjegojë se vlerat morale ndryshojnë jo vetëm nga koha në kohë, por edhe nga një shoqëri në një tjetër. Shqipëria për shëmbull ka lënë mbas krahëve shumë sjellje të etikës normativiste të së kaluarës që inspiroheshin nga morali doktrinarist.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Ndryshimet e jetës shoqërore krijojnë një presion të vashdueshëm për t'i larguar të rinjtë shqiptarë nga parimet e moralit tradicional. Nisur nga kjo premisë kërkohet që shoqëria civile dhe institucionet edukative të kultivojnë ato vlera tradicionale që kemi krijuar nga shumë breza. Kjo bëhet e domosdoshme për të garantuar edhe kohezionin social, sepse vlerat tradicionale që sendërzohen bazuar në traditën, historinë, gjuhën dhe kulturën kontribuojnë edhe për më shumë solidaritet social. Mendoj se rinia shqiptare po lëviz gradualisht nga një nihilizëm pasiv që shkatërron traditën për llogari të kohës moderne drejt një nihilizmi aktiv që është selektiv dhe përpiqet jo vetëm të largojë vetëm moralin doktrinar të kultivuar nga regjimi totalitar, por njëkohësisht përpiqet të moderojë traditën dhe të ndërtojë një etike që përshtaten me ndryshimet shoqërore.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? Cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Nisur nga këndëvështrimi sociologjik besoj se biem dakort se në shoqërinë shqiptare ka një nevojë në rritje për më shumë etikë. Media na prezanton gjithmonë e më shumë një tendencë në rritje të problematikave morale të dhunës, mungesës së qytatarisë dhe deri diku një farë nervozizmi social. Nga këtu buron domosdoshmëria se individit duhet të mësohet jo vetëm lidhur me kodet universale të sjelljes, por edhe me më shumë parime të sjelljes dhe etikës individuale. Kjo do të thotë se konsolidimi i vlerave morale dhe shoqërore te të rinjtë shqiptarë më shumë se strategji është një proces që kërkon si të domosdoshme dhe nuk mund të kryhet me cilësinë e duhur pa kontributin e të gjithë aktorëve që nisin me familjen, shoqërinë civile, institucionet fetare dhe ato qeveritare.

INTERVISTË-4

Emri – Mbiemri : Gëzim Tushi

Profesioni : Sociolog, Instituti Shqiptar i Sociologjise

Datë: 27/07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Trendi i shoqërisë shqiptare është formatuar nga ndikimet e një tranzicioni kaotik, me të cilin u kalua nga shoqëria totalitare dhe njeriu dogmatik në shoqërinë demokratike dhe njeriun e lirë. Situata tregon se aktualisht nëse tranzicioni politik dhe ekonomik duhet konsideruar të mbyllur (pa rrezik për rikthim të komunizmit apo restaurim të pronës shoqërore), për sa i takon tranzicionit moral ai nuk është mbyllur. Shkaku është kalimi eruptiv nga shoqëria kolektiviste, holiste, tradicionale në atë postmoderne, në qendër të të cilit nuk është më shoqëria, por njeriu individualist, egoist që ka qëllime dhe kërkesa konkrete që do t'i plotësojë me çdo kush “këtu dhe tani”.

2. *A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Jo unë nuk besoj më në mundësinë e moralit universalist, të përbashkët dhe autetntik për të gjithë kombet, popujt, racat. Pa mohuar një sistem të ngjashëm vlerash dhe një dimension të përbashkët human të moralit, unë besoj se morali i kohës postmoderne është “moral kontekstual” që përshtatet me traditat, zakonet, rrugën e zhvillimit historik, klimën etj.

Diversifikimi i sistemit të vlerave morale është veti universale e shoqërisë së hapur. Në këto kushte madje unë besoj se në të ardhmen do të flasim akoma më shumë për “moralin e personalizuar”, sepse njeriu i lirë nuk ka dëshirë të jetë konformist dhe të nënshtrohet nga tirania e disa rregullave të caktuara tërësisht nga jashtë. Megjithatë diçka do mbesë e përbashkët në kuptimin e përcaktimit të një lloji kufiri human për të moralshmen dhe të pamoralshmen, të mirën dhe të keqen.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Tendenca që është bërë dominante në shoqërinë tonë është mohimi i cdo gjëje që vjen nga shoqëritë e së kaluarës dhe nihilizimi i tërë sistemit të vlerave të shoqërisë tradicionale shqiptare.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Unë mendoj se aktorët dhe faktorët që kanë role edukuese në shoqëri kanë humbur shumë nga autoriteti i tyre tradicional dhe kjo ka bërë që të ndihemi sikur jetojmë në një “shkretëtirë morale”. Sipas mendimit tim, në shoqërinë tonë duhet të angazhohjmë

institucionet kryesore të sigurisë morale që janë familja, shkolla, institucionet fetare dhe media.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Strategjitë sipas meje nuk janë shumë. Që të mos hallkatemi me këtë çështje është e nevojshme të ndërtojmë atë sistem që i mëson dhe edukon njerëzit jo me dogma dhe ideologji të mëdha, por me një sistem vlerash humane që e ndihmojnë njeriun në jetë “të luajë rolin sipas pozicionit social”. Kjo do të thotë që duhet të mësojmë fëmijët të sillen si fëmijë, që prindërit të bëjnë prindin dhe të dinë të prindërojnë, mësuesi të bëjë mësuesin dhe jo vagabondin në shkollë, që klerikët (muslimanë e katolikë) të punojnë për përgatitjen shpirtërore të njeriut për të përballuar rreziqet dhe vështirësitë e jetës.

INTERVISTË-5

Emri – Mbiemri : Dr. Gjon Boriçi

Profesioni : Pedagog, Iliria College, Kosova

Datë: 28 /07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Shoqëria shqiptare pas rënies së regjimit komunist është karakterizuar nga një lëvizje pa orientim të saktë interesash. Thirrja e fillimit të viteve' 90 "E duam Shqipërinë si gjithë Evropa" u zbeh shpejt, dhe shoqëria shqiptare e pa veten në një rreth vicioz, nga i cili edhe sot e kësaj dite nuk po del dot. Trendi është ende i pakuptueshëm pasi që të ndjekësh një trend është e nevojshme një strategji. Pa strategji nuk ka trend.

- 2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Vlerat universale si morali, mirënjohja dhe ndershmëria janë universale dhe të patjetërsueshme. Çdo shoqëri, e avancuar në zhvillim e sipër apo e prapambetur e ka të nevojshme t'i ketë këto vlera në qendër të zhvillimit të vet.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Normat tradicionale po harrohen gjithnjë e më tepër dhe ky është një fenomen, që nuk gjen shpjegim të saktë për mendimin tim. Sado e avancuar të bëhet një shoqëri, e ka të nevojshme të mos harrojë origjinën e saj dhe si ka ardhur nëpërmjet epokave në kohën tonë. Familja, pa dyshim luan një rol të madh në këtë drejtim. Dobësimi i familjes në Shqipëri ka sjellë edhe lënien në harresë të normave tradicionale prej të rinjve.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh. familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Familja është e para që duhet të marrë përgjegjësinë. Elementët e tjerë janë të një rëndësie sekondare.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Që një shoqëri të avancojë, strategjia e parë duhet të jetë përmirësimi ekonomik i gjendjes nëpërmjet punës së ndershme. Të rinjtë shqiptarë nuk lodhen nga puna (ose janë të papunë) dhe shumicën e kohës e kalojnë në kafe apo duke u marrë me facebook. Televizioni luan një rol shumë negativ te të rinjtë, pasi konsumon gjithnjë gjëra luksi, por sesi arrihet te luksi nuk shpjegohet. "Easy money" për fat të keq po kthehet në kulturë.

INTERVISTË-6

Emri – Mbiemri : Lutfi Dervishi

Profesioni : Gazetar

Datë: 30/07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljen e të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Shqipëria ka qenë e mbyllur jo vetëm ndaj “Perëndimit”, por edhe ndaj fqinjëve. Një moment ekstrem është se u shpall edhe shteti i vetëm ateist në botë. I rrënuar ekonomikisht, i rraskapitur shpirtërisht, vendi përjetoi një eksod të konsiderueshëm dhe vlerësohet se mbi 30% e popullsisë është larguar. Në vitin 2000 numri i personave që merrnin pjesë për llotarinë amerikane i kalonte 1 milionë! Ndarja e familjes, (numri i konsiderueshëm i divorceve erdhi nga emigrantë të vendosur në Greqi dhe Itali) Në këto 25 vjet shoqëria po përpiqet të njohë rrënjët e veta (të prera dhunshëm) dhe në të njëjtën kohë të jetë në hapin e kohës. Tronditja e vlerave shoqërore, morale dhe etike është e pranishme edhe sot e kësaj dite.

2. *A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Sigurisht ka gjëra që janë universale (mos vidh, mos vrit, mos lakmo pasurinë e tjetrit, respekto të moshuarin etj), por aspekte të veçanta janë më të spikatura në shoqëri të ndryshme.

3. *Cili është opinionimi juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Normat tradicionale janë lëkundur për arsye të përmendura më lart dhe varet për çfarë konkretisht po flasim. Trendi është urbanizimi popullsisë, jetesa në familje të vogla, nataliteti ulët dhe të rinjtë të kapluar në kthetrat e teknologjisë.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Është një “aksion” që nuk ka sukses nëse ndërmerret nga një aktor i vetëm. Baza është familja, një rol edukues ose ç’edukues mund të luajë media, por sigurisht edhe institucionet fetare. Në radhë të parë mungon një debat për “vlerat e shoqërisë”. Kapitali moral befas u zëvendësua me kapitalin financiar dhe është kjo e fundit që ushtron tryzni negative. Debatimi i munguar nis me shkollën (tekstet), me median, me institucionet fetare, me OJF dhe përfundon te partitë politike.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Duhet një “ushtrim” që t’i japë përgjigje pyetjes: familja shqiptare në shekullin I dhe familja shqiptare në shekullin XXI.

INTERVISTË-7

Emri – Mbiemri : Prof. asoc. Tidita Abdurramani

Profesioni : Ish-drejtoresha e Institutit të Zhvillimit të Arsimit

Datë: 30/07/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Gjatë tranzicionit të tejzgjatur të periudhës paskomuniste kanë ndodhur ndryshime rrënjësore në perceptimin, përcjelljen dhe përkrahjen ndaj vlerave morale dhe shoqërore. Shumë nga ato aspekte që kohë më parë konsideroheshin si vlera filluan të konsiderohen si antivlera dhe në shoqëri dhe kryesisht mes të rinjve u përhap trendi i përqafimit të këtyre të kundërta si një nga mënyrat kryesore për të qenë bashkëkohor dhe i pëlqyeshëm nga të tjerët.

- 2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Morali dhe vlerat shoqërore ndryshojnë në shoqëri të ndryshme në varësi të kulturës, dinamikave sociale, historike, fetare etj.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Të rinjtë shqiptarë pas viteve' 90 morën një qëndrim distancues nga ajo që konsiderohej si tradicionale dhe klasike dhe përqafuan të reën, të shfrenuarën dhe shumë herë antimorale si elementë pasqyrues të të qenit modern. Pas viteve' 2000, të rinjtë filluan të ndërgjegjësohen që të jesh modern nuk do të thotë të përqafosh antivlerat dhe imoralitetin dhe filluan të respektonin dhe të lartësonin ato elementë të tradicionales që ia vlen të ruhen dhe të përcillen nga njëra epokë në tjetrën.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Familja duhet të marrë përgjegjësi për ushqimin e vlerave dhe të moralit që në gjenezë të të rinjtë shqiptarë, ndërsa institucionet qeveritare duhet të marrin përsipër të krijojnë variacioni dhe hapësira që të rinjtë shqiptarë të qëndrojnë larg veseve të këqija.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Rishikimi i kuadrit ligjor dhe ngritja e shumë politikave sociale nga ana e Ministrisë së Rinisë dhe Mirëqenies.

INTERVISTË-8

Emri – Mbiemri : Prof. Dr. Zyhdri Dervishi
Profesioni : Sociolog, Profesor në Departamentin e Shkencave
Sociale në Universitetin e Tiranës.

Datë: 02/08/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Pas shpërbërjes së regjimit socialist totalitar në shoqërinë shqiptare zhvillimet në çdo fushë janë karakterizuar nga faza çoroditjeje dhe anarkie problematike, të cilat ende nuk janë tejkaluar.

- 2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Një pjesë e konsiderueshme e vlerave dhe normave morale, kulturore janë universale, por ato përthihen konsiderueshëm në veçoritë e modelimit psikokulturor të çdo populli, pra kanë edhe ngjyresë kombëtare. Vlen të theksohet se përforcimi i prirjeve globalizuese përgjithësisht i zbeh nuancat kombëtare edhe në këto fusha.

3. Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?

Të rinjtë shqiptarë përgjithësisht priren të largohen nga modelet e sjelljeve dhe normat kulturore tradicionale, ata priren të imitojnë modele sjelljeje të të rinjve të vendeve perendimore më të urbanizuara, si Italia, Gjermania, SHBA etj.

4. Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërorë të të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)

Rol të rëndësishëm në edukimin me moral të shëndoshë të të rinjve mund dhe duhet të luajë familja, sistemi shkollor me të gjithë përbërësit e tij (programe, tekste, mësues, pedagogje etj.), institucionet fetare, institucionet kulturore e artistike shtetërore, televizionet, botimet e ndryshme etj. Ndërsa e ashtuquajtura shoqëri civile në Shqipëri deri tani ka ndikuar fare pak ose nuk ka ndikuar për mirë. Madje në ndonjë rast ka ndikuar për keq. Urojmë që në të ardhmen të ndikojë për mirë.

5. Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?

Shoqëria shqiptare deri tani më shumë ka shkatërruar sistemin totalitar se sa ka ndërtuar sistemin demokratik. Tani shoqëria shqiptare lipset të ndërmarrë reforma rrënjësore e të shpejta për të ngritur një sistem arsimor eficient, për të përforcuar realisht rolin e moralit fetar në çdo qelizë të shoqërisë, për të zhvilluar harmonikisht ekonominë etj.

INTERVISTË-9

Emri – Mbiemri : Skender Bruçaj

Profesioni : Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Datë: 04/08/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Shoqëria shqiptare ka kaluar një periudhë të vështirë tranzicioni, duke u përballë me sfida të gjithanshme, me një emigrim masiv të shqiptarëve jashtë atdheut dhe me një migrim të popullsisë nga fshati në qytet dhe nga fshati e qytetet në kryeqytet, duke u përballur me përplasje kulturash e nënkulturash, si dhe probleme midis brezave për shkak të një ndryshimi të shpejtë të mentalitetit dhe koncepteve për jetën.

- 2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Morali dhe vlerat shoqërore janë universale, por ata marrin nuanca kulturore në shoqëri të ndryshme.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Të rinjtë shqiptarë janë në përgjithësi në ndjekje të trendeve të reja, sipas modeleve të imituara nga trendet ndërkombëtare. Janë të rralla dhe të paktë ata që ndjekin traditën dhe normat e saj.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh. familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Të gjithë faktorët edukativë si familja, shkolla, shoqëria civile, media, institucionet fetare dhe shtetërore duhet të kenë dhe kanë një përgjegjësi të madhe në edukimin, formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Strategjitë duhen ndërtuar nga politikat shtetërore nëpërmjet shkollave dhe arsimit publik dhe jopublik, por në këtë rast edhe shkollat që përmbajnë lëndë fetare, siç janë medresetë luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e vlerave, vërtetuar kjo edhe nga studime të ndryshme sociologjike, të cilat vënë në pah ndryshimin e perceptimit të problemeve nga nxënësit e shkollave të ndryshme me atë të medreseve.

INTERVISTË-10

Emri – Mbiemri : Besnik Mustafaj

Profesioni : Shkrimtar, Ish-minister i puneve te jashtme

Datë: 19 /08/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljen e të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Besoj se trendi ka qenë gjithmonë në drejtimin e duhur. Pavarësisht ngërçeve që ka kaluar dhe ndryshimeve të forcave politike në pushtet, nuk është shmangur orientimi drejt integritit në Bashkimin Europian dhe në NATO. Ruajtja e këtij trendi është vlera kryesore e klasës politike udhëheqëse të Shqipërisë gjatë këtij çerek shekulli postkomunist. Në sajë të këtij trendi politik është ruajtur edhe trendi për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Thelbi i kritikizmit mbi zhvillimet e brendshme në shoqërinë shqiptare gjatë kësaj periudhe ka të bëjnë me ritmet e transformimeve që kupton ky trend dhe me cilësinë e procesit nëpërmjet të cilit do të realizoheshin këto transformime demokratike.

2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?

Qëndrimi ndaj të mirës dhe të keqes, që përbën thelbin e moralit si dhe disa nga vlerat themelore shoqërore si marrëdhënia e individit me paranë dhe vlerësimi i punës si krijuese e mirëqënies, vlerësimi i familjes si qeliza ripërtëritëse e shoqërisë, apo vlerësimi i solidaritetit ndaj të dobët mendoj se janë universale. Por mënyra e shfaqjes së tyre në realitet mund të ndryshojë nga një shoqëri te tjetra, në përputhje me gjumët që ka lënë historia nëpër të cilën ka kaluar njëra apo tjetra shoqëri. Për shembull, tabutë morale, që ka trashëguar shoqëria shqiptare nga e kaluara e vet, në shumicën e tyre nuk janë të njëjta me tabutë morale që ekzistojnë në Francë apo me të tjera tabu, që ekzistojnë në Turqi.

3. Cili është opinionimi juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?

Në rastin e Shqipërisë, mendoj se në këtë aspekt termi “tranzicion” merr tashmë kuptim edhe më të plotë se sa kur flasim për ndërtimin e tregut të lirë apo të shtetit të së drejtës. Shoqëria shqiptare është në tranzicion të plotë nga një shoqëri e mbyllur e ksenofobike drejt një shoqërie të hapur e kozmopolite. Ky tranzicion po përcillet me një konfuzion të madh, i cili ka shpjegimin e vet kur është fjala për sjelljet dhe normat tradicionale të shqiptarëve. Nga një anë, ky konfuzion shpjegohet me faktin se gjatë izolimit gjysmë shekullor, regjimi komunist jo vetëm shkëputi lidhjet dhe komunikimin e shoqërisë shqiptare me pjesën tjetër të Europës, por veçoi në mënyrë sistematike dhe të dhunshme për të asgjësuar deri në rrënjë traditat e kësaj shoqërie, të cilat i binin ndesh stereotipit të “njeriut të ri komunist”. Për pasojë, vetë brezi i prindërve të rinisë së sotme nuk ka përgatitjen e mjaftueshme për t’u përcjellë fëmijëve sjelljet dhe normat tradicionale shqiptare. Nga ana tjetër, përfshirja e

shoqërisë shqiptare në rrjedhat e zhvillimeve globaliste u bë në mënyrë të menjëhershme dhe shumë të vrullshme, pa u lënë elitave kohë për reflektim, që do të thotë se elitat shqiptare nuk ishin dhe vazhdojnë të mos jenë në rolin e tyre për t'i orientuar këto zhvillime drejt një ndërthurjeje më të natyrshme midis normave të shëndetshme tradicionale dhe atyre kozmopolite.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Ka shumë aktorë që duhet të marrin përgjegjësi më të madhe në konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë e sotëm shqiptarë. Ndër to, do të theksoja familjen, shkollën dhe mediat.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Pyetja juaj kërkon një përgjigje shumë komplekse. Me pak fjalë, do të thosha se më urgjente është një strategji për forcimin e familjes dhe rivlerësimin e saj si qeliza edukative bazë e shoqërisë si dhe një strategji për shkollën, me përparësi sistemin parauniversitar, ku edhe përfshihet brezi i ri në tërësinë e vet.

INTERVISTË-11

Emri – Mbiemri : Prof.Dr. Gjergj Sinani

Profesioni : Pedagog

Datë: 22 /08/2015

Pyetësor

Qëllimi i pyetësorit është të nxjerrë në dukje sfidat e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të tejzgjatur politik të periudhës paskomuniste, ndryshimet e ndodhura në perceptimin e vlerave shoqërore dhe masat e ndërmarra në këtë kuadër nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, media etj. Studimi është i organizuar mbi sjelljene të rinjve që studiojnë në universitete nga doktorant Fatih Ufuk Bağcı në kuadër të punimit doktorat në Departamenti e Pedagogjisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti Evropian i Tiranës / Shqipëri.

- 1. Çfarë mendoni mbi trendin që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare pas rënies së regjimit totalitar e deri më sot?*

Sigurisht, në qoftë se do të shpreheshim shkurtimisht, trendi është pozitiv, në kuptimin se lëvizja e shoqërisë shqiptare drejt lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës është një trend pozitiv. Në qoftë se do të ndaleshim në ritmin dhe shpejtësinë e këtij procesi, këtu ka shumë pengesa që e kanë vonuar këtë trend të shoqërisë shqiptare drejt demokracisë e lidhur kjo me shumë faktorë, ku përgjegjësia qendron në faktorin politik që ka drejtuar këto vite tranzicioni. Prandaj, në kuadër të një tipologjie politike, demokracia shqiptare mbetet një demokraci hibride.

- 2. A mendoni morali dhe vlerat shoqërore janë universale, apo ndryshojnë në shoqëri të ndryshme?*

Nuk ka dyshim se ka disa vlera universale, pa të cilat do të ishte i pamundur dialogu ndërmjet individëve në një shoqëri dhe ndërmjet shoqërive të ndryshme. Këto vlera

universale, përbëjnë atë bashkësi vlerash, që në qoftë se do të shpreheshim me gjuhën e Kantit, përbëjnë ligjin moral të çdo sholerat më të rëndësishme të çdo shoqërie, qenie. Ndërsa rregulla dhe vlera që karakterizojnë shoqëri të caktuara, janë rezultat të faktorëve lokalë të bashkësive të caktuara, rezultat i evolucionit shoqëror dhe politik të këtyre bashkësive. Një nga vlera, në mos më e rëndësishmja, është ajo e dinjitetit të personit njerëzor. Në këtë kuadër, çdo shoqëri duhet të përpunojë norma dhe ligje që shkojnë në favor të lulëzimit të dinjitetit të personit njerëzor. Shoqëritë që dalin nga regjimet totalitare e kuptojnë më së miri rëndësinë e një vlere të tillë.

3. *Cili është opinioni juaj mbi përvetësimin e sjelljeve dhe normave tradicionale nga të rinjtë shqiptarë?*

Më duket se një ndarje ndërmjet normave tradicionale dhe atyre moderne është shumë skematike dhe do të kërkonte një diskutim të gjatë teorik mbi kuptimin e normave tradicionale. Në qoftë se do të marrim si kriter çështjen e dinjitetit të personit njerëzor, janë të mirëpritura të gjitha ato vlera tradicionale që shkojnë në favor të dinjitetit njerëzor.

4. *Sipas jush, cilët mendoni se janë aktorët kryesorë që duhet të marrin përgjegjësi në formimin dhe konsolidimin e vlerave shoqërore te të rinjtë shqiptarë? (P.sh.familja, shoqëria civile, institucionet fetare, institucionet qeveritare etj.)*

Mendoj se duhet të përfshihen të gjithë aktorët që ju përmendni më sipër, pasi çështja e vlerave që duhet të karakterizojë individët e një shoqërie nuk është një çështje që i takon vetëm një subjekti, por i takon tërë institucioneve duke filluar nga familjë e deri te institucionet shtetërore. Nisur nga fakti se problemet fetare po shëndrrohen në probleme të manipulimit politik, atëherë duhet që institucionet fetare të ndikojnë në respektimin e tjetrit, si një nga preokupimet themelore të mësimin fetar të të gjitha

feve monotesite dhe të qartësojnë aderuesit e tyre, se urrejtja mbi baza fetare nuk përbën thelbin e mësimit fetar.

5. *Sipas jush, cilat janë strategjitë që duhen ndërmarrë në këtë kuadër?*

Mendoj se strategjitë duhet të jenë objekt i një dialogu të përgjegjshëm ndërmjet institucioneve shqiptare dhe aktorëve të shoqërsë civile, përfshirë këto dhe aktorët fetarë, pasi shqetësimi kryesor duhet të jetë paqja sociale. Nisur nga ky shqetësim, pa një dialog të hapur dhe të sinqertë ndërmjet këtyre faktorëve, nuk mund të ndërtohet strategji të mira, të cilat duhet të përfshijnë;

- a. Sistemin e edukimit.
- b. Familjen.
- c. Strukturat shtetërore.
- d. Median.
- e. Institucionet fetare.

BIBLIOGRAFIA

- Afşar, T. (1997). Sorumluluk Nedir? *Felsefe Dünyası*, sayı: 23,15-21.
- Ahioğlu-Lindberg, E. N. (2011). Piaget ve Ergenlikte Bilişsel Gelişim. *Kastamonu Eğitim Dergisi* 19(1), 1-10.
- Akarsu, B. (1982). *Ahlak Felsefresine Giriş*. İstanbul: Remzi Kitabevi.
- Akarsu, B. (1982). *Ahlak Öğretileri*. İstanbul: Remzi Kitabevi.
- Akarsu, B. (1984). *Felsefe Terimleri Sözlüğü*. Ankara: Savaş Yayınları.
- Akarsu, B. (1998, April). *Ders Belgeliği*. Retrieved 03 15, 2015, from <http://mimoza.marmara.edu.tr/~avni/dersbelgeligi/dersbelgeyazilari/dboniki/3bediaakarsu.htm>
<http://mimoza.marmara.edu.tr/~avni/dersbelgeligi/dersbelgeyazilari/dboniki/3bediaakarsu.htm>
- Akbaş, O. (2004). *Türk Milli Eğitim Sisteminin Duygusal Amaçlarının (Değerlendirilmesi) İlköğretim II. kademedeki Gerçekleşme Derecesinin Değerlendirilmesi. Yayınlanmamış Doktora Tezi*. Ankara, Gazi Üniversitesi Eğitim Bilimleri Enstitüsü.
- Akdemir, A. (2004). Küreselleşme ve Kültürel Kimlik Sorunu. *Atatürk Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, 3(1). 43-50.
- Altıntaş, R. (2009). Toplumsal Ahlak Sorunu. *Yeni Ümit Dergisi*, sayı: 86, 59-61.
- Andoni. (2015.07.23). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Arıdağ, N. Ç. (2003). Kohlberg'in Bilişsel Ahlak Gelişimi Teorisi: Ahlak ve Demokrasi Eğitimi. *Değerler Eğitimi Dergisi*, 1(1), 43-77.
- Arıdağ, N. Ç., Yüksel, A. (2010). Üniversite Öğrencilerinin Ahlaki Yargı Yetenekleri ile Empati Becerileri Arasındaki İncelemesi. *Kuram ve Uygulamada Eğitim Bilimleri*, 10(2), 683-727.
- Aristote, T. W. (1999). *Nicomachen Ethics*. (Trans. W.D. Ross). Kitchener: Batoche Books.

- Arslan, H. (2010). Ahlakın Evrenselliği Açısından İslam ve Modernizm. *İstanbul Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 1(2). 41-60.
- Arslanoğlu, İ. (2005). Türk Değerleri Üzerine Bir Değerlendirme. *Felsefe Dünyası Dergisi*, sayı: 41, 64-77.
- Arslanoğlu, İ. (2012). *Sosyal Bilimlerde Metod ve Araştırma Teknikleri*. 11.15, 2014, nga [www.gazi.edu.tr: w3.gazi.edu.tr/~iarslan/arastek.doc](http://www.gazi.edu.tr/~iarslan/arastek.doc).
- Arslantürk, Z., Amman T. (2001). Sosyoloji. İstanbul: Çamlıca Yayınları.
- Aşıkoğlu, N. Y. (1997). *Kutsal ve Toplum, Cumhuriyet Demokrasi ve Kimlik Sempozyumu*, Ege Ü. Edebiyat Fak. İstanbul: Bağlam Yayıncılık.
- Atkinson, R. L. (1995). *Psikolojiye Giriş*. (Çev: M. Atakay). İstanbul: Sosyal Yayınları.
- Aydın, C. H. (2003). Benlik ve Kişilik. *Sızıntı Dergisi*, sayı: 294, 149.
- Aydın, M. (2003). *Gençliğin Dini ve Ahlaki Değerler, Gençlik Dönemi Eğitim Sempozyumu*. Bursa: Ensar Neşriyat.
- Aydın, M. (2011). Değerler İşlevleri ve Ahlak. *Eğitime Bakış Dergisi*, sayı: 19, 39-45.
- Aydın, M. Z. (2007). Eğitimci Gözüyle Çocuğun Eğitiminde Ailenin Önemi. *Hanımefendi*, sayı:4, 6-9.
- Aydın, M. Z. (2010). Okulda Çalışan Herkesin Görevi Olarak Değerler Eğitimi. *Değerler Eğitimi Buluşması*. Ankara: Ceceli Eğitim Kurumları.
- Aydın, M. Z. (2010). Okulda Değerler Eğitimi. *Eğitime Bakış Dergisi*, 6(18), 16-20.
- Bakır, K. (2006). Pragmatizm ve Eğitime Yansımaları. *KKEFD/JOKKEF*, sayı:14, 49-68.
- Bakır, K. (2008). Eğitimde Pragmatist Yapılandırmacılık ve Anlamın İnşası. *ODTÜ Felsefe Bölümü "Anlam" Kongresi*, 15-17.
- Bandura, A. (2001). Social Cognitive Theory of Mass Communication.

MEDIAPSYCHOLOGY, 3, 265–299.

Baramidze, M. (2001). *Karadeniz Ülkelerinde Göçmen İşçilerin Korunmasına Ait Hukuki Çerçeve ve Göçmen Toplulukları ile Ev Sahibi Ülke Arasındaki İlişkiler*.

Bakü: Karadeniz Ekonomik İşbirliği Parleментар Asamblesi.

Başaran, İ. E. (1991). *Eğitim Psikolojisi*. Ankara: Gül Yayınevi.

Bayer, A. (2013). Değişen Toplumsal Yapıda Aile. *Şırnak Üniversitesi İlahiyat Fakültesi* 2(8), 101-129.

Bayrakçı, M. (2007). Sosyal Öğrenme Kuramı ve Eğitimde Uygulaması. *Sakarya Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi*, sayı: 14, 198-210.

Bender, M. (2005). John Dewey'in Eğitime Bakışı Üzerine Yeni Bir Yorum. *Gazi Üniversitesi Kırşehir Eğitim Fakültesi Dergisi* 6(1), 13-19.

Benjamin, W. (2004). *Pasajlar*. (Çev. A. Cemal). İstanbul: Yapı Kredi Yayınları.

Bergson, H. T. (1935). *The Two Sources of Morality and Religion*. London: Macmillan and Co., Limited St. Martin' Street.

Bilgin, N. (1995). *Sosyal Psikolojide Yöntem ve Pratik Çalışmalar*. İstanbul: Sistem Yayıncılık.

Bilgin, N. (2007). *Kimlik İnşası*. Ankara: Aşina Kitaplar.

Binbaşıoğlu, C. (1992). *Eğitim Psikolojisi*. Ankara: Kadioğlu Matbaası.

Bruçaj, S. (2015.08. 04). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)

Butler, W. E. (1986). Kişilik.(Çev. C. Çiloğlu). Retrieved 12.5.2014, from Ezoterik ve Okült kaynaklar Sitesi: www.hermetics.org/kisilik.html

Büyük Larousse Sözlük ve Ansiklopedisi 6.cilt. (1986). İstanbul: Gelişim Yayınları.

Büyüköztürk, Ş. (2012). *Sosyal Bilimler İçin Veri Analizi El Kitabı*. Ankara: Pagem A Yayıncılık.

- Byrne, J. (1997). *Religion and the Enlightenment: From Descartes to Kant*. Louisville: Westminster John Knox Press.
- Cesur, S., Topçu, M. S. (2010). Değerlerin Belirlenmesi Testinin Güvenirlilik ve Geçerlik Çalışması ve Yaş, Eğitim, Cinsiyet ve Ebeveyn Eğitiminin Ahlaki Gelişimle İlişkisi. *Kuram ve Uygulamada Eğitim Bilimleri*, 10(3), 1657-1696.
- Ceylan, Y. (2004). Din ve Ahlak. *Doğu Batı*, sayı: 4, 79-86.
- Chomsky, N. (1965). *Aspect of the Theory of Syntax*. Cambridge MA: MIT Press.
- Chomsky, N. (1988). *Language and Problems of Knowledge The Managua Lectures*. Cambridge MA: MIT Press.
- Clouse, B. (2000). Ergenlerde Ahlak Gelişimi ve Cinsellik. (Çev: T. Gündüz). *Uludağ Üniversitesi İlahiyat Fakültesi* 9(9), 715-753.
- Cunbur, M. (1990). *Milli Kültür Unsurlarımız Üzerine Genel Görüşler*. Ankara: Atatürk Kültür Merkezi Yayınları /46.
- Çelik, H. (2012). Küreselleşme Sürecinde Kimlik Tartışmaları ve Medyanın Rolü: Kosova Örneği. *Global Media Jurnal*, 2 (4), 22-42.
- Çelikkaya, H. (1996). *Fonksiyonel Eğitim Sosyolojisi*. İstanbul: Alfa Yayınları.
- Çilingir, L. (2003). Kant'ta Mutluluk Ahlak İlişkisi. *Felsefe Logos*, 6(21). İstanbul: Bulut yayınları.
- Çilingir, L. (2014). Din mi? Ahlak mı? *International Journal of Science Culture and Sport : Special Issue* sayı:1, 711-720.
- Çinemre, S. (2013). Bir Ahlak Eğitmcisi Olarak Lawrence Kohlberg. *T.C. Uludağ Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 22(1), 143-164.
- Çırpan, H. (2007). Yönetimin Yapı Taşı: "Olgun" Birey. *Çerçeve Dergisi*, 103-107.
- Çubukçu, İ. A. (1972). İslamda Ahlak Meselesi. *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 20(1), 13-20.

- Demir, O. (2013). *İslam Ansiklopedisi Vicdan Maddesi*. İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı Yayın Matbaacılık.
- Demirel, Ö., Kaya. Z. (2009). *Eğitim Bilimlerine Giriş*. Ankara: Pagem A Akademi.
- Derek Wright and Mary Croxen, (1976). *Ahlak Yargısının Gelişimi*. (Çev.D.Öngen) London: Then Open University Press.
- Dervishi, L. (2015. 08. 01). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Dervishi, Z. (2003). *Vështrime të kryqëzuara në det*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Dervishi, Z. (2004. 03. 5). *Trepca.net*. Retrieved 04 04, 2015, from http://www.trepca.net/2004/03/040305_zd_shqiperia_tranzicion1.htm
- Dervishi, Z. (2015. 08. 02). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Dewey, J.(2008). *Okul ve Toplum*. (Çev. A. Başaran). Ankara: Pegem Akademi.
- Doğan, İ. (2000). *Sosyoloji Kavramlar ve Sorunlar*. İstanbul: Sistem Yayınları.
- Dubiski, N. (2001). *Electronic Journal of Sociology*. Retrieved from sociology.org: <http://www.sociology.org/archive.html>
- Durak, N. (2009). Küreselleşme Evrensel Bir Etik İmkânı Sağlar mı? *Süleyman Demirel Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2(23), 33-49.
- Durkheim, E. (1951). *Suicide A Study in Sociology*. Illionis: The Free Press.
- Ekşi, H. (2006). Bilişsel Ahlak Gelişimi Kuramı: Kohlberg ve Sonrası. *Abant İzzet Baysal Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi*, 6 (1), 29-38.
- Elkin, F. (1995). *Çocuk ve Toplum Çocuğun Toplumsallaşması*. (Çev. N. Güngör). Ankara: Gündoğan Yayınları.
- Erdem, H. (1990). Dini Ahlak ve İlahi Dinlerden Yahudilik, Hristiyanlık ve Müslümanlık'da ki Bazı Ahlaki Meselelere Mukayeseli Bir Yaklaşım. *S.Ü.İlahiyat Fakültesi Dergisi*, sayı: 3, 225-254.

- Erdem, H. (2003). *Ahlak Felsefesi*. Konya: Hü-Er Yayınları.
- Eren, S. (2007). Toplumal Norm Ahlak ve Din. *C.Ü. İlahiyat Fakültesi Dergisi*,XI(2), 289-316.
- Erikson, E. (1984). *İnsanın sekiz çağı*. (Çev. B.Üstün,V. Şar). Ankara: Toplum Yayınları.
- Erkılıç, T. A. (2009). Felsefi Akımlar ve Eğitim Felsefesi Akımları. A.Boyacı, *Eğitim Sosyolojisi ve Felsefesi* (f. 131-152). Eskişehir: Anadolu Üniversitesi Yayınları.
- Eroğlu, F. (1998). *Davranış Bilimleri*. İstanbul: Beta Yayınevi.
- Ersanlı, K. (2014). *Gelişim ve Öğrenme Psikolojisi*. Ankara: Pegem A Yayıncılık.
- Falk, R. (1999). Hans Küng's Crusade: Framing a Global Ethic. *International Journal of Politics and Society*, 13(1), 63-81.
- Fichter, J. (1990). *Sosyoloji nedir?*(Çev. N. Çelebi). Konya: Toplum Yayınları.
- Frankel, S. (2012). *Children, Morality and Society*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Freud, S. (2004). *Totem and Taboo*. London: Taylor and Francis e-Library.
- Freyer, V. H. (1956). Cihan Tarihinin Yeni İmajı. (Çev. N. Hızır). *Ankara Üniversitesi Dil Tarih-Coğrafya Fakültesi*.
- Fuga, A. (2008). *Brirët e dhisë*. Tiranë: Ora.
- Fuga, A. (2008). *Media, politika,shoqëria (1990-2000)*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Fuga, A. (2013). *Rënia e qytetit*. Tiranë: Papirus.
- Fukuyama, F. (1992). *Tarihin Sonu ve Son İnsan*.(Çev. Z. Dicleli). İstanbul: Simavi Yayınları.
- Gahramanova, K. (2012). Üniversite Eğitim Sürecinde Değerlerin Şekillenmesi. *Sosyal ve Beşeri Bilimler Dergisi*-4(2), 313-322.
- Giddens, A. (2000). *Sosyoloji*. Ankara: Ayraç Yayınevi.

- Gizir, C. A. (2005). Orta Doğu Teknik Üniversitesi Son Sınıf Öğrencilerinin Problemleri Üzerine Bir Çalışma. *Mersin Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi*, 1(2), 196-213.
- Gökberk, M. (2005). *Felsefe Tarihi*. İstanbul: Remzi Kitabevi.
- Göz, K. (2014). Toplumsal Değerler Bağlamında Yaşama Hürriyeti. *P.Ü. İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 1(1), 85-101.
- Gültekin, M. (2007). Yapılandırmacılık ve Öğretim Uygulamalarına Yansımaları. *Anadolu University Journal of Social Sciences* 7(2), 503-528.
- Günay, Ü. (2012). *Din Sosyolojisi*. İstanbul: İnsan Yayınları.
- Günçe, G. (1971). Jean Piaget ve Temel Kuramsal Fikirleri. *Ankara Üniversitesi Eğitim Bilimleri Fakültesi Dergisi* 4(1), 19-32.
- Güngör, E. (1993). *Değerler Psikolojisi*. Amsterdam: Hollanda Türk Akademisyenler Birliği Yayınları. No:8.
- Gürhan, C. (2002). *Gelişim ve Öğrenme Psikolojisi*. Ankara: Pagem A Yayıncılık.
- Haidt, J. (2001). The Emotional Dog and Its Rational tail. A Social Intuitionist Approach to Moral Judgment. *Psychological Review*, 108, 814-834.
- Heimsoeth H. (1978). *Ahlak Denen Bilmece*. (Çev. N. Uğur). İstanbul: İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Basımevi.
- Halstead, J. M. (2000). Learning and Teaching about Values: a Review of Recent Research. *Cambridge Journal of Education*, Vol. 30, No.2, , 169-202.
- Hançerlioğlu, O. (1993). *Felsefe Ansiklopedisi*. İstanbul: Remzi Kitabevi.
- Hançerlioğlu, O. (1993). *Toplum Bilimleri Sözlüğü*. İstanbul: Remzi Kitabevi.
- Haydon, G. (2007). *Values for Educational Leadership*. London: Sage Publications.
- Hökelekli, H. (2010). Modern Eğitimde Yeni Bir Paradigma: Değerler Eğitimi. *Eğitime Bakış Dergisi*, sayı:18, 4-10.

- İnam, A. (1999). Halsiz Kalmış bir Ahlakın Cehenneminde: Ahlakı Hak Saklasın Bir Yarım Var İçimde. *Doğu-Batı Dergisi*, sayı: 4, 67-78.
- Inwood, M. (1992). *A Hegel Dictionary*. (Çev. C. Çuhadar). Oxford: Blackwell Puplishers.
- Kaçuradi, İ. (1995). Felsefi Açıdan Eğitim ve Türkiye'de Eğitim. İstanbul 17-18 Kasım: Türkiye Felsefe Kurumu.
- Kağıtçıbaşı, Ç. (2004). *Yeni İnsan ve İnsanlar*. İstanbul: Evrim Yayınevi.
- Kağıtçıbaşı, Ç. dhe M.Ersin Kuşdil. (2000). Türk Öğretmenlerinin Değer Yönelimleri ve Schwartz Değer Kuramı. *TürkPsikoloji Dergisi* 15 (45), 59-76.
- Karatay, H. (2011). Karakter Eğitiminde Edebi Eserlerin Kullanımı. *Turkish Studies,- International Periodical For The Languages, Literature and History of Turkish or Turkic*, 6(1), 1398-1412.
- Kaya, M. (1993). *Yüksek Öğretim Kurulu Başkanlığı Tez Merkezi*. 10 15, 2013, <https://tez.yok.gov.tr/UlusalTezMerkezi/tezSorguSonucYeni.jsp>
- Kaya, M. (1995). Çağlar-üstü Bir Değer Olarak Ahlak. *İslami Sosyal Bilimler Dergisi*. 3(3), 123-128.
- Kaya, M. (1997). Ailede Anne-Baba Tutumlarının Çocuğun Kişilik ve Benlik Gelişimindeki Rolü. *Ondokuz Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 9(9), 193-204.
- Kaya, M. (2009). Beyin Göçü/Entellektüel Sermaye Erozyonu. *Eğitime Bakış Dergisi*, sayı: 13, 14-29.
- Kaymakcan, R., Meydan, H. (2012). Ahlaki Karakter ve Eğitimi. II. Uluslararası Değerler ve Eğitimi Sempozyumu. İstanbul. İstanbul Değerler Eğitimi Merkezi.
- Kenan, S. (2009). Modern Eğitimde Kaybolan Nokta:Değerler Eğitimi. *Kuram ve Uygulamada Eğitim Bilimleri*, 9(1), 259-295.

- Kılavuz, İ. G. (2011). Erikson'un Psiko-Sosyal Gelişim Dönemleri Teorisi Açısından Kuşaklararası Din Eğitimi ve İletişimin Önemi. *Uludağ Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 20(2), 153-166.
- Kılıç, M. (2011). Değerler Filozofisi ve Hukusal Değerler. *Eğitim-Bir-Sen*, 7/(19), 51-54.
- Kılıç, T. (2013). Bireysel ve Kollektif Yeterlilik Süreci, Belirleyicileri ve Sonuçlarına İlişkin bir Model Önerisi (Doktora Tezi). *Balıkesir Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü İşletme Anabilim Dalı*.
- Kılıçgün, M. Y. (2013). Erken Çocukluk Eğitimi Ders Notları. 1-50.
- Kızılçelik, S. Y. (1996). *Açıklamalı Sosyoloji Terimler Sözlüğü*. İzmir: Saray Yayınları.
- Kodalak, A. C. ve Yağmurlu, B. (2010). *Ebeveynlik ve Okul Öncesi Dönemde Çocuğun Sosyal Gelişimi.T. Solmuş (Ed.), Romantik İlişkiler,Evlilik ve Ana-Baba-Çocuk İlişkileri İçinde*.Ankara: Nobel Yayınları.
- Kohlberg, L. (1963). *The Development of Children's Orientations Toward a Moral Order:Sequence in The Development of Moral Thought*. Vita Humana 6: 11-33.
- Kohlberg, L. (1966). Moral Education in The Schools: A Developmental View. *The School Review* 71(1), 1-30.
- Kohlberg, L. (1968). The Child as a Moral Philosopher. *Psychology Today* vol.2 no.4, 24-30.
- Kohlberg, L., Hersh, R. H. (1977). Moral Development: A Review of The Theory.Theory into Practice 16/12. *Moral Development*, 53-59.
- Korkmaz, A. (2013). Değerler Sosyolojisi. *Toplum Bilimleri Dergisi*, 7 (14).
- Korkmaz, F. (2015). Retrieved 04 15, 2015, from <http://atauzem.atauni.edu.tr/dosya/ortak/materyal/Hukukun%20Temel%20Kavramlar%C4%B1-%C3%9Cnite%201.pdf>
- Kozak, İ. (1984). *İbn. Haldun'a Göre İnsan Toplum İktisat*. İstanbul: Pınar Yayınları.

- Köknel, Ö. (1982). *Kaygıdan Mutluluga Kisilik*. İstanbul: Altın Kitaplar Yainevi.
- Köknel, Ö. (2007). *Çatışan Değerlerimiz*. İstanbul: Altın Kitaplar.
- Köse, A. (1997). *Neden İslamı Seçiyorlar*. İstanbul: İsam Yayınları.
- Köylü, M. (2010). Küresel Bağlamda Değerler eğitime Duyulan İhtiyaç ve Batı Dünyasında Din Eğitimi Teorileri. *Eğitim Öğretim ve Bilim Araştırma Dergisi*, 19(10), 20-27.
- Lickona, T. (1992). *Education for Character, How Our Schools Can Teach Respect and Responsibility*. New York: Bantam Books.
- Mahiroğulları, A. (2005). Küreselleşmenin Kültürel Değerler Üzerine Etkisi. *Sosyal Siyaset Konferansları Dergisi*, sayı: 50, 1275-1288.
- Martin, R. M., Shafko, M. and Van Deirse, W. (1977). *The Reliability, Validity, and Design of The Defining Issues Test*. *Developmental Psychology*. 13(5), 460-468.
- McKay, R. &. (2014, December 22). Retrieved 05. 26. 2015, [https://www.icea.ox.ac.uk/fileadmin/ICEA/ICEA_publication_pdfs/McKay_and whit_eho use Religion and Morality.pdf](https://www.icea.ox.ac.uk/fileadmin/ICEA/ICEA_publication_pdfs/McKay_and_whit_eho_use_Religion_and_Morality.pdf)
- Mema, B. (2015.07. 21). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Ministria e Drejtësisë. (2013). *Ministria e Drejtësisë*. Retrieved Maj 15, 2015, from <http://www.drejtësia.gov.al/al/dokumente/statistika>
- Morris, C. (1956). *Varieties of Human Value*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Mustafaj, B. (2015. 08. 19). Intervist. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Narvaez, D. (2005). The Neo-Kohlbergian Tradition and Beyond: Schemas, Expertise and Character. In C. Pope-Edwards and G. Carlo (Eds.). *Nebraska Symposium on Motivation, Moral Motivation Through The Lifespan*, vol.51, 119-163.
- Oakley, L. (2004). *Cognitive Development*. UK: Taylor and Francis e-Library.
- Okumuş, E. (2010). Toplum ve Ahlak Eğitimi. *Eğitime Bakış Dergisi*, sayı: 18, 28-32.

- Onur, B. (1979). Ahlak Eğitiminin Psikolojik Temelleri. *Ankara Üniversitesi Eğitim Bilimleri Fakültesi Dergisi*, 12(1), 1-12.
- Onur, B. (2000). *Gelişim Psikolojisi*. Ankara: İmge Kitabevi.
- Özdemir, C. (2001). Kimlik ve Söylem. *Osman Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Dergisi*: sayı: 2, 107-122.
- Özen, Y. (2011). Etik mi? Ahlak mı? Modernite mi? Medeniyet mi? *Dicle Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, 3(5), 63-87.
- Özen, Y. (2011). Kendilik Psikolojisine Bir Yapıbozumsal Girişim. *Erzincan Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, IV(1), 201-216.
- Özen, Y. (2012). Değerlerin Kişilik ve Kimlik Kazanımındaki Rolü. *İnsan ve Toplum Bilimleri Araştırmaları Dergisi Journal of the Human and Social Science Researches*, 1(4), 167-181.
- Özen, Y. (2013). Sorumluluk Duygusu Ölçeğinin Geliştirilmesi; Geçerlik ve Güvenirliği. *JEE*, 3(2), 343-357.
- Özer, M. (2005). Etkin Öğrenmede Yeni Arayışlar: İşbirliğine Dayalı Öğrenme ve Buluş Yoluyla Öğrenme. *"Bilig" Türk Dünyası Sosyal Bilimler Araştırması*-35, 105-131.
- Özeri, Z. (2004). *Okul Öncesi Din ve Ahlak Eğitimi*. İstanbul: DEM Yayınevi.
- Özlem, D. (2004). *Etik-Ahlak Felsefesi*. İstanbul: İnkılap Kitabevi.
- Öztürk, O. (2006). *Ahlak Olgusunun Kaynağı Nedir?* Retrieved Qershör 19, 2014, from Köprü Dergisi:
<http://www.koprudergisi.com/index.asp?Bolum=EskiSayilar&Goster=Yazi&YaziNo=793>
- Peker, H. (1994). *Çocuk ve Suç*. İstanbul: Çocuk Vakfı Yayınları.
- Pieper, A. (1999). *Etiğe Giriş*. (Çev. V. Atayaman, G. Sezer). İstanbul: Ayrıntı Yayınları.

- Poyraz, H. (1997). Hare Etiğinde Evrenselliğe Geçiş Yolları. *Felsefe Dünyası*, sayı: 23,145-155.
- Poyraz, H. (2011). Değerlerin Kuruluşu ve Yapısı. *Kalem Eğitim ve İnsan Bilimleri Dergisi*, 1(1), 61-71.
- Puckett, M. B. (2003). *Teaching Young Children: An Introduction to The Early Childhood Profession (2nd ed.)*. NY: Thomson.
- Reboul, O. (1995). Değerlerimiz Evrensel midir? (Çev. H. İzgar). *Eğitim Yönetimi*, 1(3), 363-374.
- Rest, J. (1979). *Development in Judging Moral Issues*. Minnesota: Minnesota Press.
- Rest, J. (1986). *Manual For The Defining Issues Test. Third Edition 8(90), Revision*. Minneapolis: University of Minnesota(Center For The Study Of Ethical Development).
- Rokeach, M. (1973). *The Nature of Human Values*. NY: The Free Press.
- Rotter, J. (1966). Generalized Expectancies For Internal Versus External Control of Reinforcements. *Psychological Monographs: General and Applied* 80(1), 1-28.
- Rutledge, K. (2000). *Social Learning Theory*. Retrieved Janar 13, 2004, from <http://teachnet.edb.utexas.edu/lynda_abbott/Social.html>
- Santrock, J.W. (2001). *Gençlerde Ahlaki Gelişim Değerler ve Din*. (Çev. S. Arslan) Retrieved 02 15, 2015, from <http://www.kemalsayar.com/KatagoriDetay-Genclerde-ahlaki-gelisim,-degerler-ve-din-67.html>
- Serin, N. B., Öztürk, S. (2007). Anne-Babası Boşanmış 9-13 Yaşlarındaki Çocuklar ile Aynı Yaş Grubundaki Anne-Babası Boşanmamış Çocukların Benlik Saygısı ve Saygı Düzeyleri. *Ahi Evran Üniversitesi Kırşehir Eğitim Fakültesi Dergisi Cilt 8, Sayı 2*, 117-128.
- Sezen, Y. (1988). *Sosyoloji Açısından Din*. İstanbul: Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları.

- Simmel, G. E. (2004). *The Philosophy of Money*. (Trans. T. Bottomore and D. Frisby) London: Routledge.
- Sinani, G. (2015, 08 22). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Sızıntı. (1983). İrade. *Sizinti Dergisi*, sayı: 57.
- Skinner, B.F. (1976). "A Case History in Scientific Method" *Psychological Research: The Inside Story*. New York: Harper and Row.
- Smelser, N. J. (1965). *Theory Collective Behavior*. New York: The Free Press of clencoe.
- Sotirofski, K., Zenelaga, B. (2011). The `Brain Gain Hypotheses` of Transition Countries Elites and Socioeconomic Development in Their Home Country (Albanian Emigrants in Italy sample). *International Conference on "Human Capital and Employment in the European and Mediterranean Area"*, 1-10.
- Sotirofski, K., Zenelaga, B. (2009). Arsimi i Larte Perballë Sistemit Vleror. *Studime Sociale*, 3(1), 79-86.
- Stangroom, J. (2011). *Büyük Fikirlerin Küçük Kitapları: Felsefe*. (Çev. F.Uslu). Ankara: Liman Kitapları.
- Şengün, M. (2007). Ahlak Gelişimin Psiko-Sosyal Dinamikleri. *Ondokuz Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, sayı: 23, 201-221.
- Şentürk, H. (2009). Küreselleşme Çağında İnsan, Din ve Medeniyet Kavramlarına Psikososyal Açıdan Bir Bakış. *Süleyman Demirel Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2(23), 103-119.
- Şentürk, H. (2010). Kişilik Gelişiminde Eğitim, Din ve Değerlerin Rölü. *Eğitime Bakış-Eğitim Öğretim ve Bilim Araştırma Dergisi Yıl:6, sayı:18*, 50-54.
- Şişman, M. (1994). *Örgüt Kültürü*. Eskişehir: Anadolu Üniversitesi Yayınları.
- T. C Milli Eğitim, B. (2014). *Çocuk Gelişimi ve Eğitimi*. Ankara: T. C, Milli Eğitim Bakanlığı.

- T. C. Milli Eğitim, B. (2007). *Çocuk gelişimi ve Eğitimi (Ahlak Gelişimi)*. Ankara: T. C. Milli Eğitim Bakanlığı.
- T. C. Milli Eğitim, B. (2009). *Çocuk Gelişimi ve Eğitimi*. Ankara: T. C. Milli Eğitim Bakanlığı.
- T. C. Milli Eğitim, B. (2013). *Çocuk Gelişimi ve Eğitimi, Ahlak Eğitimi*. Ankara: T. C. Milli Eğitim Bakanlığı.
- Tanhan, F. (2011). Çocuk Eğitiminde Anne-Baba Tutumlarının Yeri. *Hayret/1*, 5-8.
- Tansel, A., Güngör, N. D. (2004). Türkiye'den Yurt Dışına Beyin Göçü: Ampirik Bir Uygulama. *Economic Research Center, Working Paper in Economic*, sayı:2, 1-12.
- Taslaman, C. (2014). *Ahlak Felsefe ve Allah*. İstanbul: İstanbul Yayınevi.
- Taşöz, E. (2012). İnsan ve Ahlak İlişkisi. *Ahlak Bilmi Ders Notları, Eğitim Amaçlı Tematik Derleme*, 1-41.
- Tavlan, S., Peters, W. (1952). *Psikolog ve Filozof Olarak John Dewey*. İstanbul: Pulhan Matbaası.
- Taylı, A. E. (2013). *Eğitim Psikolojisi*. İstanbul: Pagem Akademi.
- Tezcan, M. (1985). *Eğitim Sosyolojisi*. Ankara: Ankara Üniversitesi Eğitim Bilimleri Yayınları.
- Theodorson, G. A. (1979). *A Modern Dictionary of Sociology*. New York: Barners and Nobel .
- Topçuoğlu, A. (. (2010). *Türkiyede Aile Değerleri Araştırması*. Ankara: Başbakanlık Basımevi.
- Tozlu, N. (1997). Şahsiyet, Sorumluluk ve Görev Bilinci. *Felsefe Dünyası*, sayı: 23, 22-27.
- Turan, İ. (2013). Gençlik Döneminde Görülen Ahlaki Sorunlar Karşısında Din Kültürü ve Ahlak Bilgisi Dersinin Yeri. *Atatürk Üniversitesi İlahiyat Fakültesi*, sayı: 40, 271-293.

- Tushi, G. (2015.07. 22). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Tuzcuoğlu, N. (1995). Psikanaliz Kuramı ve Özellikleri. *M.Ü.Atatürk Eğitim Fakültesi Eğitim Bilimleri Dergisi*, sayı: 7, 275-285.
- Türgülü, M. (1968). Ahlakın Kaynağı Tartışmaları ve Ortaya çıkan Ahlak Telakkileri. *F.Ü.İlahiyat Fakültesi Dergisi*, sayı: 3, 291-311.
- Usta, A. (2011). Kuramdan Uygulamaya Kamu Yönetiminde Etik ve Ahlak. *Kahramanmaraş Sütçü İmam Üniversitesi İktisadi İdari Bilimler Fakültesi Dergisi*, 1(2), 39-50.
- Uysal, E. (2003). Değerler Üzerine Bazı Düşünceler ve Bir erdem Tasnifi: İnsani Erdemler-İslami Erdemler. *Uludağ Üniversitesi İlahiyat Fakültesi*, 12(1), 51-69.
- Uysal, E. (2005). Dindarlığın Ahlaki Temeli Üzerine Bazı Düşünceler. *Uludağ Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi* 1(14), 41-59.
- Walsh, C. (2000). The Life and Legacy of Lawrence Kohlberg. *Academic Research Library*, 36-41.
- Weil, E. (2014). *Encyclopedia Universalis*. Retrieved 12 05, 2014, from <http://www.universalis.fr/encyclopedie/morale/>
- Xhaferaj, F. (2015. 07. 25). Vlerat. (F. U. Bağcı, Interviewer)
- Yazıcı, M. (2013). Toplumsal Değişim ve Sosyal Değerler. *Turkish Studies*, 8(8), 1489-1501.
- Z. Fulya Temel, A. B. Aksoy. (2001). *Ergen ve Gelişimi*. Ankara: Nobel Yayın Dağıtım.